

PROCESI I RREGULLT LIGJOR NË PRAKTIKËN
E GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË

ARTA VORPSI

Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



MALUKA

Recensues: Prof. Dr. **Aurela Anastasi**
Prof. Dr. **Xhezair Zaganjori**
Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë,
Departamenti i së Drejtës Publike

Arti grafik **Kleida Maluka**

Copyright © Fondacioni Konrad Adenauer
Botime Maluka, Tiranë 2011

ISBN



Konrad
Adenauer
Stiftung

Fondacioni Konrad Adenauer

Tiergartenstrasse 35
D-10785 Berlin
Germany
Tel: +49 30 269 96 453
Fax: +49 30 269 96 555
website www.kas.de

Rule of Law Program South East Europe

Konrad Adenauer Stiftung e.V
50 Plantelor Street
Sector 2
RO-023975 Bucharest
Romania
Tel: +40 21 323 31 26
Fax: + 40 21 326 0407
e-mail: office.rspsoe@kas.ro
website: www.kas.de/rspsoe

Pasqyra e lëndës

PARATHËNIE	9
HYRJE	13
I. ANKIMI INDIVIDUAL KUSHTETUES DHE PROCESI I RREGULLT LIGJOR	17
1. Vështrim i përgjithshëm krahasimor	
mbi ankimin individual kushtetues	20
1.1 Ankimi real	24
1.2 Ankimi joreal	33
1.3 Ankimi popullor.....	39
2. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas GJL amerikane	44
2.1 Aspekti substancial	45
2.2 Aspekti procedural	48
3. Kuptimi i procesit të rregullt sipas GJEDNJ.....	50
II. KUPTIMI I PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR SIPAS GJK SHQIPTARE	63
1. Ankimi individual kushtetues sipas DKK	64
2. Ankimi individual kushtetues aktual.....	70

3. Kushtet formale për t'iu drejtuar GJK për proces të parregullt ligjor	78
3.1 Legjitimimi.....	78
3.1.1 Subjektet kërkuese	79
3.1.2 Afati kohor.....	87
3.1.3 Shtërimi i mjeteve juridike.....	88
3.2 Juridiksioni i GJK.....	97
4. Elementët e procesit të rregullt ligjor sipas GJK shqiptare....	101
4.1 Prezumimi i pafajësisë.....	101
4.2 Mosdënimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër	111
4.3 E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë).....	117
4.4 E drejta për t'iu dëgjuar publikisht nga një gjykatë	137
4.4.1 e pavarur dhe e paanshme.....	140
4.4.2 e caktuar me ligj.....	153
4.5 E drejta për t'iu njohur me akuzën/padinë/ rekursin dhe aktet e dosjes.....	158
4.6 E drejta për t'iu mbrojtur.....	161
4.6.1 E drejta për t'iu mbrojtur me avokat të zgjedhur ose të caktuar nga gjykata	163
4.6.2 E drejta për t'iu mbrojtur vetë	171
4.6.3 Gjykimi në mungesë.....	175
4.7 Barazia e armëve (kontradiktoriteti)	183
4.7.1 E drejta për të thirrur dhe pyetur dëshmitarë/ekspertë; për të paraqitur dhe kundërshtuar provat e paraqitura; për të (mos)bërë deklarime.....	184
4.7.2 Kontradiktoriteti në çështjet civile	192
4.8 E drejta e ankimit	199
4.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.....	217
4.10 Siguria juridike në vendimet gjyqësore	234

III. GJEDNJ PËR GJK SHQIPTARE – NEVOJA PËR PËRMIRËSIM.....	243
1. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm	248
1.1 Praktika e GJEDNJ mbi kompetencën e GJK	248
1.2 Propozim për përmirësim	251
2. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë ...	251
2.1 Praktika e GJEDNJ mbi kompetencën e GJK	251
3. Propozim për përmirësim	255
4. Siguria juridike në vendimet gjyqësore	255
4.1 Praktika e GJEDNJ për kompetencën e GJK.....	255
4.2 Propozime për përmirësim	259
IV. PËRFUNDIME.....	261
V. PASQYRË STATISTIKORE MBI VENDIMARRJEN E GJK 1999-2011.....	264
VI. LISTA E SHKURTIMEVE	265
VII. BIBLIOGRAFIA.....	267
VIII. INDEKS ALFABETIK	279

ARTA VORPSI

PARATHËNIE

Ky botim i posaçëm mbi praktikën gati 20 vjeçare të GJK shqiptare lidhur me shqyrtimin e kërkesave individuale për proces të parregullt ligjor ka për qëllim të prezantojë një pasqyrë sa më të plotë të evoluimit të jurisprudencës në këtë drejtim. Ideja për këtë botim mori shkas nga vëmendja gjithnjë e në rritje që ka fituar vitet e fundit ankimi individual kushtetues në Shqipëri, i cili mund të konsiderohet si kompetenca kryesore e GJK shqiptare. Gjithashtu, një vështrim i përgjithshëm i zhvillimit të jurisprudencës së GJK në këtë drejtim deri më sot mungonte. Kjo ide u mbështet financiarisht nga Fondacioni Gjerman "Konrad Adenauer", Projekti për Shtetin e së Drejtës në vendet e Europës Juglindore, me qendër në Bukuresht, Rumani. Ky program ka mbështetur gjithashtu edhe botimin me vendime të përzgjedhura të GJKF gjermane, i cili u mirëprit me shumë interes në rrethin juridik shqiptar.

Në këtë botim do të gjejë pasqyrim praktika e GJK që prej viteve të para të krijimit të saj, për aq sa lidhet me elementët e procesit të rregullt, deri në vendimet më të fundit të saj të vitit 2011. Botimi është konceptuar i ndarë në këto kapituj kryesorë: kapitulli i parë i dedikohet prezantimit krahasimor të konceptit të procesit të rregullt në rende të ndryshme ose të ngjashme juridike si ai kontinental, anglosakson (konkretisht amerikan) dhe atij të parashikuar nga KEDNJ. Kjo është bërë me qëllim për të patur një kuptim më të qartë dhe të plotë mbi shkaqet historike, por jo vetëm, të formulimit të kompetencës aktuale të GJK shqiptare për shqyrtimin e kërkesave për një proces të rregullt ligjor nga Kushtetuta jonë, por edhe për

të bërë një krahasim midis tipeve të ndryshme ose të ngjashme të kontrollit mbi bazën e ankimeve kushtetuese individuale.

Më tej, një kapitull më vete i është kushtuar hapësirës së GJK shqiptare sipas DKK dhe më pas sipas Kushtetutës në fuqi, kur ushtron kontroll mbi aktet individuale të pushtetit, kur pretendohet cenimi i procesit të rregullt ligjor duke u ndalur tek risitë që ka sjellë kjo praktikë në vite. Në këtë kapitull paraqiten gjithashtu edhe kushtet formale që duhet të plotësohen për t'iu drejtuar GJK lidhur me kërkesat për një proces të rregullt ligjor si dhe me juridiksionin e GJK për t'i shqyrtuar ato. Më tej, vazhdohet me elementët e veçantë të procesit të rregullt siç janë trajtuar nga vetë GJK në praktikë të vazhdueshme.

Paraqitja e pjesës arsyetuese të vendimeve të GJK ashtu siç është shprehur ajo në vendimet e saj, është bërë kryesisht e përmbledhur shkurt por në ligjëratë të drejtë, me qëllim që të mos lihet vend për keqkuptime ose kuptim të ndryshëm nga lexuesit. Ky i fundit, ka të drejtën t'i interpretojë vetë ato, pasi t'i ketë lexuar, ashtu siç i ka shpallur vetë GJK. Në disa raste, vendimet janë pasqyruar më përfshirëse për shkak të kompleksitetit të çështjes, rrethanat e së cilës nëse nuk do të paraqiteshin, do ta bënin të mangët prezantimin e vendimit të GJK dhe gjithashtu do të ndikonin negativisht edhe në kuptimin e tyre. Gjithsesi, në çdo rast lexuesi për krahasim ose lexim më të plotë mund t'i drejtohet tekstit origjinal të plotë të vendimeve të GJK të botuara në përmbledhjet e saj në vite ose në web faqen e GJK.

Më tej, një kapitull i veçantë i kushtohet edhe qëndrimit të GJEDNJ lidhur me hapësirën e kontrollit të GJK në çështje të veçanta dhe orientimeve që ajo ka dhënë për këtë qëllim. Ky kapitull pasqyron gjithashtu edhe rastet e ndryshimit të praktikës së GJK kur kjo është shtruar si e nevojshme nga GJEDNJ por edhe raste kur GJK ende nuk ka mbajtur një qëndrim konkret. Pas kësaj paraqitje, autorja ka marrë guximin për të paraqitur edhe disa mendime personale lidhur me nevojën për ndryshime ligjore ose praktike të GJK me qëllim rritjen e standartit të mbrojtjes së të drejtave të individit në rrugën e procesit të rregullt ligjor.

PROCESI I RREGULLT LIGJOR

Në këtë botim do të gjeni edhe një pasqyrë të përmbledhur statistikore, e cila paraqet numrin e përgjithshëm të çështjeve në vite me objekt procesin e rregullt ligjor dhe numrin e kërkesave që kanë patur sukses në GJK për të krijuar kështu një ide lidhur me rritjen e efektivitetit të vendimmarrjes së GJK dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek publiku.

ARTA VORPSI

HYRJJE

Procesi i rregullt ligjor nuk është thjesht vetëm një e drejtë. Ai sot trajtohet më shumë si një parim kushtetues që shtrihet ndaj disa të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai ka si funksion dhe qëllim mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet e paligjshme të autoriteteve publike. Për ta bërë sa më efikase këtë mbrojtje, ligjvënësi kushtetues ka parashikuar edhe një mjet juridik të kontrollit ndaj këtyre akteve. Modeli i zgjedhur për këtë qëllim është i ndryshëm, por ata i bashkon qëllim i krijimit të tyre. Në disa vende ai ushtrohet nga gjykatat e zakonshme, në disa vende nga gjykata të posaçme të ashtuquajtuara edhe gjykata të të drejtave të njeriut. Të tilla mund të konsiderohen edhe gjykatat kushtetuese, të cilat i gjejmë të pëhapura gjerësisht në Europë e më pak në kontinente të tjera.

Kontrulli që ushtron gjykata kushtetuese, kur individi pretendon cenimin e këtij parimi, i cili shfaqet edhe në formën e një të drejte themelore në vetëvete, bëhet i mundur nëpërmjet ankimit individual kushtetues. Ky mekanizëm mund të parashikohet në formë dhe hapësirë të ndryshme, sipas kontekstit social-historik të një vendi. Ai mund të drejtohet kundër akteve të gjyqësorit, të ekzekutivit ose të ligjvënësit. Për sa kohë ai ofron mbrojtje efektive, funksioni i tij konsiderohet i realizuar. Kështu p.sh në vende me një sistem gjyqësor të konsoliduar mund të mos shihet më i nevojshëm parashikimi i ankimit kushtetues ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme.¹ Ndërsa në disa vende të tjera, ku vendimmarrja e gjyqësorit është

¹ *Andreas Vosskuhle*, në: von Mangold/Klein/Starck, Das Bonner Grundgesetz-kommentar (2001), neni 93, pika 166.

larg të qenit në përputhje me standartet e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm, mungesa e këtij ankimi do të ishte një e metë që do të rëndonte standartin e jetesës së individit në një shoqëri demokratike.²

Sot në vendet që e njohin kontrollin kushtetues, ky nuk mund të kuptohet pa ankimin kushtetues individual dhe në veçanti pa kontrollin ndaj akteve të gjyqësorit. Krahas nevojës për ekzistencën e këtij ankimi ka dhe qëndrime që shkojnë drejt idesë se kontrolli i akteve individuale dhe sidomos i vendimeve të gjykatave i duhet lënë vetëm pushtetit gjyqësor, pasi funksioni i tij kryesor është ruajtja e shtetit të së drejtës dhe bashkë me to edhe i të drejtave të njeriut. Qëllimi i krijimit dhe funksionimit të gjykatave të zakonshme është pikërisht rivendosja e të drejtave të shkelura të individit nga veprimet e paligjshme të administratës dhe për këtë shkak shkeljet, qoftë edhe të vetë gjykatave, duhen riparuar brenda sistemit. Sipas këtij qëndrimi, kontrollit kushtetues duhet t'i nënshtrohen vetëm akte të veçanta (normative) që nuk mund t'i kontrollojnë gjykatat. Nga pikëpamja praktike, kjo mund të sjellë dhe një lehtësim të punës së gjykatave kushtetuese, të cilat do të shkarkoheshin nga një numër i madh çështjesh. Megjithatë, pavarësisht diskutimeve, ajo që vihet re sot është se edhe në vendet që nuk e kanë patur të parashikuar këtë lloj ankimi, ai po përfshihet në kompetencat e gjykatave kushtetuese. Kështu, vende si Turqia, Bullgaria etj kanë ndryshuar Kushtetutat e tyre me qëllim përfshirjen e ankimit individual kushtetues duke përfshirë edhe kundërshtimin e vendimeve gjyqësore.

Përse paraqet rëndësi respektimi i procesit të rregullt ligjor? Për të dhënë një përgjigje të shkurtër dhe sa më të saktë, mjafton t'i drejtohemini nenit 42 të Kushtetutës, i cili parashikon se "liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor." Kjo dispozitë, e cila i ngjan për nga formulimi nenit 5 dhe 14 të Kushtetutës së SHBA-ve, detyron të gjitha organet e pushtetit publik të respektojnë lirinë, të drejtën e pronës dhe të drejta të tjera. Së dyti, nëse aktet e pushtetit publik do

² Vend tipik është Shqipëria. Po të shihen statistikat e GJK, numri më i madh i kërkesave të pranuar i referohet vendimeve gjyqësore që vijnë për herë e në rritje.

të ndërhyjnë duke i kufizuar këto të drejta dhe liri, atëherë ato në çdo rast duhet ta bëjnë këtë duke respektuar procesin e rregullt ligjor. Por ç'do të thotë proces i rregullt ligjor? Deri ku shtrihet mbrojtja e tij? Ndaj cilave akte mund ta mbrojë individin ky parim? Cili është rrethi i subjekteve që mbrohen prej tij? Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe të tjera të përafërta me to i gjejmë tek praktika mjaft e pasur e GJK shqiptare, të cilën e sjell të përmbledhur ky botim.

Të drejtat e njeriut nuk janë asnjëherë plotësisht dhe tërësisht të mbrojtura. Detyrimi që kanë institucionet shtetërore për t'i respektuar ato nuk nënkupton patjetër dhe në çdo rast garantimin e tyre. Për këtë arsye, paraqet rëndësi mjeti material dhe procedural i parashikuar në legjislacionin e një vendi me qëllim mbrojtjen gjyqësore të të drejtave themelore, kur individit nuk i ka mbetur rrugë tjetër për t'i gëzuar ato. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në çdo fazë të gjykimit të zakonshëm, sepse edhe gjykatat janë të detyruara të zbatojnë dhe të respektojnë të drejtat e njeriut.³ Nëse brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor nuk është i mundur riparimi i shkeljes së të drejtës, individit i mbetet edhe një mundësi tjetër efektive: t'i drejtohet me një mjet të veçantë ankimi një institucioni tjetër, konkretisht gjykatës kushtetuese. Kjo e fundit, duke ushtruar kompetencat e saj të njohura nga Kushtetuta do të shqyrtojë nëse ndodhet para ndonjë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore dhe nëse përgjigja është pozitive, ajo do të konstatojë se cili organ është përgjegjës për shkeljen dhe se cila është mënyra më e mirë për riparimin e shkeljes. Pas këtij vendimi, organet kompetente janë të detyruara ta zbatojnë atë, sipas rekomandimeve dhe argumenteve të gjykatës kushtetuese. Për këtë arsye, ankimi individual kushtetues sot konsiderohet si efektiv dhe vetë gjykata kushtetuese, si e tillë, konsiderohet si gjykatë e të drejtave të njeriut.

Ankimi individual kushtetues paraqet rëndësi pasi mbart në vetëvete disa funksione: *Së pari*, nëpërmjet ankimit individual bëhet i mundur konkretizimi dhe efektiviteti i të drejtave themelore. Kontrolli që ushtrohet nga gjykata kushtetuese në këto raste ka efekt të menjëhershëm dhe direkt tek individët që e vënë atë në lëvizje.

³ Neni 15/2 i Kushtetutës.

Së dyti, mund të thuhet pa hezitim se vendimmarrja e gjykatës kushtetuese ka edhe karakter edukativ për institucionet e pushtetit publik. Nëpërmjet vendimeve të saj, analizave dhe interpretimeve të parimeve kushtetuese, nëpërmjet argumenteve të përdoruar dhe standardeve të larta të vendosura prej saj, organet e pushtetit publik janë të detyruara t'i marrin parasysh ato dhe gjatë procesit të hartimit të akteve të eliminojnë sa më shumë përmbajtje të tillë që mund të çojë në cenimin e të drejtave dhe lirive të individit. *Së treti*, një funksion tjetër i ankimit kushtetues, i cili përfshin shumë më tepër se riparimin e shkeljes së të drejtës, është ruajtja dhe garantimi i të drejtës kushtetuese materiale dhe nëpërmjet interpretimit përfundimtar të saj kujdeset për zhvillimin e mëtejshëm të doktrinës kushtetuese. E thënë në këtë mënyrë, ankimi individual kushtetues është një mjet juridik mbrojtës i posaçëm i së drejtës kushtetuese materiale.⁴ Nëse do të pranojmë se të drejtat dhe liritë themelore janë zemra e Kushtetutës, atëherë nuk do të kishte kuptim të mungonte mekanizmi juridik mbrojtës, i cili, duke garantuar të drejtat dhe liritë mbron posaçërisht Kushtetutën dhe si i tillë është pjesë e qenësishme e integritetit kushtetues të çdo sistemi.

Për këto arsye, praktika e GJK shqiptare është për t'u parë në disa plane: (1) në efektin që ka patur kundrejt individëve që e kanë vënë në lëvizje; (2) në drejtim të përmirësimit të vendimmarrjes së administratës publike; (3) në drejtim të mbrojtjes së rendit kushtetues në tërësi; (4) në drejtim të zhvillimit të doktrinës kushtetuese, e cila, megjithë zhvillimet e viteve të fundit falë edhe jurisprudencës së GJK, mbetet ende e brishtë në Shqipëri.

⁴ Vendime të GJKF gjermane, BverfGE 45, 63 (74); 33, 247 (259).

I. ANKIMI INDIVIDUAL KUSHTETUES DHE PROCESI I RREGULLT LIGJOR

Procesi i rregullt ligjor është një koncept tashmë mjaft i njohur edhe i relativisht i zhvilluar në të drejtën shqiptare. Falë vendimeve të shumta të GJK, të cilat jo vetëm në numër por edhe në cilësi kanë parë rritje nga viti në vit, tashmë kemi një doktrinë kushtetuese. Para se të të shohim praktikën e GJK shqiptare le të ndalemi pak tek prezantimi i natyrës së ankimit individual kushtetues dhe ecurinë e zhvillimit të tij nga pikëpamja procedurale dhe materiale në Europë.

Ankimi individual kushtetues, siç dihet, e ka origjinën në vendet gjermanofolëse, më saktësisht në Gjermani, ku mori dhe formën e mirëfilltë që ka edhe sot. Ankimi kushtetues gjerman, i njohur me termin *Verfassungsbeschwerde*, është përqafuar nga shumica e Gjykatave Kushtetuese Europiane, dhe për këtë arsye ne do t'i referohemi këtij ankimi si tipik, i cili i ka fillesat që në vitin 1871, natyrisht në formë më të thjeshtëzuar. Në këtë vit u miratua Kushtetuta Perandorake (*Reichsverfassung*).⁵ Ideja themelore, ku u mbështet ky institut i së drejtës, ishte që të krijohej një mbrojtje gjyqësore për individin, përveçse ndaj vendimeve gjyqësore, edhe kundrejt akteve të organeve më të larta shtetërore.⁶ Njihen tre paraardhës të ankimit

⁵ *Klaus Stern, Das Staatsrecht der Bundesrepublik Deutschland, Band 2 (1994), fq.1275.*

⁶ Po aty, fq.1277.

kushtetues të sotëm gjerman: e drejta e ankimit kundër cenimit të të drejtave të garantuara nga Kushtetuta (1849), ankimi kushtetues sipas Kushtetutës bavareze (1818), si dhe ankimi kushtetues, sipas Kushtetutës bavareze të mëvonshme (1919). Sipas këtyre modeleve, u ngritën institute të ngjashme ankimi edhe në njësi të tjera federative (lande) por edhe në Austri. Vlen të theksohet se, megjithëse Austria ishte vendi, ku lindi kontrolli kushtetues, ankimi individual në këtë vend u zhvillua më ngadalë.⁷

Sipas Kushtetutës Perandorake gjermane (1849), ankimi kushtetues kishte një funksion të dyfishtë: *së pari* dhe më kryesorja, ai i shërbente sigurimit procesual të mbrojtjes subjektive të të drejtave themelore të njeriut, *së dyti*, ai kishte dhe një ndikim jo të vogël në zhvillimin e interpretimit dhe përsosjen e praktikës të së drejtës kushtetuese materiale. Me kompetencën që i ishte njohur GJK nga ligjvënësi kushtetues dhe ai i zakonshëm për të ushtruar kontroll mbi aktet normative, GJK kishte marrë përsipër përgjegjësinë për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të njeriut si dhe mbrojtjen e Kushtetutës nga veprimet e paligjshme të ligjvënësit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Ankimi kushtetues u qëndronte mbi kokë pushteteve të tjerë për të respektuar të drejtat themelore. Ky ankim individual ishte një mjet efikas për të korigjuar veprimet arbitrare të përfaqësuesve të këtyre pushteteve.⁸

Me ankim individual kushtetues, sipas doktrinës gjermane, do të kuptojmë të drejtën e çdo individi apo grupi shoqëror për të kundërshtuar akte të administratës publike, kur ato cenojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë.⁹ Ky ankim mund të jetë dhe në formën e ankimit popullor¹⁰, i cili është mjaft i gjerë dhe i jep mundësi individit për t'u ankuar edhe kur nuk vihen në lojë të

⁷ Kujtojmë se ideatori i kontrollit kushtetues ka qenë austriaku Hans Kelsen, i cili megjithëse e aplikoi këtë gjetje, nuk e përfshiu ankimin individual në fushën e kompetencave të GJK, gjë e cila do të riparohet pjesërisht më vonë (1950).

⁸ *Christian Stark*, *Verfassungsgerichtsbarkeit und Fachgerichte*, JZ (1996) fq.1033.

⁹ *Felix Ermacora*, *Der Verfassungsgerichtshof* (1956) fq. 298.

¹⁰ Si p.sh rasti spanjoll dhe maqedonas.

drejta subjektive të tij, pra kur mungon interesi i drejtpërdrejt. Këtë ankim e gjejmë në forma të ndryshme si ankim kushtetues, i cili bën të mundur vënien në vend të së drejtës subjektive, kur kjo i cenohet nga organe të administratës publike.¹¹ Përgjithësisht, llojet e tjera të ankimit kushtetues individual parashikojnë një ankim kushtetues të kufizuar: pra, nëpërmjet tij mund të kundërshtohen vetëm akte të caktuara të administratës publike.¹² **Ankimi individual kushtetues plotëson një boshllëk në sistemin e mbrojtjes që siguron gjyqësori**, i cili vepron vetëm sa i përket akteve të ekzekutivit, ndërsa ky lloj ankimi është më i gjerë duke përfshirë edhe akte të legjislativit apo gjyqësorit.¹³ Ajo që e bën të veçantë këtë ankim është se ky mund të ushtrohet vetëm në rast të cenimit të të drejtave të garantuara nga dispozitat kushtetuese dhe jo nga ligje të thjeshta.¹⁴

Ankimi kushtetues mund të jetë *direkt* ose *indirekt*. Direkt është kur ai ushtrohet drejtpërdrejt nga individi ose grupime individësh, ndërsa indirekt është kur ushtrohet nëpërmjet organizmave të tjera të ngarkuara me Kushtetutë si Avokati i Popullit apo gjykatat e zakonshme gjatë shqyrtimit të një çështje konkrete. Këto dy forma ankimi kushtetues njihen edhe nga legjisllacioni shqiptar.¹⁵ Sa i përket kritereve mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve që kundërshtohen, kjo çështje varet nga ndërtimi i Kushtetutës dhe i dispozitave kushtetuese. Në rast se kemi të bëjmë me një rregullim kushtetues të përcaktuar qartë deri në raste konkrete, atëherë gjyqtarët kushtetues janë të detyruar të tregohen të rreptë dhe strikt gjatë referimit në dispozitat kushtetuese. Sa më të përgjithshme të jenë dispozitat kushtetuese dhe të papërcaktuara të jenë përkufizimet aq më shumë hapësirë veprimi ka GJK. Sidoqoftë një gjë është e sigurtë:

¹¹ Kështu në Meksikë (Amparo), në Gjermani (ankim kushtetues), në Austri (ankim), në Zvicër (rekurs kushtetues), në Kolumbi (ankim popullor kundër ligjeve dhe akteve të tjera normative).

¹² P.sh Austria, Qipro (neni 46/1 i Kushtetutës) dhe ShBA.

¹³ Vendim i GJKF gjermane BverfGE 7, 198.

¹⁴ Krahaso nenin 131 f) të Kushtetutës shqiptare.

¹⁵ Neni 49/2 dhe 68/1 i ligjit për GJK shqiptare.

ndërtimi i hierarkisë së normave juridike – Kushtetutë, ligj, akte të tjera normative – është kriteri thelbësor në këtë proces.¹⁶

Pavarësisht se ankimi individual gjerman ka shërbyer si shembull për mjaft GJK europiane, ai ka pësuar ndryshime e përshtatje sipas karakteristikave të rendeve ligjore të secilit vend duke krijuar specifikat e veta. Për këtë arsye, më poshtë do të sjellim disa nga modelet më të përhapura në Europë.

4. Vështrim i përgjithshëm krahasimor mbi ankimin individual kushtetues

Duke qenë se kontrolli kushtetues *i përqendruar* është produkt i procesit vendimmarrës të ligjvënësit, i takon ligjvënësit të shtrojë pyetjen se cilit qëllim do t'i shërbejë kontrolli kushtetues dhe ç'hapësirë kontrolli do ketë ai. Është e padiskutueshme që ky kontroll i shërben vendosjes së përparësisë së Kushtetutës në hierarkinë e normave. Prandaj dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së akteve të pushtetit publik përbën thelbin e kompetencave të një GjK. Hapësira dhe llojet e këtij kontrolli mund të bëhen shkak për debate ose konflikte institucionale të natyrës juridiko-politike. Ligjvënësit i duhet të vendosë, nëse do t'i japë kompetenca GjK të ushtrojë kontroll mbi të gjitha aktet apo vetëm në një pjesë të tyre. Debatet lidhur me sa më sipër zhvillohen në funksion të mbrojtjes objektive të rendit kushtetues në përgjithësi dhe të drejtave dhe lirive të njeriut në veçanti. Në këtë kuadër mund të diskutohet dhe lidhur me çështjen, nëse edhe individit si subjekt i të drejtave dhe lirive mund të marrë pjesë aktivisht dhe deri në cilët kufij në procesin e kontrollit kushtetues që ushtron GjK duke e vënë vetë atë në lëvizje.

Të drejtat themelore janë pjesë e qenësishme e rendit kushtetues dhe gëzojnë mbrojtje nëpërmjet kontrollit kushtetues. Për këtë shkak, një nga mjetet juridike mbrojtëse që parashikojnë kushtetutat

¹⁶ Neni 116/1 i Kushtetutës shqiptare njeh këtë hierarki normash juridike: Kushtetutë, marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, ligje, akte normative të Këshillit të Ministrave.

moderne është edhe mbrojtja subjektive e të drejtave themelore të shtetasve edhe para GJK në rast të cenimit të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë në përmjet ankimit kushtetues individual. Mënyra se si do të ushtrohet ky kontroll dhe hapësira e tij mund të jetë e larmishme. Mund të ndiqet edhe ideja që në një shtet të së drejtës gjykatat, veçanërisht gjykatat administrative, t'i ofrojnë individit mundësi të mjaftueshme për një mbrojtje individuale.¹⁷ Një zgjidhje juridiko-teknike gjen zbatim sot duke ia lënë gjykatave të zakonshme mbrojtjen e individit. Është detyrë parësore e këtyre që t'i ofrojnë individit mbrojtjen maksimale të mundshme brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor.¹⁸ Nëse individit nuk është i kënaqur nga vendimmarrja e tyre, atëherë, në disa vende, ligjvënësi kushtetues i ka dhënë edhe një mundësi tjetër individit: t'i drejtohet GjK. Kjo e fundit ndërhyr në rastet e korrigjimit në aspektin kushtetues edhe të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme ose kur pretendohet nga individit se të drejtat e tij rrezikohen të shkelen nëpërmjet zbatimit të një ligji gjatë një procesi gjyqësor.¹⁹ Zbatimi i kësaj zgjidhje mund të sigurohet nëpërmjet parashikimit të së drejtës për të bërë ankim nga palët në proces, me anë të së cilës ato arrijnë të fillojnë procesin e kontrollit konkret të një norme.²⁰ Në një rast të tillë janë të lidhura pandashmërisht funksionet mbrojtës objektivë (mbrojtja e të drejtës konkrete të shkelur) dhe subjektivë (mbrojtja e rendit kushtetues dhe shtetit të së drejtës) të kontrollit kushtetues.

¹⁷ Kështu p.sh Kushtetuta austriake parashikon që individit t'i drejtohet edhe Gjykatës Administrative për shkeljen e të drejtave të tij (si p.sh në rastet e mosshqyrtimit të kërkesës nga organet e administratës publike). Ndërkohë edhe rruga drejt GJK është e hapur, individit i duhet të zgjedhë midis të dyjave, pasi ndryshe mund të kemi një konflikt juridiksional midis dy gjykatave.

¹⁸ Këtë shembull ndjekin vendet anglo-saksone, të cilat kanë zgjedhur si model të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit kontrollin e shpërndarë në të gjitha nivelet e gjyqësorit.

¹⁹ Ky lloj shqyrtimi njihet nga një numër GJK në Europë: Gjermani, Slloveni, Çeki, etj. GJK shqiptare deri sot ka hezitur ta aplikojë këtë kontroll.

²⁰ Kushtetuta shqiptare, në nenin 145/2 të saj, e njeh kontrollin konkret të inicuar nga gjykatat (i njohur edhe si kontrolli incidental), i cili thuhet në të gjitha rastet është filluar nga gjykata dhe jo nga palët në gjykim. Megjithatë për efektet e kontrollit kjo nuk është e rëndësishme.

Mbrojtja e posaçme e të drejtave themelore është e lidhur ngushtë me mbrojtjen ligjore të përgjithshme gjatë procesit gjyqësor, nëse palëve në proces u është vënë në shërbim një mjet ligjor i jashtëzakonshëm, me ndihmën e të cilit ata kanë mundësi të vënë në lëvizje në instancë të fundit GJK me pikësynim vënien në vend të një të drejte themelore. Ky mjet ligjor i rishikimit të së drejtës themelore mund të ketë forma të ndryshme. Në *Maltë* mbrojtja e të drejtave themelore është e integruar në mënyrë të dyfishtë gjatë procedurës gjyqësore dhe si instancë e parë është parashikuar gjykata më e lartë civile. Gjithashtu çështja e shkëljes së të drejtave themelore mund të ngrihet në çdo proces. Nëse gjykata nuk arrin në përfundimin se çështja e shtruar përbën shpërdorim të mjetit ligjor të vënë në dispozicion (merely frivolous or vexatious), ajo ka të drejtë t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Civile, vendimi i së cilës është determinant për ecurinë e mëtejshme të procesit. Përveç kësaj çdokush ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Civile, e cila mund të vendosë mbi disponimet që ofron e drejta angleze për të ndihmuar palët në proces (vendosje rregullash, dhënie orientimesh). Në të gjitha rastet vendimi i Gjykatës Civile mund të atakohet në GJK. Megjithëse një kompetencë e tillë është parashikuar që në vitin 1964, kur *Malta* shpalli pavarësinë e saj, ajo ka gjetur zbatim të gjerë vetëm kohët e fundit, sepse shkëlja e të drejtave themelore nga një ligj u bë e mundur të ankimohej vetëm pas amendimesh të njëpasnjëshme të një dispozite në vitin 1993 dhe 1996.²¹

Një lidhje më e integruar e mbrojtjes së të drejtave themelore me mbrojtjen e përgjithshme gjatë procesit gjyqësor ndeshet edhe në hapësirën spanjishtfolëse e njohur me emrin *Procesi Amparo*. Bëhet fjalë për një procedurë të shpejtuar para gjykatave të zakonshme në mbrojtje të të drejtave themelore, e cila është interpretuar dhe zbatuar në mënyra të ndryshme në vendet ameriko-latine dhe duhet parë në dy aspekte. Kjo procedurë e shpejtuar është parashikuar si

²¹ Pavarësisht vendodhjes gjeografike dhe ndikimit nga e drejta kontinentale duhet mbajtur parasysh se tradita juridike në Maltë është e ndikuar ndjeshëm nga e drejta anglosaksone për shkaqe historike.

kusht për t'iu drejtuar GJK në mbrojtje të disa të drejtave themelore.²² Megjithatë ligji i parashikuar nuk ka gjetur zbatim dhe gjendja juridike e krijuar ka çuar praktikisht në vënien në lëvizje të GJK me anë të një "recurso de amparo" më shumë si një ankim kushtetues mbi të drejtat themelore sesa një rishikim të tyre.²³ Kjo procedurë nuk ka gjetur zbatim të gjerë. Më shumë aplikim ka gjetur nga prokuroria, e cila ka të drejtë të apelojë kundër vendimit të instancës përfundimtare me anë të procedurës *amparo*, kur ka cenim të Kushtetutës lidhur me garancitë procedurale.

Në *Bosnje-Hercegovinë*, që në fillim "fuqitë e mëdha" parashikuan në dokumentin themeltar ankimin kushtetues të përfshirë në procedurën e zakonshme gjyqësore. Kështu, për të mënjeluar pasojat e konfliktit muslimano-kroat u krijuar përveç GJK edhe një Gjykatë e të Drejtave të Njeriut. Kjo e fundit është kompetente të shqyrtojë ankimet e çdo pale në proces kundër vendimit të instancës së fundit që pretendon se i është shkelur direkt ose indirekt një e drejtë themelore. Pra, shtetasve u është vënë në dispozicion një mbrojtje e dyfishtë dhe megjithatë nuk është shfaqur ndonjë problem sa i përket konkurrencës midis kompetencave të të dy organeve. Gjykata mund të marrë çdo lloj mase të nevojshme për mënjanimin e cënimit të së drejtës themelore.²⁴

²² Neni 53/2 i Kushtetutës spanjolle të 1978 dhe neni 43/2 i ligjit për GJK spanjolle.

²³ Këtë procedurë e gjejmë edhe në Andorra, e cila është orientuar sipas shembullit spanjoll, kur principata me rastin e miratimit për herë të parë të Kushtetutës në vitin 1993 parashikoi në të njëjtën mënyrë një procedurë empara para gjykatave të zakonshme dhe fillimisht legjitimoheshin vetëm palët në proces si inicues të kësaj procedure "recurs d'empara". Në 1999 ky kufizim u shfuqizua duke ua dhënë këtë të drejtë të prekurve drejtëpërdrejt, gjë e cila solli menjëherë një rritje të rasteve të zbatimit të procedurës empara në Andorra. Si përfundim, mund të thuhet se thelbi i ankimit amparo në Andorra gjendet e kufizuar në fushën e garancive procedurale gjatë procesit gjyqësor.

²⁴ Neni VI, pika 3 shkronja "c" e Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës.

4.1 *Ankimi real*

Si ankimi real mbi të drejtat themelore duhet të përkufizohet veprimi i individit me anë të të cilit ai atakon në GJK aktin e administratës publike që çënon drejtpërdrejt të drejtat e tij themelore. Me termin "*administratë publike*", si rregull, do të kuptojmë çdo organ ose pjesë e tij që është i veshur me kompetenca për të ushtruar pushtet, pra për të marrë vendime (shtetet e federuara, rajonet, komunat), ose dhe mbajtës të tjerë të pushtetit shtetëror.²⁵ Akti është në shumicën e rasteve individual (vendim gjykatë, akt administrativ, ose dhe mosveprim i organeve), përjashtimisht mund të jetë edhe normë juridike (ligj i parlamentit, vendime të qeverisë) që çënojnë direkt sferën e të drejtave themelore. Si prototip i ankimeve reale mbi të drejtat themelore merret *ankimi kushtetues gjerman*. Ky ankimi ka fituar një vëmendje të veçantë në rang ndërkombëtar, por megjithatë ai nuk është më i ngjashëm me origjinalin, sepse *Austria, Zvicra dhe Lichtensteini* kanë qenë para *Gjermanisë* në këtë drejtim. Në *Austri* shtetasve u ishte krijuar mundësia të ankoreshin kundër akteve të administratës publike për shkak të cënimit të të drejtave politike të garantuara me Kushtetutë në Gjykatën Perandorake të krijuar që në 1868. Megjithatë rëndësia e këtij ankimi ra aq shumë në praktikë, sa Gjykata mjaftohej vetëm me deklarinimin e antikushtetutshmërisë pa e shfuqizuar vetë aktin. Vetëm në vitin 1920 kur kompetencat e Gjykatës Perandorake i kaluan GJK të sotme, asaj iu njoh edhe atributi i shfuqizimit të aktit.²⁶ Kufizimi i objektit të ankimit vetëm tek aktet e administratës publike ka mbetur deri më sot, edhe pse në vitin 1975 u parashikua e drejta e individit të ankohet kundër antikushtetutshmërisë së ligjeve dhe antiligjshmërisë së vendimeve të qeverisë, nëse kërkuesi çënohej nga këto akte direkt në të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.²⁷

²⁵ *Rolf Schmidt*, Grundrechte sowie Grundzuege der Verfassungsbeschwerde (2005) fq.41.

²⁶ *Walter/Mayer*, Bundesverfassungsrecht (2000) fq. 78.

²⁷ *Hans Kelsen*, Wesen und Entwicklung der Staatsgerichtsbarkeit (1928) fq.30.

Në *Zvicër* me rastin e rishikimit të përgjithshëm të Kushtetutës në vitin 1874 u parashikua dhe ankimi sipas parimeve të së drejtës publike, me anë të të cilit atakoheshin dekrete dhe vendime, pra akte individuale që çënonin të drejtat kushtetuese të shtetasve. Para vitit 1945 në *Gjermani* pozitat e ankimit real mbi të drejtat themelore ishin tepër të dobëta. Kontributin më të madh e dha landi i *Bavarisë*, i cili përqafoi menjëherë ankimin kushtetues kundër akteve individuale që mori një rëndësi të madhe pas Luftës së Dytë Botërore. Më vonë ky ankim u përhap në rang federate që u konkretizua me krijimin e GJK Federale në 1951. Ankimi individual sipas Ligjit Themelor gjerman të 1949 mund të ngrihet kundër akteve të pushtetit publik të çdo lloji natyre. Pas bashkimit të dy Gjermanive edhe në landet e reja u ngritën GJK me kompetencë shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Ankimi kushtetues gjerman ka gjetur një respekt të gjerë në rang ndërkombëtar dhe me shmangie të vogla u përqafoi në 1980 nga *Spanja (recurso de amparo constitucional)*, në 1991 nga *Kroacia (ustavna tuzba)*, në 1992 nga *Cekia dhe Sllovakia (ustavni stiznost)* – ankim, i cili pas shpërbërjes së shtetit në dy shtete të pavarura në 1993, mbeti e pandryshuar në *Ceki* – dhe në 1994 në *Slloveni (ustavna pritozba)*, dhe që nga kjo kohë luan një rol të rëndësishëm. GJK *maqedonase* e përkrahu një ankim të tillë duke u ndjekur pas edhe nga GJK *shqiptare* deri në vitin 1998.²⁸

Një rëndësi të madhe ka ankimi kushtetues individual në *Sllovakia*, ku individit i jepet mundësia të kërkojë fillimin e një procesi para GJK, nëse ndihet i cenuar në të drejtat e tij.²⁹ Kjo dispozitë paksa misterioze, e cila nuk kufizohet as në ligjin për GJK ka shkaktuar në praktikë një ngatërrësë jo të vogël. GJK e ka interpretuar ngushtë dispozitën duke i lënë mundësi vetëm një kategorie të vogël personash t'i drejtohen GJK.³⁰ Një situatë ligjore e ngjashme gjendet edhe në *Monako dhe*

²⁸ Shih pjesën ku flitet më tepër për ndryshimet që solli Kushtetuta e vitit 1998 lidhur me ankimin individual.

²⁹ Në vit mund të bëhen mbi 100 ankime të këtij lloji dhe vetëm 1/10 e tyre arrin të shqyrtohej. Rastet më të shpeshta të ankimuara janë zgjatjet e tepërta të procedurave që çënojnë të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

³⁰ Jurisprudenca e GJK është tepër inkonsistente, por mund të arrihet në përfundimin se GJK për të inicuar procesin nuk mjaftohet vetëm me shkeljen e një të drejte të zakonshme, por duhet të jetë e drejtë e garantuar me Kushtetutë ose nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Qipro. Në *Monako* konsiderohet kërkesa për shfuqizim e ligjeve, e cila njihet si ankim mbi të drejtat themelore dhe ka për objekt vetëm ligjet në kuptimin formal. Aktet e tjera normative të ekzekutivit mund të atakohen në Gjykatën Administrative.³¹ Kushtet procedurale për lejimin e ankimit real mbi të drejtat kushtetuese janë të garantuara sipas mënyrave të ndryshme në vende të ndryshme. Megjithatë ajo që mbetet e njëjtë është kushti që kërkuesi të jetë direkt i cënuar, të ketë shterrur të gjitha mjetet ligjore të ankimit dhe t'i përmbahet afateve të caktuara.

Si rregull, objekt ankimesh janë gjithmonë aktet individuale të ekzekutivit ose të gjyqësorit. Duke qenë se shterri i të gjitha mjeteve ligjore të ankimit është kusht procedural në të gjitha vendet dhe mbrojtja gjyqësore kundër akteve të administratës publike është e garantuar kudo, ankimet mbi të drejtat themelore drejtohen zakonisht kundër vendimeve gjyqësore të shkallës së fundit. Përjashtim bën këtu *Austria*, ku ankimi real mund të bëhet vetëm kundër një akti administrativ dhe personi i cënuar pas daljes së aktit administrativ nga organi i instancës së fundit, duhet të vendosë vetë nëse do t'i drejtohet GJK apo Gjykatës Administrative. Individit do t'i interesonte, për të mos rrezikuar, t'i shfrytëzonte të dyja rrugët, megjithatë GJK mund t'ia dërgojë kërkesën Gjykatës Administrative, kur arrin në përfundimin se kërkuesit nuk i është cënuar ndonjë e drejtë themelore kushtetuese por një e drejtë e garantuar nga ligji i zakonshëm. Normat ligjore mund të atakohen në rast të cenimit të drejtpërdrejt vetëm në disa vende, p.sh në *Gjermani* (gjithpërfshirëse), në *Austri*³² (përfshirëse në procedura të ndara të ankimit individual), në *Zvicër* (e kufizuar në normat juridike të kantoneve) dhe në *Monako* (përjashtimisht vetëm ligje).

³¹ E njëjta gjë shihet dhe në *Qipro*: dy Gjykatat e Larta në të dyja pjesët e Qipros mund të luajnë rolin e gjykatës administrative kur shqyrtojnë aktet e administratës publike.

³² Në GJK Austriake nuk është i mundur kundërshtimi i vendimeve gjyqësore.

Në lidhje me ankimin real mbi të drejtat themelore shfaqen kudo tri probleme kryesore:

Problemi i parë lidhet me rastin, kur akti individual është rezultat i zbatimit korrekt të ligjit, por vetë ligji ose akti normativ, mbi bazën e të cilit është lëshuar, është antikushtetues. Është e qartë që akti individual i atakuar duhet të shfuqizohet, sepse çënon një të drejtë themelore. E diskutueshme është çfarë do të ndodhë me normën mbi bazën e së cilës është lëshuar akti individual. Për të sqaruar këtë çështje duhet t'i referohemi trajtimit të funksionit të ankimit mbi të drejtat themelore. Nëse duhet që ky ankim t'i shërbejë përjashtimisht mbrojtjes juridike individuale, atëherë në këtë kuadër në një rast konkret mund të lihet e paprekur norma ku është mbështetur akti. Po qe se do të merret parasysh edhe funksioni objektiv i kontrollit kushtetues, atëherë mund të merret shkas nga ankimi kushtetues i individit për të shfuqizuar normën antikushtetuese. Shumica e vendeve kanë përqafuar këtë këndvështrim dhe kanë marrë masa të ndryshme, për të konkretizuar mbrojtjen objektive kushtetuese. Kështu, në *Gjermani, Austri, Lichtenstein dhe Slloveni*, GJK ka kompetencë të deklarojë absolutisht të pavlefshme ose të shfuqizojë normën antikushtetuese mbi bazën e së cilës është lëshuar akti individual që çënon të drejtat themelore të kërkuesit. Në *Ceki* individit mund të ankohet përveçse kundër aktit paralelisht edhe kundër normës juridike ku ai bazohet. Në *Spanjë* senati (kupto: kolegji i GJK) kompetent për shqyrtimin e ankimeve kushtetuese ka të drejtë të fillojë kryesisht procedurën e shqyrtimit të një norme të caktuar dhe t'ia paraqesë çështjen plenumit të GJK. Nga ana tjetër, në *Kroaci*, GJK kufizohet me kontrollin incidental. Kjo mundësi i është njohur edhe GJK *maqedonase*, ku kërkuesi mund të ngrejë një ankim popullor (*actio popularis*). Vetëm në *Zvicër* hapësira midis kontrollit të normës dhe aktit të nxjerrë mbi bazën e saj është e pakapërcyeshme, sepse antikushtetutshmëria sipas parimeve të së drejtës së kontrollit të ushtruar nga gjyqtarët e sistemit të zakonshëm mund të evidentohet vetëm në pjesën arsyetuese të vendimit.³³

³³ *Walter Haller*, Schweizerischer Bundesgerichtshof als Verfassungsgericht (1989) fq.179.

Problemi i dytë është i natyrës teorike dhe ka të bëjë me vështirësinë për të dalluar vijën ndarëse midis situatës së cenimit të të drejtave themelore dhe shkeljes së zakonshme ligjore. Pyetja është: kur ndodhemi para cënimit të një të drejte themelore kushtetuese dhe kur para cenimit të një të drejte të garantuar me ligj? Nga përgjigja që mund t'i jepet kësaj pyetje varet vendimi në çdo rast individual, nëse do të pranohet ankimi mbi të drejtat themelore apo do të rrëzohet. Në *Austri* nga kjo përgjigje varet mjeti ligjor që do të vihet në zbatim. Sipas nenit 144/3 të Kushtetutës austriake, GJK, nëse arrin në përfundimin se ndodhet para cënimit të një të drejte subjektive dhe jo themelore, nuk e shqyrton çështjen, por ia dërgon atë Gjykatës Administrative.³⁴

Praktika *spanjolle* tregon se në rastin e një mbrojtje efektive ligjore, sa i përket parimit të barazisë, nuk është e mundur të bëhet një dallim midis tërësisë së normave që rregullojnë të drejtat themelore dhe atyre që rregullojnë të drejtat e garantuara me ligj. Kufijtë përzihen krejtësisht kur krijohet një e drejtë e përgjithshme, së cilës i drejtohem gjithmonë kur nuk mund t'i referohemi të drejtave të veçanta. Kështu, përmendim këtu një vendim të hershëm të GJKF *gjermane*, e cila interpretoi nenin 2/1 të Ligjit Themelor duke ngritur në postulat parimin e lirisë së lëvizjes dhe të veprimit. Ky interpretim kishte pak a shumë këtë përmbajtje: "*Me formim të lirë të personalitetit Kushtetuta nuk mund të nënkuptojë vetëm formimin brenda sferës thelbësore të personalitetit që përbën qenien e njeriut si person shpirtëror e me moral të caktuar, ai është shumë më tepër se kaq. Megjithatë, ky formim, pavarësisht sferës së gjerë të tij, nuk mund të vijë në kundërshtim me moralin dhe të çënojë të drejtat e të tjerëve apo rendin kushtetues në një demokraci. Kufizimet që i bëhen individit si anëtar i shoqërisë tregojnë se Kushtetuta i ka bërë formulim të gjerë lirisë së shprehjes.*"³⁵ Në këtë vendim bëhej fjalë për lirinë e lëvizjes, që nuk është veçanërisht e mbrojtur në Kushtetutë, ajo ka parasysh kryesisht të drejtën e lëvizjes brenda territorit të shtetit. Pra, GJKF gjermane, megjithëse ndodhej para

³⁴ Shih *Walter/Mayer*, Bundesverfassungsrecht (2000) fq.243.

³⁵ Vendimi i GJKF gjermane BVerfGE 6,32 (36) në: Vendime të përzgjedhura të GJKF gjermane, botuar në shqip (2009), fq.68.

një të drejte jo të garantuar me Kushtetutë e lidhi interpretimin dhe mbrojtjen e saj me një të drejtë të rangut kushtetues duke legjitimuar kërkuesin në kërkimet e tij. Ajo ndjek parimin se interpretimi mund të zgjerohet, kur, megjithëse në dukje nuk vihet në lojë një e drejtë themelore, mënyra se si e drejta ligjore afekton kërkuesin mund të sjellë edhe cenim të së drejtës themelore.

Ligji Themelor (Grundgesetz) *gjerman*³⁶ përmend si kufij të të drejtave dhe lirive themelore të drejtat e të tjerëve, rendin kushtetues dhe moralin, nga të cilat, praktikisht, një rol kryesor luan rendi kushtetues. Por çfarë kuptojmë me "*rend kushtetues*"? Në vendimin e sipërpërmendur GJKF *gjermane* është shprehur duke përkufizuar rendin kushtetues si "*rend juridik i përgjithshëm që duhet të respektojë dispozitat materiale dhe formale të Kushtetutës.*" Janë pjesë e rendit kushtetues "*të gjitha normat kushtetuese dhe aktet e dala mbi bazë të tyre*". Një akt individual i kundraligjshëm nuk është dhe nuk mund të jetë pjesë e rendit kushtetues dhe si rrjedhojë është antikushtetues. Pasoja e pamënjanueshme dogmatike në këtë rast është vënia në pozita të barabarta e kundraligjshmërisë dhe e shkeljes së rendit juridik me antikushtetutshmërinë. Pasoja praktike ka të bëjë me faktin që GJKF gjermane në çdo rast të atakimit të një vendimi gjyqësor duhet të provojë, nëse vendimi ka ardhur si rrjedhojë e një interpretimi të drejtë të ligjit dhe në këtë mënyrë përbën një akt të nxjerrë si rrjedhojë e zbatimit të dispozitave kushtetuese. Kjo është praktikisht detyrë e të gjitha gjykatave të instancës së dytë dhe atyre që ushtrojnë rishikim përfundimtar. Për këtë arsye, nuk është për t'u çuditur, që GJKF gjermane është cilësuar shpesh nga doktrina si "*gjykatë mbirishikuese*".³⁷ Aq më pak të çudit fakti që kjo Gjykatë reagon ashpër kundër akuzave të tilla që kanë në thelb kalimin e caqeve midis një gjykate kushtetuese dhe një gjykate fakti. Kështu, ajo përsërit herë pas here faktin që GJKF ka si normë referimi "*të drejtën kushtetuese*" dhe jo "*të drejtën e zakonshme*". Për ta përforcuar më shumë këtë argument, mund të përmendim

³⁶ Neni 2/1 i Ligjit Themelor gjerman, i cili luan rolin e Kushtetutës.

³⁷ *Peter Habaerle*, Bundesverfassungsgericht in der Krise? Në: Das Bundesverfassungsgericht zwischen Recht und Politik (1996), fq.19.

se GJKF prej vitit 1971 zbaton formulën *Mefistofel*, sipas së cilës, ajo kontrollon "nëse vendimi i gjykatës që atakohet ka qenë i bazuar në një interpretim të drejtë të normave të së drejtës civile/ penale duke respektuar parimet e të drejtave themelore, apo nëse interpretimi i bërë ka sjellë si pasojë cënimin e të drejtave themelore."³⁸ Sa i përket zbatimit praktik, formula Mefistofel të çon në përfundimin se GJKF vendos mbi ligjshmërinë e vendimeve individuale të atakuara duke iu referuar të drejtave themelore dhe me atë intensitet që i duket asaj më i përshtatshëm. Shkalla e cënimit të të drejtave themelore dhe pasojat që ka sjellë ai luajnë një rol të rëndësishëm duke bërë që vendimet penale por dhe ato administrative t'i nënshtrohen gjykimeve civile. Një ndikim në marrjen e vendimeve ka edhe rangu kushtetues që GJKF gjermane i jep çdo të drejte themelore. Kështu p.sh praktika e GJKF tregon një preferencë të veçantë për lirinë e shprehjes duke përfshirë sidomos shpalljen e lirë të personalitetit të njeriut dhe të drejtën për t'u tubuar dhe për t'u organizuar, sidomos nëse ushtrimi i tyre është politikisht i motivuar, ndërkohë që nderit dhe të drejtave të tjera personale të shtetasve ose "personaliteteve të spikatura të jetës publike" u është dhënë haptazi një vlerësim më i vogël.³⁹

Dilema e përmendur në shembullin e praktikës gjermane shqetëson sot edhe vendet e Europës Lindore që kanë praktikuar ankimin real mbi të drejtat themelore. Kështu GJK çeke kohët e fundit po përpiqet të vendosë kufijtë midis cenimit të të drejtave themelore dhe cenimit të të drejtave të zakonshme me ndihmën e ndalimit të veprimeve të paligjshme dhe parimit të drejtësisë. Megjithatë nuk mund të thuhet se kritikët e kanë përkrahur këtë qëndrim. Acarimet midis gjykatave kushtetuese dhe gjykatave të larta janë të njohura në pothuajse të gjitha vendet e Europës Lindore, dhe si rrjedhojë edhe në *Ceki*. Ato kanë të bëjnë më shumë me shkallën e prestigjit të secilit organ, por problemi kryesor paraqitet në gjetjen e arsyeve për të bërë një ndarje të funksioneve të paktën në fushën më nevralgjike: atë të

³⁸ *Paul Kirchhof*, Die Aufgaben des Bundesverfassungsgerichts in Zeiten der Umbruch në: NJW 1996, fq.1497.

³⁹ Shih për më tepër vendime të tilla si Carolina von Monaco; Schmid-Spiegel; Soldaten sind Moerder, në përmbledhjen e vendimeve të GJKF gjermane në shqip.

të drejtave themelore, ku secili prej tyre pretendon kompetencën e vet.⁴⁰

Problemi i tretë është i natyrës praktike. Eksizton, para së gjithash, në vendet e mëdha problemi i mbingarkesës së gjykatave kushtetuese nga fluksi i ankimeve mbi të drejtat themelore, e cila sjell pasoja negative lidhur me zgjatjen e procedurave dhe cilësinë e praktikës vendimmarrëse.⁴¹ Për lehtësimin e ngarkesës së tyre janë marrë masa të aspektit procedural. Zakonisht mbi këto ankime nuk vendos gjykata në përbërje të plotë, por në kolegje më të vogla prej gjashtë (*Spanja*), pesë (*Austria, Kroacia*), ose tre (*Zvicër, Çeki, Gjermani, Shqipëri*) gjyqtarësh. Është parashikuar një procedurë paraprake si rezultat i së cilës ankimet që janë të pabazuara dhe të palejueshme⁴² kthehen pa kaluar në seancë plenare të Gjykatës. Sipas rregullit të vendosur në 1993, ankimi kushtetues në GjKF *gjermane* do të kalojë për shqyrtim, vetëm nëse: a) ankimi paraqet rëndësi sa i përket aspektit kushtetues, pra është një çështje e re e pavendosur më parë nga ajo Gjykatë, ose b) ankimi është i rëndësishëm për zbatimin e së drejtës themelore për të cilën bëhet ky ankim, gjë e cila duhet të pohohet edhe nëse nuk merret vendim pozitiv lidhur me kërkesën dhe kërkuessit mund t'i vijjnë pasoja negative të rënda nga ky fakt dhe c) nëse ankimi ushtrohet brenda afatit. Këto kritere u parashikuan për të kufizuar numrin e ankimeve kushtetuese nëpërmjet funksionit mbrojtës objektiv-juridik të kontrollit kushtetues. Në të njëjtën mënyrë por më përmbledhës dhe në kuptimin mohues e ka formuluar ligjvënësi *slloven* këtë lloj ankimi, duke parashikuar rastet në të cilat ky ankim nuk do të kalojë për shqyrtim nëse: a) nga vendimi që mund të merret nuk do të ketë ndonjë sqarim të çështjes juridike që shtrohet, dhe b) cenimi i së drejtës themelore nuk sjell pasoja të

⁴⁰ *Georg Brunner*, Die neue Verfassungsgerichtsbarkeit in Osteuropa në: Zeitschrift fuer Auslaendisches Oeffentliches Recht und Voelkerrecht des Max Planck Institutes (1998) fq. 858.

⁴¹ Në GjKF gjermane çdo vit paraqiten mbi 5000-7000 ankime, në Austri dhe Çeki afërsisht 2000 dhe në Slloveni rreth 400 ankime. Në raport me sasinë të bie në sy kuota e vogël e ankimeve që përfundojnë me sukses, që arrin në 5-10%.

⁴² Bëhet fjalë për mungesë legjitimiteti.

rënda për kërkuesin ose nuk do të ndryshojë gjendjen e tij nëse ankimi ka sukses.⁴³

Me gjithë përpjekjet për t'u bazuar në kritere objektivo-juridike për marrjen në shqyrtim ose jo të ankimit, GJK duhet të jetë paksa fleksibël. Kritikët që nuk pajtohen me këtë lloj qëndrimi, akuzojnë GJK gjithmonë për shkelje të së drejtës ose kapërcim të kufijve të kontrollit kushtetues. Për të shmangur sa më shumë këto akuza, GJK kanë aplikuar përzgjedhjen paraprake ose të ashtuquajturën: *shqyrtimi pas çmuarjes*. GJK çmon paraprakisht nëse ankimi duhet të shqyrtohet në seancë apo jo dhe jep edhe argumente për këtë për të mos lënë vend për interpretime sa i takon fleksibilitetit në vendimmarrje. Në këtë mënyrë GJK mund edhe të kritikohet, por nuk mund të akuzohet për shkelje të së drejtës. Për këto arsye komisioni i ekspertëve i ngritur nga Ministri i Drejtësisë i Gjermanisë në 1996 propozoi parashikimin e një procedure sipas modelit amerikan e quajtur procedura *certiorari*, pra të shqyrtimit paraprak jashtë seancës gjyqësore. GJL amerikane krijojnë mundësinë e një "*writ of certiorari*"⁴⁴ sipas çmimit të lirë të gjykatës, nëse ka arsye bindëse për këtë. Në këtë kuadër ajo nuk heziton që si arsye bindëse të konsiderojë edhe mbingarkesën e gjykatës dhe të pranojë aq ankime (writs) sa ç'mund të shqyrtojë në një vit. Si rezultat i kësaj praktike paraqiten brenda vitit 7000 kërkesa dhe vetëm 10% pranohen të shqyrtohen në seancë dhe të merret mbi to vendim përfundimtar brenda vitit.⁴⁵ Nga numri i vogël i ankimeve që kalojnë për shqyrtim gjyqësor del se këto përbëjnë rastet më të rënda të shkeljeve, rëndësia në aspektin kushtetues të së cilës nuk vihet në dyshim. Megjithatë, pavarësisht numrit të vogël të kërkesave të pranuar për gjykim dhe ende më të vogla të atyre që kanë sukses, sondazhet e bëra tregojnë se nga institucionet politiko-juridike gjykatat kushtetuese (përfshi edhe gjykatat e

⁴³ Raste të tilla mund të jenë kur megjithëse konstatohet një shkelje gjatë vendimmarrjes së gjykatave, një shfuqizim i tyre nuk do të sillte asnjë pasojë për kërkuesin pasi efektet e tij kanë përfunduar dhe janë të pakthyeshme.

⁴⁴ Ankime mbi të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta amerikane.

⁴⁵ *Michael Kleine-Cosack*, *Verfassungsbeschwerden und Menschenrechtsbeschwerden* (2001), fq.87.

zakonshme që ushtrojnë kontroll kushtetues) janë ato që gëzojnë besueshmërinë më të madhe në popull.⁴⁶

4.2 *Ankimi joreal*

Ky lloj ankimi është i ngjashëm me atë real sa i përket kushteve për ta ngritur atë: shterrimi i të gjitha mjeteve ligjore të ankimit dhe respektimi i afatit të caktuar. Ndryshimi ka të bëjë me faktin se ankimi nuk drejtohet kundër aktit individual të administratës publike që ka sjellë cënimin e së drejtës themelore, por kundër normës juridike antikushtetuese në të cilën është bazuar akti i nxjerrë pasojat e të cilit çenojnë të drejtat themelore të individit. Meqë objekt ankimi është norma juridike, në rastin e ankimit joreal bëhet fjalë për një kontroll konkret normash. Mundësia e cënimit të të drejtave themelore është në fakt kusht për të paraqitur kërkesën, por kontrolli i normës shtrihet mbi të gjitha aspektet e kushtetutshmërisë. Ankimi joreal gjeti zbatim së pari në *Hungari* (1990).⁴⁷ Këtij ankimi i korrespondon në *Poloni padia kushtetuese* – në mungesë të një *padie popullore* – e cila gjeti menjëherë (prej 1997) një zbatim të gjerë.⁴⁸ Si vend i tretë vjen *Letonia* me *ankimin kushtetues* që prej 1 korrikut 2001.

Në krahasim me ankimin real ai joreal ka disa përparësi. Objekt kërkesë nuk janë aktet individuale të instancës së fundit por norma mbi të cilën është marrë vendimi i gjykatës së zakonshme. Edhe në këtë rast shtrohet problemi i ndarjes së kufijve midis cënimit të të drejtave themelore dhe atyre ligjore, pasi nuk do të kontrollohet

⁴⁶ *Karin Grasshof*, Die Annahmefähigkeit und Zulaessigkeit der Verfassungsbeschwerde eines Einzelnen Buergers in Deutschland në: Seminarin e organizuar nga GJK shqiptare dhe Fondacioni gjerman IRZ me temë "Përzgjedhja e kërkesave individuale nga GJK", (2005).

⁴⁷ Pas shterrimit të të gjitha mjeteve ligjore të ankimit brenda 60 ditëve mund të bëhej ankim kundër antikushtetutshmërisë së aktit, që pretendohet se kishte cënuar të drejtat themelore të individit. Ky lloj ankimi ndeshet në praktikë rrallë, sepse individit ka dhe një mundësi tjetër për t'iu drejtuar GJK atë të quajtur padi popullore (shih më poshtë tek ndarja mbi ankimin popullor) me anë të të cilit ai mund të realizojë me lehtë qëllimin e tij.

⁴⁸ Në dallim nga ankimi kushtetues hungarez këtu është e detyrueshme paraqitja me avokat dhe afati është 2-3 muaj më i gjatë. Detyrimi për avokat ka bërë që numri i ankimeve të mos kalojë çdo kufi.

zbatimi i normës konform të drejtave themelore, por kushtetutshmëria e një norme juridike. Si mënyra e konceptimit të ankimit joreal ashtu edhe përvoja e deritanishme e gjykatave kushtetuese (p.sh. asaj polake) tregojnë se ngarkesa e tyre nuk arrin në atë nivel, saqë të detyrojë nevojën e marrjes së masave lehtësuese. Ankimi joreal i shërben vetëm në mënyrë indirekte mbrojtjes së të drejtave themelore, kështu që funksioni i mbrojtjes së kontrollit kushtetues është i konceptuar më brishtë se tek ankimi real. Nëse kjo gjë është e pozitive, duke qenë se mbrojtja juridike nëpërmjet gjykatave të zakonshme parimisht konsiderohet si e mjaftueshme, kjo është më shumë një çështje politiko-juridike, që duhet të përcaktohet nga ligjvënësi.

Problemi i parë ka të bëjë me pasojat e një ankimi joreal të suksesshëm. Në këtë rast, GJK deklaroi antikushtetuese normën juridike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi individual, por nuk shfuqizon vetë vendimin e gjykatës e marrë si pasojë e zbatimit të normës konkrete. Kërkuesi nuk korr kështu asnjë përfitim pozitiv nga fitorja e tij, pavarësisht se ai kontribuoi në respektimin e së mirës së përgjithshme duke eliminuar një normë juridike antikushtetuese. Mund të thuhet se një rezultat i kënaqshëm mund të gjendet në kuadër të pasojave juridike të përgjithshme që sjellin vendimet e marra gjatë kontrollit të një norme si edhe për rastin konkret.

Në kuadër të pasojave të përgjithshme mund të vihen përballë doktrina gjermane e "pavlefshmërisë" dhe ajo austriake e "shfuqizimit". Në Europën Perëndimore hasen të dyja doktrinat, ndërsa vendet e lindjes kanë përkrahur përgjithësisht atë austriake, pra deklarimin e antikushtetutshmërisë që çon parimisht në shfuqizimin e normës me efekt *ex-nunc*. Në këtë rast shfuqizimi i normës në një rast konkret nuk ka fuqi për çështjet e zgjidhura më parë dhe për atë konkrete. E kundërta paraqitet nëse pavlefshmëria do të ketë efekte *ex-tunc* sipas frymës së përgjithshme të doktrinës së pavlefshmërisë, sepse në këtë rast baza ligjore mbi të cilën janë rregulluar marrëdhëniet juridike të caktuara shfuqizohet me vonesë dhe sigurisht që situata antikushtetuese e shfaqur do të pasveprojë. Duke qenë se pasveprimi i vendimeve që shfuqizojnë ligjet antikushtetuese shpesh mund të ketë pasojat mbi sigurinë e sistemit juridik, vendet që kanë ndjekur

doktrinën e pavlefshmërisë kanë rregulluar problemin në mënyra të ndryshme p.sh duke i lënë të paprekura aktet individuale që janë marrë mbi bazë të ligjeve të shpallura të pavlefshme – përveç rasteve kur janë dhënë dënime penale. Këtu mund të shihet si pozitiv edhe fakti se duke mos e shfuqizur normën, si ndërhyrje maksimale në hapësirën rregulluese të ligjvënësit, GJK i jep një mundësi ligjvënësit ta riparojë normën në bazë të interpretimit që ka bërë GJK në vendim.⁴⁹

E kundërta ndodh me ligjvënësin që ka parashikuar doktrinën e eliminimit duke u shmangur disi nga doktrina e pastër dhe duke i dhënë në një farë mase fuqi prapavepruese marrëdhënieve të rregulluara më parë. Pra, më shumë rëndësi paraqet për individin rregullimi lidhur me pasojat e vendimit të GJK sesa arsyetimi teorik i vendimit mbi antikushtetutshmërinë. *Hungaria dhe Polonia* që janë bazuar në doktrinën e eliminimit, kanë ecur në rrugë të ndryshme në lidhje me pasojat e vendimit të GJK. *Hungaria* duke u nisur nga siguria e sistemit juridik i është përmbajtur rreptësisht pasojave të doktrinës së eliminimit. I vetmi përjashtim është rasti kur shqyrtohet një vendim penal, kontrollin e të cilit GJK mund ta fillojë edhe kryesisht duke u shtrirë edhe ndaj personave që janë në proces gjykimi ose të vuajtjes së dënimit.⁵⁰ Përveç kësaj, GJK ka dy mundësi për t'iu shmangur këtij rregullimi strikt.⁵¹ Zbatimi sa më i rrallë i efekteve prapavepruese të një akti, është në interes të sigurisë që duhet të ofrojë sistemi juridik në një vend. Megjithatë ka edhe përjashtime. Kështu, parashikohet fuqia prapavepruese e vendimit kur bëhet fjalë për interesa jetësore të kërkuesit që justifikojnë plotësisht një efekt të tillë. Kjo teori përkrahet në shumicën e rasteve – sipas shembullit

⁴⁹ GJKF gjermane e aplikon këtë mundësi me qëllim që të mos shfuqizojë normën juridike për shkak të rëndësisë që ka ajo për rregullimin e marrëdhënieve konkrete dhe pasojave negative që do të sillte për subjektet e ndryshme që do të prekeshin prej saj, megjithëse e drejta e kërkuesit mund të vihej në vend.

⁵⁰ Një rregull i ngjashëm me nenin 76/2 shkronja "a" dhe "b" e ligjit për GJK shqiptare ku parashikohet fuqia prapavepruese e vendimit të GJK në rastet kur vendimi shtrihet ndaj një vendimi penal i cili është në ekzekutim dhe lidhet drejtpërdrejt me aktin e shfuqizuar ose ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat dhe ndaj të cilave nuk është marrë ende vendim i formës së prerë.

⁵¹ *Georg Brunner*, Die neue Verfassungsgerichtsbarkeit in Osteuropa në: Zeitschrift fuer Auslaendisches Oeffentliches Recht und Voelkerrecht (1998) fq. 861.

austriak – duke e justifikuar me argumentin se kërkuesi ka kontribuar në evidentimin dhe kontrollin gjyqësor të antikushtetutshmërisë së aktit.⁵² *Polonia* ka vendosur të zbatojë një zgjidhje tjetër që i jep përparësi drejtësisë materiale kundrejt sigurisë juridike. Vendimi që merret në fund të kontrollit kushtetues passjell automatikisht riqeljen e procesit civil. Në një çështje penale nuk ka kufizime kohore për paraqitjen e ankimit. GJK polake (Tribunali kushtetues) është kompetente t'i shmanget rregullit lidhur me efektet *ex-nunc* dhe të vendosë shfuqizimin në një afat të hershëm ose të mëvonshëm, por që nuk e kalon periudhën prej 18 muajsh në rastin e ligjeve dhe 12 muaj për aktet nënligjore.⁵³

Në mbyllje, mund të nxirret përfundimi se pasojat e një vendimi pozitiv të një ankimi joreal mbi të drejtat themelore si në *Hungari* ashtu edhe në *Poloni* janë të tilla që i ofrojnë individit mundësi për të inicuar një procedurë të kontrollit kushtetues. Ankimi joreal përmbush njëkohësisht funksionin e një mbrojtje kushtetuese objektive dhe të një mbrojtje subjektive të të drejtave themelore. Ky vlerësim vlen vetëm për rastin kur GJK deklaron antikushtetutshmërinë e normës juridike të atakuar. Problemi i vërtetë i ankimit joreal shfaqet atje, ku norma juridike kushtetuese zbatohet në mënyrë antikushtetuese duke bërë që akti individual të cenojë të drejtat themelore, si dhe në rastet kur norma juridike lejon disa mënyra interpretimi, prej të cilave një pjesë është kushtetuese dhe një pjesë antikushtetuese. Në këto raste shtrohet një pyetje e dyfishtë: si mund të ndihmohet kërkuesi në këndvështrimin e mbrojtjes subjektive të të drejtave themelore dhe si mund t'i shërbehet qëllimit të mbrojtjes objektive kushtetuese në një situatë të caktuar, kur gjykata e zakonshme më e lartë e mbështetur në monopolin e saj të interpretimit të përqendrohet tek formula e gjykimit dhe jo tek arsyet e vendimit të dalë nga kontrolli kushtetues. Ka dy zgjidhje: E para është gjetur nga GJK *italiane* në fillimet e ekzistencës së saj, kur Gjykata e Kasacionit refuzoi të ndiqte praktikën e saj, siç ndodh sot në vende të ndryshme të Europës Lindore. U zhvillua koncepti i "*së drejtës së gjallë* - diritto

⁵² Neni 139 pg 6 dhe neni 140 pg 7 i Kushtetutës austriake.

⁵³ *Brunner*, op.cit. Këtë mundësi ka filluar ta aplikojë edhe GJK shqiptare kohët e fundit.

vivente”, sipas të cilit kontrolli i normës juridike i bazuar në metoda të ndryshme interpretimi nuk duhet t’i referohet asaj përmbajtje që sipas GJK është i drejtë, por interpretimit që norma juridike ka marrë gjatë praktikës gjyqësore të vazhdueshme dhe të njëtrajtshme. Mbi këtë bazë, GJK italiane ka pranuar kërkesat për kontroll konkret normash dhe ato për kontrollin e zbatimit të normave juridike dhe ose i ka deklaruar tërësisht (*sentenza interpretative di accoglimento*) ose pjesërisht (*sentenza di accoglimento parziale*) antikushtetuese dhe të pavlefshme.⁵⁴ Këto vendime nuk ishin të detyrueshme vetëm për palët në proces por edhe për të gjitha organet. Konceptimi i *së drejtës së gjallë* u përkrah edhe nga *Hungaria* që në fillim të veprimtarisë së GJK, por më vonë është zbatuar rrallë. Vetëpërmbajtja e mëpasshme e të dyja GJK gjendet tek gatishmëria e gjykatave të zakonshme për ta pranuar si një kompetencë me rëndësi interpretimin konform Kushtetutës. Ka dhe dy kushte të tjera që e kufizojnë zbatimin e kësaj teknike. Deklarimi i pavlefshëm dhe shfuqizimi është një mbrojtje e rëndësishme që gjykata kushtetuese, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe ligjvënësin demokratik, duhet ta zbatojë vetëm nëse ligji nga aspekti i së drejtës kushtetuese është i papranueshëm për të drejtat themelore. Nëse ligji krijon mundësinë që të interpretohet në një variant tjetër konform Kushtetutës, atëherë ky është një “riparim” që i bëhet atij dhe një zgjidhje e justifikueshme për ta lënë ligjin të veprojë duke i hequr vetëm pjesën antikushtetuese të tij. Këtë zgjidhje gjykata kushtetuese duhet ta shohë në çdo rast si mundësi para se të shkojë tek shfuqizimi i saj.⁵⁵

Së dyti, *e drejta e gjallë* mund të vijë në ndihmë, nëse ekziston një praktikë e vazhdueshme dhe e njëtrajtshme. Nëse nuk ndodhemi para një rasti të tillë dhe vendimi individual që cenon të drejtat themelore i shmanget dukshëm praktikës së krijuar, kjo zgjidhje nuk mund t’i vijë në ndihmë individit. A duhet parë apo jo me rëndësi të veçantë fakti i dëmit që mund t’i vijë individit në rastin konkret, është një çështje që varet nga koncepti i ligjvënësit për

⁵⁴ *Werner Heun/Christian Starck, Verfassungsgerichtsbarkeit im Rechtsvergleich* (2008) fq.226.

⁵⁵ Shih për më tepër vendimin e GJK shqiptare lidhur me zgjedhjen e mbrojtësit të gjykuarit në mungesë nr.30/2010.

kompetencat e GJK në përgjithësi dhe për ankimin joreal në veçanti. Nëse mbrojtja kushtetuese objektive vihet në plan të parë, atëherë duhet të merret parasysh fakti se ankuesit në rastin konkret mund t'i shkaktohet dëm i riparueshëm. Drejtësi absolute nuk mund të vendoset. Po ta shohim këtë pasojë si të papranueshme në lidhje me funksionin e mbrojtjes subjektive të të drejtave themelore, atëherë duhet që kjo të gjejë zgjidhje nga ligjvënësi. Në rast se deklarohet antikushtetutshmëria e një norme, atëherë ligjvënësi duhet t'i shtrijë efektet juridike të parashikuara edhe ndaj pasojave që sjell vendimi interpretues konform Kushtetutës. Kështu mund të mbetet e vlefshme edhe norma juridike e atakuar dhe kërkuesit mund t'i kursehet një padrejtësi.

Një formë e rrallë e kontrollit konkret të normave mbi një kërkesë përbën edhe ankimi individual *rus (individual 'naja zaloba)* e shfaqur në dy variante:

Varianti i parë u parashikua me krijimin e GJK në *Rusi* në fund të 1991 dhe u zbatua deri në pezullimin e GJK nëpërmjet dekretit presidencial në tetor 1993. Ky variant të kujton si ankimin real ashtu dhe atë joreal sa i përket plotësimit të kushtit të cenimit direkt të ankuesit në të drejtat e tij themelore apo interesat e ligjshme, shterrimit të të gjithë mjeteve ligjore dhe respektimit të afatit 3-vjeçar. Veçantia e tij qëndron në faktin se ankimi nuk drejtohej kundër aktit individual dhe as kundër normës juridike ku është bazuar ky akt, por kundër "*praktikës së zbatimit të së drejtës*" (*pravoprimenitel'naja praktika*). Ligji përmbante një përkufizim ligjor të "*praktikës së zbatimit të së drejtës*", por ishte caq i paarritur, saqë nuk mundi të gjente përdorim. GJK nuk u përpoq shumë t'i jepte këtij përkufizimi konture më të sakta, por pranoi që çdo vendim gjyqësor i instancave të larta të konsiderohet si shprehje e një praktike të konsoliduar të zbatimit të së drejtës.⁵⁶ Ideja themelore ishte e njëjtë me atë të së drejtës së gjallë të përdorur nga praktika kushtetuese *italiane dhe hungareze*. Sipas këtij parimi, nëse GJK do të arrinte në përfundimin se vendimi i marrë ka qenë rezultat i një praktike antikushtetuese të zbatimit

⁵⁶ *Otto Luchterhandt/Christian Starck/Albrecht Weber, Verfassungsgerichtsbarkeit in Mittel- und Osteuropa (2007), fq.145.*

të së drejtës, atëherë ajo mund të bënte vetëm deklarin e kësaj antikushtetutshmërie. Kompetenca për të shfuqizuar vendimin individual apo normën juridike mbi të cilën bazohej ai, nuk i ishte njohur GJK. Efektet e vendimit ishin me veprim të gjatë dhe kaq të komplikua dhe antagoniste, sa që nuk jepnin asnjë shpresë për zgjidhje në rastin konkret. Efekti i deklarinimit kufizohej vetëm në rastin konkret, që mund të rishikohej vetëm nga GJL.⁵⁷

Dështimi i formulimit të ankimit individual e shtyu ligjvënësin t'i bëjë një amendim tërësor atij, me anë të të cilit GJK u vu mbi baza ligjore të reja dhe rifilloi veprimtarinë e saj në mars të vitit 1995. Në variantin e dytë ankimi individual paraqitet në formën e një ankimi individual joreal mbi të drejtat themelore, që mënjanon disa mangësi të variantit të parë, por krijon nga ana tjetër probleme të reja. Sipas formulimit të ri, iniciohet një procedurë kontrolli konkret norme, objekt i të cilit nuk është më praktika e zbatimit të së drejtës, por një ligj në kuptimin formal të tij. Si një ligj i tillë klasifikohen ligjet e federatës dhe të shteteve të federuara. Ankimi duhet të mbështetet mbi pretendimin për cenim të të drejtave themelore nëpërmjet ligjit që është zbatuar ose do të zbatohet gjatë një procedure gjyqësore apo administrative. Për pranimin e ankimit kërkohet referimi tek e drejta themelore konkrete dhe pasoja negative e ardhur ose e pritshme.⁵⁸

4.3 Ankimi popullor

Ankimi popullor është një formë e veçantë e kontrollit abstrakt të normave pa patur nevojë të parashtrahet një interes konkret individual dhe real dhe pa plotësuar kushte të tjera.⁵⁹ Një ankim të tillë mund ta bëjnë organe të caktuara kushtetuese dhe individë në raste të caktuara me ligj. Në rradhë të parë ky ankim i shërben mbrojtjes objektive të kushtetutshmërisë së rendit juridik, pjesë

⁵⁷ Një gjë e tillë nuk parashikohej shprehimisht, por gjeti zbatim në praktikë.

⁵⁸ Neni 125/4 i Kushtetutës së Federatës Ruse.

⁵⁹ P.sh shterrimi i të gjitha mjeteve ligjore të ankimit.

e të cilit janë edhe të drejtat themelore si institut më vete. Në vendet e Europës perëndimore nuk është përkrahur shumë ankimi popullor dhe është parashikuar vetëm në dy vende. Fillimisht ky ankim u parashikua në landin e *Bavarisë* (1947) kundër ligjeve dhe akteve të tjera normative të landit. Numri i kërkesave shkon 20-25 në vit, ku kuota e suksesit arrin 15%.⁶⁰ Pikë referemi për kontrollin janë vetëm të drejtat themelore të parashikuara nga Kushtetuta e landit të *Bavarisë*. Vendi i dytë që parashikoi ankimin popullor është *Malta* (1964). Ndoshta për shkak se numri i banorëve të këtij shtetit është i vogël dhe megjithë interesin e tyre nuk është e mundur të mbingarkohet GJK, është parashikuar që ankimi mund të mbështetet thjesht mbi dyshimet për antikushtetutshmërinë e normës, pa qenë nevoja të provohet se jenë prekur të drejtat themelore konkrete të kërkuarit. Në Europën Lindore ky ankim është futur për herë të parë në *Hungari* pa kufizime (1990). Ky ankim mund të paraqitet kundër çdo norme juridike me pretendimin e antikushtetutshmërisë. Nga kjo mundësi përfitojnë qytetarët edhe pse në disa raste me fuqi prapavepruese. Rrugën e Hungarisë e ka ndjekur edhe *Maqedonia* që ka parashikuar ankimin popullor pa kufizime. Numri i kërkesave ka arritur deri në 200 në vit duke fituar një rëndësi të madhe.⁶¹

Për të pasur mundësi kufizimi të ankimeve popullore, është vënë në përdorim termi "*interesa ligjorë*". Ky ankim popullor jo i plotë njihet në *Greqi* prej 1975 megjithëse në hapësira të kufizuara. Në fakt, në *Greqi* ka një gjykatë të posaçme e cila merr në shqyrtim çështje të natyrës kushtetuese. Ajo funksionon si Gjykatë e Lartë Civile dhe Penale dhe në forumin e një Kolegji të veçantë vendos për çështje kushtetuese. Ajo mund të vihet në lëvizje, kur ndodhet para një çështje të kushtetutshmërisë materiale ose interpretimit të një ligji formal, mbi bazën e të cilit janë dhënë tri vendime të kundërta të tri

⁶⁰ Vlen të përmendet që GJK të landeve në Gjermani janë gjykata *ad hoc* dmth mbliidhen vetëm kur ka kërkesa. Numri i kërkesave nuk është i madh dhe ato mund të drejtohen vetëm për të drejta themelore të mbrojtura nga kushtetutat e landeve, ndërsa për të drejtat themelore që garantoohen nga Ligji Themelor Federal Gjerman (Kushtetuta) kompetente është GJKF gjermane.

⁶¹ Neni 50/1 i Kushtetutës maqedonase. Shih për më tepër *Karl Schrameyer*, *Das makedonische Verfassungsgericht* në: WGO-MfOR (1997), fq.251.

gjykatave më të larta të vendit. Nisur nga këto kushte individi ka të drejtë t'i drejtohet kësaj gjykate jo vetëm gjatë një konflikti gjyqësor, por edhe kur vërteton se bëhet fjalë për interesa ligjore të tij.⁶²

Gjithashtu në kufij të ngushtë i është hapur rruga individit për t'iu drejtuar Gjykatës për Zgjidhjen e Konfliktëve edhe në *Belgjikë* (1989). Kjo Gjykatë u caktua në 1984 të vendosë mbi mosmarrëveshjet midis pushtetit qendror, bashkësive kulturore dhe pushtetit lokal, në këtë kuadër edhe mbi ligjet dhe aktet nënligjore. Këtë kompetencë për të ngritur një padi mohuese (*recours en annulation*) e ka çdokush që mund të provojë se paraqitet një interes jetik. Përveç kësaj ai mund ta bëjë këtë, kur një normë juridike e atakuar shkel të drejta themelore konkrete të garantuara me Kushtetutë, p.sh parimin e barazisë, ndalimin e diskriminimit, lirinë e arsimit (neni 24). Padia mohuese është e lidhur me një afat që shkon zakonisht në 6-muaj nga hyrja në fuqi e normës juridike të atakuar.⁶³

Më tej shkon ky ankim në *Slloveni*, ku prej 1994 çdokush mund të inicojë një kontroll abstrakt mbi një normë juridike, nëse ai arrin të vërtetojë se lidhet me një interes ligjor të tij.⁶⁴ Ligjvënësi është përpjekur t'i japë konture sa më të qarta termit "interes ligjor" duke lënë të kuptohet se norma juridike e atakuar duhet të prekë direkt të drejtat, interesat ligjorë apo pozitën juridike të kërkuesit. Kërkesa mund të mos pranohet jo vetëm për shkak të pabazueshmërisë, por edhe kur nuk pritet të sqarohet ndonjë çështje juridike e re ose e patrajtuar më parë. Kjo mundësi shfrytëzohet rrallë. Më shumë synohet që me anë të një praktike precize dhe të gjerë të përcaktohen gjithmonë e më hollësisht kriteret që provojnë interesat ligjorë, për të ulur kështu numrin e ankimeve të individëve. Nëse kërkuesi e paraqet kërkesën duke u nisur nga disavantazhet e mundshme që mund t'i vijnë atij – dhe ky arsyetim pranohet në paraqitjen e kërkesës – llogaritjet e tij për ta shfuqizuar normën *ex nunc* mund të mos dalin, nëse GJK në ushtrimin e kompetencave të saj shfuqizon

⁶² Neni 95/2 i Ligjit grek për Gjykatën e Lartë të Posaçme.

⁶³ Neni 142/3 i Kushtetutës së 1994, e përfshirë pas reformës kushtetuese të vitit 1988.

⁶⁴ Neni 162/2 e Kushtetutës sllovene dhe neni 24/1 i ligjit për GJK sllovene.

normën për të shmangur boshllëqet ligjore ose për të mos i hapur punë ligjvënësit *pro futuro*. Në *Sllloveni* kërkuesi ka një afat prej një viti për të paraqitur ankimin, në *Hungari* është afat i pakufizuar, ku GJK i shmanget parimit të efektit *ex-tunc* sipas këndvështrimit të dobishmërisë së këtij efekti.⁶⁵

Një kompetencë e tillë ka qenë karakteristike për kontrollin kushtetues të *ish-Jugosllavisë* komuniste. Në Kushtetutën e republikave të federuara ishte shprehimisht e parashikuar se kushdo që kishte pretendime lidhur me cenime të të drejtave mund t'i drejtohej GJK. Në fakt, kontrolli i mirëfilltë kushtetues mbi ankimet individuale ka gjetur zbatim vetëm në *Sllloveni* dhe *Kroaci*. Në republikat e tjera, shqyrtoheshin vetëm disa prej akteve të administratës publike. Kjo traditë është ruajtur në shumicën e shteteve që dolën nga federata jugosllave. Vetëm *Slllovenia* e ka refuzuar plotësisht kontrollin kryesisht të GJK, por ka forcuar nga ana tjetër të drejtën e ankimit të individit mbi bazën e ankimit popullor jo të plotë. GJK tjera e kanë ruajtur të drejtën e shqyrtimit *ex officio*, të cilat mund të marrin shkas edhe nga një pakënaqësi apo dyshim sa i përket antikushtetutshmërisë së një norme juridike të caktuar. Nga ana tjetër kjo iniciativë individuale - në *Serbi* quhet "*iniciativë*" dhe në *Kroaci* "*propozim*" - është formalizuar së tepërmi, sa që GJK çdo iniciativë e trajton si një kërkesë që duhet ta shqyrtojë paraprakisht. Mospranimi i ankimit shprehet me një vendim formal. *Maqedonia* ka shkuar një hap përpara duke parashikuar ankimin popullor të plotë.⁶⁶

Pas këtij vështrimi krahasues juridik mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës mundësi që i jepet individit për të inicuar një kontroll kushtetues para GJK, mund të nxirren disa konkluzione. Nuk ka zgjidhje absolutisht më të mira. Ka vetëm zgjidhje relativisht të mira që për vende dhe situata të caktuara janë adekuate. Çështja që shtrohet është se sa e madhe është nevojja për një mbrojtje specifike të të drejtave themelore, ose së paku për një mobilizim të interesave subjektive në mbrojtje të rendit kushtetues objektiv. Është e qartë se

⁶⁵ Shih për më tepër *Georg Brunner*, *Der Zugang des Einzelnen zur Verfassungsgerichtsbarkeit im europaischen Raum* (2001), fq.35.

⁶⁶ *Georg Brunner*, *Die neue Verfassungsgerichtsbarkeit in Osteuropa në: Zeitschrift fuer Auslaendisches Oeffentliches Recht und Voelkerrecht* (1998) fq. 865.

nevoja për një mbrojtje të tillë është më e madhe në ato vende që kanë probleme të konsiderueshme në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe në tërësi të shtetit të së drejtës. Gërshetimi i mbrojtjes ligjore me mbrojtjen gjyqësore e normative të të drejtave themelore duke respektuar kushtet e një shteti të konsoliduar të së drejtës në një vend demokratik mund të sjellë rezultate të pranueshme. Ndërkohë që mjete të tilla për vendet me demokraci të pakonsoliduar janë të pamjaftueshme dhe ndonjëherë të papërshtatshme.⁶⁷ Zhvillimi i mbrojtjes së mundshme të të drejtave themelore në kuadër të kontrollit përfshirës të normave në një mbrojtje kushtetuese specifike është i mundur nëpërmjet plotësimit të sistemit të mbrojtjes juridike lidhur me rishikimin e të drejtave themelore ose nëpërmjet përqendrimin të kontrollit konkret të normave në eliminimin e antikushtetutshmërisë së tyre. Ankimi individual kushtetues real duket se ka zënë vendin e kurorës së mbrojtjes subjektive të të drejtave themelore në një shtet demokratik. Sigurisht ajo ka sjellë një ngarkesë të madhe pune për gjykatat kushtetuese të këtyre vendeve, sidomos për ato me numër të madh popullsie, por gjithashtu njëherazi edhe konflikte në vendet midis gjykatave kushtetuese dhe gjykatave të tjera të larta të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor sa i përket ndarjes dogmatike midis të drejtave themelore dhe atyre ligjore.

Së fundmi, i rikthehemi përsëri idesë së shprehur më sipër, se i takon ligjvënësit të vendosë vetë në ç'masë dhe për ç'qëllim duhet t'i krijojë mundësinë individit për t'iu drejtuar GJK. Vlerësimi i duhur i kërkesave juridiko-politike në vend është detyrë e ligjvënësit. Krahasimi i sistemeve të ndryshme mund t'i vijë në ndihmë atij duke i bërë të qartë përparësitë dhe disavantazhet e secilit për të gjetur kështu rrugën drejt zvogëlimit të problemeve që dalin në praktikë.

⁶⁷ Kështu mund të themi se modeli amerikan funksioni i të cilit është të nxisë iniciativën e çdo gjykate të lartë, potencialin e së drejtës së gjyqtarit për të ushtruar kontroll mbi aktet në funksion të mbrojtjes së të drejtave themelore, nuk do të ishte i përshtatshëm për vende si Shqipëria ku numri më i madh i ankimeve individuale që paraqiten para GJK janë kundër vendimeve gjyqësore.

5. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas GJL amerikane

Në këtë pjesë do të ndalemi shkurt tek specifikat kryesore që paraqet ankimi individual në sistemin anglosakson, konkretisht sipas Kushtetutës së SHBA-ve si vendi më tipik përfaqësues i këtij sistemi. Amendamenti i 5-të i Kushtetutës së SHBA-së parashikon se *"askujt nuk mund t'i kufizohet e drejta e jetës, liria ose prona pa një proces të drejtë (rregullt) ligjor..."*.⁶⁸ Kushtetuta amerikane nuk përmban në fakt asnjë përkufizim të termit "proces i rregullt", megjithatë praktika e pasur e gjykatave amerikane, sidomos e Gjykatës së Lartë (më poshtë: GJL), ka bërë që të ketë një formulim të përgjithshëm të tij. Është tashmë praktikë e vendosur e kësaj Gjykate që klauzola e procesit të rregullt i referohet një sistemi të të drejtave bazuar *"në parime morale që i kanë rrënjët aq thellë në traditat dhe ndjenjat e popullit amerikan sa që mund të konsiderohen vërtetë themelore për një shoqëri të civilizuar siç është ajo amerikane, e krijuar gjatë gjithë historisë së këtij populli. Procesi i rregullt është ai që nuk bie ndesh dhe zhvillohet sipas të gjitha elementëve përbërës të asaj që konsiderohet si e drejtë (fair, right and just)"*.⁶⁹ Procesi i rregullt amerikan nuk kufizohet vetëm në respektimin e rregullave procedurale. GJL amerikane i ka dhënë këtij koncepti një kuptim mjaft të gjerë. Ajo ka theksuar se tek procesi i rregullt duhen gjetur dy anë të mbrojtjes së tij: ajo *substanciale dhe procedurale*. Procesi i rregullt *substancial* shtrihet ndaj akteve të ekzekutivit⁷⁰ që ndërhyjnë/cenojnë të drejta të tilla si: prona, liria ose jeta. Ndërsa aspekti *procedural* i procesit të rregullt ka të bëjë me procedurat që ndjek qeveria sa herë që kufizon të drejta të tilla si jeta, prona dhe liria.

68 Për qëllimet e këtij botimi do të përdoret termi "proces i rregullt" edhe për ankimin individual amerikan, megjithëse në botime të ndryshme të gjuhës shqipe gjen përshtatje të tilla si "proces i drejtë".

69 Çështja *Solesbee k. Balkcom*, 339 U.S. 9 (1950).

70 Me termin *ekzekutiv* - government do të kuptojmë të gjitha degët e pushtetit, sipas konceptit amerikan për këtë qëllim.

5.1 *Aspekti substancial*

Sa herë që GJL amerikane shprehet për të drejta të tilla si: jeta, liria ose prona, ajo bën trajtim substancial të procesit të rregullt. Ky interpretim i shërben asaj për ngritur në nivel kushtetues edhe ato elementë që nuk parashikohen direkt nga teksti i Kushtetutës. Gjithashtu, interpretimi i nevojitet GJL për të bërë të ashtuquajturin *strict scrutiny test* të ndërhyrjes shtetërore në të drejtat themelore.⁷¹ GJL tregohet e kujdesshme dhe e përmbytur në praktikën e saj lidhur me shqyrtimin substancial të procesit të rregullt. Elementë të rëndësishëm ku mbështetet Gjykata gjatë gjykimit të saj janë kryesisht: (1) koncepti i garantimit implicit të së drejtës; (2) roli i traditës; (3) rëndësia e precedentëve kushtetues; (4) zgjerimi i konceptit kushtetues të lirisë në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Përballë këtyre katër elementëve kuptimi modern i procesit të rregullt ka evoluar, duke u fokusuar më së shumti në karakterin thelbësor që kanë interesat individuale. Kështu, në një çështje ku bëhej fjalë për ndalimin e mësimi të gjuhës së huaj në disa shkolla të caktuara, ajo ka argumentuar se *"...pa dyshim që liria nuk përfshin lirinë e individit vetëm në aspektin trupor të tij; liria përfshin edhe të drejtën e individit të veprjë lirisht, të angazhohet në aktivitete që ai dëshiron me qëllim përfitimin e dijeve të nevojshme, lirinë për t'u martuar, për të ngritur familje dhe për të rritur fëmijë, lirinë për të nderuar Zotin, sipas urdhërimeve të tij dhe ndërgjegjes së individit, dhe në përgjithësi të gëzojë ato privilegje që në sistemin e së drejtës zakonore (common law) prej kohësh konsiderohen si të domosdoshme për gëzimin e një jete prej njeriu të lirë"*.⁷²

Me pak fjalë, kontrolli do të konsiderohet substancial kur, GJL, për të arritur në përfundimin nëse ka shkelje të një të drejte themelore, kontrollon të gjithë procesin e vendimmarrjes përfshi edhe atë politik. Kriteret e kontrollit për GJL janë të drejtat themelore të

⁷¹ *Strict Scrutiny test* është testi që aplikon GJL për të peshuar ndërhyrjen e qeverisë në të drejtat themelore të individit. E ngjashme me testin e proporcionalitetit që përdor edhe GJK shqiptare, kur shqyrton rastet e kufizimeve të të drejtave themelore të individit sipas nenit 17 të Kushtetutës shqiptare.

⁷² Vendimi i GJL të SHBA *Mayer k. Nebraskas*, 262 U.S 390, 399 (1923).

garantuara nga Kushtetua e SHBA-së, por gjithashtu edhe të drejta të tjera që në praktikën e asaj Gjykate janë konsideruar si pjesë e jetës, lirisë dhe pronës.⁷³ Rëndësi të veçantë sa i takon termit "liri" garantuar nga neni 5 dhe 14 i Kushtetutës së SHBA-së ka interpretimi substancial i procesit të rregullt (*substantive due process*). Ai përfshin shpalsjen private, ekonomike, politike, kulturore dhe fetare të personalitetit të njeriut. Në një kuptim tjetër të aspektit substancial të procesit të rregullt mund të thuhet se ka dhe një trajtim që lidhet me vlerat kushtetuese, të cilat kanë prioritet sa i takon të drejtave themelore që lidhen me demokracinë. Duke qenë se interpretimi i lirisë, barazisë, drejtësisë si vlera kushtetuese janë të diskutueshme dhe nuk mund të vlerësohen gjithmonë objektivisht, atëherë edhe interpretimi i Kushtetutës duhet të shkojë drejt konkretizimit të këtyre vlerave. Kontrolli kushtetues, i parë në këtë këndvështrim, ka për detyrë të mbrojë procesin demokratik dhe jo të kontrollojë përmbajtjen e rezultateve të këtij procesi. Termi "substancial" mund të shtrihet ndaj peshës së interesit publik, balancës midis qëllimit dhe mjetit si dhe në përgjithësi ndaj aspektit të rëndësisë, nevojës dhe përshtatshmërisë së ndërhyrjes. GJL ka aplikuar dy metoda të ndryshme lidhur me interpretimin modern të procesit të rregullt: e *para* është konservative/e përmbajtur, e *dyta* është aktiviste/ liberale.⁷⁴

Mënyra e trajtimit të aspektit substancial të procesit të rregullt është kritikuar mjaft sa i takon faktit se GJL mbron të drejta që nuk janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë ose nuk përputhen me vullnetin e hartuesve të saj. Kritika janë drejtuar edhe sa i takon mënyrës së arsytimit të GJL lidhur me procesin e rregullt. Në historinë moderne të GJL amerikane ka patur dy linja kryesore të procesit substancial. Më herët, në vitet '30-të, Gjykata e përdori këtë aspekt për të mbrojtur liritë ekonomike sidomos lirinë kontraktuale si një të drejtë themelore. Në çështjen *Lochner k. New York*, GJL

⁷³ *Winfried Brugger, Grundrechte und Verfassungsgerichtsbarkeit in den Vereingiten Staaten von Amerika (1997), fq.44.* Këtu ka një ngjashmëri me interpretimin e zgjeruar që bën edhe GJKF gjermane e përmendur më sipër.

⁷⁴ Brugger, op.cit. fq.143.

deklaroi si antikushtetues ligjin që parashikonte se sa orë duhej të punonte një bukëpjekës, duke mos dhënë ndonjë shpjegim se përse kjo kishte lidhje me nenin 5 të Kushtetutës.⁷⁵ Në periudhën më të vonshme procesi substancial është përdorur për të mbrojtur të drejtën e privatësisë dhe autonominë personale. Çështja *Roe k. Wade*, e cila u bë shkak për legalizimin e abortit, është një nga më të famshmet e kohës dhe një nga çështjet më të rëndësishme të procesit substancial, pasi vendimi në këtë çështje u mbështet mbi autonominë vendimmarrëse të nënës lidhur me abortin.⁷⁶

Nga ana tjetër, mbrojtësit e aspektit substancial të procesit të rregullt i referohen nevojës për mbrojtje që ka individi nga aktet e ligjvënësit. Në këtë linjë edhe vetë GJL amerikane, më shumë se një shekull më parë, ka deklaruar se procesi i rregullt "*është një kufizim për ligjvënësin, për ekzekutivin dhe gjyqësorin dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që t'i krijojë mundësinë Kongresit të miratojë akte sipas vullnetit dhe dëshirës së tij*".⁷⁷ Klauzola e procesit të rregullt ligjor përfshin dispozita të *Bill of Rights* që konsiderohen themelore si dhe elementë të tjerë që nevojiten për t'i garantuar të drejtat e parashikuara në këtë katalog. Ky është procesi substancial: pra, përdorimi i të drejtave procedurale për të mbrojtur të drejta materiale.⁷⁸ Procesi i rregullt është një koncept i së drejtës kushtetuese që përfshin dy rrafshe: GJL amerikane i referohet kuptimit përmbajtësor, material, të procesit të rregullt me qëllim që të drejtat që nuk janë parashikuar specifikisht në Kushtetutë t'i përfshijë në thelbin e lirisë, e cila nuk mund të kufizohet pa iu nënshtuar procesit të rregullt.

⁷⁵ Vendim i GJL *Lochner k. New York*, 198 U.S 45 (1905).

⁷⁶ Vendim i GJL *Roe k. Wades*, 410 U.S. 113 (1973).

⁷⁷ Vendim i GJL *Murray's Lessee k. Hoboken Land & Improv.Co.* 59 U.S. 272 (1856).

⁷⁸ *Erwin Chemerinsky, Constitutional Law, Principles and Policies* (2006), fq.548.

5.2 *Aspekti procedural*

Procesi substancial ka rëndësi sa i takon gjykimit lidhur me masat ndërhyrëse të shtetit në fushën e lirisë (*fairness of rules and rule making*). Krahas këndvështrimit evolutiv të të drejtave themelore dhe rëndësisë që merr thelbi i procesit të rregullt në tërësi, paraqitet jo më pak tërheqës edhe aspekti procedural i tij. Në aspektin procedural të procesit të rregullt rëndësi të veçantë marrin kriteret sipas të cilave zbatohen në praktikë rregullimet e organeve shtetërore (*fairness of adjudication*).⁷⁹ Në aspektin procedural, GJL konstaton nëse ndodhet para ndonjë ndërhyrje në jetën, lirinë ose pronën dhe më pas kufizohet tek kontrolli i aktit që ka shkaktuar cenimin e së drejtës, pra nëse ai ka qenë apo jo në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt. Kushtetuta amerikane ka marrë një rëndësi të madhe pikërisht nga interpretimi dhe mënyra e zbatimit të dispozitave lidhur me garancitë procedurale. Nga 23 të drejta që përmban *Bill of Rights* 12 prej tyre janë garanci procedurale. Megjithëse në to trajtohen hollësisht dhe specifikisht garanci që lidhen me përmbajtjen e nenit 5 të Kushtetutës, GJL i ka interpretuar këto norma jo vetëm specifikisht duke i lidhur me personin dhe çështjen konkrete, por në një masë të madhe edhe nga pikëpamja strukturore duke i lidhur ato me mënyrën se si duhet të zhvillohet një proces penal në gjykatat amerikane.

Nëse do të gjykonim mbi qëndrimin e GJL në dekada mund të thuhet se ajo ka qenë e larmishme. Kështu, gjatë viteve '60-të ajo ka mbajtur një qëndrim aktiv, i cili është komentuar edhe si konstitucionalizimi i procesit penal. Në vitet '70-të dhe '80-të zgjerimi i garancive procedurale pësoi një ngadalësim, pati vetëm kozmetikë të kujdesshme të tyre ose interpretim të moderuar. Ky ndryshim në literaturë i dedikohet edhe përbërjes së GJL, e cila u dha më shumë pas ndarjes institucionale midis gjyqësorit dhe aktivizmit politik. Gjithashtu, ajo pati dhe një prirje për të interpretuar gjerësisht parimin e federalizmit, duke theksuar se e drejta penale dhe procedurale penale është çështje e shteteve anëtarë të federatës dhe

⁷⁹ *Edward Rubin, Due Process and the Administrative State, 72 California Law Review 1044 (1984).*

ajo nuk mund të ndërhyjë në mënyrën se si gjykatat e shteteve i interpretojnë normat përkatëse.

Jurisprudenca e GJL amerikane është zhvilluar kryesisht në dy drejtime: së *pari*, GJL ka patur tendencë ta shtrijë interpretimin e procesit të rregullt të garantuar nga neni 14 i Kushtetutës edhe ndaj shteteve të federuara, gjë e cila, megjithë përpjekjet, nuk solli ndonjë unifikim të praktikës gjyqësore prej tyre. Së *dyti*, GJL ka bërë një interpretim të zgjeruar të garancive procedurale gjë që ka çuar në një ndryshim rrënjësor të procedurës penale. Kështu, si elementë të procesit të rregullt nga këndvështrimi i praktikës së GJL mund të përmendim: (1) njoftimi i menjëhershëm i shtetasit për masat që kufizojnë jetën, pronën ose lirinë e tij; (2) përcaktimi i organit kompetent për shqyrtimin e ankesave; (3) zhvillimi i seancës dëgjimore ose parashikimi i mundësisë për t'u shprehur me shkrim; (4) zgjedhja e një mbrojtësi; (5) mundësia për të thirrur dëshmitarë dhe për të paraqitur prova ose për të pyetur dëshmitarët e thirrur nga pala kundërshtare; (6) dhënia e një vendimi të arsyetuar bazuar në aktet e paraqitura në seancë; (7) e drejta e mbrojtjes;⁸⁰ (8) e drejta për të mos dëshmuar kundër vetes;⁸¹ (9) ndalimi i dënimeve çnjerëzore dhe të pazakonta;⁸² (10) e drejta për t'u gjykuar nga një juri/gjykatë;⁸³ (11) e drejta për të mos u dënuar dy herë për të njëjtën

⁸⁰ Çështja *Powell k. Alabamës*, 287 U.S 45 (1932), cilësohet si një nga vendimet lapidar ku GJL është përballur me nevojën për të interpretuar të drejtën e mbrojtjes në të gjitha proceset penale; *Johnson k. Zerbst*, 304 U.S 458 (1938); *Scott k. Illinois*, 440 U.S > 367 (1979).

⁸¹ Çështja *Bram k. United States*, 168 U.S. 532 (1987).

⁸² Ky është një ndalim që rrjedh nga neni 14 dhe ka të bëjë me mosdhënien e vendimeve penale të tilla që janë joproporcionale, barbare dhe çnjerëzore. Për herë të parë GJL e ka sanksionuar këtë parim në çështjen *Robinson k. Kalifornisë* 370 U.S. 660 (1962). P.sh GJL e ka konsideruar si joproporcionale dënimin me vdekje për shkak të kryerjes së veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë ndaj një gruaje madhore. Ndërsa sa i takon zgjatjes së tepruar të dënimit, GJL nuk i merr pothuajse fare në shqyrtim këto kërkesa. Ajo tregohet e kujdesshme kur i paraqiten kërkesa për anulimin e dënimit me vdekje, si dënim ekstrem.

⁸³ Sipas nenit 8 të Kushtetutës, (një nga amendamentet e bëra në Kushtetutën amerikane) parashikohet që në çdo proces penal, i pandehuri ka të drejtën e një gjykimi publik nga një juri/gjykatë. Në fakt kjo e drejtë shtrihet jo ndaj çdo akuze por vetëm kur vepra penale që atribuohet parashikohet të dënohet me mbi 6 muaj burgim dhe kur vepra e kryer është nga ato që bien ndesh me "normat e moralit të përgjithshëm të shoqërisë". Shih çështjen *District of Columbia k. Lcawans*, 300 U.S. 617 (1937).

vepër.⁸⁴ Pra, në përgjithësi garancitë procedurale që garantohen nga neni 5 dhe 14 i Kushtetutës amerikane janë të ngjashme me garancitë e nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 42 të Kushtetutës shqiptare, e elaboruar në praktikë të vazhdueshme nga GJK.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se GJL amerikane në aspektin procedural të procesit të rregullt përqendrohet në dy çështje kryesore: (1) A ndodhemi para një ndërhyrje në të drejtën e jetës, lirisë dhe pronës, në kuptim të nenit 5 dhe 14 të Kushtetutës? Nëse po: (2) Cilat të drejta procedurale gëzon subjekti i prekur nga ndërhyrjet e shtetit? Përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk kanë qenë asnjëherë shterruese dhe të qendrueshme siç u përmend edhe më lart. Jurisprudenca e GJL ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimi, të cilat kanë pasqyruar integritetin dhe këndvështrimin institucional në një kohë të caktuar, si dhe kriteret e balancës që ka vendosur gjykata gjatë kontrollit të saj.⁸⁵

6. Kuptimi i procesit të rregullt sipas GJEDNJ

Në këtë nënçështje do të fokusohemi më shumë në drejtim të hapësirës që parashikon KEDNJ, e konkretizuar nga praktika e GJEDNJ, lidhur me procesin e rregullt pa u ndalur në të drejta të veçanta për shkak të përfshirjes në masë të madhe të praktikës së GJEDNJ në jurisprudentcën e GJK shqiptare, e cila do të vijë e elaboruar sipas tematikës më poshtë.

Hartuesit e Konventës Europiane, kur kanë parashikuar të drejtat themelore, kanë patur si qëllim që interpretimi i termave dhe koncepteve të përfshira në të të jetë autonom nga përkufizimi që mund t'i jepet atyre nga legjislationet ose organet kompetente të shteteve

⁸⁴ *Joanne Banker Hames/Yvonne Ekern*, Constitutional Law, Principles and Practice (2005) fq.256.

⁸⁵ *William van Alstyne*, Cracks in the New Property: Adjudicative Due Process in the Administrative State, 62 Cornell Law Review 445 (1977).

anëtare.⁸⁶ Nëse çdo shtet palë në Konventë do t'i interpretonte në mënyrë autonome konceptet e papërcaktuara në mënyrë të shprehur ose shtrruese të Konventës, atëherë çdo shtet do të përcaktonte vetë shkallën e detyrimit që i lind atij nga zbatimi i saj. Kjo do të çonte një praktikë të ndryshme dhe të paparashikueshme si nga shtetet ashtu edhe nga GJEDNJ, çka do të sillte mospasjen e një standarti (minimal ose maksimal) të mbrojtjes ose të kufizimeve të drejtave të garantuara nga Konventa. Kjo do të ndikonte në efektin real që do të kishte Konventa dhe vetë jurisprudenca e GJEDNJ. Në këtë kuadër duhet parë edhe standarti i procesit të rregullt, garantuar kryesisht nga neni 6 i KEDNJ. Organet e krijuara nga KEDNJ janë përpjekur mjaft të japin një përkufizim uniform ose evropian të hapësirës mbrojtëse të nenit 6, i cili përputhet (pjesërisht) në formulim me përmbajtjen e nenit 42 të Kushtetutës sonë. Megjithatë, GJEDNJ nuk ka arritur të japë një definicion përfundimtar dhe gjithëpërfshirës të hapësirës së kontrollit të nenit 6. Ajo e filloi përpjekjen me çështjen *Ringeisen*⁸⁷ dhe deri sot, megjithë zinxhirin e gjatë të vendimeve të saj, ajo i ka përfshirë garancitë e kësaj dispozite rast pas rasti duke i dhënë një mbrojtje të konsiderueshme individit nga veprimet e administratës publike. Në çështjen *Ringeisen*, Gjykata theksoi se për të vendimmarrja në një çështje nuk varet nga fakti se cila degë e gjyqësorit ka vendosur mbi një çështje/mosmarrëveshje, por varet nga karakteri i të drejtës që cenohet. Vlen të ndalemi pak më gjatë në këtë çështje për të kuptuar drejt interpretimin e GJEDNJ sa i takon kompetencës së saj për të përfshirë në hapësirën e nenit 6/1 të KEDNJ çështje të natyrave të ndryshme.

Në çështjen *Ringeisen*, kërkuesit i ishte mohuar nga autoritetet administrative leja për të blerë një truall. Gjykata e interpretoi këtë si cenim të të drejtave civile (*civil rights*) për shkak të marrëdhënieve kontraktuale që ekzistonin midis palëve në kontratën e shitblerjes. Meqënëse pretendimet me natyrë civile duhet të jenë patjetër objekt i mosmarrëveshjes sipas nenit 6 të KEDNJ, pra në rastin konkret midis kërkuesit dhe zyrës për qarkullimin juridik të trojeve, Gjykata duhet të argumentonte që në rastin konkret kishte të bënte me

⁸⁶ *Frowein/Peukert*, EMRK-Kommentar, (1996) fq.5.

⁸⁷ Çështja *Ringeisen k. Austrisë*, 22 qershor 1972.

mosmarrëveshje civile ose të jepte argumente se midis palëve vihej në diskutim edhe ndonjë e drejtë tjetër ligjore. Këto të fundit duhet të jenë të lidhura me të drejtat themelore të tilla si e drejta e pronës. Gjyqtarët e GJEDNJ vendosën për një qëndrim dualist, që konsistonte në parimin që: pretendimi/mosmarrëveshja e natyrës civile konsiderohet si objekt gjykimi edhe kur ajo është indirekte, mjafton që me të të lidhet një e drejtë themelore që garantohet nga Konventa. Me kalimin e kohës, Gjykata i reduktoi kërkesat e saj për ta konsideruar aktin administrativ si objekt të shqyrtimit të saj. Për të ishte e mjaftueshme që edhe në mënyrë tangente mosmarrëveshja të lidhej me një të drejtë themelore dhe ajo e kalonte çështjen për gjykim. Në këtë mënyrë u bë e padukshme vija ndarëse midis të drejtës private dhe të drejtës publike.⁸⁸

Megjithatë, Gjykata është shprehur për kufijtë e shqyrtimit të saj jo vetëm kur bëhej fjalë për të drejtat por edhe për detyrimet e shtetasve. Në çështjen *Schouten dhe Meldrum* Gjykata vlerësoi se nuk mund të bëhej fjalë për mosmarrëveshje të natyrës civile "kur një detyrim, i cili është me natyrë financiare rrjedh nga legjislatiioni për taksat ose është pjesë e detyrimeve të tjera normale qytetare në një shoqëri demokratike".⁸⁹ Pra, përgjithësisht sa i takon pagesave publike (taksat, tatimet etj) neni 6/1 i KEDNJ nuk gjen zbatim. Gjykata në një vendim tjetër ka pranuar se edhe në një marrëdhënie të natyrës së të drejtës së taksave ka cenim të nenit 14 të KEDNJ lidhur me ndalimin e diskriminimit në bashkëveprim me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.⁹⁰

Neni 6 i KEDNJ ze një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo Konventë. Një gjykim i drejtë në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës dhe

⁸⁸ *Andreas Kley-Struller*, Art.6 EMRK als Rechtsschutzgarantie gegen die oeffentliche Gewalt (1993), fq.50. Këtu vlen të mbahet parasysht edhe parimi sipas të cilit GJEDNJ e interpreton Konventën si "living instrument".

⁸⁹ Vendim i GJENDJ, *Schouten dhe Meldrum k. Hollandës*, 9 dhjetor 1994. Ka patur debate për shprehjen "detyrime normale qytetare" se deri ku shkon kufiri i saj për shkak se çështjet që lidhen me taksat janë të shumta dhe nuk mund të përjashtohet të gjitha nga kundërshtimi gjyqësor.

⁹⁰ Çështja *Darby k. Spanjës*, 23 tetor 1990.

pjesë e trashëgimisë së përbashkët, sipas Preambulës së Konventës. Ndërsa neni 6/2 dhe 6/3 përmban dispozita specifike që vendosin minimumin e të drejtave që duhen respektuar gjatë procesit penal, neni 6/1 aplikohet edhe për procesin civil. Neni 6 është dispozita më e përdorur nga kërkuessit që i drejtohen GJEDNJ. Megjithatë mjaft elementë përbërës të kësaj dispozite janë konceptuar si autonome dhe si të tilla kanë shtruar nevojën e interpretimit të gjerë nga GJEDNJ. Vlen të theksohet se, pavarësisht vendimit që ajo jep, Gjykata nuk ka kompetencë të urdhërojë rihapjen e procesve gjyqësore për shkak të shkeljeve që ajo mund të konstatojë se janë bërë gjatë procesit. Detyra e Gjykatës duke u mbështetur në kërkesat e nenit 6 është të ekzaminojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i drejtë dhe i pajtueshëm me garantitë specifike të mbrojtura nga Konventa. Ndryshe nga një gjykatë apeli kombëtare, Gjykatës nuk i interesojnë çështjet lidhur me faktin nëse dënimi ka qenë i drejtë apo vendimi ishte i përshtatshëm, dëmshpërblimi i dhënë nga gjykatat kombëtare ka qenë në përputhje me ligjin e brendshëm etj. Gjithashtu, vendimi i GJEDNJ për mospërmbushjen e standarteve të nenit 6 nga gjykatat vendase nuk sjell shfuqizimin e vendimeve të këtyre të fundit, pra nuk bën të pavlefshëm vendimin e fajësisë ose ndryshimin e vendimit. GJEDNJ e quan këtë si respektim të parimit të mosqenies "shkallë e katërt" duke theksuar se ajo nuk duhet parë si instancë e tretë ose e katërt ankimi ndaj gjykatave kombëtare por thjesht si një riparuese e të drejtave të cenuara me mjetet që ofrojnë vetë legjislacionet kombëtare duke u rekomanduar atyre zgjidhjen më të mirë në rastin konkret.⁹¹ Pajtueshmëria e vendimeve gjyqësore me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ nuk do të thotë se kjo dispozitë mund të zbatohet e vetme dhe pa u kombinuar me të drejta të tjera të Konventës. Madje disa prej standarteve të procesit të drejtë janë vendosur nga praktika e gjerë e GJEDNJ, pavarësisht se nuk janë parashikuar shprehimisht në dispozitat e Konventës. Praktika e organeve të Konventës (Gjykata dhe Komisioni, për aq kohë sa ky i fundit funksionoi) kanë ndjekur linjën e një zgjerimi të vazhdueshëm të hapësirës së veprimit të nenit 6 të KEDNJ.

⁹¹ *Claire Ovey, RobinWhite, European Convention on Human Rights (2006), fq.159.*

Lidhur me pretendimet për proces të parregullt ligjor para institucioneve kombëtare, GJEDNJ mund t'i drejtohen shtetet palë, persona fizikë dhe juridikë. Sipas GJEDNJ, individë konsiderohen personat fizikë dhe juridikë. Ata mund t'i drejtohen GJEDNJ vetëm nëse dëshmojnë se kanë qenë drejtpërdrejt dhe personalisht të dëmtuar nga veprimi ose mosveprimi i administratës publike të shtetit konkret. Ankimi popullor nuk pranohet.⁹² Koncepti i të dëmtuarit në Konventë ka një kuptim autonom që i nënshtrohet një interpretimi të pavarur nga dispozitat e brendshme që lidhen me interesin juridik ose me zotësinë juridike për të vepruar. Sipas Konventës, i dëmtuar do të konsiderohet ai person që është realisht i cenuar nga veprimi ose mosveprimi që përbën shkelje sipas vetë Konventës (*actual victim*).⁹³ Megjithatë i dëmtuar quhet edhe personi, i cili ka shkaqe serioze dhe të arsyeshme të besojë se në çdo rast mund të bëhet viktimë e shkeljes së Konventës (*potential victim*). Kjo ndodh kur, në rrethana të caktuara, ai gjendet në rrezën e veprimeve që janë në kundërshtim me Konventën ose të praktikave të ngjashme të organeve qeveritare. Mbi këtë bazë p.sh një grua ka mundësi t'i kundërshtojë dispozitat ligjore që ndalojnë abortin, nëse mendon se kjo përbën ndërhyrje në jetës e saj private ose familjare që nuk pajtohet me Konventën. I dëmtuar në këtë aspekt për shkak të legjislacionit kundër abortit mund të jetë edhe bashkëshorti ose partneri i gruas. Në çështjen *H k. Norvegjisë*, Komisioni cilësoi se babai i ardhshëm është kaq i rrezikuar nga mundësitë ligjore të ndërprerjes së shtatëzarisë nga ana e gruas, sa që mund të konsiderohet si i dëmtuar.⁹⁴

Gjithashtu, GJEDNJ ka pranuar se "*individit në rrethana të caktuara mund të pretendojë njohjen si palë e dëmtuar si pasojë e shkeljes së Konventës për shkak të pranisë së masave të fshehta apo të dispozitave ligjore që i lejojnë këto masa pavarësisht faktit nëse janë*

⁹² Në një rast një shtetas austriak pretendoi para GJEDNJ se legjislacioni i vendit të tij që rregullonte çështjet e abortit binte ndesh me nenin 2 dhe 8 të Konventës për shkak të pasojave negative për të ardhmen e mbarë popullit si dhe për parimet e tij morale dhe juridike. Ai e paraqiti ankimin "në emër të të gjithë të palindurve". Gjykata nuk e pranoi kërkesën si e ngritur *in abstracto*. Vendimi X k. *Austrisë*, 10 dhjetor 1976.

⁹³ Çështja *Andronicou dhe Constantinou k.Qipros*, 5 korrik 1995.

⁹⁴ Vendim i datës 19 maj 1992.

përdorur kundër tij realisht".⁹⁵ Gjykata ka vlerësuar se jo vetëm për personat që preken direkt por edhe personat e lidhur ngushtë me ta mund të pretendohet se u janë cenuar të drejta të parashikuara nga Konventa. Kështu ajo ka vendosur dhënien e dëmshpërblimit veçueshëm së ankuesit për shkeljen ndaj tij të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata pohoi se si rezultat i kësaj shkeljeje dhe burgosjes së padrejtë të të shoqit ajo kishte vuajtur fizikisht dhe psikikisht si dhe kishte pësuar humbje financiare.⁹⁶

Kushti që ankimi duhet të paraqitet nga i dëmtuari nuk e përjashton mundësinë e paraqitjes së ankimit në raste të rralla nga një person tjetër por në favor të të dëmtuarit. Kjo mund të ndodhë në rastet kur i dëmtuari nuk është në gjendje ta bëjë këtë personalisht si rezultat p.sh i arrestimit, i zhdukjes, i shtrimit në spitalin psikiatrik. Në raste të tilla mund të veprojnë anëtarët e familjes, kujdestarët ose persona të tjerë të parashikuar nga ligji. Në rastet e vdekjes së ankuesit anëtarët e familjes kanë në përgjithësi të drejtën që ta vazhdojnë çështjen. Interesi i tyre prezumohet.⁹⁷

Lidhur me personat juridikë, GJEDNj është shprehur se u njeh edhe atyre të drejtën e ankimit, në konceptin autonom të nenit 34 të Konventës duke përfshirë në termin organizatë edhe ato që veprojnë me qëllime fitimi.⁹⁸ Kjo vlen për të gjitha shoqatat por edhe për shoqëritë, kooperativat dhe strukturat e organizuara duke përfshirë kishat, pavarësisht statusit juridik që ata kanë.⁹⁹

Ankimi para GJEDNj është një mjet juridik plotësues ose *subsidiar*. Për të ushtruar këtë mjet duhet që individi t'i ketë shterrur të gjitha mjetet e brendshme juridike. Në këtë aspekt, por jo vetëm, ky ankim

⁹⁵ Çështja *Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë*, 6 shtator 1987.

⁹⁶ Çështja *Colozza k. Italisë*, 12 shkurt 1985.

⁹⁷ Çështjet *Vocaturò k. Italisë*, 24 maj 1991; *Raimondo k. Italisë*, 22 shkurt 1994.

⁹⁸ Çështja *Sunday Times k. Britanisë së Madhe*, 26 prill 1979; *Mark Intern Verlag GmbH k. Gjermanisë*, *Grobera Radio AG dhe të tjerë k. Zvicrës*, 28 mars 1990; *National & Provincial Building Society k. Britanisë së Madhe*, 23 tetor 1997.

⁹⁹ Ka vende legjislacioneve të cilave i konsiderojnë komunitetet fetare si subjekte të së drejtës publike, ndërsa të tjera i konsiderojnë ato si subjekte të së drejtës private duke iu referuar parimit të laicitetit të shtetit.

ngjan me ankimin individual para gjykatës kushtetuese. Shterrimi i mjeteve juridike të brendshme vlen vetëm për rastet kur ka mjete ankimi efikase me të cilat është i mundur riparimi i shkeljes. Për të vlerësuar nëse janë ezauruar apo jo të gjitha mjetet juridike të brendshme është e rëndësishme të analizohet nëse individit ka patur mjete të tilla që t'i garantojnë atij një mbrojtje efektive dhe jo iluzore të të drejtës së shkelur. Për çdo rast bëhet një analizë e plotë e situatës juridike kombëtare.¹⁰⁰ Në këtë rast, Gjykata kontrollon nëse mjetet juridike që parashikon neni 35 i Konventës janë apo jo të disponueshme. Pra, ankuesi duhet të ketë mundësinë që personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të nisë procesin e duhur. Kjo normë i referohet vetëm shfrytëzimit të mjeteve juridike që lidhen direkt me shkeljet e Konventës dhe që garantojnë atij në mënyrë të mjaftueshme riparimin e dëmit. I dëmtuari nuk ka nevojë që t'u referohet mjeteve, të cilat megjithëse teorikisht janë mjete ligjore, nuk lejojnë një riparim të kënaqëshëm të shkeljes së supozuar të Konventës. Individit mund të mos shfrytëzojë një mjet të caktuar nëse arrin të argumentojë se një gjë e tillë do të ishte e pakuptimtë duke iu referuar praktikës së deritanishme.¹⁰¹ Gjithashtu, ankuesi duhet të paraqesë ankimet para organeve të brendshme kompetente me të njëjtat pretendime që do të paraqesë edhe ankimin para GJEDNJ.

Në pajtim me parimet e njohura gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare, mund të ekzistojnë rrethana të veçanta që e shkarkojnë të dëmtuarin nga detyrimi i përdorimit të mjeteve të brendshme. Kjo u referohet situatave që dëshmojnë eksistencën e praktikave administrative që konsistojnë në veprime të përsëritura të papajtueshme me Konventën dhe nga tolerimi i institucioneve zyrtare, të cilat bëjnë që procedurat të jenë të pavlefshme. Me

¹⁰⁰ Shih çështjen *Holzinger k. Austrisë*, 30 janar 2001; *Cerin k. Kroacisë*, 8 mars 2001.

¹⁰¹ Këtu mund të përmendim edhe çështjen *Qufaj k. Shqipërisë*, 30 mars 2005 (vendimin mbi pranueshmërinë), ku GJEDNJ ka theksuar se ankimi para Avokatit të Popullit nuk përbën mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, pasi nuk mund të marrë vendime të detyrueshme. Për këtë arsye, nuk kërkohet të shterohet ankimi para tij me qëllim investimin e GJEDNJ. Sa i takon ankimit para GJK shqiptare, GJEDNJ vazhdimisht ka theksuar se ai është efektiv dhe duhet të trajtohet si i tillë jo vetëm nga individët por edhe nga organet e tjera të shtetit. Shih për më shumë nënçështjen "GJEDNJ për GJK shqiptare".

tolerim zyrtar duhet kuptuar situata, në të cilën aktet e shkeljeve serioze lejohen, në kuptimin, që eprorët e personave, të cilët janë direkt përgjegjës, duke patur dijeni për to, nuk ndërmarrin asnjë veprim, me qëllim hetimin dhe parandalimin e vazhdimit të kësaj praktike si dhe organet e larta të pushtetit përballë këtyre fakteve janë indiferente ose i miratojnë në heshtje ato.¹⁰² Gjykata ka theksuar se në raste të tilla, barra e provës është e shpërndarë: nëse shteti ngre pretendimin se kërkuesi nuk i ka shterrur të gjitha mjetet e ankimit të disponueshme dhe të mjaftueshme, duhet të dëshmojë praninë e tyre. Nëse shteti e përmbush këtë kusht, kërkuesi duhet të provojë se mjeti i përmendur nga autoriteti është konsumuar ose, për arsye të ndryshme, ka qenë i papërshtatshëm dhe joefikas për rrethanat e çështjes konkrete ose kanë ekzistuar pengesa të veçanta që e shkarkojnë nga detyrimi për ta shfrytëzuar atë. Në një rast të tillë barra e provës transferohet tek autoritetet, të cilat duhet të sqarojnë se çfarë masash kanë ndërmarrë në përgjigje të këtyre pretendimeve.¹⁰³

Kushti i përdorimit të mjeteve të brendshme duhet të përdoret me një dozë elasticiteti. Parimi i konsumimit të mjeteve të brendshme nuk ka karakter absolut dhe nuk duhet përdorur në mënyrë automatike. Në çështjen konkrete duhet vlerësuar realisht jo vetëm mjeti formal i rekursit/ankimit në rendin juridik të një vendi, por edhe konteksti i tyre politik dhe juridik si dhe situata vetiake e viktimës. Në shumë çështje kundër Turqisë, Gjykata ka vlerësuar se për shkak të situatës së veçantë në pjesën juglindore të saj dhe që karakterizohej nga shqetësime serioze si rezultat i veprimtarisë së armatosur (të quajtur terroriste nga Turqia zyrtare) të Partisë Komuniste Kurde dhe i operacioneve të forcave të sigurisë, kishte pengesa serioze në funksionimin korrekt të drejtësisë, lidhur me sigurimin e provave në procesin gjyqësor, mungesën e hetimeve të paanshme etj. Në vendimin *Adkivar k. Turqisë*, Gjykata për herë të parë në çështje të tilla, deklaroi se rrethanat e veçanta të çështjes e përjashtonin detyrimin e

¹⁰² Shih për më tepër *Marek Antoni Nowicki*, Rreth Konventës Europiane (2003), fq.42.

¹⁰³ Çështja *Adkivar k. Turqisë*, 16 shtator 1996.

përdorimit të mjeteve të brendshme juridike. Sipas saj, një konkluzion i tillë është gjithmonë i kushtëzuar nga rrethanat konkrete të çështjes.¹⁰⁴

Përveç shterrimit të mjeteve, ankuesi duhet të plotësojë kushtin e afatit kohor prej 6 muajsh, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar të instancës së fundit të brendshme. Nëse për të paraqitur ankimin është e nevojshme edhe arsyetimi i vendimit nga gjykata përkatëse, atëherë afati fillon të nesërmen e njohjes me arsyetimin e vendimit.¹⁰⁵ Nëse shkelja nuk ka përfunduar por është e vazhdueshme, atëherë afati fillon në përfundimin e saj. Kështu p.sh nëse personi i arrestuar nuk është paraqitur para një gjyqtari ose nëse nuk i lejohet ankimi ndaj masës së arrestit, afati i ankimit para Gjykatës fillon pas datës së lirimit.¹⁰⁶

Lidhur me thelbin e nenit 6 të KEDNJ vlen të theksohet fillimisht se praktika e Gjykatës ka qenë vazhdimisht në linjën që e drejta për një proces të rregullt ze një vend të rëndësishëm në një shoqëri demokratike, në kuptimin e Konventës. Rëndësia e saj duhet parë në kontekstin e funksionimit të demokracisë dhe për këtë arsye interpretimi i saj duhet bërë sa më i gjerë. Në vendimin e saj për çështjen *Delcourt k. Belgjikës*, Gjykata theksoi se "*në shoqërinë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt ligjor ze një vend kaq të rëndësishëm, saqë çfarëdo interpretimi i ngushtë i nenit 6/1 nuk do t'i përgjigjej as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni*".¹⁰⁷ Sipas saj, neni 6 duhet të interpretohet gjithashtu duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës, të pranuar nga kombet e civilizuar, duke përfshirë këtu parimin se gjithkush duhet të ketë mundësinë t'i parashtrojë gjykatës çështjen e vet si dhe një parim tjetër nga i cili buron ndalimi për të refuzuar dhënien e drejtësisë.

¹⁰⁴ Shih *Nowicki*, vep.cituar. fq.44.

¹⁰⁵ Çështja *P.k Zvicrës*, 13 mars 1984.

¹⁰⁶ *Nowicki*, vep.cit. fq.48.

¹⁰⁷ Çështja *Delcourt k. Belgjikës*, 17 shkurt 1970.

Nëse do të bënim një ndarje të garancive që jep neni 6/1 lidhur me procesin e rregullt, mund të thuhet se ato janë garanci *institucionale*, *procedurale* dhe *materiale*. Lidhur me garancitë *institucionale* mund të themi se neni 6 dikton nevojën e ekzistencës së një gjykate¹⁰⁸ të krijuar me ligj, të pavarur dhe të paanshme. Koncepti i Konventës për gjykatën është funksional dmth. ajo shkon përtej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe përfshin "*të gjitha trupat vendimmarrëse të pavarura që vendosin mbi bazën e rregullave procedurale që garantojnë një proces të drejtë për pretendime dhe detyrime të natyrës së të drejtës civile ose akuza penale*".¹⁰⁹ Elementë thelbësorë që lidhen me gjykatën janë pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve. Sa i takon ekzistencës së instancave gjyqësore dhe mënyrës së organizimit të gjykatave, kjo është një çështje që u është lënë shteteve për t'i rregulluar sipas vlerësimit të tyre. Lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë, megjithëse kjo do të prezantohet më poshtë në praktikën e GJK shqiptare, e cila është orientuar nga jurisprudenca e pasur e GJEDNJ, do të përmend vetëm disa nga linjat kryesore të GJEDNJ.

Pavarësia e gjyqtarëve përgjithësisht ka të bëjë me përjashtimin e ndikimeve të jashtme në vendimmarrje. Pavarësia duhet të garantohet jo vetëm nga ekzekutivi por edhe ndaj palëve në proces. Një gjykatë do të konsiderohet e pavarur vetëm nëse vendimet e saj nuk mund të prishen nga ekzekutivi ose të ndikohen prej tij.¹¹⁰ Në këtë kuptim, pavarësia e gjykatës kërkon që në aspektin e vendimmarrjes të parashikohen saktë hapësira e gjykimit (juridiksioni dhe kompetenca)

¹⁰⁸ Varianti anglez dhe frances përdorin termin "tribunal", i cili përfshin jo vetëm gjykatat në kuptimin e ngushtë por edhe instancat vendimmarrëse me natyrë kuazigjyqësore.

¹⁰⁹ *Frowein/Peukert*, EMRK-Kommentar, (1996) fq.202. Shih gjithashtu edhe çështjen *Campbell dhe Fell k. Britanisë së Madhe*, 22 tetor 1984.

¹¹⁰ Deri në vitin 1994 Holanda ka patur një situatë ligjore që nuk përputhej me këtë standart. Kështu, vendimet administrative mund të kundërshtoheshin me mjetin juridik *kroonberoep*. Mbi këtë ankim vendoste një dhomë e Këshillit të Shtetit (Raad van State) pasi kishte dhënë mendimin Ministri kompetent. Nëse Këshilli i Shtetit do të vendoste ndryshe nga qendrimi i ministrit, atëherë ministri mund të zëvendësonte vendimin sipas vlerësimit të tij. Në praktikë kjo ndodhte shumë rrallë, por megjithatë u gjet nga GJEDNJ si cenim i nenit 6/1 lidhur me pavarësinë e gjykatës. Pas vendimit të marrë në çështjen *Bentham k. Hollandës*, 23 tetor 1985, në Hollandë një reformë rrënjësore në fushën e së drejtës administrative dhe sidomos të gjykimit administrativ.

të gjykatës konkrete.¹¹¹ Përveç kësaj, ka edhe disa standarte që duhen respektuar për emërimin dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve.

Lidhur me paanshmërinë e gjyqtarëve, GJEDNJ ka ecur në drejtimin e mosndikimit që duhet të ketë gjyqtari nga faktorë të jashtëm, natyra e të cilëve nuk është e rëndësishme. Gjykata e shqyrton paanshmërinë në aspektin *objektiv* dhe *subjektiv*. Paanshmëria në aspektin *subjektiv* ka të bëjë me sjelljen personale të gjyqtarit, e cila presumohet të jetë e paanshme derisa të provohet e kundërta.¹¹² Ndërsa aspekti *objektiv* nuk e lidh paanshmërinë me cilësi të personit të gjyqtarit por me veçanti të procesit, të cilat pasqyrohen me sjelljen e ndryshme të gjyqtarit ndaj secilës palë në gjykim.¹¹³

Lidhur me garancitë *procedurale dhe materiale* neni 6 përfshin mjaft të tilla, të cilat janë elaboruar në mënyrë konstante nga kjo Gjykatë. Si të tilla ajo ka konsideruar: aksesin në gjykatë, sipas të cilit çdo akt administrativ duhet t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.¹¹⁴ Natyrisht aksesin në gjykatë nuk mund të jetë absolut, ai mund t'i nënshtrohet kufizimeve¹¹⁵ të tilla si organizimi i drejtësisë¹¹⁶, interesi publik, por e rëndësishme është që të ketë një interes të ligjshëm, të jetë proporcional dhe të mos preket thelbi i saj (*the very essence*).¹¹⁷ Të njëjta kritere janë të parashikuara edhe në nenin 17 të Kushtetutës

¹¹¹ Sipas këtij standarti, GJEDNJ e gjeti në kundërshtim me kërkesat e nenit 6/1 ekzistencën e një rregulli francez, sipas të cilit interpretimi që Këshilli i Shtetit (Conseil d'Etat) i bënte marrëveshjeve ndërkombëtare nuk duhej të devijonte nga interpretimi që i bënte Ministria e Jashtme. Ky rregullim u shfuqizua. Për më tepër shih çështjen *Beaumontin k. Francës*, 24 nëntor 1994.

¹¹² Shih çështjen *Debled k. Belgjikës*, 22 shtator 1994.

¹¹³ GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin në një rast se është mjaftueshmërisht bindëse që një person politikisht aktiv të përjashtohet nga juria kur çështja ka të bëjë me lirinë e shprehjes me natyrë politike. Shih vendimin *Holm k. Suedisë*, 25 nëntor 1993.

¹¹⁴ *Frowein/Peukert*, EMRK-Kommentar, (1996) fq.198.

¹¹⁵ Shteteve anëtare u është lënë një farë hapësirë vlerësimi (*a certain margin of appreciation*). Shih për më tepër çështjen *Lithgow dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe*, 8 korrik 1986.

¹¹⁶ Mjaft herët e ka deklaruar këtë kufizim si të përligjur, shih për më tepër çështjen *Golder k. Britanisë së Madhe*, 21 shkurt 1975.

¹¹⁷ Praktikë e vazhdueshme e GJEDNJ që prej çështjes *Lithgow, Powell dhe Rayner etj.*

sonë, të cilat GJK i ka elaboruar vazhdimisht lidhur me kufizimin e të drejtave themelore në përgjithësi dhe sidomos edhe me elementët e nenit 6 të KEDNJ në veçanti.¹¹⁸

Gjithashtu neni 6 përmban edhe të drejtën për t'iu drejtuar instancave të tjera të ankimit por pa vendosur ndonjë detyrim për shtetet lidhur me numrin e instancave që duhet të parashikojë në legjislacionin e brendshëm.¹¹⁹ E diskutueshme është edhe ekzistenca e një kontrolli kushtetues për ankimet individuale, e cila theksohet nga GJEDNJ si një mjet juridik efektiv për të ulur numrin e ankimeve para saj, por nga ana tjetër ajo asnjëherë nuk ka shkuar aq larg sa të deklarojë nevojën e parashikimit të një gjykimi kushtetues nga shtetet anëtarë të Konventës.¹²⁰

Të tjera garanci që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë edhe: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht),¹²¹ mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve etj.¹²²

¹¹⁸ Për më tepër shih nënçështjet më poshtë sipas tematikës.

¹¹⁹ Çështja *Delcourt k. Belgjikës*, 17 janar 1970.

¹²⁰ Mundësia për të kundërshtuar në GJK aktet normative nuk është pjesë e nenit 6 dhe nuk kërkohet nga Konventa. Megjithatë GJEDNJ ka guxuar t'ia nënshtrojë edhe procesin para GJK kontrollit të saj sidomos lidhur me tejjgatjen e afateve të arsyeshme në gjykim duke e konsideruar atë si pjesë të procesit gjyqësor të zhvilluar para instancave kombëtare.

¹²¹ Shih për më tepër botimet e posaçme të Këshillit të Europës lidhur me garancitë procedurale të nenit 6.

¹²² *Karl/Miehlsler*, *Internationaler Kommentar zur EMRK* (1995), fq.310.

ARTA VORPSI

II. KUPTIMI I PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR SIPAS GJK SHQIPTARE

Përpara se të ndalemi hollësisht në kuptimin në tërësi dhe elementët e veçantë të procesit të rregullt ligjor sipas praktikës së GJK shqiptare, vlen t'i kushtojmë vëmendje edhe zhvillimit historik të ankimit kushtetues individual në Shqipëri për të pasur një përjasje më të plotë sa i takon vendimmarrjes së kësaj Gjykate në vite. Për këtë arsye, më poshtë do të paraqesim dy faza të rëndësishme të zhvillimit të ankimit kushtetues shqiptar: faza e parë është ajo e viteve 1992-1998, gjatë së cilës gjeti zbatim ankimi kushtetues real sipas modelit gjerman, pra individi kishte të drejtë t'i drejtohej GJK për kundërshtimin e akteve të pushtetit publik (qeveri, parlament, gjykatë), nëse i cenoheshin të drejtat e tij të parashikuara në paketën kushtetuese. Faza e dytë i referohet viteve pas miratimit të Kushtetutës në fuqi, pra pas 1998 e në vazhdim. Kjo fazë njihet si faza e ankimit kushtetues të kufizuar, pasi ankimet individuale mund të drejtohen kryesisht kundër vendime gjyqësore dhe në raste mjaft specifike edhe ndaj akteve të tjera të pushtetit publik, kur pretendohet se cenohet e drejta për proces të rregullt ligjor dhe individi nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj aktit.¹²³

¹²³ Shih për më tepër *Zaganjori/Anastasi/Methasani (Cani)*, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH (2011) fq.88.

1. Ankimi individual kushtetues sipas DKK

Pas ndryshimeve demokratike të fillimit të viteve '90-të, si në të gjitha vendet e Europës Lindore, edhe në Shqipëri lindi nevoja për të përshtatur kuadrin kushtetues dhe ligjor me marrëdhëniet e reja shoqërore të krijuara. Duke qenë se Kushtetuta e deriatëhershme nuk mund të gjente më zbatim në regjimin e ri pluralist të vendosur me zgjedhjet e para demokratike të vitit 1992, vendin e ligjit themelor e zuri përkohësisht Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese (DKK).¹²⁴ Një nga të rejat që solli ky paketë kushtetuese ishte dhe krijimi i një institucioni të ri për rendin juridike shqiptar, Gjykatën Kushtetuese, funksionimi i të cilit do të kishte ndikim të rëndësishëm për shtetin e brishtë demokratik që po ngrihej në fillimet e viteve '90-të.¹²⁵ Ky organ i panjohur më parë në Shqipëri, por me mjaft përvojë në vendet e Europës perëndimore, u konceptua në bazë të shembullit të gjykatave kushtetuese të vendeve gjermanofolëse, ku edhe lindi e ideja të krijimit të këtij institucioni.¹²⁶ Kështu, GJK gëzonte të njëjtat kompetenca të gjera si të simotrës gjermane duke filluar që nga interpretimi i dispozitave kushtetuese e deri në kontrollin e akteve normative mbi bazën e ankimit individual. Vitet e para të funksionimit të GJK kanë qenë më të vështira sa i takon ushtrimin të kompetencave të saj, sidomos atë lidhur me shqyrtimin e ankimeve individuale. Pavarësisht se institucioni i GJK ishte i ri, ai gjeti një mbështetje tek shtetasit, duke qenë se kishin kaluar një përvojë negative nga periudha e regjimit komunist. Ky regjim, pavarësisht

¹²⁴ Ligji nr.7491, dt.29.04.1991 dhe Ligji nr.7561, dt.29.04.1992 Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, dt.29.04.1991.

¹²⁵ Shih *Arta Vorpsi (Palushi)*, Rechtsstaat und Verfassungsgericht- Ein Rechtsvergleich zwischen dem oesterreichischen VfGH und dem albanischen VfGH- Temë disertacioni e mbrojtur në Universitetin e Vjenës, Austri (2001), fq 36.

¹²⁶ Ideja e krijimit të një organi që të mbikëqyrë respektimin e Kushtetutës nga të gjitha organet e administratës publike është hedhur për herë të parë nga konstitucionalisti austriak Hans Kelsen në 1868, ide e cila gjeti zbatim të plotë në Austri në 1920. Kelsen ka qenë nënkryetar i kësaj gjykate deri në vitin 1939, kohë në të cilën ai dha dorëheqjen, pas vendosjes së Anschluss-it mes Gjermanisë dhe Austrisë nga regjimi nacionalsocialist. Në këtë periudhë ai emigroi në SHBA, ku dha kontributin e tij në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të së drejtës ndërkombëtare deri në fund të jetës së tij.

nga parashikimet kushtetuese dhe propagandës, nuk respektonte në realitet liritë dhe të drejtat e qytetarëve, ato kishin karakter thjesht deklarativ. Për këtë arsye, qytetarët shqiptarë që në fillimet e punës së GJK panë tek ajo një mbrojtëse reale të të drejtave të tyre edhe kur ato shkeleshin nga organet më të larta të pushtetit shtetëror. Që në fillim të bën përshtypje përpjekja e këtij organi për t'u shprehur lidhur me parimet kushtetuese themelore, si parimi i ndarjes së pushteteve,¹²⁷ i papajtueshmërisë së funksioneve,¹²⁸ i pavarësisë së gjyqësorit, lirisë së shtypit,¹²⁹ të drejtës për informim,¹³⁰ etj.

Megjithatë duhet thënë se shkalla dhe thellësia e arsyetimeve të vendimeve dhe argumenteve që gjejnë vend në praktikën e kësaj Gjykate në këto vite është modeste. Në vendimet e GJK të asaj kohe vihet re një përsiatje midis tendencës për të marrë vendime si gjykatë e zakonshme dhe dëshirës për të ushtruar kontroll kushtetues të mirëfilltë. Kjo vërehet jo vetëm duke iu referuar strukturës së vendimit si dhe forcës argumentuese të pasqyruar në të. Kështu p.sh megjithëse në disa raste GJK ka arritur në përfundimin se është shkelur një parim themelor nga një veprim apo akt i caktuar, nuk është argumentuar bindshëm, pse ky veprim apo akt ka sjellë shkeljen e një parimi dhe çfarë standartesh cenon.¹³¹ Megjithatë vitet e para të funksionimit të GJK meritojnë vëmendje sa i takon edhe aktivizmit që ajo ka treguar për të vendosur shtyllat e para të kontrollit kushtetues në Shqipëri, i cili natyrshëm do të kalonte nëpër fazat e nevojshme të pjekurisë insitucionale.

GJK është pozicionuar që në hapat e parë të saj mbi konfliktet e lindura midis organeve shtetërore dhe individit, i cili e bazonte kërkesën e tij në dispozitat kushtetuese duke pretenduar se i ishin shkelur të drejtat themelore të tij nga veprimet e administratës publike. Ajo ka arritur të japë përkufizime duke u kthyer në pika referimi në vendimet e

¹²⁷ Vendime të GJK nr.5/1992; nr.6/1992; nr.11/1992; nr.4/1994; nr.8/1994; nr.9/1995 etj.

¹²⁸ Vendime të GJK nr.3/1992; nr.5/1992.

¹²⁹ Vendim i GJK nr.2/1992.

¹³⁰ Vendime të GJK nr.10/1992; nr.4/1993.

¹³¹ Vendime të GJK nr.11/1992; nr.1/1994 etj.

mëtejshme të saj. Kështu në rastet kur nga individit është pretenduar se ndihet i diskriminuar nga zgjidhja e ndryshme që ka parashikuar ligjvënësi për subjekte të ndryshme që ndodhen në të njëjtën situatë (p.sh të strehimit), GJK e ka hedhur poshtë këtë pretendim duke arsyetuar se një zgjidhje e ndryshme nuk do të thotë diskriminim.¹³² Kjo ka të bëjë, sipas GJK, me pozitat e ndryshme në të cilën ndodhen personat. Parimi i barazisë në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë se duhet të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash në kushte të ndryshme.¹³³ Por nuk ka qenë e të njëjtit mendim GJK në një tjetër vendim të saj, në të cilin ajo shprehet se norma e atakuar¹³⁴ ka karakter diskriminues ndaj një kategorie pronash dhe personash, sepse kjo normë cakton një rreth të ri trashëgimtarësh ligjorë vetëm për pronat e shpronësuara në mënyrë të paligjshme nga sistemi i mëparshëm. Nuk sqarohen shkaqet e këtij diskriminimi dhe arsyeja pse ligjvënësi i ka lënë jashtë këtij rregullimi pronat që nuk u janë nënshtruar masave të shpronësimit padrejtësisht gjatë regjimit të kaluar. Ky diskriminim, sipas GJK, përbën shkelje flagrante të parimit të barazisë.¹³⁵

Si diskriminues është vlerësuar edhe vendimi i ligjvënësit për t'u kthyer pronat ish-pronarëve që janë tjetërsuar nga pesona të tretë duke i kompensuar këta të fundit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Sipas GJK, personat e tretë vihen në pozita të pabarabarta me këtë lloj shpërblimi që u bëhet, pasi ligjvënësi duhet t'i referohej çmimit real të tregut në momentin e dorëzimit të objekteve të ish-pronarët.¹³⁶ GJK thekson se përveç çmimit real duhej të parashikohej edhe shpenzimet e bëra nga personat e tretë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e ndërtesave. Nëse në këtë kuadër do të trajtonim vendimin tjetër të GJK lidhur me dhënien e sigurimeve shoqërore suplementare ushtarakëve në shërbim, do të mbeteshim mbase të

¹³² Vendim i GJK nr.11/1993.

¹³³ Vendim i GJK nr.71/1998.

¹³⁴ Ligji nr. 8115, dt. 29.03.1996 "Për përjashtime nga rregullat e parashikuara në lidhje me trashigiminë ligjore nga Kodi Civil i vitit 1981".

¹³⁵ Vendim i GJK nr.11/1997.

¹³⁶ Vendimi i GJK nr.12/2000.

çuditur nga arsyetimi i vendimit.¹³⁷ Kërkuesit e kanë konsideruar përbajtjen e dispozitës, që ka si subjekt vetëm ushtarakët në shërbim pas vitit 1991, si antikushtetuese, pasi diskriminon ata persona që kanë shërbyer në forcat e armatosura para këtij viti dhe shkel kështu parimin e barazisë para ligjit. GJK ka arritur në përfundimin se *"trajtimi i diferencuar nga ligji nuk diskriminon ushtarakët e para vitit 1991 nga ata të pas këtij viti, por siguron funksionimin e rregullt të forcave të armatosura në kushtet e reja të krijara (!)"*. Siç shihet arsyetimi i dhënë nuk ka argument juridike bindëse por thjesht vlerësime subjektive të situatës shoqërore ku ndodhet vendi. GJK përmend shprehjen *"kushtet e reja shoqërore ekonomike"*, pa u ndalur tek efektet konkrete të këtyre kushteve mbi trajtimin e diferencuar të ushtarakëve apo shkaqet e tij.¹³⁸

Ky vendim nuk e ka penguar GJK që në një rast tjetër të mëvonshëm ta quajë antikushtetuese zgjidhjen e dhënë nga ligjvënësi për përfitimin e pensionit të invaliditetit për ish-të dënuarit për krime ordinere.¹³⁹ Duke u nisur nga shkaku i vuajtjes së dënimit – kryerja e veprave penale ordinere – ligjvënësi i kishte përjashtuar ata nga shtesa e pensionit për invalidë. Një dallim të tillë GJK e ka konsideruar antikushtetuese dhe është shprehur se ish-të dënuarit që kanë përfituar pension invaliditeti për shkak të aksidentimit në punë gjatë vuajtjes së dënimit, duhet të trajtohen në kushte të barabarta me invalidët e tjerë duke qenë se shkaqet që kanë sjellë aksidentimin dhe kushtet në të cilat ndodhen tani janë të njëjta. GJK e ka vlerësuar si jo të plotë kuadrin ligjor lidhur me trajtimin e kësaj kategorie të dëmtuarish, për të cilin ajo rekomandon një plotësim sa i përket miratimit të një ligji tërësor për të drejtat e të dënuarve me heqje lirie.

Duke mbetur në kuadrin e parashikimit të dispozitave për trajtimin në masë sa më të drejtë të personave të dëmtuar (në këtë rast qiramarrësit e banesave ish-pronë private), GJK ka çmuar në se

¹³⁷ Vendim i GJK nr.43/1997.

¹³⁸ Për qëllime krahasimi dhe evoluimi të praktikës vlen të shihen edhe vendimet aktuale të GJK lidhur me pensionin e ushtarakëve nr.9/2007 dhe nr.33/2010.

¹³⁹ Vendim i GJK nr.4/1997.

ligjvënësi nuk ka zgjidhur drejt raportin e masës së qirasë që do të përballohet nga qiramarrësit dhe nga shteti. Dispozita që parashikon një gjë të tillë duhet shfuqizuar duke u zëvendësuar me një përmbajtje tjetër, ku të përcaktohet detyrimi i qiramarrësve të paguajnë qiranë deri në zgjidhjen e strehimit brenda fuqisë së tyre ekonomike, ndërsa diferenca e masës së qirasë të përballohet nga shteti.¹⁴⁰

Si të bazuar dhe plotësisht të drejtë e ka konsideruar GJK pretendimin e kërkuesit se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, pasi gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar të vetëm, ndërkohë që ligji parashikon se çështja në shkallë të dytë duhet të shqyrtohet nga trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë.¹⁴¹ Si cenim të procesit të rregullt ligjor janë konsideruar nga GJK dhe raste të tjera, si p.sh mungesa e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Kasacionit,¹⁴² zgjerimi i objektit të padisë pa vënë në dijeni palën tjetër duke i hequr asaj të drejtën e mbrojtjes,¹⁴³ dhënia e dy vendimeve për të njëjtën çështje,¹⁴⁴ vendimin e Gjykatës së Kasacionit për mosshqyrtimin e padisë nga ish-pronarët për të ushtruar të drejtën e parablerjes me arsytimin se nuk legjitimohen si paditës.¹⁴⁵ GJK ka deklaruar se e drejta e parablerjes është një e drejtë parimore e ish-pronarëve të truallit mbi të cilin ndodhet objekti që privatizohet duke përbërë kështu një të drejtë kushtetuese të pacënueshme, që nuk mund të mohohet jashtë vullnetit të ish-pronarit, pavarësisht nga pjesa që i takon në privatizim. GJK duke u nisur nga parimi i sanksionuar se të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor, e quan antikushtetuese mosshqyrtimin e padisë nga Gjykata e Kasacionit. Po në këtë vendim, gjykimi i çështjes në themel nga Gjykata e Kasacionit është konsideruar tejkalim kompetencash,

¹⁴⁰ Vendim i GJK nr. 5/1997.

¹⁴¹ Vendim i GJK nr.3/1994.

¹⁴² Vendime të GJK nr.20/1997; nr.25/1998.

¹⁴³ Vendime të GJK nr. 45/1997; nr. 30/1998.

¹⁴⁴ Vendim i GJK nr.76/1998.

¹⁴⁵ Vendim i GJK nr.7/1998.

pasi ajo duhej të mjaftohej vetëm me prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Ky fakt përbën një proces të parregullt, sipas GJK.¹⁴⁶

Po kështu, GJK, në një rast tjetër, ka konstatuar se kërkuesi është ndodhur para një procesi të parregullt, pasi gjykata e zakonshme ka marrë në shqyrtim padinë e një subjekti që nuk legjitimohej dhe për më tepër ka zhvilluar më tej gjykimin dhe pasi subjekti ka hequr dorë nga (shtesë) padia, duke shkelur kështu parimin që gjykata shprehet mbi gjithçka dhe vetëm për atë që kërkohet.¹⁴⁷

Në dy raste të tjera, GJK nuk ka hezituuar të pranojë ankimin kushtetues të paraqitur nga një shoqëri private që konsistonte në rivënien e së drejtës kushtetuese të shkelur nga një akt i pabotuar në Fletoren Zyrtare. GJK theksoi se hyrja në fuqi e ligjeve dhe akteve të tjera kushtëzohet nga *publikimi i tyre* dhe në asnjë rast nuk mund dhe nuk duhen të përputhen këto dy momente. GJK çmon se zbatimi i aktit pa u publikuar zyrtarisht dhe pa hyrë në fuqi, përbën shkelje të së drejtës kushtetuese për informim.¹⁴⁸

Në kuadër të interpretimit të parimeve kushtetuese gjejmë pozicionime të GJK lidhur edhe me *efektet e ligjit penal*, për të cilin GJK shprehet se nuk ka fuqi prapavepruese, ndryshe nga e drejta penale materiale, me përjashtim të rasteve kur është në favor të të pandehurit. Ndërsa sipas të drejtës procedurale penale, ligji i ri ka fuqi dhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes në fuqi të tij për çështje që gjenden në hetim ose gjykim.¹⁴⁹ Po lidhur me zbatimin e ligjit penal, GJK çmon se mënyra e caktimit të dënimit fiks bie në kundërshtim me parimin e sanksionuar në

¹⁴⁶ Vendim i GJK nr.34/1998.

¹⁴⁷ Vendime të GJK nr.40/1998; nr.48/1998.

¹⁴⁸ Vendime të GJK nr.10/1992; nr.4/1993. Në fakt, deri para miratimit të Kushtetutës së 1998, ka patur mjaft akte normative të pabotuara në FZ, me argumentin se nuk ka qenë detyrim kushtetues. Ky justifikim ishte e pabazuar, pasi pavarësisht se nuk ishte e parashikuar në DKK, publikimi në FZ lidhet direkt me marrjen dijeni për një akt të ri, të cilën të gjithë shtetasit dhe organet janë të detyruar ta zbatojnë.

¹⁴⁹ Vendim i GJK nr.11/1995.

Kodin Penal për *individualizimin e dënimit* ndaj personit dhe pengon zbatimin e dispozitave për rrethanat lehtësuese dhe rënduese.¹⁵⁰ Sa i përket parashikimit nga ligji penal i *ndjekjes penale të të akuzuarit në mungesë*, GJK është shprehur në se nuk është antikushtetues, pasi vetë ligji për raste të tilla parashikon një sërë garancish procedurale (caktimi i mbrojtësit, njoftimi, etj). Nuk mund të pranohet argumenti se caktimi i avokatit nga shteti e bën atë të njëanshëm gjatë procesit. Është detyra ligjore dhe etika e avokatit që të përdorë me ndërgjegje të plotë të gjitha mjetet e nevojshme për mbrojtjen e të pandehurit.¹⁵¹

Pra, nga kjo pasqyrë e vendimmarrjes së GJK para miratimit të Kushtetutës vihet re një gamë e gjerë problemesh dhe aktesh që ka marrë në shqyrtim GJK në kuadër të trajtimit të ankimit kushtetues. Vlen për t'u theksuar hapësira e gjerë e kontrollit që ka pasur GJK duke marrë në shqyrtim akte ligjore me kërkesën e individëve, praktikë e cila u ndërpre me hyrjen në fuqi të Kushtetutës në nëntor të vitit 1998. Megjithatë, pavarësisht se individit mund t'i drejtohej GJK edhe për shfuqizimin e akteve normative, nuk është përdorur mjaft kjo mundësi. Shkak për këtë mund të ketë qenë edhe njohja e paktë që jo vetëm individët por edhe profesionistët e së drejtës kishin për këtë institut.

2. Ankimi individual kushtetues aktual

Në 28 Nëntor 1998 u dekretua Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë, e konsideruar edhe si e para Kushtetutë realisht demokratike pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshimet dhe të rejat që solli ky dokument u pasqyruan edhe në sferën e kompetencave të GJK. Më të ndjeshme këto ndryshime ishin lidhur me të drejtën e individit për të vënë në lëvizje GJK dhe kompetencën e kësaj të fundit për të shqyrtuar brenda një hapësire më të kufizuar ankimin

¹⁵⁰ Vendim i GJK nr.1/1996 dhe më pas nr.13/1997.

¹⁵¹ Vendim i GJK nr.31/1998.

individual.¹⁵² Kështu, sipas kuadrit kushtetues në fuqi, GJK, veç të tjerave, është kompetente të shqyrtojë ankimet kushtetuese individuale, të cilat mbështeten në pretendimet për shkelje të të drejtës për një *proces të rregullt ligjor*. Në mënyrë të natyrshme, kjo është bërë një nga kompetencat më të rëndësishme të këtij institucioni. Për këtë fakt flasin edhe statistikat e botuara nga vetë GJK.¹⁵³ Megjithëse numri i ankimeve kushtetuese individuale ka zënë dhe zë që prej krijimit të Gjykatës pjesën më të madhe të kërkesave në total, përqindja e kërkesave të kaluara në seancë gjyqësore dhe i atyre të pranuar me vendim përfundimtar është i vogël – varion nga 5%-15%. Vetë këto shifra flasin për të kundërtën e asaj që pretendohet se GJK po kthehet në shkallë të katërt të gjykimit. Ky nuk është aspak qëllim i kësaj Gjykate, por ajo vetë si organ kushtetues, garante dhe interpretuese përfundimtare e ligjit themelor të shtetit, jo vetëm ka për detyrë të veprojë brenda kuadrit kushtetues që i ka caktuar ligjvënësi por edhe të mbikëqyrë organet e tjera kushtetuese në këtë aspekt.

Vlen të theksohet se ushtrimi i kësaj kompetence nga GJK ka sjellë në disa raste vënien në vend të së drejtës së shkelur të individit nga organet e administratës publike duke realizuar kështu qëllimin e ligjvënësit për respektimin e të drejtave të individit. Konstatimi i shkeljeve nëpërmjet akteve të pushtetit shtetëror nuk mund të kalohet në heshtje nga organi që ka për detyrë t'i kontrollojë ato, me pretendimin se sistemi gjyqësor shqiptar njeh vetëm tri shkallë gjykimi. Kushtetuta dhe ligji për GJK përcakton qartë rastet, kur kjo Gjykatë është kompetente të marrë në shqyrtim ankimet kushtetuese individuale. GJK është përpjekur që pas miratimit të Kushtetutës së re të përkufizojë hap pas hapi këtë kompetencë duke vijëzuar kështu gjatë praktikës caqet e interpretimit dhe të kontrollit të saj. Qendrimet e mbajtura në praktikën e kësaj Gjykate kanë çuar në një kuptim më të drejtë dhe më përfshirës të nocionit kushtetues të procesit të rregullt ligjor.¹⁵⁴ Në tërësi, sot mund të themi se hapësira

¹⁵² Shih *Debati Kushtetues – Diskutimet në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projekt-Kushtetutës së vitit 1998*, Vëllimi i Dytë (2006), fq.26-35.

¹⁵³ Shih për më tepër pasqyrën statistikore të paraqitur në fund të botimit.

¹⁵⁴ *Sokol Sadushi*, Kontrolli kushtetues (2004) fq. 182.

e kontrollit të GJK për shqyrtimin e ankimeve kushtetuese individuale ka ardhur duke u zgjeruar.¹⁵⁵

GJK gjithnjë e më tepër po përcakton në mënyrë më të detajuar hapësirën dhe llojin e akteve normative që ajo kontrollon mbi bazën e ankimit individual. Kështu, ajo është shprehur se në bazë të nenit 131/c të Kushtetutës, GJK vendos për akte që përcaktojnë norma të përgjithshme, abstrakte dhe që rregullojnë marrëdhëniet e caktuara juridike që i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të caktuar subjektsh. Ajo shqyrton aktet administrative me karakter individual që rregullojnë marrëdhëniet konkrete për një çështje të caktuar dhe që i shtrijnë efektet mbi një kategori të caktuar subjektsh.¹⁵⁶

GJK më shumë se një herë, në praktikën e saj gjyqësore, ka bërë dallimin thelbësor midis rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës dhe funksionit të dhënies së drejtësisë që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor. Kjo është një çështje mjaft delikate, që në fakt ka krijuar edhe ndonjë keqkuptim në praktikë, kryesisht me Gjykatën e Lartë. Vetë formulimi i nenit 131/f, i cili përfshin edhe kontrollin kushtetues mbi vendimet gjyqësore, i ka hapur rrugën GJK të marrë në shqyrtim procedurat gjyqësore të zhvilluara para gjykatave të zakonshme, kur nga palët në proces është pretenduar parregullsia e tyre. Tendenca e GJK për t'u orientuar gjatë kontrollit që ajo ushtron në një pozicion që të mos konfondohej me shkallët e tjera të gjyqimit, por të përqendrohet vetëm në evidentimin e antikushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore në kuadër të procesit të rregullt ligjor, ndjehet vazhdimisht në praktikën e saj.¹⁵⁷ Ajo që herët ka përcaktuar se në juridiksionin e saj hyjnë shqyrtimi i atyre shkeljeve që kanë ndikim të drejtpërdrejt në një proces ligjor dhe vërtetimi i të cilave do të sillte pasoja negative për

¹⁵⁵ Shih për këtë *Kristaq Traja, "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës shqiptare"*, referat i mbajtur me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, botuar në: *"10-vjet Gjykatë Kushtetuese"* – *Buletin i Posaçëm*, Botim i Gjykatës Kushtetuese (2003) fq 65.

¹⁵⁶ Vendim i GJK nr.185/2001.

¹⁵⁷ *Sokol Sadushi*, Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, referuar në seminarin e organizuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Kushtetuese.

të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejte tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj.¹⁵⁸ Gjithashtu ajo ka theksuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin e parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese për të investuar GJK për zgjidhjen e tyre sa herë shfaqet prania e shkeljes së normave procedurale.¹⁵⁹

Duke ju referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat duhet të analizohen për çdo rast konkret, vihet re se tendenca e GJK nuk ka qenë dhe nuk është orientimi apo caktimi i detyrave për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Me vendimet e saj ajo synon të artikulojë standartet kushtetuese, sipas të cilave duhet të zhvillohet një proces i rregullt ligjor dhe më pas të kontrollojë nëse procesi i ka respektuar këto standarte, me qëllim garantimin e të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor. Në të drejtën e individëve për një proces të rregullt gjyqësor përfshihen mjaft të drejta dhe garanci kushtetuese e ligjore. Shkelja e garancive kushtetuese që parashikohen në kapitullin e lirive dhe të drejtave vetjake të analizuara nga këndvështrimi i procedurave të ndjekura, janë konsideruar nga GJK pjesë përbërëse e një procesi të parregullt ligjor.¹⁶⁰

Procesi i rregullt ligjor është një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e një gjykimi të zakonshëm apo një procesi administrativ . Neni 42/1 e Kushtetutës vetëm sa e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij ndonjë kuptim të hollësishëm. Atë që nuk e sqaron hollësisht Kushtetuta është përpjekur ta zhvillojë praktika e GJK, e cila është orientuar kryesisht në jurisprudencën e GJEDNJ dhe të gjykatave kushtetuese europiane. Megjithëse jurisprudenca e GJK ka filluar të marrë një fizionomi të saj, në drejtim të kuptimit që paraqet neni 42 dhe 131/f e Kushtetutës, për procesin e rregullt ligjor ende nuk ka një qëndrim të konsoliduar dhe të vetëm lidhur me përkufizimin shterrues të tij. Personalisht nuk e konsideroj si mangësi këtë. Madje mendoj se një përkufizim shterrues nuk do të ishte

¹⁵⁸ Vendim i GJK nr.7/2000.

¹⁵⁹ Vendime të GJK nr.22/2002; nr.25/2005; nr.21/2008.

¹⁶⁰ Po aty.

shumë i dobishëm, pasi mund t'i mbyllte shtigjet GJK për interpretime të mëtejshme lidhur me të, gjithmonë nëse ato zgjerojnë fushën e mbrojtjes së individit.

Nëpërmjet procesit të rregullt ligjor kontrollohet më shumë procedura e rregullt gjyqësore, por jo vetëm ajo, pasi nuk përjashtohet edhe procedura administrative nga ky koncept. Që në vitet e para të funksionimit kjo Gjykatë ka deklaruar se "*procesi i rregullt ligjor nuk shtrihet vetëm ndaj qytetarëve të thjeshtë por edhe ndaj atyre që gjykojnë të tjerët dmth gjyqtarët*".¹⁶¹ Në vendimet e saj, GJK është përpjekur të bëjë dhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të KEDNJ, dhe nenit 42/1 të Kushtetutës së RSH. Sipas saj, *ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e saj, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ*. Kjo ka qenë një nga ato çështje që shënon një evoluim të praktikës së GJK shqiptare, e cila është treguar krijuese por pa kaluar kufijtë e Kushtetutës.¹⁶² Në këtë çështje, GJK e e konsolidoi qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e saj duke mos e kufizuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor vetëm në çështjet gjyqësore. Në vendim thuhet: "*Gjykatës Kushtetuese i rezulton se Kuvendi gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standarteve. Kështu, Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat e drejtuara ndaj kërkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave*".¹⁶³

¹⁶¹ Vendim i GJK nr.8/1994.

¹⁶² Vendim i GJK nr.76/2002.

¹⁶³ Shih edhe vendimin e mëvonshëm nr.21/2008 për të njëjtën çështje, në të cilën ish-Prokurori i Përgjithshëm kundërshtoi procedurën e shkarkimit nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës si të parregullt. Në këtë vendim GJK nuk konstatoi shkelje të procedurave të shkarkimit. Me interes për doktrinën është edhe mendimi i pakicës, i cili ka analizuar të gjitha pretendimet e kërkuesit duke konstatuar, ndryshe nga shumica, shkelje të procesit të rregullt ligjor.

GJK ka përfshirë në praktikën e saj edhe aktet me karakter individual të institucioneve kushtetuese duke deklaruar se edhe ato kanë detyrimin të respektojnë elementët e procesit të rregullt. Sipas saj, "[Presidenti i Republikës] ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, që mund të çenojnë të drejtat juridiko-civile të prokurorit. Duke pasur të tilla cilësi dekreti, ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.25, datë 13.02.2002, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta. Kufizimi që i bëhet kësaj të drejte për shkak të përgjegjësisë së veçantë që ata kanë në mbrojtje të interesave publikë, nuk gjen mbështetje tek neni 17 i Kushtetutës. Edhe nga përmbajtja e nenit 148 të Kushtetutës, ku përcaktohen detyrat e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzave në gjyq, etj., si dhe nga vetë kuptimi si organ i pavarur, del që prokurorëve duhet t'u jepen të drejta e garanci siç është edhe e drejta e ankimit ndaj masave që ata i konsiderojnë të padrejta. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.25, datë 13.02.2001, pranon se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta dhe se dallimi që mund t'u bëhet atyre nga gjyqtarët e nënpunësit civilë për të drejtën e ankimit çënon frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Duke shkuar më tej, kjo gjykatë, në jurisprudencën e saj, e ka konsideruar të drejtën e ankimit si të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës e nenin 6 të Konventës Evropiane".¹⁶⁴

Megjithatë, pa dashur të ndalem më gjatë këtu, pasi trajtimi më i hollësishtëm i saj do të bëhet më poshtë sipas tematikës, mund të

¹⁶⁴ Vendim i GJK nr.38/2003. Çështja lidhej me të drejtën e prokurorit të shkarkuar për t'u ankuar ndaj dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e tij. Gjykata e Lartë në këtë rast e kishte pushuar çështjen duke e konsideruar si jashtë juridiksionit gjyqësor dekretin e Presidentit, pasi ai është i natyrës juridiko-kushtetues dhe jo administrativ (!).

thuhet se GJK përqendrohet gjatë kontrollit të saj vetëm në elementët që përmban e drejta për një proces të rregullt ligjor. Ajo nuk i hyn në asnjë rast themelit të çështjes, por ndalet vetëm në aspektin procedural të tyre.¹⁶⁵ Pra, GJK shqiptare kufizohet tek parregullsitë e një procesi gjyqësor apo administrativ lidhur me procedurat e nxjerrjes së aktit dhe jo sa i takon përmbajtjes së tij. E kundërta do t'i jepte GJK natyrën e një gjykate të shkallës së katërt të pushtetit gjyqësor me funksion rishikues të vendimeve të gjykatave më të ulta. I tërë kontrolli i GJK përqendrohet në aspektin kushtetues të tij, pra në evidentimin e respektimit të garancive kushtetuese gjatë procedurës vendimmarrëse të organit konkret. GJK ka theksuar vazhdimisht se *"parimi i barazisë së armëve si dhe marrja e provave në mënyrë të ligjshme, përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, "detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë".*¹⁶⁶

Në qëndrimet e arsyetimet e veta, GJK, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, ka pranuar gjithashtu se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit.¹⁶⁷ Duke shkuar më tej rezultojnë se ajo nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor në rastet, kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulta në plotësimin e standardeve dhe elementëve të një procesi të rregullt ligjor.¹⁶⁸ *"Kompetenca e GJK për të shqyrtuar ankesat e*

¹⁶⁵ Vendim i GJK nr.76/2002. GJK është shprehur se *"(Kuvendi) gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur standardeve (të gjithpranuara demokratike kushtetuese) Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat ndaj kërkuesit pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin, pa i dhënë kohën e nevojshme për mbrojtje dhe pa e dëgjuar atë..."*

¹⁶⁶ Vendim i GJK nr.11/2005.

¹⁶⁷ Vendim i GJK nr.25/2005.

¹⁶⁸ Vendim i GJK nr.21/2008.

*individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka për qëllim të dublojë dhe të spostojë të drejtën e gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor për të zgjidhur vetë çështjet. E drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Europiane dhe lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të atyre parimeve esenciale që përbëjnë thelbin e procesit. Standarte të tilla kushtetuese si e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta e mbrojtjes, paanësia në gjykim, gjykimi publik, prezumimi i pafajësisë etj., përbëjnë elementet kryesore që Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar në jurisprudencën e saj për kuptimin sa më të plotë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor”.*¹⁶⁹

GJK, si garantuese e interpretuese e Kushtetutës, e luan këtë rol dhe në kuadër të shqyrtimit të kërkesave të individit që atakojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave.¹⁷⁰ Si kufij të kontrollit kushtetues në këtë rast shërbejnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kushtetuta në nenin 17/1 garanton se kufizimi i të drejtave kushtetuese bëhet vetëm me ligj dhe për interesa publike apo mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kjo dispozitë e ndërthurur me pg 2 të nenit 17 e ngushton akoma më shumë hapësirën e legjislativit për të parashikuar kufizime mbi të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese. Ky kufizim rrjedh nga detyrimi i vendosur nga teksti i KEDNJ, i cili i detyron shtetet anëtare të mos shkojnë përtej kufizimeve të vendosura prej saj (parimi i Konventës: mbrojtje minimale, kufizim maksimal). Shqipëria, si palë e kësaj Konvente prej vitit 1996, respekton këtë garanci, duke e ngritur atë në rang kushtetues, gjë që e detyron legjislativin t'i përmbahet hapësirës së caktuar të veprimit, kur vjen çështja tek kufizimi i të drejtave kushtetuese për interes publik.¹⁷¹ Më poshtë evidentohet qëndrimi i GJK shqiptare në referimin që ajo i bën

¹⁶⁹ Vendim i GJK nr.8/2003.

¹⁷⁰ Shih vendimin nr.18/2000, ku GJK shprehet se: " ...nuk është detyrë e GJK të vlerësojë, nëse Gjykata e Lartë, si instancë që gjykon ankimet ndaj vendimeve të KLD, i ka mbledhur ose jo të gjitha provat për të konkluduar mbi vërtetësinë e faktit që i atribuohet ankuesit. ...nuk është e drejtë e GJK të vlerësojë vendimin e GJL, nëse fakti i pranuar si i vërtetë prej saj përbën shkelje dhe nëse kjo shkelje është apo jo e rëndë...”

¹⁷¹ Kristaq Traja, Karakteristikat e sistemit të të drejtave themelore, në: Tribuna Juridike Nr.47 (2004), fq.15.

standartit të vendosur nga KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

3. Kushtet formale për t'iu drejtuar GJK për proces të parregullt ligjor

3.1 Legjitimimi

Një nga kushtet për t'iu drejtuar GJK lidhur me pretendimin për proces të parregullt ligjor është edhe legjitimiteti i kërkuesit. Së pari, kërkuesi duhet të jetë *individ*, sipas nenit 131/f të Kushtetutës. Kushtetuta shqiptare i njeh individit të drejtën për të vënë në lëvizje GJK vetëm për rastet kur i cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor. Mbrojtja e individit ndaj shkeljeve të karakterit kushtetues është parë me përparësi nga kushtetutbërësi dhe është menduar jo vetëm si detyrë e GJK por edhe e të gjithë gjykatave dhe organeve të tjera vendimmarrëse.¹⁷² Të gjitha gjykatat janë të veshura me të drejtën dhe detyrimin që gjatë procesit vendimmarrës të bëjnë interpretime konform Kushtetutës. Çdo gjykatë ka të drejtë të interpretojë dispozitat kushtetuese dhe në rast se ka papajtueshmëri midis tyre dhe ligjeve ose akteve të tjera normative, nëpërmjet interpretimit pajtues të përpiket t'i shmangë ato, nëse kjo është e mundur. Nëse jo, atëherë ajo ka mundësinë të inicojë një kontroll kushtetues para GJK.¹⁷³

Legjitimiteti i kërkuesit nga pikëpamja formale përfshin tri aspekte: *së pari*, qenien e tij *individ*, *së dyti*, paraqitjen e kërkesës brenda *afatit kohor* prej 2 vjetësh, *së treti*, *shterrimin e të gjitha mjeteve të tjera juridike* para ushtrimit të ankimit individual. Nëse një nga këto kritere nuk plotësohet, GJK, në kolegji prej tre anëtarësh, vendos

¹⁷² Shih vendimin nr.76/2002 mbi ankimin e ish-Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilin GJK shprehet se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standartet e gjithpranuara demokratike që kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë.

¹⁷³ Neni 145/2 i Kushtetutës parashikon mundësinë e inicimit të një kontrolli konkret nga gjykatat e zakonshme, si mënyrë e mbrojtjes së kushtetutshmërisë nga të gjitha nivelet e gjykatave.

moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore.¹⁷⁴ Le t'i shohim më nga afër kriteret sipas vetë praktikës së GJK.

3.1.1 Subjektet kërkuese

Të drejtën për të ushtruar ankim në GJK lidhur me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor e kanë vetëm individët.¹⁷⁵ Marrë në kuptimin fillestar, individ konsiderohet një person fizik. Por nëse do t'i referohemi doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore, situata ndryshon. Cilët subjekte përfshin termi *individ*? Sqarimi i pozicionit të personave juridikë përballë GJK është i nevojshëm për arsyen e thjeshtë se ato persona që nuk gëzojnë të drejtat themelore nuk mund as t'i kërkojnë ato në rrugë procedurale (ku hyn edhe vënia në lëvizje e GJK). Gjithsesi sa i përket legjitimitit të kërkuesit para GJK, vlen parimi: *Ankimin kushtetues para GJK mund ta ushtrojnë vetëm ato subjekte që mund të jenë përfitues të të drejtave dhe lirive themelore.*

Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese njeh si subjekte që mund të vënë në lëvizje GJK:

- *Individin*, në kuptimin e personave fizikë; Lidhur me legjitimitimin e personave fizikë nuk mbetet shumë për të thënë, pasi ato, për shkak të qenies së tyre, kanë të drejtë t'i drejtohen GJK. Dallimi mund të bëhet vetëm sa i takon shtetasve të huaj dhe shtetasve shqiptarë. Nisur nga neni 16/1 të Kushtetutës "*të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e lirive të caktuara.*" Duke qenë se

¹⁷⁴ Nenet 30, 31 të Ligjit nr. 8577, dt.10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e GJK të RSH", më poshtë: Ligji për GJK.

¹⁷⁵ Neni 131/f i Kushtetutës: "*Gjykata Kushtetuese vendos për: ...gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shtruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.*"

ankimi individual para GJK nuk përmban ndonjë rezervë lidhur me shtetasit e huaj ose ato pa shtetësi, GJK ka legjitimuar edhe këta (në fakt vetëm të parët, kanë paraqitur kërkesë). Kështu, në një rast GJK ka marrë në shqyrtim kërkesën e një shtetasi të huaj, jo me banim në Shqipëri, i cili kërkonte konstatimin e procesit të parregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë. GJK e legjitimoi dhe vendosi mbi kërkimet e tij. Në vendim nuk ka gjetur vend asnjë vlerësim ose deklaratë lidhur me shtetësinë e kërkuarit apo vendbanimin e tij, gjë që na bën të pranojmë se nuk ka pengesa ose kushte të tjera që mund të lidhen me legjitimitimin e kërkuarit për shkak të shtetësisë.¹⁷⁶

- *Bashkime të organizuara individësh ose shoqata* që nuk hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile, pasi për të vënë në lëvizje GJK nuk ka rëndësi pasja ose jo e zotësisë për të marrë përsipër detyrime juridiko-civile, por fakti nëse është përfitues i të drejtave dhe lirive themelore.¹⁷⁷

Shoqatat ose organizatat vitet e fundit janë bërë shpesh inicues të proceve para GJK. Ato kanë qenë aktive jo vetëm në rastet kur kanë kërkuar shfuqizimin e akteve normative (ligje dhe akte nënligjore) si antikushtetuese por edhe në rastet kur kanë patur pretendime për zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor para gjykatave të zakonshme. Legjitimimi i këtyre subjekte ka ngjallur më tepër debat gjatë gjykimit në GJK sa i takon kërkesave të tyre për shfuqizimin e akteve normative. Kjo për faktin se legjitimimi i tyre lidhet me një kriter të posaçëm që është justifikimi i interesit.¹⁷⁸ Pretendimet

¹⁷⁶ Vendim i GJK nr.12/2011. Kërkuari ishte shtetas grek me banim në Greqi. Atij i ishin njohur të drejtat prindërore me vendim të gjykatave greke, ndërkohë që e ëma e fëmijës nuk i krijonte kushtet për t'u takuar me fëmijën. Kërkuari kërkonte detyrimin e autoriteteve për të zbatuar vendimin e gjykatës greke.

¹⁷⁷ Në një vendim të GJKF gjermane BVerfGE 3, 383 thuhet se: "*Nga neni 19/3 i Ligjit Themeltar nuk duhet nënkuptuar se vetëm personat fizikë që kanë zotësi juridike mund të vënë në lëvizje GJK. Ky nen ka si qëllim të bëjë të qartë se nuk janë vetëm personat fizikë përfitues të të drejtave dhe lirive themelore, por edhe personat juridikë, pavarësisht faktit, nëse ato janë grupime personash fizikë.*" GJKF gjermane në këtë kuadër ka pranuar të legjitimojë kërkuarin, i cili ka qenë anëtar i komitetit drejtues të punonjësve në një ndërmarrje, për sa kohë që ky kërkuar prekej në të drejtat e tij legjitime.

¹⁷⁸ Neni 134/2 i Kushtetutës.

për moslegjitimim janë lidhur kryesisht me numrin e vogël ose të pайдentifikueshëm të anëtarëve të shoqatës,¹⁷⁹ me kohën e shkurtër të veprimtarisë së tyre,¹⁸⁰ me fushën e veprimtarisë së tyre apo përmbajtjen e statutit¹⁸¹ nga i cili mund të nxirret edhe interesi i këtyre organizatave për vënien në lëvizje të GJK.

Megjithatë duke qenë se objekti i këtij botimi është i lidhur vetëm me procesin e rregullt ligjor dhe jo me të drejtën e individëve për të vënë në lëvizje GJK edhe për kundërshtimin e akteve të tjera dhe për shkaqe të ndryshme, do të ndalem më gjatë tek e drejta e organizatave për të vënë në lëvizje GJK për të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor. Kështu, GJK ka pranuar si subjekt kërkues organizata që kanë kërkuar para saj konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, kur ato kanë qenë palë në gjykimin e zakonshëm. Ajo ka theksuar se *"...praktika e Gjykatës, çështjen e legjitimitetit të palëve në një proces civil, e ka vlerësuar në këndvështrimin e standardit të aksesit në gjykatë si një element të procesit të rregullt. Moslegjitimimi i një subjekti, që duhet të legjitimohet në bazë të ligjit, përbën shkak për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Gjykata, lidhur me legjitimitetin e palëve në proces civil dhe në përputhje me nenin 42/2 të Kushtetutës është shprehur, se KPC, në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në*

¹⁷⁹ Kështu p.sh në një çështje të inicuar nga shoqata/unioni i gjyqtarëve, subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, pretendoi moslegjitimitetin e kërkuesit për shkak se nuk ishte në gjendje të jepte informacion për anëtarësinë e tij dhe nëse ai përfaqësonte të gjithë gjyqtarët ose shumicën e tyre.

¹⁸⁰ Vendimi i akademisë së shkencave dhe arsimit të lartë

¹⁸¹ Shih për më tepër vendimin e GJK nr.4/2011, ku ajo është shprehur se *"Sipas statutit të saj, KSHH-ja është një organizatë jofitimprurëse që ka si mision të vet mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky funksion, lidhet edhe me kujdesin për përsosjen e legjislacionit vendas, të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve. Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar para Gjykatës argumente se si dispozitat e ligjit objekt i këtij kontrolli kushtetues cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat kjo organizatë ka për mision që t'i mbrojë. Ndaj Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet si subjekt për të inicuar kontrollin kushtetues të ligjit objekt shqyrtimi lidhur me pretendimet për cenim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtës së pronës dhe të së drejtës për mbrojtjen e jetës private". Vlen të lexohet edhe mendimi i pakicës lidhur me legjitimitetin e kërkuesit, i cili, sipas saj, nuk arrin të japë fakte lidhur me rezultatin konkret negativ që i ka ardhur kërkuesit ose anëtarëve të organizatës që ai përfaqëson nga veprimi i ligjit objekt gjykimi.*

atë të posaçme, zberthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë çka garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 KPC-ja e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e në ligje ose jo, kurse neni 32, shkronja "a" parashikon, se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur ... Gjykata çmon, se vetëm fakti i legjitimitit të një subjekti për të ngritur padi, që nuk duhet të legjitimohet sipas ligjit, nuk cenon në çdo rrethanë të drejtën e palës tjetër për proces të rregullt ligjor. Në këtë rast Gjykata vlerëson nëse janë respektuar të drejtat e palës kundërshtare për një proces gjyqësor kontradiktor".¹⁸²

Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se, personat juridikë publikë legjitimohen të venë në lëvizje një gjykim kushtetues kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil dhe cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë, si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në këtë vështrim, personat juridikë publikë do të trajtohen si individë, në kuptim të nenit 134/1, shkronja "g" në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës.¹⁸³ Gjykata ka vlerësuar se nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrohen në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, të cilat duhet të kenë lidhje me cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.¹⁸⁴ Për këtë arsye ajo ka çmuar në vazhdimësi se "*legjitimimi nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik (publik apo privat), por nga natyra e pretendimeve që ai parashtron. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është person juridik publik që ka pretenduar shkeljen e të drejtave procedurale që rrjedhin nga Kushtetuta. Në këtë drejtim, duhet bërë dallimi midis legjitimitit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të*

¹⁸² Vendim i GJK nr.8/2008.

¹⁸³ Vendim i GJK nr.39/2003; nr.36/2010.

¹⁸⁴ Vendim i GJK nr.14/2009.

tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Në çështjen në shqyrtim kërkuesi është person juridik publik, i paditur në gjykim, dhe pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimimit dhe të aksesit në gjykatë. Këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elementë të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, në çështje të ngjashme¹⁸⁵ duke u shprehur se dispozitat procedurale ... nuk përmbajnë të drejta individuale, por parime të së drejtës procedurale, të cilat duhet të respektohen në çdo proces dhe të shfrytëzohen nga çdo subjekt që në bazë të normave procedurale mund të konsiderohet palë në proces ose preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi. Në një proces gjyqësor, çdo subjekt pjesëmarrës në të i nënshtrohet njëlloj juridiksionit vendimmarrës të gjykatës. Të drejtat procedurale duhet t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve në proces, duke respektuar parimin e barazisë së armëve".¹⁸⁶

- *Personat juridikë të së drejtës publike, të cilët paraqesin më së shumti debate sa i përket legjitimitit.*

Legjitimimi i personave juridikë publikë paraqet specifikën e vet për shkak të natyrës juridike që kanë këto subjekte. Duke qenë se të drejtat dhe liritë themelore garantohen vetëm për individët apo organizime individësh, personat juridikë publikë logjikisht përjashtohen nga përfitimi i të gjitha të drejtave. Kështu, GJKF gjermane i ka përjashtuar ato nga grupi i personave që mund të vënë në lëvizje atë, fillimisht duke hezitur paksa, pastaj nëpërmjet një interpretimi strikt e të rreptë të nenit 19/3 të Ligjit Themelor.¹⁸⁷

¹⁸⁵ Vendim i GJKF Gjermane BverfGE 21, 362 (373).

¹⁸⁶ Vendim i GJK nr.22/2006.

¹⁸⁷ Neni 19/3 i Ligjit Themelor gjerman parashikon: "Të drejtat themelore vlejné edhe për personat juridikë vendas, për aq sa lidhen me qenien e tyre si të tilla".

Argumenti bazë ka qenë: Të drejtat dhe liritë themelore mund t'i përfitojnë vetëm njerëzit dhe grupimet e përbëra prej tyre, dhe jo organizmat shtetërore apo entitete të varura prej tyre. Ankimet kushtetuese të paraqitura nga subjekte të së drejtës publike nuk pranohen për shqyrtim nga GJKF gjermane, pasi nuk konsiderohen "individë" në kuptim të Kushtetutës dhe nuk janë përfitues të të drejtave dhe lirive themelore. GJKF gjermane ka theksuar se të drejtat themelore veprojnë vetëm për personat fizikë apo personat juridikë të së drejtës private, pasi thelbi i këtyre të drejtave konsiston në ngritjen lart të dinjitetit dhe lirisë njerëzore, si person fizik. *Qëllimi themelor i të drejtave dhe lirive është mbrojtja e sferës private të individit nga shteti, prandaj është e pamundur të mendohet që organizmat e vetë shtetit të bëhen subjekte të të drejtave dhe lirive themelore gjatë kryerjes së detyrave të tyre shtetërore.* Nëse të drejtat dhe liritë shtrihen në marrëdhëniet e individit me pushtetin shtetëror, është e papajtueshme qënia e këtij pushteti përfitues i këtyre të drejtave njëherësh me individin, pasi shteti nuk mund të jetë njëkohësisht edhe përfitues edhe garantues i këtyre të drejtave.¹⁸⁸ GJKF gjermane, edhe në raste të ngjashme, është shprehur se *"lidhur me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, këto dispozita procedurale nuk bëjnë pjesë në përmbajtjen e nenit 19 të Kushtetutës (e njëjtë me përmbajtjen e neneve 16 e 17 të Kushtetutës shqiptare – sh.im) ato nuk përmbajnë të drejta individuale, por parime të së drejtës procedurale, të cilat duhet të respektohen në çdo proces dhe të shfrytëzohen nga çdo subjekt që në bazë të normave procedurale mund të konsiderohet palë në proces ose preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi. Në një proces gjyqësor, çdo subjekt pjesëmarrës në të i nënshtrohet njëllor juridiksionit vendimmarrës të gjykatës. Të drejtat procedurale duhet t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve në proces, duke respektuar parimin e barazisë së armëve".*¹⁸⁹

Kjo Gjykatë ka trajtuar edhe parimin e barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor duke e vlerësuar si një element të rëndësishëm të të drejtave procedurale. Sipas saj: *"... ky parim është një e drejtë*

¹⁸⁸ Klaus Stern, Allgemeine Lehre der Grundrechte, (1988) fq 1100.

¹⁸⁹ Vendim i GJKF gjermane BverfGE 21, 362 (373)

themelore subjektive por njëkohësisht duhet të konsiderohet si element i parimit të drejtësisë objektive dhe rrjedhimisht i shtetit të së drejtës, parim kryesor ku mbështetet Ligji Themelor i vendit. Përmbajtja e normës që parashikon parimin e barazisë si dhe ndalimi e diskriminimit vlen edhe për marrëdhëniet brenda organizimit shtetëror. Këtu bëhet fjalë për një parim të së drejtës në tërësi që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe shoqëron parimin e drejtësisë në përgjithësi: në këtë rast ndërtimi dhe përmbajtja e një të drejte themelore që i takon një personi juridik të së drejtës publike nuk është më i domosdoshëm".¹⁹⁰ Këto vendime janë konsoliduar në praktikën e mëtejshme duke mos u trajtuar më nga pikëpamja teorike prej kësaj Gjykate. Ajo që vazhdon të ngjallë debate në vazhdimësi është qëndrimi ndaj subjekteve të së drejtës publike kur pretendojnë për cenime të të drejtave themelore substanciale. Këtu GJKF gjermane mban një qëndrim mjaft strikt duke e lidhur fitimin e të drejtave të tilla drejtpërdrejt dhe ngushtë me individin si dhe qëllimin për të cilin krijohet personi juridik publik.

Po ç'linjë ka ndjekur GJK shqiptare? Në nenin 16/2 të Kushtetutës sonë të drejtat dhe liritë themelore u njihen edhe personave juridikë. E drejta kushtetuese njeh dhe respekton personat juridikë si subjekte të të drejtave dhe lirive themelore.¹⁹¹ Lidhur me personat juridikë të së drejtës private nuk ka asnjë diskutim se ata janë përfitues të të drejtave dhe lirive themelore. Edhe personat juridikë, të cilët nuk hyjnë në marrëdhënie juridike civile mund të bëhen subjekt i të drejtave dhe lirive themelore, si p.sh partitë politike, ose shoqata. Pasoja më e rëndësishme që vjen nga kjo pozitë për këto subjekte është e drejta e tyre për të vënë në lëvizje gjykatën kushtetuese me anë të ankimit kushtetues. Nga ana tjetër, personat juridikë të së drejtës publike, përkatësisht shteti ose organet përbërëse të tij, nuk mund të bëhen subjekt i të drejtave themelore, për aq kohë sa ata ushtrojnë funksione shtetërore. Rregullimet dhe vendimet që nxjerrin këto organe nuk mund të bëhen objekt i të drejtave themelore, sepse mungon lidhja e tyre me qënien njerëzore. Përrjashtime mund të

¹⁹⁰ Vendim i GJKF gjermane BVerfGE 23, 564 (121)

¹⁹¹ Neni 19/3 i Ligjit Themelor gjerman, përmbajtja e të cilit është e njëjtë me atë të nenit 16/2 të Kushtetutës shqiptare.

bëhen vetëm në rastet, kur një person juridik i së drejtës publike është i ngarkuar direkt me mbrojtjen e një fushe të caktuar jetësore dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur nga shteti ose të paktën i distancuar dukshëm prej tij, si p.sh institucionet fetare, universitetet, stacionet radiotelevizive. Pra, bëhet fjalë për ato organizma që gëzojnë autonomi nga shteti dhe kanë për qëllim të mbrojnë liri dhe të drejta të veçanta të individit (liria e besimit fetar, e drejta për arsimim, liria e informimit, etj).

Këtë qëndrim GJK shqiptare e ka përqafuar dhe pasqyruar në praktikën e saj. Kështu, ajo ka theksuar se *"si përjashtim, personat juridikë publikë, mund ta venë në lëvizje GJK kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil e cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtëpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në rastin e fundit do të trajtoheshin si individë që venë në lëvizje GJK, në kuptim të nenit 134/1 "g" në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës edhe organet e pushtetit lokal, universitetet dhe stacionet radio-televizive".*¹⁹²

Në këtë drejtim, GJK ka bërë dallim midis legjitimitimit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Sipas saj, *"shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje GJK. Në çështjen në shqyrtim kërkuesi është person juridik publik, i paditur në gjykim, dhe pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimit dhe të aksesit në gjykatë. Këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elementë të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në GJK për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë...nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik ose privat, por*

¹⁹² Vendim i GJK nr.39/2003.

*nga natyra e pretendimeve që parashtrohen. E drejta për akses në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në proces dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejt prej tij. Për këto arsye, ankimi në GJK për shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë”.*¹⁹³

Pra, ajo që vihet re është se GJK e ka zgjeruar gjithnjë e më shumë grupin e subjekteve që mund t’i drejtohen asaj në rrugën e procesit të rregullt ligjor, por jo vetëm. Kjo është pritur mjaft pozitivisht nga rrethi i profesionistëve të së drejtës për vetë faktin se vetë individit ka mundësi të kufizuara për të kundërshtuar aktet normative para GJK shqiptare. Megjithatë ende ka një qëndrim të pakonsoliduar mes trupës së GJK lidhur me legjitimitimin e **personave juridikë të së drejtës private, gjë e cila bën që praktika e kësaj Gjykate të shihet me interes në të ardhmen.**

3.1.2 Afati kohor

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (më poshtë ligji për GJK) parashikon, veç të tjerave, edhe procedurat e veçanta të gjykimit para kësaj Gjykate. Në Kreun V mbi paraqitjen dhe shqyrtimin paraprak të kërkesave parashikohet se afati kohor për paraqitjen e kërkesave individuale për pretendimet për një proces të rregullt ligjor, është jo më shumë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individit mund t’i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në GJK, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror.¹⁹⁴ Lidhur me afatin 2 vjeçar të ankimit ka debate lidhur me zgjatjen e tij. Konsiderohet si afat i gjatë krahasuar

¹⁹³ Shih edhe vendimin e GJK nr.14/2009.

¹⁹⁴ Neni 30/2 i ligjit për GJK.

edhe me legjislacionet e vendeve të tjera.¹⁹⁵ Megjithatë në vitet e para të funksionimit të GJK, për shkak të institutit të ri të ankimit, u pa si e nevojshme parashikimi i afatit 2 vjeçar, si një periudhë e mjaftueshme për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me këtë mjet të veçantë juridik. Në një reformë të mundshme, mendoj se shkurtimi i afatit në disa mujor do t'i shërbente më mirë edhe sigurisë juridike për palët në gjykim dhe stabilitetit në vendimmarrje.

3.1.3 Shterrimi i mjeteve juridike

Në praktikë kërkesat që janë paraqitur nga individët para GJK lidhur me kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme përbëjnë përqindjen më të madhe të numrit të përgjithshëm të tyre. GJK ka qenë e detyruar që shumë prej tyre të mos i kalojë për gjykim duke qenë se ato nuk plotësonin kushtet për shqyrtimin kushtetues. Rastet më të shumta janë ato, kur nuk janë shterrur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për të atakuar vendimin e gjykatës, kërkesë kjo që e pengon GJK për të ushtruar kontroll mbi vendimin e atakuar. Parimi i subsidiaritetit ose i plotësueshmërisë së ankimit kushtetues kërkon domosdoshmërisht që kërkuesi të shfrytëzojë jo vetëm mjetet ligjore në kuptimin e ngushtë por më shumë se kaq.¹⁹⁶ Ai duhet të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për të ndaluar një cënim të të drejtave themelore ose së paku për ta korrigjuar atë. Mjetet e ankimit në kuptimin e ngushtë nënkuptojnë çdo mundësi të garantuar nga një dispozitë ligjore për të kundërshtuar një vendim të gjykatës. Si shembuj mund të përmendim: apelimin, rekursin. Gjithashtu, mund të gjejmë zbatim edhe kërkesat për rikthim në gjendjen e mëparshme ose kundërpaditë.

¹⁹⁵ Kështu p.sh shumica e legjislacioneve europiane parashikojnë një periudhë kohore nga 3 muaj deri në 12 muaj të paraqitjes së ankimit para gjykatës kushtetuese.

¹⁹⁶ Ankimi kushtetues është konceptuar si siguri ndihmëse ose plotësuese (subsidiare) krahas mjeteve të tjera ligjore, për këtë arsye ai mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet e parashikuar nga ligji për të fituar një të drejtë.

Parimi i subsidiaritetit në lidhje me shterrimin e mjeteve ligjore kërkon që kërkuesi të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ka në dispozicion për të ndaluar një rrezik që i kërcënohet të drejtave të tij themelore ose të korigjojë dëmin e shkaktuar. Në këtë kuadër, mund të thuhet se shterrimi i mjeteve quhet i kryer, si kusht për të paraqitur një ankim kushtetues, nëse bëhet fjalë për rrezikun e nisjes së një procesi penal në bazë të procedurave hetimore paraprahe jo të rregullta të policisë ose të prokurorisë. Po kështu, duhet të shfrytëzohet më parë mundësia për të marrë pjesë në një proces gjyqësor si person i interesuar, pra të shfrytëzohen të gjitha mjetet procedurale, me qëllim që personi (i interesuar) të ketë mundësi në një fazë të mëvonshme të ngrëjë një ankim kushtetues para GJK. Pra, edhe personat e tretë në një proces gjyqësor duhet t'i nënshtrohen rregullit për shterrimin e mjeteve ligjore për t'iu drejtuar GJK me ankim kushtetues.

Mjetet e ankimit para gjykatave të zakonshme duhet të shterren para ngritjes së një ankimi kushtetues. Shterrimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës. Mjetet shterrojnë kur rregullat procedurale në rastin konkret nuk parashikojnë mjete të mëtejshme ose të gjitha mjetet e tjera ligjore janë haptazi të palejueshme. Mjetet ligjore nuk duhet të jenë të shterrura në kuptimin e ngushtë, që do të thotë se nuk mjafton vetëm përdorimi i mjeteve në kuptimin procedural, por duhet që kërkuesi t'i përdorë mjetet në aspektin material të tyre, pra të ketë pretenduar gjatë përdorimit të të gjitha mjeteve të mëparshme shkeljet të cilat ai dëshiron t'i paraqesë në ankimin kushtetues para GJK. Parimisht, mjetet e ankimit quhen të shterrura, nëse janë kaluar plotësisht të gjitha shkallët e gjyqësorit. Parimi i subsidiaritetit të ankimit kushtetues kërkon që individi gjatë procedurave para gjykatave të zakonshme të ketë përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, në përputhje me rregullat dhe format e kërkuara nga ligji procedural, kundër cenimit të të drejtave të tij. Mjetet ligjore duhet të shterohen para ngritjes së një ankimi kushtetues, nëse shanset për sukses janë të paqarta ose të vogla, si p.sh kërkesa për rivendosjen e gjendjes së mëparshme ose rihapjen e procesit. Edhe në rastet kur

lejueshmëria e mjeteve ligjore është e diskutueshme ato duhet të shfrytëzohen para ankimit kushtetues.¹⁹⁷

Sipas doktrinës kushtetuese gjermane, problematik paraqitet rasti kur kërkuesi pretendon se nuk është respektuar procesi i rregullt ligjor gjatë procesit në instancën e fundit të gjykimit dhe nuk është parashikuar asnjë mjet tjetër ankimi kundër vendimit të kësaj instance.¹⁹⁸ Por këtu ka një përjashtim sencial: kur instanca e fundit vendos prishjen e vendimit të gjykatave më të ulta duke urdhëruar rigjykimin e çështjes, GJKF gjermane në këtë rast nuk e legjitimon subjektin për të bërë ankim kushtetues para saj, pasi mjetet ligjore të ankimit nuk konsiderohen të shterrura për sa kohë nuk kemi një vendim ose zgjidhje përfundimtare të çështjes në themel. Ajo që është vendimtare për pranimin e një ankimi kushtetues nga GJKF ka të bëjë me faktin, nëse para kërkuesit paraqiten shanse për të vendosur në vend të drejtën e tij gjatë procesit të mëtejshëm gjyqësor para gjykatave të zakonshme. Në bazë të këtij arsytimi, kërkuesi nuk i ka shterrur të gjitha mjetet ligjore, pasi procesi vazhdon dhe nuk ka ende një vendim përfundimtar, prandaj nuk mund të parashikohet se si do të vendoset mbi themelin e çështjes dhe natyrisht si do të zhvillohet procesi ligjor.¹⁹⁹

Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shterrur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterrimi, nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjete ligjore shterrojne kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Sipas kriterit kushtetues të vlerësimit të çështjes lidhur me shterrimin e mjeteve ligjore, GJK shqiptare ka çmuar se "...

¹⁹⁷ Sipas përkufizimit që i jep fjalori juridik gjermanisht-gjermanisht kuptimit të shterimit të mjeteve ligjore para ankimit kushtetues, kemi këtë përmbajtje: *"...ankimi kushtetues mund të ngrihet vetëm pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet ligjore, dmth, të gjitha mjetet e vëna në dispozicion para gjykatave të zakonshme për eliminimin e cënimit të së drejtës kushtetuese"*.

¹⁹⁸ *Umbach/Clemens, Grundgesetz-Mitarbeiterkommentar (1988) fq. 1022.*

¹⁹⁹ Vendim i GJKF gjermane 2BvR 452/01.

përgjithësisht, nuk konsiderohen të shterrura mjetet ligjore kur për shkelje gjatë procedimeve të mëparshme, çështja është kthyer për rigjykim nga instanca më e lartë gjyqësore. Në këto raste, mungesa e legjitimitetit për të ushtruar ankim kushtetues lidhet dhe përcaktohet nga fakti se procesi vazhdon dhe ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor. Një situatë e ndryshme krijohet kur kërkuesi pretendon se nuk janë respektuar kriteret e procesit të rregullt ligjor në instancën e fundit të gjykimit dhe nuk është parashikuar asnjë mjet ankimi ndaj vendimit të kësaj shkalle gjykimi. Në këto raste edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterrimit të mjeteve ka rëndësi fakti, se kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon të ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shterrur ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara... për vetë rrethanat specifike të paraqitura, kur rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesit nuk kanë mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto rrethana, kërkuesit i kanë shterrur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj pretendimet e ngritura në kërkesë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues".²⁰⁰

Një qëndrim të tillë lidhur me kriteret vlerësuese për shterimin e mjeteve ka mbajtur edhe GJEDNJ në praktikën e saj. Në një vendim të saj kjo Gjykatë, duke u ndalur tek shterimi i mjeteve juridike të brendshme, përcaktoi se ky rregull nënkupton që kërkuesi t'u drejtohet mjeteve që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara. Ajo nënvizon se ekzistenca e mjeteve në fjalë duhet të jetë me siguri e realizueshme, jo vetëm në teori por edhe në praktikë pa cënuar efektivitetin e domosdoshëm.²⁰¹

²⁰⁰ Vendime të GJK nr.17/2005; nr.8/2006; nr.15/2007; nr.27/2007; nr. 42/2007; nr.23/2008; nr.1/2009; nr.32/2009; nr.6/2010; nr.36/2010.

²⁰¹ Shih vendimin *Akdivar, etj. k. Turqisë*, 16 shtator 1996.

Çështja e shterrimit të mjeteve juridike si kusht për t'iu drejtuar GJK është shqyrtuar nga kjo Gjykatë edhe në aspektin e ngritjes së pretendimeve para të gjitha instancave të parashikuara për këtë qëllim. Kështu, ajo ka theksuar se *"pretendimi i kërkuarit se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka cenuar një element thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente, pasi e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar pa përcaktuar më parë vlerën e padisë, nuk mund të merret në shqyrtim në aspektin e kontrollit kushtetues sepse nuk është ngritur në asnjë shkallë të gjykimit. Nga aktet nuk rezultojnë që palët e interesuara në gjykim ta kenë ngritur një pretendim të tillë në gjykatën e shkallës së parë dhe as në atë të apelit. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë përmendet fakti që gjykimi është bërë nga një gjyqtar, por nuk është kërkuar që çështja të gjykohej me trup gjykues duke përcaktuar edhe vlerën e padisë. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese konfirmon qëndrimin e saj të mbajtur në vendimet e mëparshme se shkëlqja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliemeve.²⁰² Mbrojtja kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nënkupton edhe konsumimin, si rregull, para gjykatave të sistemit gjyqësor të çdo pretendimi ligjor që parashikohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, ky pretendim mbi përbërjen e trupit gjykues, i ngritur nga kërkuari në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore".²⁰³*

Përveç kësaj, Gjykata e ka lidhur shterrimin e mjeteve juridike para ankimit në GJK edhe me ngritjen reale të pretendimeve për proces të parregullt në çdo shkallë ankimi pavarësisht shkaqeve të tjera të ankimit në instancat gjyqësore. Kështu ajo ka theksuar se *"Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar kushtëzimin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike jo vetëm për rastet kur individit nuk është ankuar kundër një vendimi gjyqësor në instancat e tjera gjyqësore apo*

²⁰² Vendim i GJK nr.10/2003.

²⁰³ Vendime të GJK nr.9/2005; nr.1/2006. Në vendimin nr.1/2006 vlen të lexohet edhe mendimi i pakicës, i cili ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me shkëlqet e pretenduara nga kërkuari.

*administrative, por dhe për rastet kur, ndonëse ka kundërshtuar vendimin gjyqësor në tërësi, nuk ka ngritur pretendimin që parashtron në Gjykatën Kushtetuese”.*²⁰⁴

Më tej, GJK e ka konsideruar si shterrim të mjeteve juridike situatën kur individi ka paraqitur ankim në GJK, pasi GJK ka vendosur rishikimin e çështjes. Sipas saj, *“Kërkesa për rishikimin e një vendimi të formës së prerë është një mjet i jashtëzakonshëm që pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2001 nuk shqyrtohet fillimisht nga gjykata e rrethit por drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë dhe si rrjedhojë pala në proces, e cenuar nga prishja e vendimit, nuk ka asnjë mundësi e mjet procedural brenda juridiksionit gjyqësor të kundërshtojë prishjen nga kolegji civil dhe të kërkojë respektimin e të drejtave që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë. Jurisprudenca kushtetuese nuk i konsideron të shterrura mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese në rastet kur shqyrtimi i çështjes nuk ka përfunduar por vazhdon pas kthimit të saj për rigjykim sepse pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese të procesit në marrjen e provave e zbatimin e ligjit do të marrin përgjigje gjatë rigjykimit të çështjes. Po në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e formës së prerë që i takon një procesi tashmë të përfunduar duke vendosur kthimin për rigjykim dhe pezullimin e zbatimit të atij vendimi.*

...Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke pranuar kërkesën për rishikimin e çështjes jo vetëm e pranoi kërkesën e provat e paraqitura, por bëri edhe vlerësimin e tyre në raport me kërkesat e nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile. Ai jo vetëm i konsideroi ato prova të reja dhe që kanë lidhje me zgjidhjen e mëparshme të çështjes por arriti edhe në përfundimin që këto prova nuk mund të dihehin nga palët gjatë gjykimit të mëparshëm të çështjes. Për këtë gjykim dhe për këto konkluzione të Gjykatës së Lartë kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi të efektshëm për të kundërshtuar cenimin e parimeve të një procesi të rregullt që ka sjellë si pasojë prishjen e vendimit...Në këto rrethana, duke u nisur nga sa më sipër dhe nga fakti që rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm e vendimi i Gjykatës së Lartë për prishjen është përfundimtar në sistemin gjyqësor, duhet të pranohet

²⁰⁴ Vendime të GJK nr.26/2008; nr.1/2010.

*që kërkuesve u janë shterrur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj ata legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.*²⁰⁵

Një çështje tjetër të ngjashme GJK ka theksuar se "...Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shterrur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterrimi, nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterrojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Sipas kriterit kushtetues të vlerësimit të çështjes lidhur me shterrimin e mjeteve ligjore, Gjykata Kushtetuese çmon se përgjithësisht, nuk konsiderohen të shterrura mjetet ligjore kur për shkelje gjatë procedimeve të mëparshme, çështja është kthyer për rigjykim nga instanca më e lartë gjyqësore. Në këto raste, mungesa e legjitimitit për të ushtruar ankim kushtetues lidhet dhe përcaktohet nga fakti se procesi vazhdon dhe ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor. Një situatë e ndryshme krijohet kur kërkuesi pretendon se nuk janë respektuar kriteret e procesit të rregullt ligjor në instancën e fundit të gjykimit dhe nuk është parashikuar asnjë mjet ankimi ndaj vendimit të kësaj shkalle gjykimi. Në këto raste edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterrimit të mjeteve ka rëndësi fakti, se kërkuesi, nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon të ndreqë këto shkaqe por të gjykojë çështjen në themel. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, të vlerësojë sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shterrur ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara....Nisur nga këto kritere kushtetuese dhe qëllimi që ato synojnë të arrijnë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, për vetë rrethanat specifike të

²⁰⁵ Vendim i GJK nr.8/2006.

paraqitura, kur rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesit nuk kanë mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto rrethana, kërkuesit i kanë shterrur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj pretendimet e ngritura në kërkesë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues".²⁰⁶

Edhe sa i takon shterrimit të mjeteve për vendime të ndërmjetme që lidhen me kufizimin e të drejtave themelore me efekt të menjëhershëm për individin, ajo ka theksuar se duhet provuar që nuk ka asnjë mjet tjetër ankimi për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Kështu sa i takon ankimit para GJK lidhur me masën e arrestit, GJK ka çmuar se "*Dhunimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor e garantuar nga neni 42 i Kushtetutes, mund të pretendohet në Gjykatë [Kushtetuese-shënimi] vetëm pasi të shterren të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte. Duke qenë se kërkuesi i ka shterrur mjetet e ankimit për "masën e arrestit në burg" dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".²⁰⁷ Ajo i është referuar për këtë edhe praktikës së GJEDNJ, e cila ka deklaruar se procedurat paraprake, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendosjen e një mase të ndërmjetme, si p.sh. një urdhërim, normalisht nuk konsiderohen të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile dhe, si pasojë, normalisht nuk bien nën mbrojtjen e nenit 6 të Konventës. Megjithatë, në disa raste, GJEDNJ ka zbatuar nenin 6 të Konventës për vendimet e ndërmjetme, sepse ato kanë qenë përfundimtare për sa i përket të drejtave civile të aplikuesit.²⁰⁸ Për më tepër, është vlerësuar nga GJEDNJ se duhet*

²⁰⁶ Vendim i GJK nr.17/2005.

²⁰⁷ Vendim i GJK nr.28/2011.

²⁰⁸ Çështjet *Wiot k. Francës*, 15 mars 2001; *APIS a.s. k. Sllovakisë*, 13 janar 2002; *Libert k. Belgjikës*, 8 korrik 2004; *Aerts k. Belgjikës*, 30 korrik 1998.

bërë një përjashtim nga parimi se neni 6 i Konventës nuk aplikohet për vendime të ndërmjetme, kur natyra e vendimit të ndërmjetëm e kërkon domosdoshmërisht këtë përjashtim.²⁰⁹

Gjithashtu, GJK i ka konsideruar të shterrura mjetet juridike kur, për shkak të specifikës së çështjes, kërkuesi nuk mund ta kundërshtonte vendimin e dhënë me mjet tjetër. Kështu, në një rast pjestimi pasurie lidhur me pjestimin ideal, pra të fazës së parë GJK ka deklaruar se "Gjykimi për pjestimin e pasurisë trashëgimore, apo sendeve në bashkëpronësi, është një nga llojet e gjykimeve të posaçme që parashikohen nga KPC. Megjithëse gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore iniciohet nga një padi, e cila në thelb kërkon t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë, KPC parashikon se ky proces gjykimi realizohet në dy faza. Faza e parë e gjykimit ka për objekt shqyrtimi përcaktimin e rrethit të bashkëpronarëve, sendet që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese të bashkëpronarëve mbi sendet objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin e fazës së dytë bëhet ndarja në natyrë e sendeve objekt pjesëtimi.

Gjykata, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e pjesëtimin gjyqësor dhe interpretimin që u kanë bërë këtyre dispozitave Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr.628, datë 15.05.2000 konstaton, se çështjet që zgjidhen në fazën e parë të këtij gjykimi nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor në fazën e dytë, fazë e cila fillon kur vendimi i fazës së parë ka marrë formë të prerë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se vendimi i fazës së parë të pjesëtimin është një vendim përfundimtar për problemet që ngrihen në Gjykatën Kushtetuese dhe si rrjedhojë nuk pranohet që kërkuesi nuk i ka shterrur mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave në kuptim të nenit 131, germa f të Kushtetutës".²¹⁰

²⁰⁹ *Shih Markass Car Hire Ltd k. Qipros*, 23 tetor 2001; *Micallef k. Maltës*, 15 tetor 2009.

²¹⁰ Vendim i GJK nr.24/2008.

3.2 Juridiksioni i GJK

Kjo është një temë e diskutueshme në rrethin e jurisprudencës kushtetuese dhe degët e tjera të së drejtës. Në disa raste, GJK është akuzuar për ndërhyrje në pavarësinë dhe integritetin e Gjykatës së Lartë duke e cilësuar si gjykatë mbirishkuese.²¹¹ Praktika e GJK shqiptare po konsolidohet çdo ditë e më tepër sa i përket parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. GJK ka arritur të elaborojë gjithnjë e më qartë elementët e këtij parimi, gjë e cila po kthehet në një jurisprudencë referuese për organet e tjera kushtetuese, në mënyrë të veçantë për gjykatat e zakonshme.

Kontrulli që ushtron GJK mbi ankimin kushtetues të individit ndaj procesit gjyqësor mund të quhet edhe kontroll i kontrolluesve, pasi vetë gjykatat janë institucione të ngritura për të kontrolluar veprimtarinë e administratës publike. Si të tilla ato vetë janë garante të të drejtave themelore. Prandaj, GJK nuk merr përsipër të dublojë këtë funksion duke rishikuar edhe një herë interpretimin e së drejtës së zakonshme nga gjykatat apo vlerësimin e provave nga ana e tyre. Ajo përqendrohet thjesht në respektimin e garancive kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Edhe vlerësimi i gabuar i provave apo gabimet e ndryshme juridike mund të cenojnë të drejtat themelore të individit, por për të mënjeluar këto shkelje Kushtetuta ka parashikuar të tjera gjykata dhe instancat përkatëse të tyre. Shkelje të të drejtave themelore që vijnë si pasojë e interpretimeve të ndryshme të ligjit apo nga mangësi të zakonshme ligjore duhen mënjeluar apo riparuar brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor. Pra, GJK ushtron një kontroll kushtetues të veçantë. Me këtë shpjegohet edhe fakti i vetëpërbajtjes së GJK shqiptare gjatë shqyrtimit të ankimeve kushtetuese të paraqitura nga individit. Duke qenë se pothuajse në të gjitha rastet ankimet e individëve drejtohen kundër vendimeve të gjykatave të zakonshme, GJK përballet jo rrallë me domosdoshmërinë e përcaktimit të kufijve ndarës midis kontrollit që duhet të ushtrojë ajo dhe kontrollit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

²¹¹ Vendime të GJK nr.5/2001; nr.20/2011.

Lidhur me kompetencën e GJK për çështjet që lidhen me respektimin e procesit të rregullt ligjor, mund të thuhet haptazi se praktika e kësaj Gjykate ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje cilësore e sasiore. Arritjet cilësore kanë patur të bëjnë së pari me rritjen e forcës argumentuese dhe referimin e praktikave më të mira të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të GJEDNJ. Gjithashtu, GJK nga viti në vit ka treguar prirje për të zgjeruar kufijtë e interpretimit të saj sa i takon elementëve të procesit të rregullt ligjor. Në vendimmarrjen e viteve të para pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së 1998, me anë të së cilës u kufizua e drejta e individit për të kundërshtuar akte normative në GJK për çdo akt të administratës publike, vihet re numri i kufizuar i pretendimeve kryesisht të karakterit procedural që shqyrtonte GJK (e drejta e mbrojtjes me avokat, e drejta e ankimit, etj). Vitet e fundit shihet se praktika e GJK ka evoluar mjaft jo vetëm në drejtim të thellimit të analizës që i bëhet në tërësi procesit të rregullt ligjor por edhe në drejtim të shtimit të vazhdueshëm të elementëve përbërës të këtij parimi të rëndësishëm. Sot gjejmë vendime që kanë përfshirë në parimin e procesit të rregullt shumë më tepër se garancitë procedurale të tilla si: siguria juridike në praktikën e gjykatave të zakonshme, arsyetimi i vendimeve gjyqësore, mënyra e sjelljes së palëve dhe gjykatës gjatë procesit gjyqësor për të vlerësuar rregullsinë e tij, detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, respektimi i rregullave të ekstradimit të të kërkuarit e mjaft të tjerë.²¹²

Edhe lidhur me thelbin e pretendimeve, GJK ka treguar vetëpërmbajtje sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të kërkuarit që lidheshin me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. GJK ka mbajtur qëndrimin se ajo *"...konstaton se përveç të drejtës për një proces të rregullt ligjor (nenit 42), disa nga të drejtat e tjera kushtetuese individuale që parashikohen në nenet 29, 31, 32, 34 etj., të Kushtetutës shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj, se pretendimet për shkeljen e parimeve themelore që përmbajnë këto të drejta themelore individuale,*

²¹² Këto elementë do të trajtohen më poshtë në veçanti, prandaj referohuni praktikës sipas ndarjes së tematikës në këtë material.

në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, janë objekt shqyrtimi në këtë gjykatë...Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë ashtu edhe në këtë Gjykatë janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë duhet të investojë në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj".²¹³

Gjithashtu edhe në rastet kur asaj i është kërkuar rivlerësimi i disa fakteve dhe provave, mbi të cilat është mbështetur gjykata e zakonshme për marrjen e vendimit të kundërshtuar para GJK, ajo ka argumentuar se "bërja e një analize apo vlerësimi të ri nga ana e Gjykatës Kushtetuese të një prove të administruar në dosjen gjyqësore, që në rastin konkret lidhet me aktekspertimin e vlerës së objektit të padisë dhe të kundërpadisë, do ta deformonte procesin kushtetues dhe do ta shndërronte atë në një proces gjykimi të zakonshëm. Mbi këtë analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuesi nuk provon se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese... Përcaktimi me saktësi nëse vlera e padisë dhe e kundërpadisë e kalojnë ose jo kufirin prej 10 milion lekë që parashikon neni 35 i Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret, është një çështje të provuari që nuk mund të rivlerësohet nga Gjykata Kushtetuese. Të

²¹³ Vendimi i GJK nr.41/2005. Në këtë vendim GJK është mjaftuar vetëm me konstatimin se GJL duhet të kishte marrë në shqyrtim rekursin e kërkuarit pa i hyrë në analizë pretendimeve dhe pa mbajtur qëndrim konkret për to. Është me interes të lexohet mendimi i pakicës së këtij vendimi, ku vihet re se këtë mangësi të shumicës e kanë plotësuar me arsyetimin e tyre paralel. GJK nuk mban më këtë qëndrim, ajo shqyrton të gjitha pretendimet për elementë të procesit të rregullt duke bërë edhe analizën e qëndrimit të gjykatave në lidhje me to.

*dy gjykatat, në vendimet e tyre, e kanë analizuar këtë pretendim të kërkuesit duke i dhënë përgjigje se vlera e padisë dhe e kundërpadisë nuk e kalon kufirin ligjor të përcaktuar me ligj”.*²¹⁴

Vlen të përmendet se GJK, megjithëse në një rast ka konstatuar se kërkuesi ka paraqitur pretendime që lidhen me procesin e rregullt, ajo nuk i ka marrë vetë në shqyrtim ato por ka detyruar Gjykatën e Lartë të rishqyrtojë çështjen duke mbajtur parasysh pretendimet e kërkuesit për shkeljet konkrete. Ajo që është më interesante është se një pjesë e gjyqtarëve të GJK në mendimin e tyre paralel kanë mbajtur qendrim të analizuar ndaj shkeljeve të pretenduara, çka normalisht duhet të ishte bërë në pjesën arsyetuese të vendimit të GJK.²¹⁵

Një çështje tjetër që lidhet me juridiksionin e GJK është edhe trajtimi i parimit të gjësë së gjykuar nga ana e saj, kur ky pretendim është ngritur nga palët në proces. Në jurisprudencën e saj, GJK e ka vënë theksin në kuptimin formal e procedural, të parimit të ndalimit *res iudicata* – gjësë së gjykuar, si në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ashtu edhe të fuqisë së tij detyruese. Gjykata ka nënvizuar se *“...tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur papajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për papajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo gjë varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera”.*²¹⁶ Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerësoi se vendimi i Kolegjit nuk përbënte pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që kërkuesi priste një qëndrim përfundimtar të GJK për ato shkaqe, për të cilat ajo nuk i ka shqyrtuar më parë. Në kërkesën e re, objekt shqyrtimi, kërkuesi kishte parashtruar një shkak të ri që nuk ishte shqyrtuar në vendimin e Kolegjit të GJK. Për pasojë, Gjykata çmoi se në rastin konkret nuk vepron parimi *res*

²¹⁴ Vendim i GJK nr.28/2005.

²¹⁵ Vendim i GJK nr.41/2005.

²¹⁶ Vendim i GJK nr.29/2006.

judicata.²¹⁷ Mosshqyrtimi nga Kolegji i shkakut ligjor që lidhej me garancinë e dhënë nga Shteti Shqiptar për rigjykimin e kërkesit nuk krijoi pengesë për GJK që të përfshinte këtë çështje në juridiksionin e saj kushtetues.

GJK në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2 vjeçar të parashikuar nga ligji i saj organik, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.²¹⁸

4. Elementët e procesit të rregullt ligjor sipas GJK shqiptare

4.1 Prezumimi i pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë njihet si element i procesit të rregullt ligjor nga këndvështrimi i nenit 6/2 të KEDNJ. Ky parim nënkupton që i pandehuri konsiderohet i pafajshëm deri në provim të fajësisë nga gjykata kompetente. Provimi i fajësisë quhet i realizuar në momentin që jepet vendimi i formës së prerë. GJEDNJ ka pranuar në mënyrë të përsëritur se garancia e parashikuar nga neni 6/2 i KEDNJ ka për qëllim që të detyrojë prokurorin gjatë një procedimi penal të provojë bindshëm akuzat kundër të pandehurit *“without resort to evidence obtained through methods of coercion or oppression in defiance of the will of the accused”*.²¹⁹ Kjo është e lidhur në mënyrë të pandashme me parimin e prezumimit të pafajësisë. Është pranuar nga praktika e GJEDNJ se formulimi i dispozitave që parashikojnë prezumimin e pafajësisë dhe procedura/mënyra e vërtetimit të fajësisë është tagër e ligjvënësit të brendshëm, ndërsa GJEDNJ ka të drejtë të ushtrojë kontrollë ndaj akteve dhe vendimeve në rast shpërdorimi

²¹⁷ Shih për krahasim edhe mendimet e pakicës që shoqërojnë vendimin nr.21/2010 lidhur me parimin e gjësë së gjykuar dhe shterimit të mjeteve juridike.

²¹⁸ Vendimi i GJK nr.21/2010.

²¹⁹ Shih për më tepër çështjen *Saunders k.Mbretërisë së Bashkuar*, 17 dhjetor 1996 dhe *Allenet de Ribemont k. Francës*, 10 shkurt 1995.

të hapësirës ligjore që parashikon. Presumimi i pafajësisë mbron jo vetëm të pandehurin por edhe të dyshuarin përpara se të ngrihet akuza ndaj tij.²²⁰

Parimin e prezumimit të pafajësisë duhet ta respektojë në rradhë të parë gjyqtari por gjithashtu edhe organet e tjera të administratës publike.²²¹ GJEDNJ ka çmuar në praktikën e saj se është e papajtueshme me funksionin e tij (kupto në këtë rast gjyqtarin), nëse ai hap një proces penal me bindjen se i pandehuri është fajtor. Fajësia e të pandehurit duhet të provohet nga akuzuesi dhe çdo dyshim është në favor të të pandehurit.²²² Në rast të kundërt i akuzuari, në zbatim të parimit të vjetër *in dubio pro reo* duhet të deklarohet i pafajshëm. Në këtë këndvështrim, gjyqtari duhet t'i japë mundësi të pandehurit të provojë pafajësinë e tij. Dënimi i të pandehurit duhet të bazohet në prova direkte dhe indirekte, të cilat arrijnë të argumentojnë fajësinë e të pandehurit.²²³

GJEDNJ ka përcaktuar qartë se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk duhet kuptuar vetëm si rregull procedural, i cili mjafton të realizohet në formën e paanshmërisë së gjykatës, garanci kjo e shprehur në paragrafin 1 të nenit 6. Duhet, gjithashtu, që të provohet nëse e drejta e brendshme parashikon një formulim të shprehjes *deri në provim të fajësisë*, e cila është në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës duke garantuar dhënien e një vendimi të drejtë mbi fajësinë e të pandehurit.²²⁴ Me fjalë të tjera, dënimi i një veprimi ose mosveprimi nuk mund të mbështetet vetëm në elementët objektivë të veprës penale, por edhe të provohet në çdo rast që i pandehuri ka përbushur edhe elementët subjektivë dhe si rrjedhojë të mund

²²⁰ Pavarësisht se teksti origjinal në anglisht dhe frëngjisht përdor fjalën "i akuzuar" praktika e Strasburgut e ka shtrirë mbrojtjen e parimit të prezumimit të pafajësisë edhe ndaj personave të dyshuar por ende të pangarkuar me akuzë nga prokurori. *Frowein/Peukert*, *Europäische Menschenrechtskonvention-Komentar* (1996) fq.164.

²²¹ *Adolf k. Austrisë*, 26 mars 1982 dhe *Lutz, Englert dhe Nolckenbockhof k. Gjermanisë*, 25 gusht 1987.

²²² *Manfred Nowak*, Pakti i OKB për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin Fakultativ – *Komentar* (1989) 267.

²²³ Çështja *Barbera, Messegue dhe Jabardo k. Spanjës*, 6 dhjetor 1988.

²²⁴ Çështja *Allenet de Ribemont k. Francës*, 10 shkurt 1995.

të akuzohet dhe të dënohet për kryerjen e saj. Dyshimet në një proces penal nuk janë tërësisht të përjashtuara, por ato mund të konsiderohen në përputhje me nenin 6/2 vetëm nëse të pandehurit i jepet mundësia e një mbrojtjeje efektive.²²⁵

Këtyre parimeve iu përmbajt GJEDNJ edhe në një çështje që lidhej me efektet e dispozitave të Kodit Doganor Francez.²²⁶ Sipas tyre, konsiderohet se një person ka kryer veprën penale të trafikut të paligjshëm (kontrabandës), nëse në protokollin zyrtar të doganës deklarohet se një person është posedues i mallrave, të cilat janë të ndaluara dhe për të cilat nuk është bërë deklaratë nga poseduesi në momentin e kalimit të pikës doganore. Në një rast, poseduesi ishte një shtetas afrikan, i cili kishte deklaruar në aeroportin francez një dërgesë në emër të tij që duhej të përmbante ushqime. Pasi këqyri nga jashtë të gjitha bagazhet, përcaktoi njëërën prej tyre si dërgesën e tij. Ai e mori valixhen megjithë paralajmërimin se në të mund të kishte mallra të ndaluara. Pas kësaj ai u nis drejt daljes nga ana ku kalojnë pasagjerët që nuk kanë asgjë për të deklaruar. Më vonë ai u ndalua nga punonjësit e doganës dhe u cilësua si posedues i valixhes, e cila, pas kontrollit të ushtruar, rezultoi se përmbante lëndë narkotike. Mbi këtë bazë, ai u arrestua dhe u shpall fajtor për mbajtjen dhe kontrabandimin e lëndëve narkotike. Gjykata e apelit e la në fuqi vendimin.

GJEDNJ, pas shqyrtimit të kësaj çështje, deklaroi se dënimi i kërkuesit nuk ishte bazuar vetëm në faktin e posedimit të mallrave të ndaluar. Sipas së drejtës franceze të doganave, gjykatat ndodheshin para një dyshimi të ligjshëm (arsyeshëm). Ky dyshim, sipas GJEDNJ, ishte zbatuar në mënyrë kufizuese dhe të pakundërshtueshme. Kështu, akuza kundër kërkuesit bazohej në elementë të tillë si: keqbesim i të pandehurit, pretendimi se kërkuesi e kishte pranuar valixhen megjithë paralajmërimin se mund të përmbante mallra të ndalura pa e vëzhguar më parë, ai kishte zgjedhur me vetëdije daljen në të cilën kalojnë personat që nuk kanë gjë për të deklaruar.

²²⁵ *Frowein/Peukert*, EMRK-Kommentar (1996) fq.282.

²²⁶ Çështja *Salabiaku k. Francës*, 7 tetor 1988.

Një rast i ngjashëm me këtë të fundit është edhe ai *Telfner k. Austrisë*. Është konsideruar si shkelje e nenit 6/2 të KEDNj deklarimi fajtor i kërkuesit, i cili mbështetej vetëm në dyshime që nuk arritën të provoheshin nga akuza.²²⁷ Kërkuesi dyshohej se kishte qenë në drejtim të automjetit, në momentin e aksidentimit të një personi. Viktima kishte arritur të identifikonte llojin e makinës, targën por jo drejtuesin e saj. Policia, pas hetimesh të kryera, arriti në konkluzionin se makina në fjalë përdorej nga disa persona, anëtarë të së njëjtës familje. Duke qenë se nga kontrollet kishte rezultuar se makinën e përdorte më shpesh i pandehuri (kërkuesi), organi i akuzës filloi ndjekjen penale ndaj tij, pa asnjë provë tjetër veç fakteve të mësipërme, duke e akuzuar për vepër penale të kryer si pasojë e pakujdesisë në formën e neglizhencës. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë ishte në mënyrë të përmbledhur i kësaj forme: *"...i pandehuri mohon të ketë kryer veprën penale të plagosjes, pasi nuk ka qenë drejtues i automjetit në momentin e kryerjes së kësaj vepre. E ëma dhe motra e tij nuk pranuan të dëshmojnë gjatë gjykimit. Pala e dëmtuar nuk mund të identifikonte drejtuesin e automjetit në momentin e aksidentit. E vetmja provë që mbetet e vlefshme është vëzhgimi i policisë së qarkut, e cila e konsideron si të njohur publikisht faktin se i pandehuri është përdoruesi kryesor i automjetit me të cilin është kryer vepra penale. Mbi bazë të këtij vëzhgimi gjykata arrin në përfundimin se i akuzuari ka qenë drejtues i automjetit në çastin e kryerjes së veprës penale. Edhe fakti tjetër se i akuzuari nuk ishte gjetur në shtëpinë e tij pas kryerjes së krimit dhe askush nuk kishte dijeni se ku mund të gjendej, flasin në favor të faktit dhe të çojnë në përfundimin e padiskutueshëm se i akuzuari është autor i veprës penale. Prezumohet se ai ka refuzuar të pranojë krimin, pasi ka qenë nën influencën e alkoolit, por kjo nuk mund të merret si provë".* Gjykata e apelit la në fuqi vendimin e mësipërm duke shtuar: *"...provohet se makina është përdorur më së shumti nga i akuzuari dhe ndonjëherë edhe nga të tjerët. I akuzuari ka pasur mundësinë gjatë gjykimit të jepte një version të kundërt të fakteve për të kundërshtuar akuzën dhe të përcaktonte dikë tjetër si autor të veprës penale. Gjykata e faktit ka bërë vlerësim të drejtë të fakteve,*

²²⁷ Çështja *Telfner k. Austrisë*, 20 mars 2001.

veçanërisht kur nuk ka prova se dikush tjetër ka drejtuar automjetin në momentin e krimit”.

GJEDNJ, pasi vlerësoi këto vendime të gjykatave të mësipërme, arriti në përfundimin se ndodhej para shkeljes së nenit 6/2 të KEDNJ. Ajo ritheksoi se, si rregull i përgjithshëm, “është detyrë e gjykatave të brendshme të marrin dhe vlerësojnë provat që paraqiten në proces, kurse GJEDNJ ka për detyrë të sqarojë se procedura si e tërë ka qenë e drejtë, gjë e cila në proceset penale përfshin edhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Neni 6/2 kërkon, inter alia, që në zbatim të detyrës së tyre gjykatat nuk duhet të fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet: barra e provës i bie prokurorit (akuzës) dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit.²²⁸ Prandaj parimi i prezumimit të pafajësisë do të quhej i cenuar, nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i akuzuari”.²²⁹ _

Në çështjen në fjalë, të dyja gjykatat e brendshme janë mbështetur vetëm në një raport të policisë lokale se kërkuesi ishte përdoruesi kryesor i mjetit dhe nuk ishte kthyer në shtëpi natën e aksidentit. GJEDNJ vlerëson se viktimi e krimit nuk ishte në gjendje të identifikonte drejtuesin e automjetit as të pohonte nëse ishte i gjinisë femërore ose mashkullore. Gjykatat kishin kërkuar nga kërkuesi të jepte shpjegime, pasi nuk kishin arritur të realizonin një çështje *prima facie* kundër tij. Për këtë arsye, ato e kishin kaluar barrën e provës nga akuza tek i akuzuari. Në përfundim, GJEDNJ vëren se të dyja gjykatat kanë spekuluar me mundësinë që kërkuesi të ketë qenë nën ndikimin e alkoolit, gjë e cila nuk ishte e bazuar në asnjë provë dhe kjo u pohua nga vetë akuza. Megjithëse ky spekulim nuk ishte direkt relevant me faktin e krijimit të elementëve të akuzës me të cilën ishte ngarkuar kërkuesi, ai ndikon në krijimin e përshtypjes se gjykatat e kishin formuar paraprakisht idenë për fajësinë e kërkuesit. Kjo përbën shkelje të nenit 6/2 të KEDNJ.

²²⁸ Shih rastin e përmendur më lart *Barbera k. Spanjës*, 6 dhjetor 1988.

²²⁹ Çështja *Murray k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 shkurt 1996.

Në vazhdim të standartit të mësipërm, le t'i hedhim një vështrim më poshtë qendrimin të GJK shqiptare. Lidhur me këtë parim, GJK ka theksuar se gjykatat nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet; barra e provës i takon palës akuzuese; çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit; gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza. Gjatë një kontrolli kushtetues për të arritur në përfundimin se është cenuar ose jo parimi i prezumimit të pafajësisë, ajo nuk duhet të ndalet në mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave, pasi kjo, sipas GJK, përbën gjykim themeli, gjë e cila nuk është në kompetencë të saj, ndryshe do të konsiderohej gjykatë konkurrenente me ato të sistemit të zakonshëm. Ky është një qendrim konsequent i kësaj Gjykate. Pyetja që shtrohet në këtë rast është: Në cilët elementë është mbështetur GJK për të arritur në përfundimin se është cenuar prezumimi i pafajësisë, i cili është element i procesit të rregullt ligjor?

Në një vendim të saj²³⁰, GJK ka marrë në shqyrtim një vendim të gjykatës së shkallës së parë ku, midis të tjerave, thuhet se "*i pandehuri është larguar në drejtim të paditur dhe kjo provon që ai është autor i krimit*". Thjesht largimi i të pandehurit nuk duhet të çojë në përfundimin se i ai është fajtor, vetëm e vetëm se akuza nuk arrin të sjellë prova konkrete, veç një dëshmie konfuze dhe të paqendrueshme të babait të të pandehurit, e cila konsistonte vetëm në faktin se i pandehuri në momentin e kryerjes së krimit mund të kishte qenë në posedim të armës me të cilën është kryer vepra penale – edhe kjo është thjesht hipotezë²³¹, pasi dyshimi binte mbi tre persona njëherësh, dy prej të cilëve u përjashtuan nga përgjegjësia penale.²³² GJK shqiptare ka theksuar se nuk është në kompetencë të saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove.²³³ Para këtij vendimi, GJK mori në shqyrtim

²³⁰ Vendim i GJK nr.9/2004.

²³¹ Sipas jurisprudencës kushtetuese gjermane, prezumimi i pafajësisë nënkupton mbrojtjen e të akuzuarit përballë akuzave të ngritura gjatë një procesi të drejtë duke i lënë mundësinë atij t'iu kundërvihet provave të prokurorit. Vendim i GJKF gjermane BVerfGE 35, 311, 320.

²³² Shih për argumentim më të gjerë mendimin e pakicës që shoqëron këtë vendim.

²³³ Po aty.

një tjetër ankim kushtetues, i cili bazohej në pretendimin se kërkuesit i ishte mohuar e drejta për të kërkuar ekspertimin mbi vërtetësinë e një dokumenti që pretendohet të ishte i falsifikuar. GJK arriti në përfundimin se gjykatat i kishin mohuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi hetimi i dokumentit të falsifikuar ishte e vetmja mënyrë që do të garantonte barazinë e armëve midis palëve dhe do ta çonte gjykatën në konkluzione të drejta për çështjen, aq më tepër po të kihet parasysh se vërtetimi në fjalë ishte prova e vetme dhe vendimtare mbi të cilën janë bazuar gjykatat në dhënien e vendimeve(!).²³⁴ Megjithëse GJK shqiptare lidhur me çështjen e administrimit dhe vlerësimit të provave ka mbajtur qëndrime të ndryshme,²³⁵ ajo e cilësoi në këtë rast mospranimin e kërkesës që pretendon falsifikimin e një akti ose dokumenti si shkak që sjell një proces të parregullt ligjor. Pra, GJK ia lejoi vetes vlerësimin se cila provë ishte vendimtare dhe e rëndësishme për procesin. Për të justifikuar qëndrimin GJK iu drejtua praktikës së GJEDNJ.²³⁶

Është deklaruar dhe konsoliduar qëndrimi se GJK nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor dhe rrjedhimisht nuk mund të bëjë gjykim themeli

²³⁴ Vendimi i GJK nr.8/2004.

²³⁵ Në vendimin nr.7/2000, GJK shprehet se "*analiza e provave të administruara gjatë gjykimit ose mënyra e vlerësimit të tyre janë e drejtë ekskluzive e gjykatave të zakonshme, pasi vetëm gjykatat më të larta mund të shqyrtojnë bazueshmërinë në ligj e në prova të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta. Vlerësimi i marrjes së provave nuk bën pjesë në gjykimin kushtetues. Shkelja e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor nuk varet nga zbatimi i ligjit material as nga mënyra e vlerësimit të provave. GJK nuk ka për detyrë të kontrollojë vendimet e gjykatave të zakonshme nga pikëpamja e bazueshmërisë së tyre në prova. Shih gjithashtu edhe vendimet e GJK nr.106/2001, nr.207/2001; nr.166/2002.*

²³⁶ Sipas GJEDNJ, detyrimi i gjykatës është të krijojë kushte të njëjta për palët në proces, por jo domosdoshmërisht edhe rezultatin e vlerësimit të provave ose deklaratave prej saj. Qëllimi i përmbajtjes së nenit 6/1, sipas GJEDNJ është të krijojë barazinë e palëve në proces duke i lënë autoriteteve kompetente mundësinë për të vendosur lidhur me rëndësinë e provave të paraqitura (Çështja *Feldbrugge k. Holandës*, datë 29 maj 1985). Fakti që gjykata, në rastin konkret, nuk ka marrë parasysh pretendimin e palës paditëse për ekspertim, nuk do të thotë se paditësi nuk ka përfitur nga parimi i barazisë së armëve. Gjykata ka për detyrë të çmojë kërkesën për ekspertim, dhe jo të vendosë detyrimisht ekspertimin për një çështje ose provë të caktuar. Gjykata nuk është e detyruar të pranojë apriori kërkesat e palëve, por pasi të ketë dëgjuar pretendimet e palëve, duhet t'i japë përgjigje atyre me vendim. Në këtë këndvështrim, nuk mund të konsiderohet shkelje e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor mospranimi i kërkesës për kryerje të ekspertimit nga gjykatat.

pra, të marrë dhe të administrojë prova që lidhen me zgjidhjen e çështjes në fakt. Kjo mbetet kompetencë e gjykatave të zakonshme. Por nëse mosrespektimi i parimeve kushtetuese për marrjen, administrimin e çmuarjen e provave ka sjellë një proces të parregullt ligjor, pra i ka mohuar të drejtat kushtetuese individit, atëherë kjo nuk ka të bëjë më me gjykimin e themelit por me gjykim kushtetues të mirëfilltë. Pro kësaj flet edhe praktika e GJEDNJ, e cila duke iu referuar nenit 6/1 të KEDNJ, thekson se gjykatat që shqyrtojnë ankimet duhet të vlerësojnë faktin, nëse mosadministrimi i provave thelbësore ka ndikuar ndjeshëm në vendimin e gjykatës më të ulët.²³⁷ Në rastin e çështjes së prezumimit të pafajësisë të sjellë më lart, ku kërkuesi ishte dënuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë, GJK, duke iu referuar tërësisë së fakteve të paraqitura gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal dhe mënyrës së administrimit të tyre, duhet të merrte në shqyrtim nëse fajësia e të akuzuarit kishte qenë apo jo e bazuar në fakte e prova bindëse apo thjesht dyshime.

Duke përmbledhur sa u tha më lart, mendoj se gjatë kontrollit kushtetues të GJK duhet të mbizotërojë parimi se *çdo vendim i parregullt cenon një të drejtë*. Kjo ndodh edhe në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese europiane, ku mund të gjejmë deri edhe korrigjim të interpretimeve ligjore të gjykatave të zakonshme, pasi këto të fundit nuk janë perqendruar tek e drejta kushtetuese e posaçme.²³⁸ Kështu,

²³⁷ Çështja *Edwards k. Britanisë së Madhe*, 16 dhjetor 1992.

²³⁸ Vendim i GJK sllovene SLO-1996-2-006. Në të midis të tjerave thuhet: " ...Article 27 of the Constitution, (which) provides that any person charged with a criminal offence shall be presumed innocent until he or she is proven guilty by due process of law, the presumption of innocence is prescribed. The presumption of innocence means that (1) a person shall be deemed to be innocent until found guilty, (2) that the evidence of guilt shall be provided by a state prosecutor, not by the defendant (burden of proof) and (3), which is the most important, in case of doubt, when guilt has not been manifestly proven, the court must find the defendant not guilty. A court which had not followed such rules, had adjudicated in violation of the legal principles recognized by civilized nations. And application of such provision in today's proceedings would be contrary to the now applicable legal system. Po ashtu edhe vendimi i GJL të Britanisë së Madhe GBR-2001-1-003 " ... It follows that what is of the essence in this context is the use to which evidence obtained under compulsion is made in the course of the criminal trial. The Court notes that at each level of jurisdiction the domestic courts assessed the effect of admission of the evidence on the fairness of the trial by reference to section 78 of PACE, and the courts discussed, amongst other matters, the non-statutory basis for the surveillance. The central question in the present case is whether the proceedings as a whole were fair."

për GJKF gjermane një ankim kushtetues individual kundër një vendimi gjykate pranohet si i bazuar, kur gjyqtari gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës nuk ka arritur të vlerësojë siç duhet të drejtat themelore, pra nuk ka arritur të dallojë se ndodhet para një konflikti midis dy ose më shumë fushave të së drejtës dhe si rrjedhim nuk ka bërë balancimin e duhur midis tyre.²³⁹ Kjo ka sjellë si pasojë mosrespektimin e të drejtave themelore në procesin gjyqësor. Lidhur me këtë GJEDNJ ka ritheksuar edhe në çështjen *Allenet de Ribemont k. Francës*²⁴⁰ dhe *Heaney & McGuinness k. Irlandës*²⁴¹ se mënyrat e interpretimit të përmbajtjes së nenit 6/2 të Konventës duhet të jenë "praktike dhe efektive dhe jo teorike e iluzore". Marzhi i kontrollit që ushtron GJK nuk duhet të jetë i përcaktuar një herë e përgjithmonë, ai duhet të jetë elastik, pra të mund të zgjerohet sa herë që kjo i shërben kauzës më të rëndësishme: mbrojtjes së lirive dhe të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë/Konventë. Në fund të fundit ky është edhe misioni i GJK: të garantojë zbatimin e Kushtetutës dhe të mbrojë individin nga arbitrariteti shtetëror.

Në vazhdimësi, praktika e GJK është përqendruar kryesisht në këto linja sa i takon parimit të prezumimit të pafajësisë:

GJK ka theksuar "se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Ky parim parashikohet nga neni 30 i Kushtetutës ... Gjykata është shprehur edhe më parë, se parimi i prezumimit të pafajësisë do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuzat... Bazuar në materialet e dosjes gjyqësore, Gjykata çmon se nuk ekziston ndonjë e dhënë e cila tregon që anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen ta kenë filluar procesin me idenë e paracaktuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Dosja gjyqësore nuk përmban

²³⁹ Vendime të GJKF gjermane BVerfGE 42, 312; BVerfGE 70, 138; BVerfGE 67, 90, 94.

²⁴⁰ Çështja *Allenet de Ribemont k. Francës*, 10 shkurt 1995.

²⁴¹ Çështja *Heaney & McGuinness k. Irlandës*, 21 dhjetor 2000.

ndonjë fakt apo rrethanë që të dëshmojë se anëtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të Gjykatës së Apelit Vlorë, apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. As vendimi për masën e sigurisë arrest me burg të kërkuesit dhe ai lidhur me sigurimin e provës nuk përmbajnë deklarata ose arsyetime, të cilat, në një apo tjetër mënyrë, të çojnë në përfundimin se këto gjykata e kanë konsideruar kërkuesin si fajtor. Gjykata çmon gjithashtu, se gjykatat e zakonshme, nuk e kanë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri...Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk i është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë si element i procesit të rregullt ligjor në bazë të nenit 42 të Kushtetutës".²⁴²

GJK ka bërë dallimin midis procesit të rregullt ligjor gjatë gjykimit penal sa i takon prezumimit të pafajësisë dhe procesit administrativ që lidhen me shkarkimin e funksionarëve të lartë. Ajo ka theksuar se "...komisionet parlamentare, në rastet e shkarkimit të funksionarëve kushtetues zhvillojnë procedura "quazi gjyqësore" dhe respektojnë parimet e procesit të rregullt ligjor për atë që u lejohet mundësia e shqyrtimit për të marrë një vendim, i cili është me karakter politiko administrativ dhe jo gjyqësor. GJK, në vendimin nr.18/2003 është shprehur, se në këto raste Kuvendi duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, ndërsa në vendimin nr.75, datë 19.04.2002 ka pranuar gjithashtu, se funksioni që kryen Kuvendi në rastet e verifikimit të shkaqeve për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces, sipas atij vendimi, është një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative, ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkrete që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo të prokurorit. Megjithatë, edhe në rastet e gjykimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe ai i paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, sepse Parlamenti, qoftë në përbërjen dhe organizimin e vet, qoftë në veprimtarinë e funksionit të tij, nuk ka si të jetë organ gjyqësor.

²⁴² Vendime të GJK nr. 9/2004; 19/2008; nr.16/2009.

Parlamenti, në një procedurë shkarkimi nuk ushtron pushtet gjyqësor, por një pushtet tjetër e të ndryshëm, që në mënyrë ekskluzive i është deleguar atij. Prandaj, ky organ mund të zbatojë parimin e paanësisë në një mënyrë tipike kushtetuese d.m.th. për aq sa nuk e pengon të ushtrorë kompetencat e veta për të nxjerrë një akt administrativ që ka njëkohësisht edhe një natyrë kushtetuese.

...Prerogativa e Kuvendit për paraqitjen e propozimit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe ajo e Presidentit të Republikës për të dekretuar shkarkimin e tij, të parashikuara në nenin 149 të Kushtetutës, realizohen nëpërmjet një procedure që disiplinohet edhe nga Ligji nr.8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit", nga Rregullorja e Kuvendit dhe nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë prej këtyre burimeve që disjplinojnë këtë procedurë nuk ndalohet që deputetët që kanë kërkuar nisjen e një procedure shkarkimi të mos jenë edhe anëtarë të komisionit parlamentar. Gjithashtu, në asnjë prej këtyre burimeve nuk ndalohet dhe nuk mund të ndalohet që të lartpërmendurit të mos marrin pjesë në votimin e raportit përfundimtar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Presidentin e Republikës. Duke qenë organi i vetëm që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ai është njëkohësisht i pazëvendësueshëm në këtë vendimmarrje dhe si i tillë në konkurrimin e parimit të ushtrimit të funksionit të organit shtetëror me atë të paanshmërisë, merr përparësi ai i kryerjes së funksionit kushtetues".²⁴³

4.2 Mosdënimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër

Parimi *ne bis in idem* ose mosdënimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe si i tillë ajo duhet të kuptohet dhe përkufizohet duke patur parasysh kriteret e mëposhtme. Parimi *ne bis in idem* ndalon sipas akteve ndërkombëtare "ndjekjen penale gjyqësore dhe /ose dënimin (to be tried or punished again) për shkak të kryerjes së një vepre të

²⁴³ Vendim i GJK nr.21/2008.

dënueshme (an offence), për të cilën ai është dënuar ose lënë i lirë më parë me vendim të formës së prerë” (finally convicted or acquitted). Ky është përkufizimi që jep Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile i OKB –së. Rihapja e procesit për shkaqe të jashtëzakonshme, p.sh gjetja e provave të reja nuk përbën cënim të parimit *ne bis in idem*.²⁴⁴

Shprehja *“për të njëjtën veprë penale”* interpretohet nga doktrina kushtetuese dhe ajo penale si *“ngjarje e ndodhur më parë në kohë mbi të cilën është ngritur një akuzë dhe ka filluar procesi penal në seancë gjyqësore, në përfundim të së cilës i pandehuri ka rezultuar autor ose bashkëpunëtor në kryerjen e veprës objekt akuze”*.²⁴⁵ Vendimtare për të arritur në këtë përfundim është pyetja se çfarë do të konsiderohet si ngjarje e ndodhur më parë, pra do të quhen edhe pjesë të së njëjtës ngjarje apo duhet të konsiderohet vetë ngjarja si e tërë. Përkufizimi që mund t’i jepet kësaj shprehje nga pikëpamja e së drejtës kushtetuese lidhet direkt me përkufizimin që jep teoria e së drejtës penale për veprën penale në përgjithësi. Por megjithatë të dyja këto përkufizime nuk janë identike, sepse nga pikëpamja e së drejtës kushtetuese ky përkufizim trajtohet i lidhur ngushtë me rrethana dhe situata të ndryshme dhe në varësi të tyre merr kuptim të ndryshëm ose më të gjerë.

Në veçanti, si një veprë e vetme konsiderohet një sjellje e caktuar, e pandarë, e parashikuar si e dënueshme e cila mund të kryhet e ndarë në pjesë por ka të njëjtën vendngjarje dhe të njëjtin moment kryerje, megjithëse ligjërisht (juridikisht) mund të shihet nga kënde të ndryshme vështrimi dhe mund të bëhet objekt shqyrtimi në dy procedime penale. Kështu p.sh do të konsiderohet si e njëjta veprë penale moszbatimi i thirrjes për kryerjen e shërbimit ushtarak për shkak se kjo lidhet me një qëndrim të vetëm, i cili është marrë mbi bazën e ndërgjegjes së personit dhe që ka mbetur i pandryshuar gjatë gjithë kohës. Nga ana tjetër, do të konsiderohen si vepra të veçanta të shkëputura nga njëra-tjetra mosbindja e një personi, në

²⁴⁴ Neni 14/7 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat dhe Politike dhe Civile i OKB-së, miratuar në 1966.

²⁴⁵ Vendim i GJKF gjermane BverfGE 23, 191.

mënyrë të përsëritur, ndaj urdhërit, kur ai nuk është deklaruar si kundërshtar i bindur i luftës ose shërbimit ushtarak, pra nuk bën pjesë te kundërshtarët e ndërgjegjes.²⁴⁶

Parimi *ne bis in idem* konsiderohet i shkelur jo vetëm në rastin kur personi dënohet më shumë se një herë kur ai edhe ndiqet penalisht nga organi i akuzës në mënyrë të përsëritur. Instituti që ngre akuzën në përfundim të hetimeve duhet të vendosë ose lënien e lirë të tij ose pushimin e çështjes penale në ngarkim të të akuzuarit. Kështu që, për të respektuar parimin e mësipërm, duhet që e njëjta akuzë të mos ngrihet përsëri për të njëjtën vepër, pasi veprohet jo vetëm në kundërshtim me legjislacionin penal por edhe me atë kushtetues. Pra, nuk është e domosdoshme që të jetë marrë patjetër një vendim nga ana e gjykatës, por mjafton thjesht nisja e procedimit penal nga organi i akuzës.

Parimisht pranohet se ndalimi i dënimit më shumë se një herë nënkupton rastin kur për veprën penale konkrete është marrë një vendim i formës së prerë nga gjykata.²⁴⁷ Vendimi në këtë rast do të nënkuptojë atë akt i cili ka sjellë pasojë juridike të plotë duke e rregulluar përfundimisht dhe plotësisht situatën juridike konkrete. Këtu bëjnë pjesë të gjitha vendimet për lënien e lirë të të pandehurit ose shpalljen e tij fajtor në fund të gjykimit. Shprehja "*dënuar me vendim të formës së prerë ose shpallur i pafajshëm*" ka brenda kuptimin se duhet të jenë shterrur të gjitha shkallët dhe afatet konkrete të ankimit. Parimi *ne bis in idem* ka për qëllim mbrojtjen e personit të shpallur një herë fajtor ose të pafajshëm me vendim të formës së prerë për një vepër penale. Parimi *ne bis in idem* ndalon rigjykimin e ridënimin për të njëjtën vepër dhe nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me natyrë të ndryshme, p.sh penale dhe disiplinore. I njëjti veprim mund të konsiderohet si shkelje e dy ligjeve/normave edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë që ligji/norma tjetër nuk e

²⁴⁶ Vendimi i GJKF gjermane BverfGE 23, 191, në: Vendime të përzgjedhura të GJKF gjermane (2009), fq.632.

²⁴⁷ *Denar Biba, Ne bis in idem*, në: Jeta Juridike (2005) fq.59.

ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia apo dënimi në bazë të njërit ligj nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit.²⁴⁸

Në këtë linjë duhet parë edhe praktika e GJK shqiptare, e cila vetëm vitet e fundit ka filluar të elaborojë qëndrimin e saj lidhur me këtë element të rëndësishëm të procesit të rregullt. Ajo ka theksuar se *"neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i Protokollit 7 të KEDNJ nuk janë pengesë gjithashtu për gjykimin e dënimit e personave që kryejnë sjellje kriminale të njëpasnjëshme edhe nëse sjelljet janë të ngjashme ndërmjet tyre. Ideja e parimit ne bis in idem nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Megjithatë, aktet e mësipërme lejojnë rigjykimin, kur dalin fakte të reja të cilat janë të një natyre të tillë që mund të çënojnë vendimin e dhënë. Në këtë rast e drejta për rishqyrtim nuk mund të bazohet mbi skema logjike të supozuara në mënyrë apriori por mbi kritere praktike të mundshme. Parimi ne bis in idem si dhe trajtimi i barabartë i të gjykuarve cenohen jo vetëm kur personi dënohet përsëri për të njëjtën vepër, por edhe kur ndiqet penalisht në mënyrë të përsëritur për këtë vepër. Prandaj, ky parim gjen zbatim edhe për rastet e mbrojtjes nga masat shtrënguese e ndaluese të cilat janë të lidhura ngushtë me procedimin. Përkundrazi, një person që është thirrur si i pandehur dhe është dënuar penalisht gjatë një procesi mund t'i nënshtrohet një procesi të dytë civil për të njëjtën vepër si përgjegjës civilisht për dëmin e shkaktuar ose si i dënuar me gjobë duke u zbatuar parimi që gjëja e gjykuar është e vërtetë".*²⁴⁹ Siç del edhe nga teksti i vendimit të mësipërm, GJK, në çështje të tjera të kësaj natyre, ka mbajtur qëndrimin se ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Kjo nuk

²⁴⁸ Shih për më tepër Raportin Shpjegues (Explanatory Report) lidhur me hartimin dhe miratimin e Protokollit 7 të KEDNJ, konkretisht për nenin 4 që parashikon ndalimin e dënimit të përsëritur për të njëjtën vepër penale.

²⁴⁹ Vendim i GJK nr.5/2005.

vlen për rastet e procedimit penal kur ai pushon për shkak se nuk gjenden prova të mjaftueshme për të akuzuar dhe më pas gjykuar të dyshuarin. Kështu, ajo në një çështje konstatoi se "kërkuesi ishte akuzuar nga organi i prokurorisë për kryerjen në bashkëpunim të veprave penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga nenet 109/1, 88/1 e 278/2 të Kodit Penal, lidhur me ngjarjen e rrëmbimit të shtetasit I.G. dhe plagosjes së vëllait të tij Dh.G., ngjarje e ndodhur më datë 28.06.1998. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, me vendim të prokurorit datë 06.10.1998 u vendos "pushimi i procedimit penal ndaj të pandehurit A.R për mungesë të provave të mjaftueshme". Në atë periudhë u kryen një sërë hetimesh paraprake dhe meqenëse nuk u bë i mundur zbulimi i autorëve, ... prokurori pezulloi hetimet në lidhje me këtë ngjarje. Me vendimin datë 25.01.2001 të prokurorit, u shfuqizua vendimi i pezullimit, rifilluan hetimet dhe në përfundim të tyre u akuzuan si autorë të ngjarjes shtetasit R.H, A.R. e Z.H. ...Neni 328 i KPP ka parashikuar rastet kur mund të vendoset pushimi i akuzës ose çështjes nga prokurori dhe një nga këto raste është ai i parashikuar në pikën "dh" (del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai). Në rastin e parë, pra kur "del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën", nga hetimi është vërtetuar pafajësia e të pandehurit, kurse në rastin e dytë, pra kur "nuk provohet që e ka kryer ai", fajësia e të pandehurit mbetet e dyshimtë. Në të dyja rastet kemi pushim të akuzës ndaj personit të marrë në cilësinë e të pandehurit, por jo pushim të çështjes, sepse vepra penale ekziston, autori i saj nuk dihet dhe hetimet për gjetjen e autorit të veprës penale vazhdojnë. Rasti kur i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, ndryshon nga rasti kur nuk provohet që veprën e ka kryer ai, sepse në rastin e parë pafajësia e tij është e provuar dhe e qartë, ndërsa në rastin e dytë fajësia nuk provohet, por mbetet e dyshimtë dhe dyshimi është në favor të të pandehurit.

Gjykata Kushtetuese vëren, se dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, në aspektin procedural penal, do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen

e një vepre penale dhe as mund t'i jepet një dënim penal, pa një vendim gjykate, të marrë në bazë të ligjit. Gjykata Kushtetuese vë në dukje, se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë, se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori. Për pasojë, pushimi i akuzës ose i çështjes penale nga prokurori, në vetvete, nuk barazohet me pafajësinë e të pandehurit... çështja penale është e hapur dhe hetimet vazhdojnë pasi autori nuk është gjendur ende. Organi i akuzës ka detyrimin të vazhdojë punën për zbardhjen e ngjarjes dhe, me gjetjen e provave të reja, prokuroria mund të ngrejë akuzë edhe ndaj personit për të cilin kishte pushuar më parë procedimin penal, por është gjykata ajo që do të vendosë mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, me një vendim përfundimtar. Sa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson, se vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përfaqëson një vendim përfundimtar, të formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe, në këtë kuptim, nuk ka cenim të parimit ne bis in idem".²⁵⁰

Pra, GJK nuk e konsideron të shkelur parimin, nëse nuk ka një vendim përfundimtar lidhur me çështjen konkrete. Në të njëjtin vendim, GJK ka mbajtur qëndrim edhe për rastin kur kërkuesi ka pretenduar cenim të parimit *ne bis in idem* për shkak të dënimit për herë të dytë lidhur me të njëjtën vepër penale (armëmbajtje pa leje). Sipas GJK, "parimi *ne bis in idem* nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Parimet e sanksionuara në nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Protokollit 7 të KEDNJ parashikojnë, se një person i gjykuar dhe i dënuar me vendim të formës së prerë nuk mund të procedohet dhe të gjykohet përsëri për të njëjtën akuzë, që duhet kuptuar për të njëjtin fakt. Për pasojë,

²⁵⁰ Vendim i GJK nr.10/2009.

*një fakt i ri do të gjykohet normalisht edhe pse është kryer nga i njëjti person dhe ka të njëjtin cilësim ligjor me një fakt tjetër për të cilin ai është dënuar më parë. Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se megjithëse kërkuesi ndodhet përpara akuzave të njëjta, ato jo vetëm që i referohen dy ngjarjeve të ndryshme, por madje nuk i referohen as të njëjtës armë për të cilën ai ka vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata. Në këto kushte, as në këtë aspekt nuk kemi cenim të parimit ne bis in idem".*²⁵¹

4.3 E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës me qëllim kundërshtimin e një akti të organeve të administratës publike konsiderohet si një e drejtë themelore autonome dhe si element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës.²⁵² E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton mundësinë e individit për të kundërshtuar gjyqësisht një akt si dhe ekzistencën e një organi të caktuar me ligj, të pavarur dhe të paanshëm për shqyrtimin e ankimit. Pra, në vetevete ky nen sanksionon jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjithashtu, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42/2 të Kushtetutës, i cili siguron zbatimin efektiv të një procesi të rregullt ligjor, ka për qëllim t'u garantojë palëve në proces të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'i vendosur ato në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës.²⁵³

GJK ka vlerësuar se normat dhe parimet kushtetuese, ku bën pjesë edhe e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për të pasur një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që

²⁵¹ Po aty.

²⁵² Vendim i GJK nr.5/2009.

²⁵³ Vendime të GJK nr.15/2003; nr.9/2003; nr.17/2005.

është përgatitur më parë dhe dhënie e një vendimi përfundimtar mbi të. Gjatë shqyrtimit, gjykata, në ushtrimin e funksioneve të saj, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, me qëllim vendosjen në vend të një të drejte të cenuar nga një akt i pushtetit publik, ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. Në një shoqëri demokratike e drejta e individit për t'iu dëgjuar nga gjykata është një garanci e domosdoshme për të respektuar të drejtat dhe liritë e tjera themelore të shtetasve në një shtet të së drejtës.²⁵⁴

Duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si element përbërës i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ, është pranuar se vendimet e autoriteteve administrative duhet t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë, i cili duhet të sigurojë garancitë e tjera të kësaj Konvente. GJEDNJ ka vlerësuar vazhdimisht se kjo e drejtë është thelbësore dhe ka karakter parësor në një shoqëri demokratike për shkak të pasojave që ka në interesat legjitime të individit. Në vijim edhe të jurisprudencës më të fundit të po asaj Gjykate, autoriteti që ushtron kompetencën e rishikimit të një akti ose procesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.²⁵⁵

GJK të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e ka lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave që rregullohet nga Kushtetuta dhe ligje të tjera. Kuptimi dhe interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave, si rregull është detyrë e Gjykatës së Lartë, por në kuadër të një gjykimi kushtetues, këtë interpretim e bën edhe GJK në funksion të verifikimit të pretendimeve për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t'iu drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. GJK vëren se "...kjo

²⁵⁴ Vendime të GJK nr.4/2005; nr.21/2006; nr.10/2007; nr.26/2007.

²⁵⁵ Çështja *Bujnita k. Moldavisë*, 16 janar 2007 dhe çështja *Xheraj k. Shqipërisë*, 29 korrik 2008.

dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Dispozita i garanton subjekteve të cenuar të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë, publik e të paanshëm. Shteti i të drejtës presupozon, që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të konfliktit.

...Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke nxjerrë mosmarrëveshjen objekt gjykimi jashtë juridiksionit gjyqësor, bie ndesh me dispozitat kushtetuese të sipërcituara, ashtu dhe me dispozitat ligjore në fuqi, që zbatojnë parimet kushtetuese në këtë aspekt. Të tilla janë nenet 324 e 325 të KPC, ku përcaktohet se në kompetencë të seksioneve për gjykimet administrative është "pasia me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ", si dhe neni 22 i ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Në këtë të fundit parashikohet në mënyrë të shprehur e drejta e ankimit nga çdo subjekt i interesuar apo në mirëbesim, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kërkuar të drejtat lidhur me pasuritë e sekuestruara me akt administrativ ...Gjykata Kushtetuese çmon se qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, prek standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e pengimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, duke i mohuar shoqërisë kërkuese të drejtën për gjyq".²⁵⁶

Në një vendim tjetër ajo është shprehur edhe lidhur me kufizimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës duke vlerësuar se "...e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute, pasi nga natyra e saj, kjo e drejtë kërkon rregullim ligjor. Një aspekt konkret i këtij rregullimi janë edhe rregullat për paraqitjen e padisë, që përcakton KPC. Për pasojë, fakti se kërkuesi ka paraqitur një kërkesë për shtimin e objektit të padisë, që nuk përmbush standardet e padisë nuk e vinte gjykatën para detyrimit për ta marrë atë në shqyrtim. E drejta e aksesit në

²⁵⁶ Vendim i GJK nr.10/2007.

*gjykatë imponon për kërkuuesin respektimin e rregullave procedurale në këtë drejtim. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Lartë e ka lënë të hapur mundësinë që kërkuesi lidhur me kërkimin për shpërblimin e dëmit mund t'i drejtohet me padi të veçantë gjykatës së apelit”.*²⁵⁷

GJK ka tentuar ta interpretojë gjerësisht edhe dispozitën lidhur me të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatës kundër masave disiplinore. Ky ka qenë edhe rasti, kur GJK ka pranuar se procesi i rregullt shtrihet jo vetëm ndaj vendimeve gjyqësore por edhe ndaj akteve individuale administrative. Kështu në një rast, ajo ka theksuar se mosparashikimi i shprehur i mjetit të ankimit gjyqësor ndaj masave disiplinore që jep KLD ndaj gjyqtarëve nuk do të thotë se atyre u mohohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës së zakonishtme lidhur me pretendimet e tyre. *“E drejta e çdo individi për t'iu drejtuar gjykatës buron nga neni 42/2 i Kushtetutës. Përsa u përket gjyqtarëve, Kushtetuta i ka deleguar ligjvënësit kompetencën që, nëpërmjet ligjit, të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që lidhen me transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore, por pa u shprehur për të drejtën e ankimit të tyre dhe për organin që do të shqyrtojë këto ankesa. Jo vetëm kaq, por legjislacioni ynë ka parashikuar të drejtën e aksesit të një numri funksionarësh publikë nëpërmjet rrugës gjyqësore si p.sh. nëpunësit e shërbimit civil kundër vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil, për largimin e tyre nga detyra, apo të prokurorëve për të kërkuar pagën nëse shkarkimi i tyre nga detyra është i pabazuar.*

...Legjislacioni shqiptar nuk ka pasqyruar ndonjë kufizim për të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatave të sistemit gjyqësor. Përkundrazi, ai ka pranuar të drejtën e ankimit të tyre në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe në rastet e masave disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Nëse Gjykata e Lartë ka ndalim kushtetues sepse një kompetencë e tillë nuk i është dhënë shprehimisht nga Kushtetuta, një ndalim të tillë nuk e kanë gjykatat e tjera të sistemit gjyqësor, të cilat për më tepër, në shqyrtimin e çështjeve bazohen në parimin e përcaktuar në nenin 1/2 të KPC,

²⁵⁷ Vendim i GJK nr.18/2007.

*sipas të cilit ato nuk mund të refuzojnë të shqyrtojnë dhe të japin vendime për çështjet që paraqiten për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë”.*²⁵⁸

Në një çështje të ngjashme me këtë, lidhur përsëri me të drejtën e ankimit të gjyqtarëve ndaj masave disiplinore, ajo ka ritheksuar se *“e drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një pjesë e pandashme e garancisë për një proces të rregullt ligjor, që sanksionohet nga neni 6 i KEDNJ. Kjo e drejtë nuk është absolute dhe disa kufizime të saj mund të konsiderohen në përputhje me KEDNJ, nëse ato kanë qëllime të ligjshme dhe janë në përpjestim me synimin që duan të arrijnë. Sidoqoftë, Konventa garanton të drejta që janë praktike, efektive dhe jo teorike dhe iluzore. Shtetet janë të lira të vendosin mbi një institucion me juridiksion apeli dhe mbi kategoritë e çështjeve që do të përfitojnë nga kjo,²⁵⁹ por, një shtet i cili nuk krijon institucione të tilla duhet që, në legjislationin e tij të brendshëm, të mirëpërcaktojë kategoritë e çështjeve të cilat nuk do të gëzojnë të drejtën e apelit. Për pasojë, në respekt të nenit 6 të KEDNJ, shtetet janë të detyruara të sigurojnë për këdo një të drejtë efektive për t’iu drejtuar gjykatës.*

...Për çështjen në shqyrtim, nisur nga qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që e kanë nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit të tyre, në referencë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kërkuesja synon nëpërmjet këtij gjykimi realizimin dhe shtrirjen e kësaj të drejte edhe për masat e tjera disiplinore që merren ndaj gjyqtarëve. Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të nënvizojë faktin, se qëndrimi i mbajtur prej saj për evidentimin e zgjerimit në mënyrë antikushtetuese dhe tej kuptimit të nenit 141 që ligjvënësi i kishte dhënë juridiksionit të Gjykatës së Lartë, nuk ka patur për qëllim mohimin e të drejtës së gjyqtarëve për t’iu drejtuar gjykatës për masat e tjera disiplinore. Ajo është konsekuente në qëndrimin e saj lidhur me moslejimin e tejkalimit të juridiksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë, në funksion të standardit të mbrojtjes së gjyqtarit. Për rastin konkret, Kushtetuta nuk jep hapësirë për të interpretuar në mënyrë të zgjeruar juridiksionin e Gjykatës së Lartë, por njëkohësisht

²⁵⁸ Vendim i GJK nr.24/2007.

²⁵⁹ Çështja *Delcourt k. Belgjikës*, 17 janar 1970, cituar në vendimin e GJK.

as nuk e ndalon ligjvënësin, që nëpërmjet nxjerrjes së normave ligjore, të parashikojë hollësisht të gjitha elementet e domosdoshëm që lidhen me rastet e përgjegjësisë disiplinore, si dhe të procedurave që duhen ndjekur.

Në nenin 147 të Kushtetutës parashikohen dy rregullime për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, nga të cilat, në kuptim dhe të nenit 4 të saj, njëri zbatohet drejtpërsëdrejti, ndërsa tjetri të referon te zgjidhja diskrecionare e ligjvënësit. Nga mënyra e formulimit të nenit 147, pika 6 konkludohet se vetë Kushtetuta ka rregulluar çështjet që lidhen me largimin nga detyra të gjyqtarit si dhe ka njohur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si organin kompetent që merret me shqyrtimin e këtij ankimi. Një formulimi i ndryshëm jepet në pikën 4 të këtij neni, sipas të cilit, "Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit". Kushtetuta, nëpërmjet kësaj dispozite referuese e ka autorizuar ligjvënësin që mbi bazën e koncepteve dhe parimeve kushtetuese të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve nëpërmjet nxjerrjes së normave përkatëse juridike. Pikërisht mbi bazën e këtij interpretimi të dispozitës së sipërcituar, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se "lloji dhe natyra e masave disiplinore si dhe procedura e marrjes së tyre janë brenda vullnetit të ligjvënësit, përjashtimisht masës së shkarkimit nga detyra për të cilën Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të veçantë".²⁶⁰

...Parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gjyqësorit kërkojnë gjithashtu ekzistencën edhe të mekanizmave që garantojnë realizimin efektiv të tyre. Kriteri i aksesit në gjykatë është i përmbushur në qoftë se vendimet e autoriteteve administrative i nënshtrohen kontrollit të organit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë.²⁶¹ E drejta e gjyqtarit për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur, i cili ka në dispozicion mjetet për të rivendosur në vend të drejtat e procesit ligjor, ose pavarësinë e vet gjyqësorit, përbën një standard për funksionimin normal të shtetit të së drejtës.

²⁶⁰ Vendim i GJK nr.29/2005.

²⁶¹ Çështja *Albert dhe Le Compte k. Belgjikës*, 10 shkurt 1983.

...Gjykata Kushtetuese thekson se, nga njëra anë, të drejtat e njeriut nuk mund të vendosen në të njëjtin nivel mbrojtjeje me të drejtat që i përkasin një funksionari publik, por, nga ana tjetër, ajo konstaton gjithashtu se e drejta e gjyqtarit për t'iu drejtuar gjykatës për veprimet që cenojnë të drejtat dhe elemente të pavarësisë së tij nuk mohohet nga Kushtetuta apo ligji. Mbi bazën e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese konkludon, se Kushtetuta nuk i njeh të drejtën Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të shqyrtojë ankimet ndaj masave të tjera disiplinore të gjyqtarëve, me përjashtim të shkarkimit nga detyra, por njëkohësisht nuk pengon të drejtën e gjyqtarëve që t'iu drejtohen gjykatës për veprimet që kanë të bëjnë me shkëlqjen e të drejtave, të pavarësisë ose të procesit ligjor. Prandaj, duke qenë në kushtet e një ometimi ligjor që mund të sjellë dhe antikushtetutshmëri, Gjykata Kushtetuese çmon, se mbetet në vullnetin e ligjvënësit, që në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, por dhe të jurisprudencës së saj, të garantojë në të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatës për shqyrtimin e masave të tjera me karakter disiplinor".²⁶²

GJK është ndalur edhe tek një element tjetër i të drejtës së aksesit në gjykatë, konkretisht tek çështja e legjitimitit të individëve para gjykatave të zakonshme. Ajo ka theksuar se çështja e legjitimitit të palëve në një proces civil nga GJK duhet vlerësuar në këndvështrimin e standartit të aksesit në gjykatë, si element i procesit të rregullt. Lidhur me legjitimitimin e palëve në proces civil, ajo gjithashtu është shprehur se KPC, në pjesën e përgjithshme të tij, zbërthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë çka garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 të KPC padia përkufizohet si e drejta për t'iu dëgjuar e çdo personi për pretendimet e tij, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e ligj ose jo.²⁶³ GJK ka vlerësuar se vetëm fakti i legjitimitit të një subjekti për të ngritur padi që nuk duhet të legjitimohet sipas ligjit, nuk cenon në çdo rrethanë të drejtën e palës tjetër për proces të rregullt ligjor. Në raste të tilla, GJK vlerëson nëse janë respektuar

²⁶² Vendime të GJK nr.26/2007; nr.29/2007. Vlen të theksohet se në këto vendime GJK është shprehur edhe për ometimin ligjor si element antikushtetutshmërie që cenon garantitë e njohura me Kushtetutë.

²⁶³ Vendime të GJK nr.5/2006; nr.8/2008.

të drejtat e palës kundërshtare për një proces kontradiktor.²⁶⁴ Bazuar në këto argumente, GJK ka mbajtur qëndrim konstant lidhur edhe me arsyetimin e vendimeve gjyqësore kur gjykatat arrijnë në përfundimin se paditësi nuk legjitimohet t'i drejtohet gjykatës duke nënvizuar se *"... mohimi i të drejtës së aksesit, d.m.th. i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ...E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut, ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj.*

...Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Në vendimin e saj, gjykata, ndër të tjera, shprehet se "...padija e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër Bashkisë Korçë...". Me këtë arsyetim jo të plotë dhe të dykuptimshëm, Gjykata e Apelit ka vënë në diskutim të drejtën e kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje për themelin e pretendimit të tij dhe ka lënë të nënkuptohet që ai nuk ka një bazë ligjore ku mund ta mbështesë padinë e tij.

Gjykata e vlerëson të lidhur me të drejtën e aksesit parimin e deklaruar nga neni 1 i KPC: "Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë." Në bazë të këtij parimi gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjykata për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje

²⁶⁴ Vendim i GJK nr.8/2008.

me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese.

Gjykata çmon se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Korçë nuk ka respektuar detyrimet e evidentuara më sipër, që rrjedhin nga parimi i parashikuar në nenin 1 të KPC dhe nga e drejta e kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës. Ajo është mjaftuar duke u shprehur se padia e kërkuesit nuk mund të ngrihet, duke i cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë një përgjigje nga gjykata për themelin e pretendimit të tij”.²⁶⁵

Përsëri lidhur me legjitimitimin por në këtë rast duke iu referuar mohimit të drejtës për të paraqitur padi për shkak të tejkalimit të afatit, GJK ka theksuar se *"e drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi...Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. Gjykata Kushtetuese thekson, se në përputhje me parimet e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës, KPC rregullon/ implementon të drejtën e aksesit në një sërë dispozitash të tij. Kështu, Kodi rregullon të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë, e cila duke patur parasysh natyrën e saj si arbitër, nuk procedon me nismën e vet, nëse nuk vihet në lëvizje nga palët (neni 2 i KPC). Në çdo rast është pala inicuese ajo që tregon objektin e gjyqimit dhe kështu, gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i KPC). Përveç këtyre, KPC parashikon një tërësi rregullimesh të tjera parimore dhe specifike, si parakushte për realizimin e të drejtës individuale të aksesit në një gjykatë.*

...Gjykata Kushtetuese vëren, se në vështrim të nenit 162 të KPC, në rastin e shpronësimit për interes publik të një pasurie të paluajtshme, e cila figuron në bashkëpronësi të disa subjekteve, padia për kërkimin

²⁶⁵ Vendim i GJK nr.28/2008.

e një shpërblimi të drejtë, është një rast i bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme. Kjo do të thotë, se kjo padi ngrihet nga të gjithë subjektet/bashkëpronarët, të cilëve iu drejtohet akti. Megjithkëtë, edhe në rast se padia ngrihet nga njëri ose disa prej bashkëpronarëve, në kuptim të dispozitave të mësipërme të KPC, ajo ka efekt edhe për bashkëpronarët e tjerë, që nuk janë paraqitur në gjykatë, ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar...Në rastin në shqyrtim, [duke qenë se] nga dokumentet e dosjes gjyqësore rezulton se ... në momentin e shpronësimit prona ka qenë në bashkëpronësi të të gjithë bashkëpronarëve ... [Gjykata Kushtetuese] konkludon, se padia për kërkimin e shpërblimit të drejtë për shkak të shpronësimit për interes publik të truallit në bashkëpronësi, përbën një rast të bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme...Në këto kushte, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.129, datë 17.03.2004, ka prishur me të drejtë vendimin e gjykatës së faktit dhe ka kërkuar që edhe këta bashkëpronarë të jenë palë në këtë gjykim, duke respektuar kështu edhe të drejtën e aksesit në gjykatë të këtyre të fundit".²⁶⁶

Çështja e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës është parë edhe nga këndvështrimi i interpretimit të afateve ligjore siç duhet nga gjykatat e zakonshme. Kështu në një vendim të saj, GJK ka konsideruar si antikushtetues interpretimin e Kolegjit Civil të GJL, sipas të cilit kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi ishte paraqitur jashtë afatit një vjeçar të parashikuar nga ligji. Sipas saj, "...afati i kërkesës për rishikim të kërkuesit duhet të fillojë nga marrja formë të prerë e vendimit që përmban shkakun e rishikimit. Meqenëse vendimi që ka vërtetuar rrethanën e falsifikimit ka marrë formë të prerë me datë 14.11.2005 dhe kërkuesi e ka paraqitur kërkesën për rishikim pranë Gjykatës së Lartë me datë 21.11.2005, kërkesa duhet të konsiderohet se është paraqitur brenda afatit një vjeçar... Gjykata Kushtetuese konstaton se interpretimi jo i drejtë i dispozitave në fjalë ka lidhje të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe i ka mohuar kërkuesit të drejtën e aksesit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kërkuar të drejtën e pronësisë".²⁶⁷

²⁶⁶ Vendim i GJK nr.18/2009.

²⁶⁷ Vendime të GJK nr.20/2008; nr.17/2009.

Në kuadër të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, GJK ka vlerësuar edhe masat që ndërmerr shteti për të vjelur detyrimet (tatimore ose doganore) dhe mundësisë së individit për t'i kundërshtuar aktet e organeve tatimore e doganore në gjykatë. Marrjen e masave ligjore përkatëse nga ana e shtetit GJK e ka konsideruar jo vetëm të drejtë por edhe detyrim të tij për të rregulluar lirisht çështje të taksave dhe tatimeve, si një nga burimet kryesore të të ardhurave publike. Megjithatë ajo nuk e ka konsideruar këtë kompetencë si të pakufizuar. Çdo masë ligjvënëse duhet t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit duke iu referuar kështu nenit 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimet maksimale dhe të ligjshme që mund t'i bëhen të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë aspekt, GJK ka konstatuar se "... është detyrë e çdo gjyqtari që të vlerësojë nëse palëve në proces u garantohet një e drejtë efektive e aksesit në gjykatë dhe, nëse *prima facie* konstaton se një normë ligjore i kufizon në mënyrë të padrejtë njërës prej palëve mundësinë e aksesit në gjykatë, atëherë ai është i legjitimuar të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk mund të përmbushë detyrimin ligjor që buron jo vetëm nga Kushtetuta por edhe nga KEDNJ... Posaçërisht lidhur me vendimet administrative, GJEDNJ shprehet, se palët kontraktuese duhet të përcaktojnë procedura ligjore të qarta, në bazë të së cilave, vendimet administrative të mund të ankimohen para një gjykate të pavarur dhe të paanshme²⁶⁸ ...GJEDNJ shprehet se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë efektive dhe jo formale. GJEDNJ duke marrë në shqyrtim barrierat financiare për t'iu drejtuar gjykatës ... përcaktoi se këto barrierat duhet të analizohen rast pas rasti, në përputhje me mundësitë reale që ka paditësi dhe jo të merret në shqyrtim një mundësi abstrakte për të paguar nga ana e personit që kërkon të vërë në lëvizje gjykatën...Mekanizmi i përshkruar nga GJEDNJ është i njëjtë me atë të parashikuar nga neni 158/a i KPC, në bazë të së cilit gjyqtari ka mundësinë të përjashtojë nga parapagimi i taksës mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore palën ndërgjyqësore që është në pamundësi për të përballuar këtë barrë financiare që mbart pala që vë në lëvizje gjykatën.

²⁶⁸ Çështja *Albert dhe Le Compte k. Belgjikës*, 10 shkurt 1983, cituar në vendimin e GJK.

Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim ballafaqohen dy interesa të mbrojtura nga Kushtetuta, nga njëra anë, e drejta e shtetasve për të pasur një akses efektiv në një proces të drejtë para një gjyqtari të paanshëm dhe të pavarur, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, nga ana tjetër, interesi i shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet doganore, qoftë edhe duke kufizuar të drejtën e aksesit të individëve në gjykatë, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

Gjykata...vëren se nuk vihet në dyshim që grumbullimi efektiv i detyrimeve që shtetasit kanë kundrejt shtetit përbën një interes të ligjshëm publik, më se të mjaftueshëm për të justifikuar kufizime të të drejtave të shtetasve, por me kusht që ato të jenë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Një ndërhyrje shtetërore, e cila kufizon të drejta të ligjshme të shtetasve, mund të ndërmerret kur është e domosdoshme dhe nuk ekziston asnjë rrugë tjetër për të mundësuar arritjen e interesave publikë. Ndërhyrja që kufizon të drejtat e shtetasve, në asnjë rast, nuk mund të cenoje thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Gjykata ka argumentuar se duhet një analizë e kujdesshme nga ana e organit vendimmarrës (në rastin konkret, Kuvendit) në lidhje me mjetin e përdorur për të arritur qëllimin e ligjshëm. Para së gjithash, mjeti i përdorur duhet të jetë efikas, në mënyrë që të mos kemi një cenim a mohim të të drejtave të individëve pa u arritur realizimi i interesit publik, në funksion të së cilit është hartuar norma juridike. Mjeti duhet të jetë i tillë që të shmangë sa më shumë të jetë e mundur kufizimet e të drejtave të individëve në raport me rezultatet që kërkohen të arrihen. Ky konkretizim i parimit të proporcionalitetit detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e të drejtës së individëve.

Në vendimin nr.9, datë 02.04.2003, Gjykata Kushtetuese shprehet se dispozitat objekt kërkesë kushtëzojnë të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të vlerësimit tatimor, gjë që përbën kufizim të kësaj të drejte. Po në këtë vendim thuhet, se si çdo e drejtë subjektive, edhe e drejta e ankimit nuk e përjashton mundësinë që ligjvënësi të vendosë kufizime në ushtrimin e saj për të mbrojtur një interes publik

ose të drejtat e të tjerëve, por këto duhet të bëhen me kusht që të garantojnë zbatimin e urdhërimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, pra që kufizimi të bëhet me ligj, të bëhet në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, të mos cenoje thelbin e së drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

...Nisur nga sa më sipër Gjykata analizoi faktin nëse vjelja e detyrimeve tatimore mund të arrihej pa vendosur kufizime të aksesit të individëve për t'ju drejtuar gjykatës, të cilat mund të prekin thelbin e të drejtës. Duke qenë se nga ana e subjekteve të interesuara është pretenduar se masat e marra kanë për qëllim rritjen e efikasitetit lidhur me vjeljen e detyrimeve që individët kanë ndaj organeve shtetërore, Gjykata vëren se legjislacioni administrativ në fuqi u jep mundësinë organeve doganore të bëjnë të mundur vjeljen efektive të detyrimeve, pa kufizuar të drejtën e aksesit në gjykatë të shtetasve. Në nenin 130 të KPA thuhet se ekzekutimi i detyrimeve të parashikuara në aktin administrativ mund të bëhet forcërisht nga administrata, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar gjykatës, me kusht që ekzekutimi të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit...Ndërsa në nenin 138 të këtij Kodi parashikohet se ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ me përjashtim të rastit kur akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore... Në këto kushte Gjykata arrin në përfundimin se organet doganore i kanë të gjithë tagrat që të veprojnë me anë të ekzekutimit të detyruar kundrejt debitorëve të tyre, të cilët edhe nëse ankohen, nuk kanë të drejtë të përfitojnë pezullimin e ekzekutimit kundrejt pasurisë së tyre, si pasojë e ankimit administrativ ose gjyqësor. Pikërisht për këto arsye Gjykata, ashtu si dhe në rastin e gjobave tatimore, vlerëson se objektivi i ligjshëm shtetëror për të rritur efektivitetin e vjeljes së detyrimeve doganore mund të realizohet pa cenuar të drejtën e individëve për t'iu drejtuar gjykatës.

Të njëjtin mjet juridik, pra ekzekutimin forcërisht të vendimeve të autoriteteve doganore, pa pezulluar këtë ekzekutim në rastin e ankimit e gjejmë edhe në Rregulloren (EEC) No.2913/92 e cila krijonte Kodin Doganor Komunitar. Palët e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kanë pretenduar se neni 289/5 është i harmonizuar me Kodin Doganor Komunitar. Gjykata pasi

shqyrtoi dispozitat e këtij Kodi arriti në përfundimin se mbështetja në Kodin Doganor Komunitar për të justifikuar kufizimet e aksesit të shtetasve në gjykatë është fryt i një interpretimi të gabuar të Kodit Komunitar European. Në preambulën e Kodit Doganor Komunitar thuhet, se në mënyrë që të sigurohet një balancë ndërmjet nevojës së autoriteteve doganore, për të garantuar një aplikim korrekt të legjislacionit doganor në njërën anë dhe të drejtës së tregtarëve për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë në anën tjetër, autoriteteve të mësipërme duhet t'u garantohen inter alia fuqi të zgjeruara kontrolli dhe tregtarëve të mësipërm e drejta e ankimit...Këto dispozita duhen shqyrtuar në raport edhe me formulimin e nenit 232 të Kodit tonë Doganor, sipas të cilit kur shuma që përbën detyrimin nuk është paguar në afatin e caktuar, autoritetet doganore do të ndër marrin të gjitha hapat e mundshëm të lejuar nga legjislacioni në fuqi, përfshirë ekzekutimin e detyrueshëm, për të siguruar përmbushjen e detyrimit. Qëllimi i këtyre dispozitave është që t'u japin mundësinë autoriteteve doganore që të bëjnë sa më efikase vendimet e tyre dhe mënyra më e mirë për të bërë këtë të fundit është ekzekutimi me forcë i sendeve në posedim të kreditorit. Me fjalë të tjera, autoritetet doganore nuk pengohen të sekuestrojnë mallrat e debitorit të gjendura në posedimin e tyre edhe pse debitori mund të ketë paraqitur një ankim administrativ pranë autoriteteve doganore, ose pranë autoritetit gjyqësor.

Për sa sipër Gjykata vlerëson se kushti i vendosur në nenin 289, pika 5 të Kodit Doganor për pagimin e gjobës për të pasur akses në gjykatë përbën një kufizim jo proporcional dhe për pasojë një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42, pasi kufizimet e parashikuara nuk janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës".²⁶⁹

²⁶⁹ Vendimi nr.18/2010. Edhe ky vendim është marrë me inicativën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në rrugën e kontrollit incidental. Vlen të theksohet se GJK, megjithëse nuk ka detyrim t'i referohet akteve që nuk janë të detyrueshme për të, siç është rasti i Kodit Doganor të BE-së, e ka bërë një gjë të tillë me qëllim referimin tek praktika më e mirë europiane, si standart të cilin legjislacioni ynë duhet ta arrijë. Shih edhe mendimin e pakicës për këtë çështje, sipas të cilit kufizimi i bërë nga ligjvënësi në këtë rast nuk është joproporcional.

E drejta e aksesit në gjykatë kohët e fundit është shfaqur para GJK edhe në një aspekt tjetër: konkretisht në mospranimin e rekursit nga GJL për shkak të mosfirmosjes nga mbrojtësi i të pandehurit, të cilën GJK e ka lidhur direkt edhe me një të drejta të tjera të rëndësishme si e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata dhe në disa raste edhe të drejtën e mbrojtjes. Numri i këtyre çështjeve ka ardhur duke u shtuar para GJK, pasi GJL bën një interpretim të ngushtë të nenit 435/2 të KPP, i cili parashikon mospranimin e rekursit kur nuk është e firmosur nga mbrojtësi. GJK ka bërë një interpretim të zgjeruar të kësaj dispozite duke gjykuar se "...procesi i rregullt ligjor ka si element përbërës, midis të tjerash, edhe të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së...

E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet. Gjykata është shprehur gjithashtu se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në KPP-në, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, zbatimi i gabuar i normave të KPP-së, që ka sjellë mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të kërkuesit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i ka mohuar atij të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, si element thelbësor i të drejtës për proces të rregullt ligjor. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë

dhe të përqendrimit (kompetencës) të saj në probleme të ligjit, pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuojë në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjeve. Për më tepër, përfaqësimi me avokat në seancat dëgjimore në Gjykatën e Lartë bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale.

...Gjykata konstaton se në rastin konkret, kërkuesi ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs, të nënshkruar prej tij, i cili në pjesën hyrëse përmban ndër të tjera se është akt i Kolegjit të Avokatëve Durrës, por nuk rezulton i nënshkruar nga mbrojtësi që e ka redaktuar atë. Kolegji Penal, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.518, datë 16.10.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke u bazuar në mosplotësimin e kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së, i cili parashikon: "Akti i rekursit dhe memoriet duhen të nënshkruhen, me pasojë mospranimin, nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit."

Nga rrethanat e parashtruara më sipër dhe në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Gjykata vlerëson se neni 435/2 i KPP-së, nuk mund të interpretohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë (kuptim i ngushtë), që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Mbrojtja me avokat e të pandehurit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenin 437, pikat 3 dhe 5 të KPP-së, është vlerësuar nga Gjykata si kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se edhe neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhen të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të

filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale. Qëllimin e ligjvënësit, për të garantuar mbrojtës në këtë proces, e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur.

Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijlojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 e KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 e KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formalë që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Një interpretim i ndryshëm që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 KPP-së nuk i shërben rritjes së standardit në favor të garancive për të mos humbur të drejtën e gjykimin, përkundrazi, sjell si pasojë cenimin e të drejtës së të pandehurit për akses në Gjykatën e Lartë...Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson, se Gjykata e Lartë para se të vendosë mospranimin e rekursit, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor lidhur me vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.09.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se: "Sekretaritë e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i pa nënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij". Gjithashtu, në rastin kur i pandehuri nuk ka

mbrojtës të tij, Gjykata e Lartë duhet të verifikojë nëse kryetari i kolegjit e ka përmbushur detyrimin e tij për të caktuar avokat kryesisht. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë ... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të panënshkruar nga mbrojtësi, nuk ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ".²⁷⁰

Ky qëndrim i GJK ka qenë në përputhje të plotë edhe me praktikën e GJEDNJ, e cila lidhur specifikisht me karakterin e gjykimit në gjykatat më të larta të një vendi ka konstatuar se vendimet gjyqësore gjithmonë ndikojnë mbi personat. Megjithëse vendimi i Gjykatës së Kasacionit (ose asaj të Lartë) thjesht konfirmon ose anulon një vendim, ai vendim mund të ketë efekte të ndryshme në pozicionin e personit të interesuar. Madje, nganjëherë, gjykimi i Kasacionit ka pasoja shumë më të mëdha mbi fatin e një personi se vendimet e gjykatës së faktit dhe të apelit. Është e vërtetë që neni 6/1 i KEDNJ nuk kërkon nga shtetet themelimin e gjykatës së apelit ose të Kasacionit. Megjithatë, një shtet i cili i ka këto gjykata, është i detyruar të sigurojë se personat që i drejtohen ligjit do të gëzojnë përpara këtyre gjykatave garancitë themelore të parashtruara në nenin 6 të KEDNJ. Në një shoqëri demokratike në kuptimin e Konventës, e drejta për një administrim të mirë të drejtësisë zë një vend kaq të dallueshëm, sa që asnjë interpretim i ngushtë i nenit 6/1 nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e kësaj dispozite.²⁷¹

Vendimi i mësipërm i GJK është ndjekur nga disa të tilla të ngjashme, për shkak të interpretimit të gabuar dhe *stricto sensu* të dispozitës së KPP nga GJL. GJK ka vazhduar në mënyrë të përsëritur të orientojë GJL të mos bëjë interpretim të ngushtë të dispozitave të KPP, pasi kjo sjell cenimin e të drejtave themelore të individit. GJK ka theksuar në mënyrë të përsëritur se "... neni 435/2 i KPP, i cili parashikon

²⁷⁰ Vendimi i GJK nr.38/2010.

²⁷¹ Çështjet *Delcourt k. Belgjikës*, 17 janar 1970; *Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee k. Greqisë*, 16 nëntor 2001; *Brualla Gómez de la Torre k. Spanjës*, 19 dhjetor 1997, *Saez Maeso k. Spanjës*, 9 nëntor 2004.

se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikojnë rregullat procedurale penale. Qëllimin e ligjvënësit për të garantuar mbrojtës në këtë proces e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur.

Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë zbatimi i nenit 435/2 të KPP duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijlojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 e KPP, si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP. Një interpretim i ndryshëm që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 nuk i shërben rritjes së standardit në favor të garancive për të mos humbur të drejtën e gjykimit, përkundrazi, sjell si pasojë cenimin e të drejtës së të pandehurit për akses në Gjykatën e Lartë.

Në rastin në shqyrtim, nga analiza e materialeve shkresore që gjenden në dosjen gjyqësore në emër të kërkuesit, rezulton që kopje të rekursit, të depozituara pranë gjykatës janë të nënshkruara dhe vulosura nga mbrojtësi i kërkuesit, avokat S.V. Ky element

procedural është vërtetuar nga shkresa nr 24/6 prot., datë 24.06.2010, që Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i ka dërguar Gjykatës. Pra, rekursi i dorëzuar prej kërkuesit (së paku një kopje e tij), ka qenë konform rregullimit të parashikuar nga neni 435 i Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, po në dosje, figuron edhe një tjetër kopje e rekursit, pikërisht ajo që është dërguar nga sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për në Gjykatën e Lartë, e cila nuk mbart mbi vete as vulën dhe as nënshkrimin e mbrojtësit. Në vijim, mungesa e nënshkrimit renditet edhe si shkak i parë i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë”.²⁷²

GJK, në një çështje pothuajse të ngjashme me këtë në shqyrtim, ka arritur në përfundimin se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Ajo ka vlerësuar se "...Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përpara se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.09.2009, kur shprehen: "Sekretaritë e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të Kodit të Procedurës Penale, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij". Gjithashtu, në rastin kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të tij, duhet verifikuar nëse kryetari i kolegjit e ka përmbushur detyrimin e tij për të caktuar avokat kryesisht. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë...Gjykata Kushtetuese, në frymën edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, tërheq vëmendjen se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave

²⁷² Vendime të GJK nr.5/2011; nr.9/2011; nr.10/2011.

*materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive”.*²⁷³

4.4 E drejta për t’u dëgjuar publikisht nga një gjykatë

E drejta për t’u dëgjuar nga gjykata është një element tjetër i procesit të rregullt ligjor. Ajo lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime/parashtrime dhe për të marrë përgjigje për to. Kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, të marra në tërësi, kanë për qëllim që t’i garantojnë kujtdo që pretendon se i janë shkelur të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj, në radhë të parë ndjekjen e çështjes në gjykatë. Në këtë kuptim, pjesëmarrja në gjykim është një e drejtë e pamohueshme për faktin, se kjo pjesëmarrje, shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur. Sipas një vendimi të hershëm të GJEDNJ, do të ishte e pakuptimtë që neni 6/1 i Konventës të përshkruante me detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve në proces dhe të mos mbronte në radhë të parë atë që bën në të vërtetë të mundur që të përfitohet nga këto garanci: pra, pjesëmarrjen në gjyq dhe dëgjimin nga gjykata.²⁷⁴ Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore, sipas nenit 6/1 të Konventës, mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të

²⁷³ Vendim i GJK nr.26/2011. Në këtë vendim, kërkuesi kërkoi edhe shpalljen antikushtetuese të dispozitës së KPP që parashikonte detyrimin e firmosjes së rekursit nga mbrojtësi. GJK në këtë rast argumentoi se ajo ka bërë një interpretim pajtues të dispozitës përkatëse dhe kjo bën që GJL duke iu referuar këtij interpretimi të mos cenojë standartet e gjykimit të rregullt duke mospranuar rekursin e pafirmosur nga mbrojtësi. Prandaj, nuk është e nevojshme të shfuqizohet dispozita, pasi efekti antikushtetues nuk rrjedh nga përmbajtja e saj por nga mënyra e interpretimit të GJL. Përveç kësaj, GJK nuk e legjitimoi kërkuesin për shkak të mungesës së interesit në çështje. Vlen të përmendet se pakica në këtë vendim e ka konsideruar mospranimin e rekursit të pafirmosur si cenim të së drejtës së ankimit dhe jo të aksesit në gjykatë.

²⁷⁴ Çështja *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975.

drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike.²⁷⁵

Kushtetuta dhe Konventa kanë përcaktuar standarte të qarta për pjesëmarrjen në gjykim dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor në mënyrë të atillë që t'u garantohet të gjitha palëve mbrojtje efektive në të gjitha shkallët e gjykimit, prandaj prekje e tyre, përbën shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të standarteve të vendosura nga Kushtetuta dhe KEDNJ, GJK ka vlerësuar se *"në shqyrtimin e çështjeve nga gjykatat e sistemit gjyqësor duhet të mos preken kriteret e procesit të rregullt, duke dalluar qëllimin dhe kompetencat e dhomës së këshillimit nga njëra anë dhe të seancës gjyqësore nga ana tjetër. Nga referimi në dispozitat e KPC që parashikojnë shqyrtimin e rekursit dhe rishikimin e vendimeve del qartë se dhoma e këshillimit është një strukturë që shërben për shqyrtimin paraprak e seleksionimin e çështjeve, por jo për zgjidhjen e tyre në themel. Dhoma e këshillimit vendos për mospranimin e rekursit ose të kërkesës për rishikim, por nuk mund të vendosë për prishjen e vendimeve aq më tepër pa njoftuar palën që ka fituar gjyqin...Nga përmbajtja e dispozitave të KPC, që kanë të bëjnë me rekursin dhe rishikimin, del se shqyrtimi në dhomën e këshillimit lidhet me mospranimin e tyre për t'u shqyrtuar nga gjykata sepse nuk përmbushin kriteret ligjore. Në të kundërtën, kur këto kritere plotësohen, nuk mund të vendoset pranimi i kërkesës për rishikim dhe rekursit jashtë seancës gjyqësore dhe pa praninë e palëve. Aq më tepër pranimi i rishikimit pa kaluar çështjen në seancë për shkak të efekteve të mëdha që sjell si mjet i jashtëzakonshëm në ndryshim nga rekursi që është formë e zakonshme ankimi, e bën edhe më të qartë prekjen e standarteve dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Rifillimi i procesit gjyqësor nga e para, pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë e prerë e vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për të shprehur e mbrojtur pretendimet e tyre, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt në kuptim të Kushtetutës dhe KEDNJ. Çdo provë e paraqitur nga pala që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi*

²⁷⁵ Çështja Axen k. Republikës Federale të Gjermanisë, 8 dhjetor 1983.

palës tjetër për të shprehur pretendimet e saj, sepse ajo nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta që i është njohur me vendim të formës së prerë të gjykatave. Në raste të tilla, standarti minimal që duhet t'i garantohet palës respektive, është shansi i barabartë për të qenë e pranishme në një proces ku do të shqyrtohet pozita e saj juridike...Bazuar në këto argumente, kërkesa për rishikim është një mjet ankimi dhe duhet t'i njoftohet palës tjetër sipas rregullave të përgjithshme aq më tepër që ky mjet përbën në vetvete një kërkesë të re për të cilën, pala e interesuar, jo vetëm që nuk ka dijeni, por është akoma nën përfytyrimin e realizimit konkret të së drejtës së fituar".²⁷⁶

Jurisprudenca e GJK e ka pranuar të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar si elementë të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor duke i trajtuar këto të drejta të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. "Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që para marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht mbi thelbin e çështjes. Në këtë mënyrë garantohet edhe zbatimi i një parimi thelbësor në procesin gjyqësor, ai i kontradiktoritetit. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. Kushdo, qoftë në procesin penal, qoftë në procesin civil, duhet të ketë mundësinë t'i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtarë".²⁷⁷

Megjithatë GJK nuk e ka konsideruar si absolute të drejtën për t'u dëgjuar publikisht në të gjitha instancat dhe mjetet e përdorura. Ajo ka mbajtur qëndrimin se edhe në rastet kur nuk zhvillohet seanca publike por gjykohet mbi bazën e dokumentave, e drejta për t'u dëgjuar nuk cenohet. Sipas saj, "...mënyra e shqyrtimit të çështjes (në dhomë këshillimi-shën.imi) dhe moskalimi i saj në seancë me anë të vendimit të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën

²⁷⁶ Vendim i GJK nr.17/2005.

²⁷⁷ Vendim i GJK nr.12/2005.

*e këshillimit, nuk përbën shkelje të së drejtës kushtetuese të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor. Kjo e drejtë, praktikisht, i është kufizuar në mënyrë të arsyeshme kërkuarit, por pa u prekur në thelbin e saj. Në këndvështrimin formalo-juridik, kërkuari e ka ushtruar atë në një masë të caktuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ai i ka paraqitur pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Këto pretendime janë shqyrtuar nga kolegji civil i kësaj gjykate, në dhomën e këshillimit, dhe mbi këtë bazë, është vendosur moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Një qëndrim i tillë është në përputhje të plotë edhe me KEDNJ dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Kjo jo vetëm në këndvështrim të hapësirës së gjerë të vlerësimit që u lihet shteteve për të kufizuar të drejtën e ankimit, por edhe të mundësisë së mosshqyrtimit të këtij ankimi në seancë publike. GJEDNJ në një sërë rastesh ka theksuar ndër të tjera se moszhvillimi i një procesi publik në shkallët më të larta të gjykimit mund të përlligjet nga veçantia e procedurave të veçanta të çështjes, por me kusht që procesi i zhvilluar në shkallën e parë të ketë qenë publik. Për këtë arsye, edhe procesi që mund të zhvillohet në këto gjykata pa praninë e palëve dhe në bazë të një ankimi vetëm për çështje të zbatimit të ligjit, konsiderohet si në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 6 të Konventës”.*²⁷⁸

Le të shohim më poshtë praktikën e GJK lidhur me elementët e veçantë të gjykatës së ligjshme para së cilës duhet garantuar e drejta për t’u dëgjuar e individit.

4.4.1 e pavarur dhe e paanshme

Sa i takon elementëve të veçantë që duhet të plotësojë një gjykatë për t’u konsideruar se realizon një proces të rregullt, GJK është ndalur tek to, kryesisht vitet e fundit të praktikës së saj. Kështu lidhur me elementin e pavarësisë që duhet të reflektojë gjykata, ajo ka theksuar se “...parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku krijojnë kushtet e nevojshme

²⁷⁸ Vendim i GJK nr.14/2005. Shih *Monnell dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987; *Sutter k. Zvicrës*, 22 shkurt 1984, cituar në vendimin e GJK.

*që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur... Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare”.*²⁷⁹

Gjithashtu, lidhur me pavarësinë e gjykatave, GJK ka nënvizuar se "...sistemi i qeverisjes [në Shqipëri] bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve. Ky parim do të thotë që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe duhet të ketë një balancë midis tyre. Çdo institucion i një pushteti gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, nga raportet e fuqive të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese ...Pushteti gjyqësor, sipas nenit 135 të Kushtetutës, ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e rrethit. Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve.

...Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është, që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata

²⁷⁹ Vendim i GJK nr.26/2009.

duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet se: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të patur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve.

...Kushtetuta e ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe gjyqtarëve. Në paragrafin e tretë të nenit 145 të saj parashikohet: "Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit". Pavarësia procedurale e gjyqtarit është një kusht i nevojshëm për një shqyrtim të pavarur dhe të paanshëm të çështjes. Kjo normë e Kushtetutës ngarkon institucionet dhe pushtetet e tjera me detyrën kushtetuese që të respektojnë pavarësinë e gjykatave.

Është për t'u theksuar, se pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave në dhënien e drejtësisë, e garantuar nga Kushtetuta, duhet të mbrohet dhe të mos cenohet nga ligjet dhe aktet e tjera ligjore...Pavarësia nuk është qëllim në vetvete ose një mënyrë për të siguruar pozicionin profesional të gjyqtarëve për të mirën e tyre, por është një mjet për të arritur qëllimet e një shoqërie të drejtë dhe të përparuar. Për këtë arsye, pavarësia shoqërohet me mjete për të siguruar, që gjyqtarët

dhe gjyqësori në tërësi, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike.

...Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep gjyqtarëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim. Për shkelje të funksioneve të tyre gjyqtarët mund të mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe penale. Bazuar në nenin 147 të Kushtetutës, gjyqtarët shkarkohen nga detyra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Sjellja e një gjyqtari lidhur me veprimtarinë e tij, për detyrat e tij funksionale, si dhe për veprimtarinë e tij jashtë detyrës, nuk duhet të krijojë dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

...Gjykata çmon se në vendimmarrje gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa ndikim të papërshtatshëm, presione, kërcënime ose ndërhyrje, të drejtpërdrejta ose jo, nga kushdo dhe për çfarëdo arsye. Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës".²⁸⁰

Duke mbajtur parasysh sa më sipër lidhur me pavarësinë e gjykatës, e cila më së shumti është trajtuar në rrugën e kontrollit abstrakt, GJK në shqyrtimin e kërkesave individuale për një proces të rregullt ligjor, është ndalur më gjatë në elementët përbërës të paanshmërisë së gjykatës/gjyqtarëve gjatë vendimmarrjes konkrete të tyre. Në këtë drejtim, ajo ka mbajtur qëndrim konstant lidhur me elementët konkret të vlerësimit me objektivitet të testit të paanshmërisë së gjyqtarit. Kështu p.sh GJK ka theksuar se jo gjithmonë pjesëmarrja e gjyqtarëve të njëjtë në shkallë të ndryshme gjykimi përbën cenim të

²⁸⁰ Vendim i GJK nr.11/2008.

paanshmërisë së gjyqtarit. Sipas saj, "gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si në rastin e vleftësimit të masës së arrestit dhe në dhënien e vendimit përfundimtar, ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta, të cilat janë marrë duke analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e çështjes. Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen për të kontrolluar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara. Në këtë kuptim, gjykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm për faktin se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vleftësimin e masës së arrestit për të njëjtën çështje. Nga kjo analizë arrihet në përfundimin se pjesëmarrja e disa anëtarëve të Gjykatës së Lartë në vleftësimin e masës së arrestit për kërkuesin nuk e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues".²⁸¹

Në një tjetër vendim të saj ajo ka mbajtur qëndrimin se për sa i përket paanshmërisë, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, "ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari, konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në fjalë në një çështje të dhënë; i dyti, në vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor.

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka parashtruar si rrethanë për njëanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pretendimin, se vendimi i dhënë nga kolegjet e bashkuara vjen në kundërshtim me një vendim të mëparshëm unifikues të këtyre kolegjeve. Nisur nga konsideratat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese konkludon se ky pretendim nuk ka të bëjë me njëanshmërinë e gjykatës. Zbatimi i ligjit dhe unifikimi i praktikës gjyqësore është në diskrecionin e Gjykatës së Lartë. Koherenca e vendimeve të kësaj Gjykate është një aspekt i besueshmërisë në këto vendime, por shmangia e kësaj Gjykate, në ndonjë rast, nga praktika e saj e unifikuar, nuk mund të interpretohet si shkelje e standardit të

²⁸¹ Vendim i GJK nr.9/2006.

paanshmërisë së gjykatës. Përveç kësaj, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë tjetër, që vë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në aspektin objektiv dhe subjektiv, rrethana, që në vija të përgjithshme, përshkruhen në nenin 72 të KPC.

*...Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkuesi nuk ka asnjë bazë të ligjshme për të vënë në dyshim paanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes së tij”.*²⁸²

Megjithatë lidhur me përbërjen e trupit gjykues në instancat më të larta jo me gjyqtarë të njëjtë si në instancat e ulta, GJK ka konsideruar se *"parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përlligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë.*²⁸³

Për këtë qëllim dhe në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues deklarohen edhe dispozita të veçanta ligjore. Kështu, në nenin 15 të KPP theksohet shprehimisht se "Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit". Nga sa më sipër, është më se e qartë që parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në

²⁸² Vendim i GJK nr.18/2007.

²⁸³ Vendim i GJK nr.16/2003.

Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë, që gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë anëtar i një kolegji, nëse për të njëjtën çështje, ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të procedimit.

Në fakt, shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk i ka të gjitha karakteristikat e një gjykimi në kuptim të nenit 15 të KPP... Në dhomën e këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur kundër një vendimi të formës së prerë. Nëse ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP vendoset kalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Në të kundërt vendoset mospranimi i rekursit. Ky vlerësim bëhet gjithnjë në funksion të kompetencës që ka Gjykata e Lartë për të kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta, pra nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe gjykata e apelit....Por, një vlerësim i tillë mjaft i rëndësishëm për fatin e çështjes duhet bërë nga një gjykatë e paanshme. Është e papranueshme, që një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjyqimit (në rastin konkret në gjykatën e apelit), të jetë sërish në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë pikërisht edhe kundër këtij vendimi.

Në rastin konkret, dyshimi i kërkuesve për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i drejtë.²⁸⁴ Një nga gjyqtarët në përbërje të këtij kolegji ka marrë pjesë më parë në trupin gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka gjetur fajtorë dhe dënuar kërkuesit respektivisht me 8 vjet dhe 10 vjet burgim. Madje, në këtë rast, ky gjyqtar kishte qenë edhe relator i çështjes. Mbi këtë bazë duhej të ishte mënjanuar pjesëmarrja e këtij gjyqtari në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuesve. Vetë të gjykuarit apo mbrojtësit e tyre nuk e kanë pasur dhe as nuk mund ta kenë mundësinë ta kërkojnë këtë në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ata nuk janë të

²⁸⁴ Shih çështjen *Oberschlick* k. *Austrisë*, 23 maj 1991, cituar në vendimin e GJK.

pranishëm...Gjykata Kushtetuese rithekson se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është pjesë e rëndësishme e procesit gjyqësor në tërësi dhe si i tillë, në përputhje me natyrën e këtij shqyrtimi në dhomën e këshillimit, duhet të respektojë parimet themelore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këtu, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet veçanërisht problemeve që kanë të bëjnë me përbërjen e kolegjit, pasi siç u theksua, kjo lidhet ngushtë me çështjen e paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjes".²⁸⁵

Në vazhdim të çështjes lidhur me përbërjen e trupit gjykues në GJL, GJK ka ritheksuar edhe së fundmi se pjesëmarrja e tre gjyqtarëve në Kolegjin Civil në dy gjykime me palë të njëjta (një herë në dhomë këshillimi dhe dy herë në Kolegji) përbën arsye të mjaftueshme për të dyshuar në paanshmërinë e tyre.²⁸⁶ Në fakt, çështja e përbërjes së trupit gjykues me të njëjtët gjyqtarë në dy instanca gjykimi, ka preokupuar shpesh GJK. Kështu që asaj i është dashur të analizojë edhe rrethanat kur një gjyqtar që ka gjykuar në apel ka marrë pjesë në dhomë këshillimi ose në kolegjin civil/penal të GJL. Sipas rrethanave dhe provave ajo ka shqyrtuar vazhdimisht rolin e gjyqtarit në secilën prej trupave vendimmarrëse dhe efektin e tyre tek vendimmarrja konkrete. Kështu, GJK ka konsideruar si cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës kur i njëjti gjyqtar ka qenë relator dy herë në gjykimin në Kolegjin Civil të GJL. Sipas saj "...në çështjen objekt shqyrtimi, nuk i janë dhënë kërkuessit garancitë e nevojshme objektive për të krijuar besim në paanshmërinë e gjykatës. Në rigjykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë si relator i njëjti gjyqtar që ka marrë pjesë si i tillë edhe në gjykimin e mëparshëm në atë kolegji. Në vendimin nr. 1055, datë 03.11.1999 të atij kolegji është vendosur prishja e vendimeve të gjykatës së rrethit e të apelit, me të cilët ishte pranuar padia e kërkuessit dhe është dërguar çështja për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar. Në këtë vendim është arsyetuar, ndërmmjet të tjerave, për problemet e themelit të çështjes që kishin të

²⁸⁵ Vendim i GJK nr.12/2007.

²⁸⁶ Vendime të GJK nr.1/2010; nr.21/2010.

bënin me zbatimin e ligjit të kohës së lindjes së marrëdhënies juridike apo të kohës së gjykimit të çështjes, me interpretimin e përmbajtjes së këtyre normave, me juridiksionin e gjykatës për shqyrtimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ të birësimit, etj. Këto probleme janë diskutuar përsëri në rigjykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi për respektimin e parimit të paanësisë bëhet, sipas rastit konkret, duke marrë në konsideratë elementët subjektivë dhe objektivë të gjykimit. Në rastin në shqyrtim, çështja jo vetëm është shqyrtuar në dy rastet në seancë gjyqësore, me të njëjtin relator, por janë trajtuar të njëjtat probleme të themelit të çështjes. Kjo krijoi shqetësimin e kërkuesit për mungesën e garancive të mjaftueshme për paanësinë e gjykatës, aq më tepër, që vendimi është marrë me shumicë të thjeshtë votash. Prandaj, heqja dorë e relatorit nga gjykimi ishte e domosdoshme si për interesin e drejtësisë, ashtu edhe të palëve në gjykim...".²⁸⁷

Gjykata nuk e ka konsideruar si cenim të paanshmërisë së gjykatës, kur gjykatat, duke u bazuar në dispozitat përkatëse procedurale, kanë arritur në një qëndrim të ndryshëm nga ai i gjykatave më të ulta ose të njëjta. Sipas saj, parimi i paanshmërisë cenohet kur gjyqtarët mbajnë qëndrime të ndryshme duke u pozicionuar në favor të njëjës ose tjetrës palë, duke shfaqur mendim jashtë veprimtarisë procedurale të çështjes ose kur kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit.²⁸⁸ GJK ka mbajtur qëndrim edhe në rastet kur nga kërkuesi është pretenduar anshmëria e gjykatës për shkak të njohjeve të njëjës nga palët me një ose disa gjyqtarë. Kështu ajo ka theksuar se "...në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike. Paanshmëria kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja

²⁸⁷ Vendime të GJK nr.17/2007; nr.38/2007.

²⁸⁸ Vendim i GJK nr.37/2007.

e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe super partes. Ekzistenca e paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar dy teste: testin objektiv, që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, dhe testin subjektiv, që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga pikëpamja e testit subjektiv, gjykimi konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën. Nga këndvështrimi i testit subjektiv, kërkuesit nuk kanë vënë në dyshim bindjen e brendshme të gjyqtarit përkatës për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Prandaj, mbetet të shqyrtohet pretendimi nga pikëpamja e testit objektiv. Në çështjen në gjykim, konstatohet se gjyqtari A.K., anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë, i ka drejtuar kryetarit të kësaj gjykate një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi. Ky i fundit, me vendimin datë 27.04.2005 ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se shkaqet e ngritura nga gjyqtari nuk janë të bazuara në nenin 72 të KPC dhe shprehet, se "është për t'u theksuar se paditësi ka njohje me të gjithë gjyqtarët e Apelit si dhe me personelin e administratës. Kjo lidhje ka të bëjë dhe me natyrën e paditësit, me rrethin e madh shoqëror që ka, si dhe me angazhimet dhe punët që kryen."

Në rrethanat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se Gjykata e Apelit Korçë, në përbërje të të cilës ka qenë edhe gjyqtari A.K., nuk i ka ofruar palës së paditur (kërkuesve) garancitë e nevojshme që do t'i largonte dyshimin për njëanshmërinë e gjykatës. Përkundrazi, megjithëse një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kryetari i gjykatës jo vetëm nuk e ka pranuar këtë kërkesë, por ka deklaruar në vendimin e tij edhe njohjet e palës paditëse me gjyqtarë të kësaj gjykate, veprim ky që vë seriozisht në dyshim paanësinë e kësaj gjykate. Justifikimi i rrëzimit të kësaj kërkesë me arsyetimin se shkaqet e ngritura nga gjyqtari nuk janë të bazuara në nenin 72 të KPC nuk harmonizohet me detyrimin që kanë gjykatat për respektimin e parimeve kushtetuese të procesit të rregullt e të paanësisë. ...Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se gjykata

*e apelit ka cenuar parimin e paanshmërisë si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor”.*²⁸⁹

Duke u ndalur specifikuat tek testi objektiv i paanshmërisë, GJK ka deklaruar se *“kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm”.*²⁹⁰ Në një rast tjetër, GJK nuk ka konstatuar cenim të paanshmërisë së gjyqtarit, kur kërkuesi ka vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit, duke pretenduar se ai ka lidhje me personin e dëmtuar nga vepra penale, pasi daja i gjyqtarit dhe personi i dëmtuar nga vepra penale kishin bashkëshortet motra (pra ishin baxhanakë), dhe për shkak të kësaj lidhjeje ky gjyqtar nuk duhet të merrte pjesë në trupin gjykues që ka gjykuar këtë çështje. GJK në këtë rast u tregua aktive për të vërtetuar me iniciativën e saj fakte që vërtetojnë një lidhje të tillë. Ajo kërkoi nga organet përkatëse të pushtetit vendor dokumente për të verifikuar këtë pretendim, por përsëri nuk u saktësua plotësisht lidhja e pretenduar. Megjithatë, GJK në këtë rast vlerësoi se lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk ishte e tillë sa të përbënte shkak për një dyshim të ligjshëm lidhur me paanshmërinë e gjyqtarit.²⁹¹ Si konkluzion, GJK ritheksoi parimin se respektimi i paanshmërisë në gjykim duhet të ekzaminohet vetëm nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim se ky gjyqtar nuk ka qenë i paanshëm gjatë gjykimit.²⁹²

²⁸⁹ Vendim i GJK nr.23/2008. Vlen të theksohet se mendimi i pakicës në këtë vendim i referohet faktit të mosprovimit të elementit subjektiv të paanshmërisë së gjyqtarit. Sipas pakicës, thjesht njohjet e gjyqtarit nuk mund të prezumojnë anshmërinë e tij në proces.

²⁹⁰ Po aty.

²⁹¹ GJK iu referua nenit 16 të KPP, i cili përjashton të marrin pjesë si gjyqtarë në të njëjtin procedim, vetëm personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, *bashkëshortë, gjini e afërt...ose krushqi e afërt*. Nga kategoria e personave *krushqi e afërt*, kjo dispozitë përjashton ata gjyqtarë që janë midis tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim vjehërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër, thjeshtërë, njerë, njerë. Në kuptim të kësaj dispozite procedurale, GJK konstatoi se lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk përfshihet në rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit, parashikuar nga neni 16 i KPP.

²⁹² Vendim i GJK nr.10/2009.

GJK, për të arritur në përfundimin se gjyqtari ka qenë apo jo i anshëm gjatë procesit, i është dashur të bëjë dallimin midis roleve që ka patur një gjyqtar si pjesë e trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes. Kështu, ajo nuk e ka konsideruar si cenim të paanësisë faktin se një gjyqtar ka marrë pjesë në seancën për vërtetimin e faktit (të pronësisë) dhe më pas ka qenë anëtar i trupit gjykues në gjykimin e një çështje në GJL lidhur me këtë pronë. GJK ka theksuar se gjykimi, mbi bazë të së cilit është dhënë ai vendim, ka qenë një gjykim pa palë kundërshtare, pra një gjykim jokontencioz. Për pasojë, vendimi gjyqësor që është dhënë në përfundim të këtij gjykimi është thjesht deklarativ, i cili, në bazë të nenit 391 të KPC, ka fuqi provuese vetëm për kërkuesin dhe jo për personat e tjerë që nuk janë thirrur në këtë gjykim. Nisur nga natyra e këtij gjykimi, si një gjykim jokontencioz, rezulton se ky gjykim ka prodhuar një vendim thjesht deklarativ.²⁹³

Vlen të përmendet se GJK në një rast më të fundit ka vendosur ndryshe nga praktika e mëparshme e saj sa i takon cenimit të paanshmërisë kur gjyqtarë të GJL kanë marrë pjesë edhe në shqyrtimin e rekursit edhe të kërkesës për rishikim. Ajo, në një nga vendimet e fundit të saj, ka theksuar se *"gjyqtari, që shqyrton kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, nuk kryen vlerësime të reja në themel të të njëjtave fakte të vlerësuara nga gjykata në gjykimin e themelit, por ai kryen një vlerësim për herë të parë të fakteve dhe provave të reja, të cilat nuk kanë qenë më parë objekt gjykimi, diskutimi dhe vlerësimi nga gjykatat që kanë dhënë vendimin për të cilin bëhet rishikimi. Rishikimi i vendimit si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj, që në asnjë mënyrë nuk përfshijnë veprimtarinë vlerësuese të gjyqtarit në gjykimin që kërkohet/pranohet të rishikohet...Duke analizuar rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Penal ka refuzuar kërkesën për rishikim me arsyetimin se deklaratat e tre shtetasve, sipas të cilëve kërkuesi nuk është autor i vrasjes, dhe akti ekspertimit mjeko-ligjor... nuk përbën provë të re në kuptim të nenit 450, shkronja "c" të KPP.*

²⁹³ Vendim i GJK nr.22/2011.

...Gjyqtarët në procesin e dytë, në Dhomë Këshillimi kanë vlerësuar ekzistencën e shkaqeve për të rishikuar vendimin gjyqësor penal të formës së prerë, ndërsa në procesin parë, në seancë gjyqësore kanë vlerësuar respektimin ose zbatimin e drejtë të ligjit procedural dhe material. Gjyqtarët e pranishëm në Kolegjin Penal, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk kanë gjykuar drejtësinë e një vendimi të mëparshëm të dhënë prej tyre, por kanë vlerësuar ekzistencën e një prove të pretenduar si të re nga kërkuesi, e cila nuk dihej në kohën e gjykimit. Gjykata vlerëson se në këtë proces dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, kanë vlerësuar ekzistencën e një prej rasteve të parashikuara nga neni 450 i KPP. Duke qenë kështu, Gjykata konkludon se pretendimi për anësinë e gjyqtarëve është i pabazuar, sepse nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i justifikueshëm mbi anësinë e tyre. Si përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuetit në lidhje me pretendimet e tij, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ”.²⁹⁴

Ndërsa me vendimin nr.7/2011, GJK është shprehur se “... gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt”.²⁹⁵

Gjithashtu GJK nuk e ka konsideruar si cenim të parimit të paanshmërisë faktin që gjyqtarë që kanë gjykuar në Kolegjin (penal) kanë marrë pjesë në vlerësimin e masës së arrestit ndaj kërkuetit. Gjykata ka theksuar se gjykimi i çështjes në GJK si në vlerësimin e masës së arrestit ashtu edhe në rekursin mbi vendimin përfundimtar ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave

²⁹⁴ Vendim i GJK nr.25/2011.

²⁹⁵ Shih për më tepër mendimin e pakicës së vendimit nr.25/2011, i cili thekson ndryshimin e praktikës së GJK lidhur me paanshmërinë në gjykim në Gjykatën e Lartë.

më të ulta. GJL nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen për të kontrolluar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara. Për këtë arsye, sipas saj, nuk konsiderohet i cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës.²⁹⁶

4.4.2 e caktuar me ligj

Që një gjykatë të shqyrtojë konflikte midis palëve (pavarësisht natyrës së tyre) dhe të japë vendime të ekzekutueshme dhe me pasoja për to, duhet që jo vetëm të krijohet me ligj por ligji duhet të parashikojë hollësisht fushën e kompetencave tokësore dhe lëndore të saj. Shqyrtimi i një konflikti midis palëve nga një gjykatë e caktuar me ligj është element i procesit të rregullt ligjor. Termi "gjykatë" karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit.²⁹⁷

Qendrimi i GJK lidhur me përkufizimin e termit "gjykatë e caktuar me ligj" ka qenë konstant që në rastet e para ku ajo është përballur me të. Sipas saj, "*objekti i termit "gjykatë e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës, është të sigurojë që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet në diskrecionin e ekzekutivit, por të rregullohet me ligj të parlamentit. Gjykata shton se shprehja "gjykatë e caktuar me ligj" mbulon jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e vetë "gjykatës", por edhe përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e çdo çështje konkrete...Sipas nenit 481 të KPC, "Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të vendosë që gjykata të shprehet në kolegje të bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme në kolegjet e thjeshta". Ndërsa sipas nenit 485 të këtij Kodi, në përfundim të*

²⁹⁶ Vendim i GJK nr.9/2006.

²⁹⁷ Shih vendimet e GJK nr.7/2009 dhe nr.31/2005.

shqyrtimit të çështjes, si kolegji civil ashtu dhe kolegjet e bashkuara, kanë të njëjtat mundësi procedurale për të vendosur. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se shqyrtimi i çështjes në këto kolegje nuk e keqëson mundësinë procedurale të kërkuarit. Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se në rastin në shqyrtim, ka një bazë të vlefshme juridike që çështja e kërkuarit të shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si "gjykatë e caktuar me ligj".²⁹⁸

Parimi i gjykatës së caktuar me ligj është parë nga GJK edhe nga këndvështrimi i përbërjes së rregullt të trupit gjykues, pra nëse është formuar siç duhet trupi gjykues. Sipas GJK, fjala "ligj" përfshin edhe legjisllacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjisllacionit përkatës, ajo nuk është e krijuar me ligj sipas nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ.²⁹⁹

GJK në një rast, kur kërkuari është gjykuar nga gjykata e krimeve të rënda, megjithëse ligji i ri që kishte hyrë në fuqi parashikonte gjykimin nga gjykata e zakonshme penale, ka mbajtur qëndrimin se "...ndryshe nga e drejta penale materiale, ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, në të drejtën procedurale penale vepron parimi sipas të cilit, ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji ka vendosur shprehimisht. Bazuar në këtë standard kushtetues si dhe në faktin se në ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, që ndryshoi kompetencën lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, nuk parashikoheshin dispozita transitorë për çështjet që ishin regjistruar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda apo ishin duke u gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda përpara këtij ligji, arrihet në përfundimin, se këto të fundit nuk

²⁹⁸ Vendim i GJK nr.18/2007.

²⁹⁹ Vendim i GJK nr.11/2009.

kanë qenë kompetente për të shqyrtuar akuzat e ngritura ndaj tij... Problemet e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitat për kompetencën, u takojnë në parim gjykatave të pushtetit gjyqësor. Megjithatë, duke u nisur edhe nga jurisprudenca kushtetuese, tejkalimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej kësaj Gjykate kur ka patur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (ne bis in idem), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar.

...Në kundërshtim me pretendimin e subjektit të interesuar, shqyrtimi i një çështje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykatë tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton... Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit. Në ndryshim nga kompetenca lëndore, akti i dhënë në mungesë të kompetencës tokësore është një akt relativisht i pavlefshëm dhe deklarohet si i tillë nga gjykata mbi kërkesën e palëve, bërë para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor...Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, duke gjykuar vetë çështjen për një vepër penale që i takon kompetencës së gjykatave të zakonshme të sistemit gjyqësor, kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ".³⁰⁰

³⁰⁰ Po aty.

GJK e ka shtrirë efektin e konceptit të gjykatës së caktuar me ligj edhe në fushën e kompetencës së GJL, konkretisht në gjykimin e Kolegjit Penal ose Civil si edhe në atë të Kolegjeve të Bashkuara. Ajo ka theksuar se *"nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 472 të KPC, ky kolegji ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të mbahet i njëjti qëndrim lidhur me parregullsinë e procesit ligjor kur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prish vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit.*

...Nisur nga natyra e veçantë e këtij gjykimi, Gjykata thekson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykata e shkallës së parë dhe e apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe e apelit dhe pa i ndryshuar ato...Gjykata thekson se lindja e çdo dyshimi të arsyeshëm mbi vërtetësinë e nënshkrimit në aktet objekt shqyrtimi nuk i jep të drejtë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të konkludojë mbi falsitetin apo pavërtetësinë e dokumentit, pa u shprehur më parë eksperti për një çështje të tillë. Bazuar mbi një vlerësim të ndryshëm të provave dhe të fakteve që janë dhënë nga gjykata e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, duke pranuar padinë e paditësve, [ç'ka bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj]".³⁰¹

³⁰¹ Vendim i GJK nr.7/2009. Pakica në këtë vendim ka qenë e mendimit se kolegji civil ka vepruar brenda hapësirës së tij ligjore duke vlerësuar faktet e konstatuara në mënyrë të pavarur nga gjykatat më të ulta.

Lidhur me këtë standart, GJK ka vlerësuar edhe kompetencën e gjykatave të zakonshme për të vendosur mbi kërkimet e palëve. GJK sqaron, se "...çështjen e kompetencës ajo e ka parë të lidhur me standardin kushtetues të gjykatës së krijuar me ligj, element ky i procesit të rregullt ligjor dhe i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Megjithatë Gjykata thekson, se bazuar në nenin 7 të Kushtetutës që sanksionon jo vetëm ndarjen, por dhe balancimin e pushteteve dhe në aktet normative që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të këtij parimi, pushteteve të tjera u është njohur e drejta/kompetenca për të zgjidhur çështjet ose mosmarrëveshjet që kanë lidhje me funksionet e tyre. Parimi i shtetit të së drejtës kërkon gjithashtu që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individit ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike.

...Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari i drejton organeve përkatëse të administratës publike. Sipas nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", nëse individit kërkuar nuk është dakord me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejtë në gjykatë. Vendimet e organeve të administratës ka të drejtë t'i kundërshtojë në gjykatë, përveç kërkesave, edhe çdo person tjetër që pretendon për vete të drejta pronësie. Legjitimiteti i këtyre subjekteve, si pjesë e praktikës së zakonshme gjyqësore, është pranuar dhe nga Gjykata e Lartë, që sipas nenit 141/2 të Kushtetutës ka bërë njësimin e praktikës gjyqësore.³⁰² Gjatë gjykimit të iniciuar prej subjekteve të mësipërme, përveç të tjerave, hetohet dhe vërtetohet dhe fakti nëse këtyre

³⁰² Vendimet nr.25, datë 28.03.2003 dhe nr.2, datë 06.01.2009 të Gjykatës së Lartë, cituar në vendimin e GJK.

*subjekteve u është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe, çdo vendim gjykate që do të anulonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës së administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tyre të pronësisë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e iniciuar nga të tilla subjekte, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Megjithatë, shqyrtimi i një mosmarrëveshjeje të tillë duhet të kufizohet vetëm në pronën që është objekt i vendimeve të organit administrativ dhe jo të shtrihet në prona të tjera që nuk janë objekt i këtyre vendimeve pasi, siç u parashtrua më sipër, njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës i takon fillimisht juridiksionit administrativ, ndërsa gjykata, me ankesë të individit, shprehet mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të organeve të administratës, pasi ato të kenë marrë vendimin përkatës. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata arrin në përfundimin se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor. Do të kemi një tejkalim të tillë në rastet kur gjykata jep vendim për të drejta pronësie mbi sipërfaqe që nuk janë kërkuar dhe nuk janë marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ. Në raste të tilla, gjykata merr kompetencat e këtij të fundit, duke cenuar parimet e shtetit të së drejtës e të ndarjes së pushteteve”.*³⁰³

4.5 E drejta për t’u njohur me akuzën/padinë/ rekursin dhe aktet e dosjes

Në jurisprudencën e GJK është pranuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndaluar në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në vendimet e veta GJK nuk ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet

³⁰³ Vendim i GJK nr.27/2009.

kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, ka plotësuar apo ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulta në plotësimin e standardeve dhe elementëve të një procesi të rregullt ligjor.³⁰⁴ Në këtë linjë, GJK e ka lidhur në mjaft raste të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes (akuzën/padinë, provat etj) me realizimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Ajo ka theksuar se *"e drejta e mbrojtjes nuk mund të realizohet nëse palëve në proces nuk u jepet mundësia të njihen me aktet e dosjes dhe pretendimet e palës kundërshtare"*.³⁰⁵ Po këtë qëndrim ka mbajtur GJK edhe në rastet kur nga kërkuesi është pretenduar mosmarrja njoftim për rekursin e bërë nga pala tjetër. Ajo ka theksuar se *"e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë përbërëse e së drejtës për t'u mbrojtur. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë në kohë të mjaftueshme palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ato padrejtësisht nga gjykimi"*.³⁰⁶

Në vazhdimësi ajo nuk ka hezituuar të ritheksojë respektimin e të drejtës për t'u njoftuar për gjykimin por edhe për të marrë dijeni për aktet e paraqitura në gjykim me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor. Ajo ka konstatuar shkelje kur palët nuk janë njoftuar sipas rregullave procedurale për seancat e gjykimit. Në një rast konkret, ajo ka deklaruar se *"nuk rezulton që gjykatat e sistemit gjyqësor të kenë plotësuar standardet e gjykimit, sidomos në dhënien e mundësive Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave publike. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në shkallë të parë dhe në këtë mënyrë i është mohuar një shkallë gjykimi për të paraqitur prova, për të dëgjuar pretendimet e palës tjetër e për të bërë prapësimet e duhura ndaj aktit të ekspertimit. Sipas pretendimit të përfaqësuesit të Avokaturës së Shtetit, kjo e fundit nuk kishte dijeni as për gjykimin në apel dhe pjesëmarrja e punonjësës së saj në këtë gjykim ishte rastësore. Por, edhe sikur të ishin dërguar rregullisht kopjet e akteve të gjykimit*

³⁰⁴ Vendim i GJK nr.21/2008

³⁰⁵ Vendim i GJK nr.7/2005.

³⁰⁶ Vendim i GJK nr.11/2005.

dhe të ishte njoftuar rregullisht për gjykimin në Apel, pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit nuk do të mund të realizonte një mbrojtje efektive, të riparonte mangësitë themelore procedurale që kishin të bënin me mosnjoftimin e pjesëmarrjen e palëve, mosrespektimin e juridiksionit dhe kompetencën, etj., të cilat gjykata e apelit, sipas nenit 467 të KPC, nuk mund t'i korrigjojë vetë, dhe për këtë arsye është e detyruar të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë e të dërgojë çështjen për rigjykim.

Pretendimin e shkeljes së juridiksionit gjyqësor dhe të mosnjoftimit të akteve Avokatura e Shtetit e ka ngritur dhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në vendimet e veta, se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, prandaj Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur për të...Për sa më sipër, Gjykata çmon se në këtë aspekt ka patur cenim të parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor".³⁰⁷

GJK i ka konsideruar të mjaftueshme veprimet e gjykatës për njoftimin e rekursit avokatit të kërkuesit, kur ai ka qenë avokat i zgjedhur prej tij dhe e ka përfaqësuar kërkuesin në gjykimin në apel si dhe kur është konfirmuar marrja e rekursit nëpërmjet nënshkrimit të tij (avokatit).³⁰⁸ GJK është ndalur gjatë tek standarti i procesit të rregullt kur bëhet fjalë për njoftimin e të pandehurit lidhur me akuzën ose procesin e filluar ndaj tij. Megjithëse ky qëndrim i riparë i GJK është trajtuar hollësisht tek nënçështja "gjykimi në mungesë", këtu paraqitet vetëm standarti lidhur me njoftimin e të pandehurit për fillimin e procesit penal. Kështu ajo ka theksuar se "është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim...".³⁰⁹

³⁰⁷ Vendim i GJK nr.27/2009.

³⁰⁸ Vendim i GJK nr.1/2008.

³⁰⁹ Vendim i GJK nr.30/2010.

4.6 E drejta për t'u mbrojtur

Neni 31/ç i Kushtetutës parashikon se *"kushdo gjatë procesit penal ka të drejtë...të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme."* Kjo e drejtë garantohet edhe nga dispozitat përkatëse të KPP dhe ligjeve të tjera. GJK, gjatë elaborimit të së drejtës së mbrojtjes është referuar edhe tek qëndrimi i GJEDNJ lidhur me këtë element të procesit të rregullt. GJEDNJ ka theksuar se, ndërsa neni 6/3 c) i KEDNJ i jep të drejtën çdokujt që është akuzuar për një vepër penale *"të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi"*, nuk specifikon mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Konventa iu le shteteve anëtare të bëjnë zgjedhjen e mjeteve që do të mund të sigurojnë brenda sistemit të tyre gjyqësor të drejtën e mbrojtjes. Detyra e GJEDNJ konsiston vetëm në kontrollin që ajo ushtron për të verifikuar nëse metoda që ata kanë zgjedhur është e pajtueshme ose jo me kërkesat e gjykimit të drejtë.³¹⁰ Në këtë kuptim, duhet të kemi parasysh se Konventa është hartuar me qëllim që të garantojë jo të drejta që janë iluzore por të drejta që janë praktike dhe efektive dhe thjesh caktimi i një mbrojtësi për të pandehurin nuk e garanton në vetvete efektivitetin e asistencës ligjore që i nevojitet atij (të pandehurit) gjatë procesit penal.³¹¹ Më tej, GJEDNJ ka nënvizuar se as dispozita dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk e ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, duke shprehur haptazi ose me heshtje, të drejtën për të patur një proces të drejtë. Megjithatë në një rast të tillë, i pandehuri duhet të përfitojë në mënyrë të padiskutueshme nga garancitë minimale pa të cilat një proces penal nuk mund të konsiderohet si në përputhje me qëllimet e Konventës.³¹²

³¹⁰ Çështja *Quaranta k. Zvicrës*, datë 24 maj 1991.

³¹¹ Çështja *Imbrosia k. Zvicrës*, datë 24 nëntor 1993 dhe *Artico k. Italy*, datë 13 maj 1980.

³¹² Çështja *Hermin k. Italisë*, datë 12 qershor 2006; *Poitrimol k. France*, datë 23 nëntor 1993.

Gjithashtu, në raste të tilla nuk duhet mënjanuar interesi publik për të bërë drejtësi në përpunime me standartet.³¹³

Në këtë kuptim, GJEDNJ nuk e ka konsideruar të cenuar procesin, kur i pandehuri ka zgjedhur vetë mbrojtësit e tij, të cilët kanë qenë aktivë gjatë procesit por nuk kanë marrë pjesë në seancën përfundimtare ku do të deklarohet qëndrimin e tyre final lidhur me akuzën. Sipas saj, që të pranohej cenimi i nenetit 6 duhet që i pandehuri të pretendonte se mbrojtësit po veprojnë kundër vullnetit të tij dhe se ai (i pandehuri) ka hasur në vështirësi sa i takon përgatitjes së pretendimeve përfundimtare, të cilat nuk janë bërë siç duhet nga mbrojtësi.³¹⁴ Duke iu referuar praktikës së GJEDNJ, e cila konsideron se caktimi i mbrojtësit nga familjarët kur i pandehuri është në mungesë dhe nuk ka dijeni për procesin ndaj tij është i papranueshëm, pasi nuk garanton të drejtën e mbrojtjes efektive në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ, ka lindur edhe detyrimi për të ndryshuar praktikën gjyqësore të GJK shqiptare.³¹⁵

E drejta e mbrojtjes duhet parë në fazën e hetimeve në dy aspekte: në të drejtën e mbrojtjes që ka/duhet të ketë personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale dhe e drejta e mbrojtjes për të pandehurin pasi i është komunikuar akuza. Neni 34/4 i KPP shqiptar parashikon se *"dispozitat që parashikohen për të pandehurin zbatohen edhe ndaj personit nën hetim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe. Ndaj atij personi shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin."* Nga kjo mund të nxjerrim se edhe personi i dyshuar nuk mund të merret në pyetje pa iu siguruar mbrojtja ose asistencë nga një mbrojtës i kualifikuar.³¹⁶ Duke qenë se personi i dyshuar pas pyetjes mund të kthehet në të pandehur, është shumë e rëndësishme që edhe atij t'i garantohen të njëjtat të drejta në procesin e hetimit. Kështu, neni 309 i KPP parashikon se *"mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht lajmërohet të paktën*

³¹³ Çështja *Håkansson dhe Stureson k. Suedisë*, 21 shkurt 1990.

³¹⁴ Shih për më tepër çështjen *Caka k. Shqipërisë*, datë 8 dhjetor 2009. Gjithashtu edhe *Cuscani k. Mbretërisë së Bashkuar*, datë 24 shtator 2002, *Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, datë 16 dhjetor 1992.

³¹⁵ Për më shumë shih më poshtë nënçështjen mbi gjykimin në mungesë.

³¹⁶ Nenet 255 e 256 e KPP shqiptar.

24 orë përpara kur procedohet me marrje në pyetje, këqyrje ose ballafaqim. Procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit, me të drejtën për mbrojtësin që t'i shqyrtojë dhe të nxjerrë kopje". Që në momentin e thirrjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ky ka të drejtën të kërkojë asistencën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij ose nëse nuk ka mundësi të një mbrojtësi të caktuar nga organi procedues. Mbrojtësi duhet të ketë kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e të akuzuarit. Lidhur me caktimin e mbrojtësit nga gjykata kur i pandehuri dëshiron të mbrohet prej tij por nuk ka mundësi ta zgjedhë vetë, KPP ia njuh mundësinë nëpërmjet nenit 6/2 të tij dhe nenit 256 kur personi ende nuk është marrë i pandehur. Ajo që mbetet për t'u parë është mënyra e ushtrimit të efektiv të mbrojtjes gjë e cila mund të verifikohet gjatë zhvillimit të procesit.

Lidhur me çështjen e caktimit/zgjedhjes së mbrojtësit mundësitë që ka i pandehuri për të siguruar mbrojtjen gjatë një procesi janë këto: (1) mbrojtësi i të pandehurit zgjidhet prej tij ose nga familjarët;³¹⁷ (2) mbrojtësi i të pandehurit caktohet kryesisht nga gjykata;³¹⁸ (3) i pandehuri dëshiron të mbrohet vetë dhe jo nga një avokat ose person i kualifikuar.

4.6.1 E drejta për t'u mbrojtur me avokat të zgjedhur ose të caktuar nga gjykata

Neni 6 i KPP parashikon se "*i pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij*

³¹⁷ Neni 48/3 i KPP. Për këtë çështje shih më tepër vendimin e GJK lidhur me ndryshimin e praktikës së deritanishme sa i takon të drejtës së familjarëve të të pandehurit për të zgjedhur mbrojtësin kur i pandehuri gjykohet në mungesë ose nuk ka shprehur vullnet për një gjë të tillë.

³¹⁸ Neni 49 i KPP.

ligjore". Parimisht e drejta mbrojtjes është e garantuar duke marrë edhe rastin kur i pandehuri nuk ka mundësi të zgjedhë vetë një mbrojtës. Le të shohim më poshtë qendrimin e GJK lidhur me të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur nga një avokat i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga gjykata. Sa i takon rastit të caktimit të avokatit kur i pandehuri gjykohet në mungesë, për shkak të problematikës që paraqet sot, do të trajtohet posaçërisht më poshtë gjykimi në mungesë në Shqipëri.

GJK që herët është ndalur tek detyrimi i mbrojtjes sidomos kur gjykohen të mitur. Ajo ka theksuar se *"në gjykimin e të miturve mbrojtja është e detyrueshme dhe se mungesa e saj, në bazë të nenit 128 të KPP, i bën aktet procedurale absolutisht të pavlefshëm e për pasojë, gjykimin antikushtetues. Dispozitat e KPP të përmendura më lart, përbëjnë garanci për zbatimin në këtë fushë të nenit 54 të Kushtetutës, i cili parashikon për fëmijët një mbrojtje të veçantë nga shteti, krahas disa subjekteve të tjera...Për çështjen në shqyrtim, rëndësi të veçantë merr diskutimi dhe zgjidhja e problemit nëse dispozitat e mësipërme procedurale do të zbatohen në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë.*

*...Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se, Gjykata e Lartë, krahas parimeve të tjera, është e detyruar të respektojë konradiktoritetin e barazinë e palëve në gjykim. Zbatimi i këtyre parimeve në gjykimin penal kërkon që i pandehuri i mitur, nëpërmjet mbrojtësit të tij, të paraqitet e të dëgjohet njëlloj si prokurori. Zbatimi me korrektësi i këtyre parimeve do të përjashtonte dizavantazhin e një pale ndaj tjetrës. Në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë e ka shkelur parimin edhe pse shqyrtohej një rekurs që nëpërmjet ndryshimit të vendimeve të shkallëve të tjera të gjykimit rëndonte pozitën e të pandehurit të mitur".*³¹⁹

Si cenim i së drejtës së mbrojtjes është konsideruar nga GJK edhe njoftimi i rekursit/ankimit të pandehurit ose palës tjetër në procesin civil.³²⁰ Sidomos në procesin penal, GJK e ka konsideruar të

³¹⁹ Vendim i GJK nr.13/2005.

³²⁰ Vendime të GJK nr.15/2005; nr.17/2005.

domosdoshme marrjen e masave nga gjykatat për të njoftuar ankimin/ rekursin kur ky ushtrohet nga prokurori. Sipas GJK, "garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të respektohen edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Natyrisht, mënyra me të cilën aplikohen këto garanci në gjykimin në këtë Gjykatë varet nga karakteristikat e veçanta të procesit në këtë instancë, nga mbajtja parasysh e tërësisë së procesit (pra, në të tre shkallët) dhe nga roli i Gjykatës së Lartë në këtë proces...Respektimi i parimit të barazisë së armëve si dhe ai i mbrojtjes me avokat janë aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për pasojë, në funksion të respektimit të këtyre parimeve një rol të veçantë luajnë edhe njoftimi i palës si dhe i avokatit mbrojtës të tij, si për kopjen e rekursit ashtu edhe për ditën e gjykimit.

...Nga materialet e dosjes rezulton se kopja e rekursit të prokurorit nuk i është dorëzuar kërkuesit por avokatit që kërkuesi kishte caktuar për mbrojtjen e tij në shkallë të parë dhe në apel. Është e vërtetë se ky avokat, mbi deklarin në seancë të kërkuesit, është caktuar të realizojë mbrojtjen e tij në dy shkallët e para të gjykimit. Mirëpo, nga procesverbali i seancave gjyqësore, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel, nuk rezulton që këtij avokati t'i jenë dhënë tagra mbrojtjeje tej këtyre dy shkallëve të gjykimit. Në këto rrethana dhe në mungesë të ndonjë prokure noteriale me të cilën do të ngarkohej avokati i mësipërm me mbrojtjen e kërkuesit në gjykimin në Gjykatën e Lartë, ai nuk mund të ushtrojë funksionin e mbrojtësit në këtë Gjykatë. Për pasojë, dorëzimi i kopjes së rekursit këtij avokati e bën njoftimin e këtij akti të pavlefshëm. Kjo situatë ka bërë të pamundur marrjen dijeni të kërkuesit për ditën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, sepse marrja dijeni për rekursin është sinjali i parë që merr pala që i kundrejtohet ky akt, kohë nga e cila ky i fundit fillon të ndjekë listën e datave të gjykimit në këtë Gjykatë. Mirëpo, në kundërshtim me këtë, Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar me shpalljen e ditës së gjykimit në listën e gjyqeve, e ka shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuesit dhe në mungesë të mbrojtësit të tij, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky parim luan një rol të rëndësishëm në procesin penal, sepse në këtë rast përballë personit të akuzuar

për veprën penale është shteti. Për këtë arsye shteti (në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë), duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore që t'i sigurojë të akuzuarit mundësitë e njohjes dhe të deklarimit për ... vlerësimet ligjore të çështjes. Në rastin në shqyrtim, kjo Gjykatë ka patur në dispozicion pretendimet ligjore të prokurorit për mosaplikimin e kushtit në rastin e dënimit me burgim të kërkuesit, por nuk i ka dhënë mundësi këtij të fundit që të njihet dhe të komentojë lidhur me këto pretendime. Në këtë drejtim, Gjykata Lartë duhet të mbante parasysh edhe faktin se, pranimi i rekursit, mund të çonte, ashtu siç ka ndodhur në fakt, në keqësimin e pozitës së kërkuesit, pa i dhënë mundësi këtij të mbrohet, ndërkohë që pala e akuzës, jo vetëm që ka paraqitur rekursin, por edhe është përfaqësuar nga prokurori në gjykimin në këtë Gjykatë...Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, Gjykata e Lartë nuk duhet të zhvillonte gjykimin në mungesë të kërkuesit, por duhet ta shtynte seancën për t'i dhënë mundësi atij të vinte në dijeni për rekursin dhe për realizimin e mbrojtjes".³²¹

Në vijim të domosdoshmërisë së garantimit të të drejtës së mbrojtjes edhe në Gjykatën e Lartë, GJK e ka lidhur prezencën e mbrojtësit të të pandehurit edhe me një faktor tjetër, atë të interesit të drejtësisë. Ky koncept i shfaqur rishtazi në praktikën e GJK, ka konstatuar kryesisht në nevojën e sqarimit sa më të mirë të rrethanave dhe mbrojtjes sa më të mirë të të pandehurit. "...Vlerësimi i çështjes nëse ndodhemi ose jo para interesit të drejtësisë në gjykimin që do të zhvillohet në Gjykatën e Lartë do të varet, sipas rastit, nga natyra e çështjes, nga subjekti që ka paraqitur rekursin, nga kompleksiteti apo vështirësia e problemeve ligjore të parashtruara në të, nga lloji dhe masa e dënimit që rrezikon të jepet ndaj të akuzuarit në krahasim me vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta, etj. Ajo varet gjithashtu edhe nga vendi, roli dhe detyrat që kryen një gjykatë e tillë në çdo vend të veçantë. Në këtë kuadër, theksohet se ndihma ligjore është veçanërisht e rëndësishme në vendet ku e drejta e aksesit në këto

³²¹ Ky qendrim është mbajtur si për çështjet penale ashtu dhe çështjet civile. Shih për më tepër: Vendimet e GJK nr.21/2005; nr.23/2005; nr.24/2005; nr. 8/2006; nr.7/2007.

grykata mund të realizohet vetëm nëpërmjet avokatit mbrojtës³²² ose legjislacioni procedural përkatës nuk parashikon mundësinë e kundër rekursit nga ana e palës kundërshtare...Grykata Kushtetuese vlerëson se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të akuzuarit që grykohet nga Kolegji Penal i Grykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij, në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga grykata e apelit.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesit një e drejtë e tillë nuk i është garantuar në Grykatën e Lartë. Grykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes dhe lirimim të tij të menjëhershëm nga paraburgimi. Në grykimin që ka zhvilluar Kolegji Penal i Grykatës së Lartë, grykim i bërë pas rreth 7 muajsh mbi bazën e rekursit të prokurorit, nuk ka marrë pjesë as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij. Ky kolegji praktikisht ka vlerësuar vetëm pretendimet e prokurorit të paraqitura në rekurs dhe në seancë, në të cilat është kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi me burgim i të pandehurit. Pala e akuzuar, pra mbrojtja e saj, nuk ka pasur mundësi të shprehet për asnjërin nga këto pretendime. Në këto kushte, duket mjaft qartë se nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe ai i kontradiktoritetit dhe, për pasojë, është cenuar rëndë e drejta e mbrojtjes së kërkuesit.

Grykata Kushtetuese çmon se përputhja me kërkesat e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, të garantuar në nenet 31/1, 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, duhej të ishte verifikuar nga Kolegji Penal i Grykatës së Lartë...[ky i fundit] duhej të verifikonte arsyet e mosparaqitjes dhe më pas, në funksion të këtij verifikimi, duhej të kishte vendosur shtyrjen e seancës gryqësore ose edhe mbrojtjen e kërkuesit me avokat të caktuar kryesisht".³²³

Prania e mbrojtësit të të pandehurit në GJL është trajtuar vazhdimisht nga GJK si një nevojë për garantimin e të gjitha të drejtave procedurale që rrjedhin nga prania e të interesuarit në një proces gryqësor.

³²² Shih R.D. k. Polonisë, 18 dhjetor 2001, cituar në vendimin e GJK.

³²³ Vendime të GJK nr.16/2006; nr.13/2008.

Sidomos në rastet kur nga procesi në GJL ka ardhur përkeqësimi i situatës juridike të të pandehurit GJK ka qenë e prerë në qëndrimin e saj për nevojën e pranisë së mbrojtësit të të pandehurit pa e lidhur domosdoshmërisht me praninë e vetë të pandehurit. Kështu, ajo ka theksuar se "*pas rekursit të paraqitur nga prokurori, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e dhënë e ka ndryshuar in peus (në përkeqësim) masën e dënimit të kërkuesit, ndërkohë që ky i fundit nuk ka mundur të sigurojë mbrojtjen e tij...Për shkak të zhvillimit të debatit gjyqësor për çështje të ligjit, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykimin e çështjes në gjykatat më të larta nuk është paraqitur e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë patur rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Mbi këtë bazë është konsideruar si i mjaftueshëm njoftimi i avokatit mbi ankimin e ushtruar në shkallët më të larta të gjykimit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë gjyqësore, është konsideruar e palejueshme vazhdimi i mëtejshëm i saj.*"³²⁴

*...Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja gjykohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili kishte kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe faktit që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, sepse ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të realizonte të drejtën për tu mbrojtur".*³²⁵

Edhe në rastet kur i pandehuri i fshihet drejtësisë procesi gjyqësor nuk mund të zhvillohet pa i caktuar të paktën një mbrojtës kryesisht atij. Sipas GJK, "*parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten*

³²⁴ Vendim i GJK nr.23/2005. Shih gjithashtu edhe vendimin nr.13/2008 të po kësaj Gjykate.

³²⁵ Vendime të GJK nr.5/2008; nr.16/2009; nr.28/2009.

dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër... Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe në dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi

... Në dallim nga procesi civil, procesi penal i shkallës së parë e të dytë, në referim të KPP, është konceptuar për çdo rast si proces që zhvillohet me mbrojtës, të cilin, në raste të caktuara nga ligji, nuk përjashtohet ta caktojë edhe vetë gjykata. Kjo për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme që ka në një shtet demokratik garantimi i lirisë së personit nga çdo cenim. Megjithëse organet e gjykimit nuk mund të bëhen përgjegjës për çdo mosparaqitje në seancë nga ana e të gjykuarit ose avokatit të tij, u takon këtyre organeve të ndërmarrin hapa për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura nga Kushtetuta, siç është e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve si element i saj përbërës. Garantimi i kësaj të drejte merr rëndësi dhe për arsye se paraqitja e rekursit nga prokurori KPP nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtarë. Në këto rrethana, pjesëmarrja e të gjykuarit dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij kërkohet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces gjyqësor.... Gjkata është shprehur se përgjithësisht seancat gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit dhe, se pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh se debati zhvillohet për çështje të ligjit, nuk është automatikisht e domosdoshme me përjashtim të rasteve, kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm

nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit...

Gjykata çmon se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka përmbushur detyrimet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes të të akuzuarit në procesin penal. Vetëm nëpërmjet garantimit të të drejtës së mbrojtjes realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë me objektivitet e paanësi. Siç u theksua dhe më sipër, mospajtimi i pjesëmarrjes në gjykim të të akuzuarit në çdo rast, edhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Interesat e drejtësisë e kërkonin detyrimisht realizimin e mbrojtjes së kërkuesit, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, duke pasur parasysh që gjykimi nga Gjykata e Apelit është bërë mbi bazën e ankimit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, është kërkuar një rëndim i dukshëm i pozitës së kërkuesit në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e shkallës së parë.

[Ndërkohë] Gjykata e Lartë, në kushtet kur Gjykata e Apelit ka gjykuar kërkuesin, në mungesë të tij dhe të mbrojtësit dhe ka rënduar pozitën e tij në krahasim me gjykimin në shkallën e parë, ka patur detyrimin për të siguruar mbrojtjen e kërkuesit në këtë gjykim, qoftë dhe nëpërmjet caktimit të një avokati kryesisht. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ishte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, si e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes këtij të fundit, të realizonte të drejtën për t'u mbrojtur".³²⁶

³²⁶ Vendime të GJK nr.30/2009; nr. 37/2010.

GJK e ka konsideruar të garantuar të drejtën e mbrojtjes kur avokati i të pandehurit është përjashtuar nga gjykimi për shkak të shkeljeve të rregullave të seancës gjyqësore dhe gjykata ka caktuar mbrojtës kryesisht për të pandehurin. Në këto raste, GJK ka vlerësuar se caktimi i një avokati kryesisht për kërkuesin në vend të avokatit të zgjedhur prej tij nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit.³²⁷

4.6.2 E drejta për t'u mbrojtur vetë

GJK ka konsideruar se e drejta e mbrojtjes nga vetë i pandehuri ose i padituri/paditësi është një e drejtë kushtetuese. Një e drejtë e tillë nuk është e pakufizuar dhe nuk do të thotë që individi ka të drejtë në çdo instancë dhe fazë të procesit të kërkojë të drejtën për t'u dëgjuar drejtpërdrejt. Kështu si përjashtim, GJK ka çmuar pjesëmarrjen e të pandehurit për t'u dëgjuar në GJL. Në një vendim të hershëm të saj, GJK ka theksuar se *"shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë ka karakter të veçantë. Ajo nuk përsërit gjykimet e zhvilluara për të njëjtën çështje në shkallë të parë ose edhe në gjykatën e apelit, pra nuk e trajton çështjen edhe nga pikëpamja e faktit, por kufizohet kryesisht në çështjet ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga këto gjykata. Gjykata e Lartë kontrollon nëse në gjykimet e zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit janë zbatuar ose jo kërkesat e ligjit.*

...Kur çështja kalon në seancë gjyqësore zbatohen parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Në funksion të sigurimit të një mbrojtje sa më efektive, vetë specifika e trajtimit të çështjes në këtë fazë në Gjykatën e Lartë imponon disa veçanti. Problemet që shtrohen aty kanë karakter të mirëfilltë ligjor, prandaj diskutimi i tyre kërkon përgatitje dhe nivel të lartë profesional. Në emër të të pandehurit apo palëve në gjykim një gjë të tillë mund ta realizojë me profesionalizëm avokati i tyre. Ai i ka të gjitha mundësitë dhe aftësitë për të mbrojtur realisht dhe me efikasitet përpara Gjykatës së Lartë interesat e subjektit që përfaqëson. Pikërisht për këto arsye, ka raste që edhe nga këndvështrimi formal, vende të

³²⁷ Vendim i GJK nr.14/2007.

ndryshme ofrojnë zgjidhje të ngjashme me atë të vendit tonë, ku procesi në Gjykatën e Lartë quhet edhe si "procesi i avokatit". Për më tepër, në funksion të kësaj specifike të trajtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, në shumë vende, të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit apo palëve pranë kësaj Gjykate e ka një numër i kufizuar avokatësh që zgjidhen sipas kriterëve të përcaktuara rigorozisht në ligj, mes të cilave vemendje e veçantë i kushtohet përgatitjes profesionale...Një mbrojtje e tillë me avokat, nga ana tjetër, është edhe në interes dhe në funksion të kërkesave të shtetit të së drejtës, pasi i shërben më mirë krijimit të sigurisë juridike dhe dhënies së drejtësisë në përgjithësi, për të cilat një rol tepër të spikatur Kushtetuta jonë i ngarkon Gjykatës së Lartë. Mbrojtja objektive e të drejtave dhe lirive themelore ka prioritet dhe rëndësi të veçantë në Gjykatën e Lartë. Përmes kësaj mbrojtje bëhet njëkohësisht edhe njësimi i praktikës gjyqësore, zbatimi i drejtë dhe i njëlojtë i ligjit si dhe vetë garantimi i të drejtave dhe lirive individuale... Pjesëmarrja e të pandehurit në seancë gjyqësore dhe mundësia e mbrojtjes vetë janë padyshim elemente të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, deklarimet e të pandehurit në seancë, pavarësisht se ai mund të mbrohet njëkohësisht dhe nga një avokat, i shërbejnë vetë gjykimit të çështjes. Ato shërbejnë për të saktësuar e sqaruar më mirë mjaft elemente të veprës penale, si rrethanat e kryerjes së saj, motivet, formën dhe shkallën e fajësisë të cilat, marrë në tërësi, do të ndikojnë dukshëm edhe në fatin e akuzës, kualifikimin e veprës si dhe llojin dhe masën e dënimit.

...Parimet e pjesëmarrjes dhe të mbrojtjes vetë të palëve kanë rëndësi edhe në proceset civile, pavarësisht se në këto procese, për vetë natyrën e tyre, si rregull, palët përfaqësohen që në fillim me avokat. Sidoqoftë, në gjykime të posaçme deklarimet e palëve edhe në procesin civil në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, marrin rëndësi të dorës së parë për vetë procesin. Jo vetëm kaq, por edhe në procesin civil, sipas nenit 186 të KPC, gjykata ka të drejtë ta thërrasë dhe pyesë palën në gjykim, pasi shpeshherë ajo është burimi kryesor i drejtpërdrejtë i fakteve apo rrethanave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.

...Nga ky këndvështrim, dispozitat që kontestohen nga kërkuesi, konkretisht pikat 3 dhe 5 të nenit 437 të KPP dhe paragrafet 2 dhe 3 të nenit 483 të KPC, duke kërkuar që mbrojtja e interesave të të pandehurit dhe palëve në procesin civil në seancën gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë të bëhet me avokat, mund të duket se bien në kundërshtim me nenet 31/c dhe 33/1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ. Gjykata Kushtetuese konstaton se në seancën gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë nuk kemi cenim të parimit të përgjithshëm të mbrojtjes. Përkundrazi, përfaqësimi me avokat në këtë seancë synon garantimin e një mbrojtje sa më efektive dhe sa më profesionale të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Ajo synon mbrojtjen reale të të drejtave të të pandehurit dhe palëve në proces, respektimin e ligjit dhe dhënien e drejtësisë në përgjithësi.

Duke iu referuar të drejtës së mbrojtjes në gjykatën e apelit apo në Gjykatën e Lartë, GJEDNJ ka theksuar disa herë se në këto raste, rëndësi thelbësore ka garantimi i praktikitetit dhe efektshmërisë së kësaj mbrojtje. Në çështjen Airey kundër Irlandës, ajo ka vënë në dukje se: "Konventa synon të garantojë të drejta që nuk janë teorike dhe sipërfaqësore, por të drejta që janë praktike dhe efektive".³²⁸ Mbi këtë bazë, ajo ka konkluduar në mjaft raste se trajtimi nga gjykata respektive jo i problemeve të faktit, por vetëm i problemeve ligjore, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat, por për më tepër është e domosdoshme për garantimin e një mbrojtje efektive dhe të dobishme, gjithnjë në favor të të pandehurit apo palëve në gjykimin civil.³²⁹ Në çështjen Pakelli kundër Gjermanisë, GJEDNJ ve në dukje, ndër të tjera, nisur pikërisht nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe fokusimin e saj në çështje të ligjit, se "... pa ndihmën e një avokati ai nuk mund të kontribuonte në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndronin në thelb të mosmarrëveshjeve".³³⁰

³²⁸ Shih *Airey k. Irlandës*, 9 tetor 1979, cituar në vendimin e GJK.

³²⁹ Shih *Sutter k. Zvicrës*, 22 shkurt 1984; *Monnelli & Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987, cituar në vendimin e GJK.

³³⁰ Shih *Pakelli k. Gjermanisë*, 7 maj 1981, cituar në vendimin e GJK.

Nga ky këndvështrim duhet të evidentohet fakti i rëndësishëm se legjislacioni ynë, mbi bazën e Kushtetutës dhe në përputhje me standartet e KEDNJ, i garanton plotësisht të pandehurit dhe palëve në procesin civil mundësinë e pjesëmarrjes aktive në gjykimet që zhvillohen në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, pra aty ku çështja trajtohet në tërësi si nga pikëpamja faktike ashtu edhe ajo ligjore. Pavarësisht se interesat e tyre edhe në këto raste mbrohen si rregull me avokat, në këto gjykime ato kanë të drejtën dhe mundësinë të paraqesin dhe kundërshtojnë vetë prova, të bëjnë pyetje dhe të japin vetë sqarime, të shprehen për aspekte të përgjithshme dhe të veçanta të procesit të cilat i vlerësojnë vetë si të rëndësishëm. Gjithçka e deklaruar apo e pretenduar prej tyre pasqyrohet në dosjen gjyqësore, e cila administrohet më pas e plotë edhe në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Në trajtimin e çështjes dhe në vendimin që merr Gjykata e Lartë ka parasysh edhe këto deklarime apo prova, por duke u kufizuar kryesisht në kontrollin e zbatimit të ligjit material ose procedural për çështjen konkrete nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit. Pikërisht, për shkak të kësaj specifike parashikohet që në Gjykatën e Lartë interesat e të pandehurit dhe të palëve në procesin civil të mbrohen me avokat.

Së fundi, duhet të theksohet se edhe seanca gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë ka karakter publik. Në këtë seancë mund të marrin pjesë edhe palët e interesuara, të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm dhe mund të konsultohen apo mund t'i bëjnë propozime në çdo kohë avokatit të tyre. Avokati është zëri profesional i të përfaqësuarit. Palët nuk mund të jenë protagonistë në seancën që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Ky rol u takon avokatëve të tyre. Krahas të tjerave, protagonizmi i të pandehurit dhe palëve në procesin civil do të sillte në mënyrë të pashmangshme në Gjykatën e Lartë edhe elemente të panevojshëm emocionalë, të cilët natyrshëm do të shkaktonin zvarritje të problemit si dhe shmangie nga detyra qendrore e kësaj gjykate, që është shqyrtimi i çështjes kryesisht në këndvështrim të zbatimit të saktë të ligjit material dhe procedural".³³¹

³³¹ Vendim i GJK nr.25/2003. Ky vendim u soll më i plotë, pasi është një nga vendimet e para më të plota që shënon gurin themeltar të trajtimit të së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit para gjykatave. Mbi këtë vendim është bazuar jurisprudenca vijuese e GJK lidhur me këtë element të procesit të rregullt.

GJK e ka konsideruar të lidhur me vullnetin e të pandehurit nevojën për të zgjedhur ose për t'iu caktuar një avokat. Në rast se ai nuk e kërkon ose nuk e pranon avokatin e caktuar nga gjykata, atëherë e drejta e mbrojtjes nuk konsiderohet e cenuar, pasi ajo nuk është absolute dhe nuk mund të garantohet nëse i pandehuri nuk e dëshiron ose kërkon atë. GJK ka vlerësuar se *"qëllimi i dispozitës është garantimi i mbrojtjes së detyrueshme nëse e kërkon personi ndaj të cilit zhvillohen hetime. Por ky detyrim për garantimin e mbrojtjes së palës së akuzuar nuk është kategorik nëse personi ndaj të cilit zhvillohen hetime nuk e kërkon atë. Në të kundërt, nëse ai e kërkon, pala akuzuese duhet t'ia sigurojë mbrojtjen konform urdhërimeve të nenit 296/1 të KPP. Pra, kjo e drejtë nuk barazohet me mbrojtjen e detyrueshme, pasi nga ajo mund të hiqet dorë nga personi me vullnet të lirë..."*³³²

4.6.3 Gjykimi në mungesë

Lidhur me caktimin e mbrojtësit nga të afërmit praktika e viteve të fundit në Shqipëri ka shfaqur një problem sa i takon gjykimin në mungesë të të pandehurit. Konkretisht, në disa raste, kur procesi penal ndaj të pandehurit në mungesë kishte filluar, gjykata ka pranuar caktimin e mbrojtësit të të pandehurit të zgjedhur nga familjarët e tij. Më pas, kur i pandehuri ka marrë dijeni për zhvillimin e procesit në mungesë dhe ekzistencën e një vendimi penal të formës së prerë ndaj tij, ai ka kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit, pavarësisht se mbrojtësi i zgjedhur prej familjarëve i kishte ushtruar të gjitha mjetet e ankimit të parashikuara nga legjislati. Argumenti i përdorur rëndom prej të pandehurit në raste të tilla lidhej me atë se "avokati nuk ka qenë i zgjedhur prej tij, se ai nuk kishte patur gjatë gjithë kohës asnjë kontakt me familjarët, prandaj nuk mund të konsiderohet se zgjedhja e avokatit ka shprehur vullnetin e tij". Megjithatë, gjykatat shqiptare, përfshi edhe GJK, kanë pranuar se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët plotëson kriteret e

³³² Vendim i GJK nr.42/2007.

mbrojtjes sipas konceptit të parashikuara në KPP.³³³ Në vazhdim, GJK ka konsideruar si antikushtetuese vendimet e gjykatave më të larta që nuk kanë pranuar ankimin e bërë nga avokati i të pandehurit kur ky i fundit është gjykuar në mungesë.³³⁴

Pavarësisht qendrimit të mbajtur prej saj, GJK, së fundmi, e ndryshoi praktikën e saj disa vjeçare sa i takon caktimit të mbrojtësit nga familjarët jo vetëm gjatë zhvillimit të procesit në themel por edhe sa i takon ushtrimit të së drejtës së ankimit prej tij. Në një nga vendimet më të fundit që shënon kthesën e praktikës gjyqësore, ajo theksoi se *"...parashikimi në nenin 48/3 i mundësisë së familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehurit, nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë veti i ke nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili, në çdo rast, mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse*

³³³ Vendim i GJK nr.15/2003. Me anë të këtij vendimi, GJK shfuqizoi fjalën "i pandehuri" nga neni 410/2 i KPP, kur parashikohej se ankimi mund të bëhet nga mbrojtësi i pajisur me prokurë nga i pandehuri. GJK në atë vendim çmoi se kjo përbënte një kufizim të së drejtës së ankimit, pasi nuk lejonte familjarët e të pandehurit të zgjidhnin një mbrojtës kur i pandehuri ishte në pamundësi për ta bërë një gjë të tillë. Sipas GJK, kjo dispozitë binte ndesh edhe me nenin 48/3 të KPP, pasi këtu lejohej caktimi i mbrojtësit nga familjarët ndërsa në nenin 410/2 (sipas formulimit të vjetër) nuk lejohej.

³³⁴ Vendime të GJK nr.17/2003; nr.19/2003 e në vazhdim. Në fakt, ky qëndrim i GJK është mbajtur deri në vitin 2010, gjë e cila ka shkaktuar mjaft përplasje midis jurisprudencës së GJL dhe GJK, të cilat kanë interpretuar në mënyra të ndryshme ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes nga i pandehuri ose avokati i tij.

*nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, sipas GJEDNJ-së është detyrë e organeve kompetente shtetërore. E njëjta situatë është edhe për sa i përket ankimit. Familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë duke përmbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit”.*³³⁵

GJK me këtë vendim të saj ka bërë një interpretim pajtues me Kushtetutën lidhur me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit që gjykohet në mungesë. GJK, me anë të këtij interpretimi, shmangu shfuqizimin e dispozitës së antikushtetues përsa kohë është i mundur zbatimi i saj nëpërmjet interpretimit antikushtetues. Megjithatë, personalisht mendoj se vullneti i të pandehurit është primar, pra caktimi i mbrojtësit duhet të bëhet prej tij. Kur ai kërkon që të autorizojë familjarët për ta bërë këtë, atëherë format e parashikuara me ligj e mundësojnë një gjë të tillë. Prandaj mendoj se për të garantuar një mbrojtje efektive dhe për të mos patur përplasje midis vullnetit të të pandehurit dhe familjarëve që zgjedhin mbrojtësin e tij, paragrafi 3 i nenit 48 është i panevojshëm dhe krijon mundësi të kundërshtimit të proceseve thjesht e vetëm për faktin se mbrojtja është kryer jo në përputhje me vullnetin e të pandehurit. Pra, duhet të mbetet e qartë se i pandehuri cakton mbrojtësin vetë. Mënyrat se si e ushtron ai këtë të drejtë mund të parashikohen shprehimisht: p.sh duke autorizur familjarët, duke kërkuar ndihmën e gjykatës etj. Në këtë mënyrë jemi të sigurtë se vullneti në fund të fundit është shprehur direkt nga i pandehuri. E drejta e mbrojtjes është një e drejtë që lidhet direkt me të pandehurin.

Ndryshimi i praktikës së GJK lidhur me zgjedhjen e mbrojtësit të të pandehurit erdhi si pasojë e jurisprudencës së GJEDNJ lidhur me gjykimet në mungesë. Praktika më e fundit e GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se gjykimi në mungesë kur i pandehuri nuk gjendet (pra, nuk vërtetohet nëse i shmanget apo jo drejtësisë) nuk garanton asnjë nga të drejtat procedurale të parashikuara në Konventë. Duke qenë se ajo sugjeron që edhe në rastet kur gjykimi bëhet në mungesë, t'i

³³⁵ Vendim i GJK nr.30/2010.

krijohet mundësia të pandehurit të rihapë procesin, rezulton se ky lloj gjykimi është i tejkaluar ose i panevojshëm. Në fakt, praktika e GJEDNJ për gjykimin në mungesë është më e hershme. Ajo fillon kryesisht me vendimin në çështjen *Colozza k. Italisë*³³⁶. *Colozza* ishte dënuar për mashtrim me 6 vjet burg dhe i deklaruar në fillim i pakapshëm dhe pastaj i arratisur, nuk u njoftua për nisjen dhe zhvillimin e procesit dhe marrjes së një vendimi penal në ngarkim të tij. Vendimi i ishte njoftuar vetëm avokatit të caktuar kryesisht, sipas dispozitave që përcaktonin njoftimin në këtë rast. GJEDNJ në këtë vendim, duke vlerësuar garancitë e procesit të rregullt ligjor të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ, ka theksuar se *"edhe pse në të nuk gjen vend në mënyrë eksplicite e drejta e të pandehurit që të paraqitet në gjykim, kjo e drejtë del nga objekti dhe qëllimi i nenit 6 të KEDNJ i parë në tërësinë e tij. Të drejtat e njohura çdo të pandehuri nga paragrafët c) d) dhe e) të § 3 të "mbrohet vetë", "të pyesë dëshmitarët" dhe "të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në seancë" mbeten të pazbatueshme pa garantuar paraqitjen e tij në seancë"*. GJEDNJ përcaktoi një shkelje të Konventës nga rendi juridik italian për mungesën në këtë legjislacion të një mase që mund të balanconte të drejtat e të pandehurit, duke i krijuar atij mundësinë që, pasi të kishte marrë njoftim për procesin, të mund të merrej nga gjykatat kombëtare një vendim i ri. Si rezultat i vendimeve të vazhdueshme të GJEDNJ, u ndërmorrën reforma në legjislacionin italian. Gjithashtu, lindi nevoja edhe e përshtatjes së legjislacionit me Urdhërarrestin Europian.³³⁷

³³⁶ Vendim i datës 12 shkurt 1985.

³³⁷ Lidhur me Urdhër-Arrestin Europian, vendimi i Këshillit n. 2002/584/GAI i 13 qershorit 2002 parashikon se, nëse urdhër arresti europian është dhënë për ekzekutimin e një vendimi dënimi të një të gjykuari në mungesë dhe i gjykuari nuk është njoftuar personalisht, dhe as është informuar në mënyrë tjetër për datën dhe vendin e seancës gjatë së cilës është dhënë dënimi, dorëzimi i tij mund të kushtëzohet nga fakti që autoriteti gjyqësor që ka bërë kërkesën të japë *"garanci të mjaftueshme për t'u siguruar personave ndaj të cilëve është dhënë urdhër arresti europian, mundësinë që të kërkojnë një proces të ri në shtetin që ka bërë kërkesën dhe të jenë të pranishëm në gjykim"*. Kjo dispozitë gjeti zbatimin në shumë vende anëtare, legjislacioni i të cilave parashikon në mënyrë eksplicite refuzimin e ekzekutimit të urdhër arrestit europian të dhënë nga një shtet anëtar kur, në rast gjykimi në mungesë, legjislacioni i vendit që bën kërkesën nuk garanton të drejtën për një proces të ri.

Në vendimin *Somogyi k. Italisë*,³³⁸ GJEDNJ ka dënuar shtetin italian duke vënë në pah se "kemi të bëjmë me një mohim të drejtësisë në rastin kur një individ, i dënuar *in absentia*, nuk mund të ketë një gjykim të ri, pasi ai është vënë në dijeni të themelit të akuzës, për sa i përket fakteve dhe të drejtës". *Somogyi*, i arrestuar në Austri dhe i ekstraduar në Itali, u dënua si rezultat i një gjykimi në mungesë. Atij iu mohua edhe kërkesa për rivendosje në afat për të ankimuar vendimin e dënimit në mungesë. *Somogyi*, në ankimin e paraqitur para GJEDNJ parashtronte se nuk ishte informuar mbi ekzistencën e gjykimit ndaj tij, se fletë-lajmërimi nuk i ishte njoftuar dhe se firma e vënë në të nuk ishte e tij. Në vendimin e saj, GJEDNJ deklaroi se "kërkuesi disa herë ka kundërshtuar origjinalitetin e firmës që përbënte të vetmin element që mund të provonte se me të vërtetë ai ishte informuar për fillimin e procedimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe pse ky element ishte shumë i rëndësishëm në çështjen në fjalë, nuk u bë asnjë hetim për të verifikuar këtë fakt dhe, me gjithë kërkesat e shumta të bëra nga i interesuari, nuk u bë asnjë ekspertizë grafologjike për të krahasuar firmat."

GJEDNJ dënoi qeverinë italiane për shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ, sepse mungesa e verifikimeve për të hequr çdo dyshim mbi refuzimin për t'u paraqitur në gjykim nga ana e të pandehurit është në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor të sanksionuar nga Konventa. Në fakt, GJEDNJ nuk interpreton në mënyrë të ngurtë dhe formale të drejtën e të pandehurit për t'u informuar për akuzat në ngarkim të tij dhe të marrë pjesë, ose të refuzojë që të marrë pjesë në proces. Në disa vendime të saj parashikohet se "nuk përbën shkelje të nenit 6/1 dhe 6/3 të Konventës, për proces të rregullt ligjor, gjykim në mungesë, kur njoftimi është bërë në vendbanimin e zgjedhur në momentin e daljes nga burgu pranë avokatit".³³⁹ Rregulli se një i dënuar *in absentia* ka të drejtë të pyetet nga gjyqtari me qëllim verifikimin e bazueshmërisë së akuzës së ngritur ndaj tij "gjen një kufizim në rastet kur, pa asnjë ekuivok, ka pasur një heqje dore për t'u paraqitur në seancë"³⁴⁰ dhe për të provuar heqjen dorë me

³³⁸ Vendim i GJEDNJ, 18 maj 2004.

³³⁹ Çështja *Kimmel k. Italisë*, 2 shtator 2004.

³⁴⁰ Çështja *Poitrimol k. Francës*, 23 nëntor 1993.

vullnet të lirë duhet të argumentohet mjaftueshëm se personi, në mënyrë të arsyeshme, ka qenë në gjendje të parashikonte rrjedhojat e veprimeve të tij.³⁴¹ Kur i pandehuri ka zgjedhur vendbanimin si vendin për të marrë njoftim, kjo vlen edhe për avokatin e tij. Është detyrë e këtij të fundit të informohet në mënyrë që të ketë dijeni mbi zhvillimet e procesit dhe *"fakti që nuk është interesuar është i barasvlershëm me heqje dorë nga paraqitja në seancë"*.

GJEDNJ në disa vendime ka deklaruar se *"duhet që garancitë e ofruara nga legjislacioni i vendit në fjalë të jenë efektive, nëse rezulton që i pandehuri nuk ka hequr dorë nga paraqitja dhe as nga e drejta e mbrojtjes si dhe nuk i shmanget vullnetarisht drejtësisë"*, duke lënë të kuptohet se nuk duhet të rihapet një proces i ri kur i pandehuri gjendet në një situatë mungese të pafalshme ose të provokuar nga rrethana për të cilat ai vetë ka kontribuar, si në rastin kur ai është larguar vullnetarisht nga pjesëmarrja në proces duke u bërë i pakapshëm qëllimisht.³⁴² Në vendime të tjera konkluzionet janë të kundërta pasi njëherë përjashtohet nevoja e një procesi të ri në rastin e shmangies nga drejtësia, ndërsa më vonë përcaktohet e drejta e rihapjes së procesit *"në çdo rrethanë në të cilën vendimi është dhënë në mungesë"*.³⁴³

Në një çështje tjetër, *Sejdovic k. Italisë*, kërkuesi, i deklaruar i arratisur dhe i gjykuar në mungesë, ishte dënua me burgim për 21 vjet dhe 8 muaj për vrasje dhe armëmbajtje pa leje. Nga kërkimet ndërkombëtare u arrestua në Gjermani, autoritetet e të cilës refuzuan dorëzimin e tij Italisë, duke i quajtur jo të mjaftueshme garancitë e ofruara nga legjislacioni italian për rihapjen e procesit, që ndërkohë kishte përfunduar (vendimi kishte marrë formë të prerë). *Sejdovic* parashtronte se ishte gjykuar pa pasur asnjëherë dijeni mbi procesin penal në ngarkim të tij, ndërsa qeveria italiane parashtronte se kërkuesi kishte hequr dorë nga marrja pjesë në proces dhe kjo rrethanë përcaktohej nga fakti se *"menjëherë pas një vrasje, përgjegjësia e të cilës sipas dëshmitarëve ishte e tij, ishte larguar"*

³⁴¹ Çështja *Jones k. Anglisë*, 9 shtator 2003.

³⁴² Çështja *Medenica k. Zvicrës*, 12 dhjetor 2001.

³⁴³ Çështja *Sejdovic k. Italisë*, 10 nëntor 2004.

nga vendbanimi i tij pa lënë asnjë adresë të re apo çdo lloj gjurme". Në çështjen në fjalë, GJEDNJ vendosi që mungesa e të pandehurit nga vendet e zakonshme të vendbanimit apo vendqëndrimit mund "të jepte përshtypjen" që ai ishte në dijeni se policia e kërkonte, por nuk jep "provën" që ai ishte në dijeni të procesit penal në ngarkim të tij. Në vendim parashikohet se "të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe jo formal nuk mjafton".

Këto konkluzione janë paraqitur edhe ne vendimet *R.R. k. Italisë*,³⁴⁴ *Sejdovic k. Italisë*,³⁴⁵ *Zunic k. Italisë*,³⁴⁶ në të cilat Gjykata ka afirmuar se "në mungesë të një njoftimi formal të aktit me të cilin i pandehuri është informuar për procedimin penal dhe për akuzat kundër tij, mungesa e të pandehurit në adresën e shënuar në lejeqëndrimin e tij dhe versionet kontradiktore të dhëna nga të tretët për lëvizjet e tij, nuk janë elemente të mjaftueshme për të treguar në mënyrë të qartë që i pandehuri ka hequr dorë nga marrja pjesë në proces ose që do t'i shmanget drejtësisë". Në çështjen *Sejdovic k. Italisë*, GJEDNJ ka shqyrtuar edhe institutin e rivendosjes në afat, duke afirmuar se "është një e drejtë e personit të dënuar in absentia, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për tu paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat e bëra".

Në praktikën e GJK shqiptare është trajtuar edhe çështja e gjykimit në mungesë kur i gjykuari, megjithëse ka qenë i pranishëm në fazat e tjera të gjykimit, në një nga instancat e ankimit nuk ka marrë pjesë se nuk i është njoftuar ankimi/rekursi ose nuk është njoftuar rregullisht edhe kur ka bërë vetë ankimin. GJK ka theksuar se "...prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet

³⁴⁴ Vendim i GJEDNJ, 9 qershor 2005.

³⁴⁵ Vendim i GJEDNJ, 31 mars 2006.

³⁴⁶ Vendim i GJEDNJ, 21 dhjetor 2006.

juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit.³⁴⁷ Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata, kur si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Gjykata e Lartë, kur ka gjykuar këtë rast konkret, me përjashtim të argumenteve të paraqitura nga prokurori nuk ka patur të administruar asnjë argument ligjor nga pala e akuzuar. Çështja vështirësohet edhe për arsye se me paraqitjen e rekursit nga prokurori, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Pjesëmarrja e të gjykuarit, dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij, kërkohet për të siguruar jo vetëm të drejtën për t'u mbrojtur, por edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces ligjor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se koncepti i ndihmës së mbrojtësit nuk identifikohet domosdoshmërisht me praninë personale të të pandehurit në gjykim, por kuptohet si një garanci e pashmangshme e mundësisë për t'u mbrojtur, që në rastin e gjykimit përpara Gjykatës së Lartë është gjerësisht e siguruar përmes njohjes dhe kujdesit për të interesuarin të një sërë të drejtash procedurale të lidhura saktësisht me ndihmën e mbrojtësit. Për këtë arsye në rastin në shqyrtim paraqitej e domosdoshme pjesëmarrja e avokatit. Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ mbrojnë interesat e të pandehurit në një proces, sepse është ai që do të preket drejtpërdrejt nga pasojat e një procesi të zhvilluar pa pjesëmarrjen e tij dhe të avokatit.

...Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja shqyrtohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili ka kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe faktit, që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i

³⁴⁷ Frowein/Peukert, EMRK-Komentar (1996), fq.227.

*Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa u garantuar për arsyet e mosparaqitjes së tyre dhe pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të pandehurit, pasi kjo ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri përmes figurës përfaqësuese të avokatit të merrte pjesë në debatet e mundshme”.*³⁴⁸

GJK, në rastet kur ka patur për shqyrtim kërkesa që lidheshin me mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat nga gjykatat e zakonshme, është ndalur edhe tek verifikimi i faktit nëse i gjykuari në mungesë ka patur apo jo dijeni për procesin e zhvilluar ndaj tij. Kështu, ajo në një rast nuk e ka pranuar kërkesën e paraqitur për shkak se nuk provohej që i gjykuari nuk kishte patur dijeni për fillimin e hetimeve dhe procedimin penal të tij.³⁴⁹

4.7 Barazia e armëve (kontradiktoriteti)

Barazia e armëve në proces fillon që në momentin e hetimit në çështjet penale, ndërsa në çështjet civile që në fillim të procesit gjyqësor. Ajo duhet respektuar në të gjitha fazat e hetimit gjyqësor si dhe në ushtrimin e të drejtës së ankimit në instancat më të larta gjyqësore. GJK ka theksuar se moslegjitimimi i mbrojtësit të të pandehurit kur ky gjykohet në mungesë dhe njëkohësisht pranimi i shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga prokurori i vendos palët në pozita të pabarabarta. Kjo nënkupton që gjykimi do të zhvillohej vetëm me praninë e njëjës palë, pra prokurorit, gjë që e bën procesin të parregullt.³⁵⁰ Le të shohim disa nga vendimet më të spikatura të GJK lidhur me barazinë e armëve në procesin penal dhe atë civil.

³⁴⁸ Vendim i GJK nr.23/2005.

³⁴⁹ Vendim i GJK nr.22/2005.

³⁵⁰ Vendime të GJK nr.17/2000; nr.48/2000; nr.77/2000; nr.53/2001.

4.7.1 E drejta për të thirrur dhe pyetur dëshmitarë/ekspertë;
për të paraqitur dhe kundërshtuar provat e paraqitura;
për të (mos)bërë deklaratime

GJK në praktikën e saj lidhur me këto elementë të procesit të rregullt ka elaboruar gjerësisht standartet që duhet të mbajnë parasysh gjykatat e zakonshme gjatë gjykimeve sidomos atyre penale. Një nga çështjet më të rëndësishme lidhur me këtë parim ka qenë edhe mënyra e marrjes dhe vlerësimit të provave, ku GJK në fakt është ndalur vetëm tek e para, pra mënyra e marrjes së tyre nga gjykata. Ajo e ka vlerësuar si të rëndësishëm procesin e mbledhjes dhe marrjes së provave nga gjykatat, pasi gjatë këtij procesi vendoset fati i përfundimit të gjykimit në tërësi. Në këtë fazë i duhet dhënë mundësia të pandehurit të jetë prezent, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit, t'i kundërshtojë ato ose të debatojë rreth tyre etj. Këtë të drejtë GJK e ka lidhur, midis të tjerave, edhe me garancinë që jep neni 32/2 i Kushtetutës, ku parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës. Në bazë të kërkesave të KEDNJ dhe interpretimit të saj nga GJEDNJ, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ishte e drejtë.³⁵¹ Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Është e pamundur që gjykata, pa dëmtuar dhënien e drejtësisë, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, janë edhe të kundërligjshme.³⁵²

³⁵¹ Çështja *Vindisch k. Austrisë*, 27 shtator 1990.

³⁵² Çështja *Schenk k. Zvicrës*, 12 korrik 1988.

Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën e GJEDNJ, GJK e ka konsoliduar qëndrimin e saj, duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Sipas saj, *"vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerrogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.*

...Legjislacioni ynë procedural penal, doktrina si dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht mënyrën e marrjes së provave si një aspekt të rëndësishëm të procesit. Marrja e provave, sipas KPP, merr një kuptim të ri bazuar në sistemin akuzator, duke ndryshuar metodën e të proceduarit në lidhje me marrjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë përfundimisht nga të gjitha ato norma, të cilat sanksiononin pabarazinë e palëve në procesin penal në disfavor të individit dhe të të drejtave të tij. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Dispozitat e këtij kodi kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e procedimit penal në të gjitha fazat e tij. Prandaj, mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie që ndikon drejtpërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor.

...Duke iu referuar rastit në shqyrtim dhe bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore rezultojnë se provat mbi të cilat është bazuar gjykata në dënimin e kërkuesit janë deklarimet e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe procesverbalit i paraqitjes për njohje, i mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore. Nga dosja gjyqësore nuk konstatohet që kërkuesi të jetë pyetur me cilësinë e të pandehurit, por vetëm në një rast, ai është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Në të njëjtën datë rezultojnë edhe përpilimi i procesverbalit të paraqitjes për njohje. Këto dy të dhëna janë kundërshtuar si nga kërkuesi ashtu dhe nga dëshmitarët në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit. Deklarata e dhënë

përpara oficerit të policisë gjyqësore, pa praninë e mbrojtësit, është kundërshtuar gjatë procesit gjyqësor nga i akuzuari me arsyetimin se është marrë nën presionin e dhunës dhe të torturës. Për vërtetimin e këtij pretendimi, i gjykuari ka paraqitur kartelën klinike dhe epikrizën e mjekut, në të cilën pasqyrohet se ai "ankon për dhimbje koke, marrje mendsh, të vjella, rrahje të shpeshta të zemrës dhe rreth kyçeve të duarve, në formë byzylyku, vërehet ekimozë me gjerësi 0,5 cm dhe mbi kyçin e dorës së djathtë dërmishje ekimotike me 2 cm gjatësi".

Sigurisht që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë gabimet faktike apo juridike, që kanë të bëjnë me themelin e gjykimit, të cilat kryhen nga gjykatat e zakonshme dhe as të provojë vërtetësinë e të dhënave të tilla. Ekziston, pra, parimi në bazë të të cilit problemet lidhur me vlerësimin e provave të administruara në çështjen konkrete, janë në kompetencën e gjykatës vendimdhënëse.³⁵³ Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përjashtojë nga shqyrtimi rastet që i përkasin parimit dhe gjykimit se provat të cilat sigurohen në mënyrë të paligjshme të jenë të pranueshme.

Nga një analizë e hollësishme e dispozitave të sipërcituara, nga të dhënat që pasqyrohen në dosjen gjyqësore, si dhe nga referenca që bëhet në jurisprudencën europiane, Gjykata Kushtetuese çmon se ndaj kërkuesit është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, për arsye se është dënuar mbi bazën e provave të marra në mënyrë të kundërligjshme. Megjithëse këto të dhëna janë kundërshtuar në vazhdimësi nga kërkuesi, nga procesverbali gjyqësor në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit nuk rezulton të jenë respektuar kërkesat e nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale. Evidentimi në aspektin e kontrollit kushtetues i mosrespektimit të kërkesave procedurale që lidhet me kundërshtimin e dëshmisë në gjykatë përbën një çështje të mënyrës së marrjes së provave.

Sipas kuptimit të KPP, deklaratimet e bëra para prokurorit ose policisë gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete. Në rastin e kundërshtimit të këtyre thënieve në gjykatë, në kuptim të nenit

³⁵³ Shih më gjerë çështjen *Kostovski k. Holandës*, 20 nëntor 1989, cituar në vendimin e GJK.

362 të KPP, ato nuk janë provë por vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur. Deklarimet e dhëna para tyre, thuhet në pikën 3 të këtij neni, mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Parimi i procesit të rregullt përfshin edhe të drejtën e palëve për të njohur dhe për të komentuar çdo provë apo vërejtje, që i është paraqitur trupit gjykues, pavarësisht prejardhjes së tyre.³⁵⁴

...Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i avokatit të kërkuesit për pavlefshmërinë e kësaj prove, për arsye të moszhevillimit të seancës së paraqitjes për njohje në datën 25.09.2001, është i drejtë...Refuzimi nga ana e gjykatës i kërkesës së mbrojtësit për thirrjen si dëshmitarë të tre personave që kanë shërbyer gjatë paraqitjes për njohje, nuk i ka dhënë atij mundësinë për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes. E drejta e palëve për të paraqitur argumente sigurohet vetëm në rastin kur ato dëgjohen realisht, pra, kur shqyrtohen nga gjykata në mënyrën e duhur. Nuk mund të thuhet se kjo është bërë, nëqoftëse është nënvleftësuar një provë me rëndësi esenciale.³⁵⁵ Parë nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nuk i është krijuar mundësia, megjithë kërkesat e shumta në të gjitha shkallët e gjykimit, t'u drejtonin pyetje dëshmitarëve për të kundërshtuar provën në këtë proces penal, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes në një masë të papajtueshme me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafët 1 e 3, shkronja "d" të KEDNJ-së".³⁵⁶

Ky vendim u paraqit më gjerësisht për të dhënë standartin e vendosur dhe të mbajtur në vazhdimësi nga kjo Gjykatë për rolin që ajo ka në shqyrtimin e kërkesave për mosrespektim të procesit të rregullt sa i takon marrjes dhe vlerësimit të provave. GJK vazhdimisht ka theksuar se marrja dhe vlerësimi i provave është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa GJK ka kompetencë të vlerësojë

³⁵⁴ Çështja *Niderhost-Huber k. Zvicrës*, 18 shkurt 1997, cituar në vendimin e GJK.

³⁵⁵ Çështja *Fouquet k. Francës*, 12 tetor 1994, cituar në vendimin e GJK.

³⁵⁶ Vendim i GJK nr.7/2005.

nëse mënyra e marrjes dhe vlerësimit të tyre kanë respektuar ose jo parimet kushtetuese të parashikuara për këtë qëllim.³⁵⁷

GJK ka konsideruar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti përbëjnë elementë të rëndësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Prandaj për respektimin e tyre "gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbrojtjen kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht. GJEDNJ ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë.³⁵⁸

Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese konfirmon që në gjykimet penale të shkallës së parë dhe në apel, pra aty ku çështja shqyrtohet në fakt dhe në ligj, pjesëmarrja e të pandehurit ose e mbrojtësit ligjor të tij është e detyrueshme në çdo rast. Mungesa e të pandehurit apo avokatit të tij do të çonte sipas rastit në shtyrjen e seancës gjyqësore ose në caktimin e një mbrojtësi kryesisht ... Respektimi i standardeve të lartpërmendura në gjykimin që zhvillon Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë gjithnjë i njëjtë. Padyshim që këtu merren në konsideratë veçoritë dhe natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë, e cila përqendrohet kryesisht në çështje ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e nivelit më të ulët.

³⁵⁷ Vendime të GJK nr.1/2007; nr.14/2007;

³⁵⁸ Shih ndër të tjera çështjen *Alimena k. Italisë*, 19 shkurt 1991.

Pikërisht për këtë arsye, realizimi i mbrojtjes së personit të akuzuar në seancën gjyqësore që mund të zhvillohet në këtë gjykatë bëhet vetëm nga mbrojtësi ligjor i tij. Një mbrojtje e tillë është në interes të të pandehurit dhe të dhënies së drejtësisë në përgjithësi, për të cilën Kushtetuta i ngarkon pikërisht Gjykatës së Lartë një rol posaçërisht të veçantë.³⁵⁹ Prandaj, edhe në këtë rast, në funksion të garantimit të kësaj mbrojtje sipas KPP, ndër të tjera, duhet të bëhet njoftimi i palëve me qëllim që personit të akuzuar të mund t'i realizohet një mbrojtje sa më efektive edhe në këtë shkallë gjykimi".³⁶⁰

Më tej, lidhur me këtë parim, GJK, në mënyrë konsistente ka mbajtur e ka analizuar atë në koneksitet me të drejta të tjera të rëndësishme me qëllim garantimin në tërësi edhe të elementëve të tjerë të procesit të rregullt ligjor. "...Në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, përbëjnë në vetvete elementët më të qenësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt ligjor. Për respektimin e këtyre elementeve, gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave, rëndësi të veçantë paraqet sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht. Në kuptim të kontrollit kushtetues të procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, Gjykata rithekson se pranimi i provave bëhet si rregull nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë

³⁵⁹ Shih vendimin e GJK nr.25/2003.

³⁶⁰ Vendim i GJK nr.16/2006.

nëse procesi në tërësinë e tij, përfshi edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt.³⁶¹ Këtë qëndrim mban edhe GJEDNJ në një sërë çështjesh paraqitur para saj.³⁶²

Gjykata, në qëndrimet e saj, ka evidentuar ... dallimin që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objektin e kontrollit për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësimit bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.³⁶³

Gjykata është shprehur edhe më parë se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Por mund të ndodhë që të dhënat për veprën, për shkak të natyrës së tyre, të ndryshojnë ose të zhduken. Për pasojë, paraqitja e tyre në gjykim bëhet e pamundur. Me qëllim që të ruhet vlera e të dhënave të konstatuara gjatë hetimeve paraprake është pranuar instituti i sigurimit të provës, në bazë të të cilit, në rastet e parashikuara me ligj, prova formohet në këtë fazë të procedimit nëpërmjet marrjes së saj nga gjykata sipas parashikimeve të KPP.

Lidhur me përdorimin e deklaratave si prova të marra në fazën para shqyrtimit gjyqësor, GJEDNJ është shprehur se përdorimi i këtyre deklaratave nuk është gjithmonë i papajtueshëm me nenet 6/3(d) dhe 6/1 të KEDNJ, me kusht që të drejtat e mbrojtjes të jenë respektuar.³⁶⁴ Kjo gjykatë mban qëndrimin se të gjitha provat normalisht duhet të prodhohen në një seancë publike, në prani të të

³⁶¹ Vendim i GJK nr.7/2005

³⁶² Vendime të GJEDNJ P.S. k. Gjermanisë, 4 shtator 2002; Balliu k. Shqipërisë, 16 qershor 2005.

³⁶³ Vendime të GJK nr.95/2001, nr.7/2005.

³⁶⁴ Shih çështjen *Windisch kundër Austrisë*, 27 shtator 1990, cituar në vendimin e GJK.

akuzuarit me qëllim që të paraqiten argumentet e kundërta. Por ka përjashtime nga ky parim, përjashtime të cilat nuk duhet të vijnë në kundërshtim me të drejtën e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, i akuzuari duhet të ketë një mundësi të përshtatshme dhe të vërtetë për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, ose kur ai bën deklarin e tij ose në një fazë të mëvonshme. Parimet e procesit të rregullt kërkojnë që interesat e mbrojtjes të balancohen me ato të dëshmitarëve ose viktimave të thirrur për të dëshmuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për jetën, lirinë ose sigurinë e një personi.³⁶⁵

Bazuar në materialet e paraqitura nga kërkuesi, si edhe nga dosja gjyqësore, Gjykata vëren se në kohën e sigurimit të provës i pandehur ishte A.F.Sh dhe jo Th.N.Sh, dhe për rrjedhojë, as ky i fundit, as mbrojtësi i tij, nuk mund të ishin të pranishëm në seancën gjyqësore për sigurimin e provës. I pranishëm në seancën e sigurimit të provës ishte mbrojtësi i caktuar kryesisht për A.Sh. Vendimi për sigurimin e provës së dëshmisë së shtetasës L.A. kundër kërkuesit, nuk u apelua brenda afatit në gjykatën e apelit dhe rrjedhimisht ai mori formë të prerë. Në seancat gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Fier dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, mbrojtësi i kërkuesit pati mundësi që të paraqesë kundërshtimet mbi thëniet e deklaruara nga dëshmitarja, si edhe të parashtrojë kërkesa për realizimin e mbrojtjes së të pandehurit, gjatë gjithë procesit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Gjykatat kanë dëgjuar edhe dëshmitarët e kërkuar nga avokati i kërkuesit dhe kanë vlerësuar, në cilësinë e provës, shkresa të ndryshme të paraqitura nga prokuroria. Kërkuesi ka patur mundësi që të bënte deklarin e tij para gjykatave të zakonshme, ndonëse ka zgjedhur që këtë gjë ta bënte përmes avokatit mbrojtës, pasi gjykimi është kryer në mungesë të kërkuesit. Sipas kërkesës së avokatit mbrojtës të kërkuesit, përveç dëshmisë së administruar në seancën gjyqësore për sigurimin e provës, gjykatat kanë vlerësuar dëshmitë e shtetasve F.A., P.G., M.A. dhe Xh.A. të kërkuar edhe nga mbrojtja, si dhe disa dokumente shkresore, të cilat, sipas gjykatave të zakonshme, mbështesin deklarinet e bëra nga L.A. dhe u kanë krijuar gjykatave bindjen e brendshme që deklarinet e L.A. ishin të vërteta. Gjykata

³⁶⁵ Shih çështjen *Doorson kundër Hollandës*, 26 mars 1996, cituar në vendimin e GJK.

çmon se kërkesa për ballafaqim nuk është pranuar nga gjykatat e zakonshme, pasi ato nuk janë bindur në nevojën e një ballafaqimi të tillë, veçanërisht duke patur parasysh që një nga të akuzuarit në proces ishte babai i shtetasës L.A. dhe ballafaqimi kërkohej, ndër të tjera, me nënën dhe motrën e saj. Gjykatat e mësipërme megjithatë, personat me të cilët mbrojtja kërkonte të bënte ballafaqimin, i kanë thirrur si dëshmitarë dhe thëniet e tyre janë regjistruar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

*Për sa më sipër, Gjykata çmon, se në tërësi, procesi ndaj kërkuesit nuk ka qenë i parregullt. Kërkuesi ka patur një mundësi të përshtatshme dhe të vërtetë, që gjatë deklarimit të tij ose gjatë gjithë fazave të procesit gjyqësor të kundërshtonte akuzën kundër tij, të ngritur nga prokurori i çështjes”.*³⁶⁶

4.7.2 Kontradiktoriteti në çështjet civile

Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit ka gjetur gjerësisht shprehje në jurisprudencën e GJK jo vetëm në çështjet penale por edhe në çështjet civile. Kështu ajo ka theksuar se “...parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e GJEDNJ kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim me qëllim që t’i krijohen mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur.

...Nga përmbajtja e dispozitave të KPC rezulton gjithashtu se gjykata verifikon fillimisht nëse janë rastet e rishikimit, nëse është bërë nga ata që e kanë këtë drejtë, nëse është në tërësi e mbështetur në ligj e në prova e nëse janë kriteret ligjore për shqyrtim. Kjo e fundit, pra dhoma e këshillimit, është një organizëm që nuk mund të shërbejë për prishjen e vendimeve të formës së prerë, aq më tepër kur ai i ka kaluar të gjitha shkallët e shqyrtimit, por vetëm për seleksionimin e tyre d.m.th., për verifikimin nëse janë paraqitur

³⁶⁶ Vendim i GJK nr.19/2008.

shkaqe për kalimin në seancë. Nëse kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim. Por nëse këto kritere plotësohen, gjykata nuk mund të vendosë drejtpërdrejt prishjen e vendimit pa respektuar parimet kushtetuese të dëgjimit të palëve e të barazisë së mjeteve... Në çështjen objekt shqyrtimi është vendosur prishja e vendimit të formës së prerë, nëpërmjet kërkesës për rishikim, që është një mjet i jashtëzakonshëm. Megjithëse shqyrtimi është bërë në seancë gjyqësore, ku janë vlerësuar dobishmëria dhe rëndësia e provave të paraqitura nga njëra palë, nuk është njoftuar pala tjetër të marrë pjesë në gjykim dhe të japë mendimet e veta për këto prova dhe për ndikimin që ato duhet të kenë në cenimin e vendimit të formës së prerë. Në këtë mënyrë prishja e vendimit të formës së prerë është bërë duke venë në situatë krejtësisht të pafavorshme palën në favor të së cilës ishte dhënë vendimi dhe duke cenuar ekuilibrin që duhet të kenë ato në proces.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr. 17, datë 18.07.2005, duke iu referuar praktikës së GJEDNJ, ka pranuar se e drejta për një proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra. Ajo ka pranuar gjithashtu se duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjeve në rishikim që ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre, ky vlerësim duhet të bëhet mbi bazën e parimit të barazisë së armëve apo kontradiktoritetit në gjykim. Pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat e interpretimin e ligjit në çështjen konkrete, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës e neni 6 i KEDNJ, sepse kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e secilës palë. Jo vetëm kaq por krijimi i kushteve për të bërë një mbrojtje efektive është jo vetëm në interes të palëve, por edhe në interes të drejtësisë.

Në çështjen në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka shqyrtuar kërkesën me argumentet dhe provat e paraqitura nga një palë dhe ashtu siç pranojnë vetë kërkuuesit është

bërë shqyrtimi i kërkesës për rishikim mbi bazën e një dokumenti - provë e re. Por vendimi objekt shqyrtimi ka cenuar një gjendje juridike të krijuar dhe të drejta të fituara të cilat duhet të respektohen si nga shteti ashtu edhe nga individët. Këto të drejta nuk mund të mohohen dhe as të vihen në dyshim me arsyetimin se është paraqitur një provë e re në qoftë se nuk respektohen parimet kushtetuese ndërmjet të cilave është edhe dëgjimi i pretendimeve të palës tjetër për provat e paraqitura. Çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të procesit të rregullt përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Prandaj, respektimi i parimit kushtetues të procesit të rregullt nuk mund të pranohet se fillon vetëm në rigjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit. Përkundrazi, ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku kërkohet të cenohen të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre".³⁶⁷

Edhe njoftimin lidhur me zhvillimin periodik të senacave gjyqësore GJK e ka konsideruar si element të rëndësishëm pa të cilin nuk mund të garantohet kontradiktoriteti në gjykimin civil. Në një rast, ajo ka theksuar se "nga ky procesverbal konfirmohet se kërkuesit nuk i është bërë njoftimi i drejtpërdrejtë as për seancën e gjykimit të datës 21.05.2003, në të cilën është përfunduar shqyrtimi i çështjes. Kështu, gjykata e apelit nuk ka përmbushur detyrimet e saj që rrjedhin nga KPC, dhe ka cenuar të drejtat e kërkuesit në atë proces. Ajo ka dëgjuar vetëm pretendimet e njëjës palë, ndërsa kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të bënte mbrojtjen e tij para gjykatës duke paraqitur provat e argumentet e veta rreth objektit të kërkesës si dhe rreth pretendimeve të palëve të tjera në gjykim. Shkeljet ligjore të Gjykatës së Apelit Korçë, të cilat përbëjnë njëkohësisht edhe cenim të parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës, nuk u korrigjuan as nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Ky i fundit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të ngritur nga kërkuesi në rekurs për mosnjoftimin e tij nga gjykata e apelit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë...GJEDNJ,

³⁶⁷ Vendim i GJK nr.8/2006. Ky vendim përveç standartit të barazisë së armëve sjell në vëmendje edhe një standart tjetër atë të sigurisë juridike për paprekshmërin e të drejtave të fituara.

në një çështje të saj shprehet se "Prania e palëve në një proces civil ... është karakteristikë e rëndësishme e garancive të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ. Në lidhje me çështjet civile, gjykata ka vendosur se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur probleme të një natyre faktike ose personale janë vënë në lojë...".³⁶⁸

...Neni 42 i Kushtetutës, ashtu si edhe neni 6 i KEDNJ, nuk e kushtëzojnë plotësimin e standardeve për një proces të rregullt nga gjykatat me paraqitjen e detyrueshme të palëve në gjykim apo me nivelin e realizimit të mbrojtjes nga ana e këtyre të fundit. Në rastin në shqyrtim, pranohet që kërkuesi ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të gjykatës së apelit, ku ka parashtruar shkaqet për prishjen e atij vendimi. Nga këto shkaqe e pretendime ai nuk është tërhequr edhe pasi ia ka paraqitur me shkrim Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit ka në kompetencë të zhvillojë gjykimin e çështjes edhe pa praninë e palëve duke respektuar rregullat procedurale dhe duke u bazuar në shkaqet e parashtruara në rekurs. Mosparaqitja e palëve në seancë në Gjykatën e Lartë nuk mund të justifikojë shkeljet kushtetuese të bëra në gjykatën e apelit, aq më tepër që kjo e fundit, ndryshe nga Gjykata e Lartë, ka në kompetencë të administrojë e të vlerësojë drejtpërdrejt provat".³⁶⁹

E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është konsideruar vazhdimisht si pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrrojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër. Sipas GJK, "...Gjykata e Lartë [ka] detyrimin ... për t'ia njoftuar kërkesën për rishikim palës tjetër pavarësisht nga fakti se çështja do të shqyrtohet në dhomën e këshillimit apo do të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore...Në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar të parashtruara në kërkesën e vet dhe pa dëgjuar pretendimet e kërkuesit lidhur me dobishmërinë e rëndësinë e provave të paraqitura për çështjen në gjykim si dhe për

³⁶⁸ Çështja *Krombach k. Francës*, 3 shkurt 2001, cituar në vendimin e GJK.

³⁶⁹ Vendim i GJK nr.19/2006.

*mundësinë e marrjes e paraqitjes së tyre në gjykimet e zhvilluara. Në këtë mënyrë, ai është vënë në pozitë krejtësisht të pafavorshme në raport me palën tjetër”.*³⁷⁰

Ajo duke iu referuar akteve të brendshme dhe praktikës së GJEDNJ ka ritheksuar se "...Kushtetuta dhe KEDNJ kanë përcaktuar standarte të qarta për pjesëmarrjen në gjykim dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor në mënyrë të atillë që t'u garantohet të gjitha palëve mbrojtje efektive në të gjitha shkallët e gjykimit, prandaj prekja e tyre përbën shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Nga përmbajtja e dispozitave të KPC që kanë të bëjnë me rekursin dhe rishikimin del se shqyrtimi në dhomën e këshillimit lidhet me mospranimin e tyre për t'u shqyrtuar nga gjykata, sepse nuk përmbushin kriteret ligjore. Në të kundërtën, kur këto kriterë plotësohen, nuk mund të vendoset pranimi i kërkesës për rishikim apo rekursit jashtë seancës gjyqësore dhe pa praninë e palëve. Aq më tepër pranimi i rishikimit pa kaluar çështjen në seancë për shkak të efekteve të mëdha që sjell si mjet i jashtëzakonshëm në ndryshim nga rekursi që është formë e zakonshme ankimi, e bën edhe më të qartë prekjen e standarteve dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Rifillimi i procesit gjyqësor nga e para, pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë e prerë e vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për të shprehur e mbrojtur pretendimet e tyre, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt në kuptim të Kushtetutës dhe KEDNJ. Çdo provë e paraqitur nga pala që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi palës tjetër për të shprehur pretendimet e saj, sepse ajo nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta që i është njohur me vendim të formës së prerë të gjykatave. Në raste të tilla, standarti minimal që duhet t'i garantohet palës respektive është shansi i barabartë për të qenë e pranishme në një proces ku do të shqyrtohet pozita e saj juridike.

...Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 6/1 të Konventës, karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore mbron palët

³⁷⁰ Vendim i GJK nr.5/2007.

ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike.³⁷¹ ... Barazia në mjete dhe e drejta për t'u vënë në dijeni për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare përbëjnë aspekte të procesit të rregullt. Kjo nënkupton që çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e vet dhe asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve.³⁷² E drejta për proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët në një seancë civile, apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra.³⁷³

...Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka bërë të qartë dallimin midis shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe rasteve kur shqyrtimi duhet të bëhet detyrimisht në seancë, ndryshe preken standartet e procesit të rregullt. Në vendimin e saj nr.6, datë 26.02.2003, duke iu referuar çështjes konkrete në zbatim të dispozitave procedurale që parashikojnë ushtrimin e rekursit dhe kërkesës për rishikim, thuhet se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë, kur ajo është bërë jashtë kritereve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Nëpërmjet arsyetimit të këtij vendimi bëhet mirë dallimi mes kompetencave të dhomës së këshillimit, kur kërkesa nuk përmban kritere ose shkaqe ligjore dhe në të kundërt, kur shkaqet ligjore ekzistojnë dhe provohen si të tilla nga gjykata, shqyrtimi i çështjes nuk mund të bëhet më në dhomën e këshillimit, por në seancë gjyqësore, përndryshe një shqyrtim i tillë është antikushtetues. Në çështjen në shqyrtim, ashtu siç pretendohet edhe nga kërkuesit, Gjykata Kushtetuese konstaton, se nga ana e

³⁷¹ Çështja Axen k. Republikës Federale të Gjermanisë, 8 dhjetor 1983, cituar në vendimin e GJK.

³⁷² Shih çështjen Dehaes dhe Giples k. Belgjikës, 24 shkurt 1997, cituar në vendimin e GJK.

³⁷³ Çështja Ruiz-Mateos k. Spanjës, 23 qershor 1993, cituar në vendimin e GJK.

Gjykatës së Lartë është pranuar kërkesa për rishikim të vendimit duke u vlerësuar si të reja provat e paraqitura dhe, në kundërshtim me të gjitha standartet e procesit të rregullt ligjor, çështja është zgjidhur në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë procesi i zhvilluar është i parregullt gjë që e bën vendimin antikushtetues".³⁷⁴

Në po këtë linjë ka ecur GJK edhe lidhur me vlerësimin e njëjtë që duhet t'u bëjë gjykata provave dhe fakteve të paraqitura nga të gjitha palët në proces dhe pranimin ose jo të tyre vetëm pasi t'i ketë shqyrtuar dhe arsyetuar mjaftueshmërisht pranimin ose mospranimin e tyre, sipas rastit. Sipas saj, "Barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj) në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e tyre gjykatat e zakonshme i kanë bazuar vetëm në provat e palës paditëse dhe nga ana tjetër nuk kanë administruar e vlerësuar edhe provat e tij. Në mënyrë të veçantë, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat e zakonshme nuk kanë vlerësuar si provë vendimin nr. 5972, datë 18.09.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili, sipas kërkuesit, e njeh atë si pronar mbi truallin dhe lokalin.

...Gjykata Kushtetuese thekson se marrja dhe vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Megjithatë, kjo Gjykatë ka detyrimin të vlerësojë nëse procesi gjyqësor i zhvilluar, në tërësinë e tij, përmbush kërkesat e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Në mënyrë të veçantë, neni 42 i Kushtetutës i vë detyrë gjykatës së zakonshme të bëjë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin nëse këto prova janë të rëndësishme për vendimin e saj. Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjykatat e zakonshme nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në vendimet e tyre. Në mënyrë të veçantë, gjykatat nuk kanë administruar si provë dhe nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre

³⁷⁴ Vendim i GJK nr.17/2005.

*nëse vendimi gjyqësor i pretenduar nga ana e kërkuarit, ka ndonjë vlerë ligjore (efekt) në gjykimin e padisë për deklarimin e falsitetit të dokumenteve. Ky vendim është paraqitur si provë kryesore në këtë gjykim. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se në këtë rast është shkelur parimi i barazisë së mundësive në një proces civil”.*³⁷⁵

Gjykata nuk e ka konsideruar cenim të parimit të barazisë së armëve kur një palë ka marrë pjesë si palë e tretë dhe jo si i paditur në gjykim. Kërkuari e ka kundërshtuar këtë proces duke e lidhur pretendimin me mosformimin siç duhet të ndërhyjë. GJK në këtë rast i është referuar fakteve nëse pala ka gëzuar të gjitha të drejtat procedurale që i takojnë për të provuar nëse është respektuar ose jo parimi i barazisë së palëve në gjykim. Roli dhe pozita e palëve në proces është një aspekt që kontrollohet nga gjykata e zakonshme gjatë gjyimit.³⁷⁶ Gjithashtu, GJK nuk e ka konsideruar si të cenuar parimin e barazisë së palëve dhe kontradiktoritetit në gjykim kur në gjykim nuk janë thirrur personat që duhej të ishin thirrur sipas kërkuarit. Në këtë rast, GJK ka argumentuar se kërkuari nuk mund të ngrejë pretendime për personat e tjerë në gjykim por vetëm kontrollon pretendime që prekin atë në mënyrë të drejtpërdrejt. Sipas GJK, ajo kontrollin vetëm nëse kërkuari gjatë procesit që kundërshtohet ka patur ose jo mundësi të ushtrojë të drejtat e tij dhe nuk legjitimohet të kërkojë realizimin e të drejtave të të tjerëve.³⁷⁷

4.8 E drejta e ankimit

E drejta e ankimit garantohej nga neni 43 i Kushtetutës. Ajo përfshin ankimin ndaj akteve të administratës publike si dhe vendimet gjyqësore. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale

³⁷⁵ Vendim i GJK nr.23/2007.

³⁷⁶ Vendim i GJK nr.1/2006.

³⁷⁷ Vendim i GJK nr.13/2006. Për më tepër shih edhe nënçështjen lidhur me legjitimitimin e subjekteve para GJK.

konkrete. Në këtë mënyrë, çdo dispozitë ligjore që nuk respekton përmbajtjen e nenit 43 të Kushtetutës, duke sjellë si pasojë cenimin e një të drejte themelore të individit, konsiderohet si e papajtueshme me Kushtetutën dhe si e tillë duhet shfuqizuar. E drejta e ankimit e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim.³⁷⁸ Praktika e GJK shqiptare është mjaft e pasur lidhur me elementët përbërës të së drejtës së ankimit. Ajo që në vitet e para të funksionimit të saj është ballafaquar me veprime të tilla që i mohonin ose cenonin pjesërisht individit të drejtën e ankimit.³⁷⁹

E drejta e individëve për t'u ankuar në gjykatë kundër akteve e veprimeve administrative ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. Kjo është një garanci e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve dhe një ndër parimet më të rëndësishme kushtetuese siç është e drejta e çdo individi që çështja e tij të dëgjohet para një gjykate, siç përcaktohet në nenin 42 të Kushtetutës. GJK, në shqyrtimin e çështjeve të tilla i është përmbajtur kritereve kushtetuese e ligjore si dhe praktikës së saj që ankimi në gjykatë ndaj akteve e veprimeve administrative të kondicionohet edhe nga respektimi i kërkesave ligjore nga palët. Kështu, ajo ka deklaruar se *"...referimi i gabuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për datën e paraqitjes së padisë (data e depozitimit të padisë është ngatërruar me datën e caktimit të gjyqtarit të çështjes nga kryetari i gjykatës-shën imi) e ka çuar atë në dhënien e një vendimi antikushtetues, duke i mohuar kërkuetit një nga të drejtat themelore kushtetuese, atë të ankimit në gjykatë kundër një akti administrativ dhe për rrjedhojë, ka cënuar të drejtën për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës...Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ishte i detyruar*

³⁷⁸ Vendim i GJK nr.5/2009.

³⁷⁹ Vendimi i GJK nr.8/1994 lidhur me të drejtën e ankimit të gjyqtarit të shkarkuar nga detyra.

ta shqyrtonte çështjen dhe të shprehej në lidhje me pretendimet e parashtruara në rekurs. Duke e konsideruar padrejtësisht paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor, ky kolegji ka zhvilluar një proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese thekson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një qëndrim të gabuar e të padrejtë si rezultat i të cilit mohohet ankimi në gjykatë ndaj një vendimi administrativ. Sigurisht që ankimi në gjykatë ndaj një akti administrativ nuk është i pakufizuar dhe një nga kushtet ligjore që duhet respektuar është edhe afati i paraqitjes së padisë. Në rast se ajo paraqitet jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, gjykatat nuk mund të investohen për shqyrtimin e çështjes. Në lidhje me llogaritjen e afateve gjykata është e detyruar të zbatojë kriteret ligjore dhe jo të caktojë kritere të tjera duke shkelur të drejtat e palëve. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke injoruar faktet reale, ka marrë një vendim të paligjshëm e arbitrar dhe ka shkelur të drejtën kushtetuese të palës për akses në gjykatë. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera...”.³⁸⁰

Sipas një qëndrimi të GJEDNJ, nuk kemi të bëjmë me cenimin e parimit të procesit të rregullt nëse gjykata më e lartë që gjykon çështjen (në kasacion ose rishikim) pretendimeve ligjore të ngritura nga njëra palë nuk i kundërvendos detyrimisht pretendimet e palës tjetër.³⁸¹ Edhe fakti i marrjes së një vendimi të ri (të mëvonshëm) nga po e njëjta gjykatë që ka vendosur edhe më parë për të njëjtën çështje nuk do të thotë se kemi të bëjmë me një gjykatë që nuk respekton parimin e paanshmërisë. GJEDNJ, në çështjen *Ringeisen k. Austrisë*, ka arritur në përfundimin se nga parimi i paanshmërisë nuk rrjedh përfundimi se çështja që rigjykohet për së dyti nga e njëjta instancë gjyqësore duhet të përbëhet nga gjyqtarë të ndryshëm dhe të ketë përfundim

³⁸⁰ Vendim i GJK nr.4/2005.

³⁸¹ Nuk bëhet fjalë për parimin e kontradiktoritetit por për faktin se gjykata nuk është e detyruar patjetër t'i referojë në vendim kundraprovat e paraqitura nga të gjitha palët në proces. Kjo mbetet në çmim të gjykatës. Shih për më tepër *Frowein/Peukert*, EMRK-Kommentar (1996), fq.225.

të njëjtë.³⁸² Ka qenë qëndrim i përsëritur i GJEDNJ se çështja e vlerësimit dhe e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme varet nga vetë sistemi juridik i çdo vendi anëtar dhe nuk përbën objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë, përveç rasteve kur shtrohen pretendime për mosrespektimin e garancive procedurale që rrjedhin nga neni 6 i KEDNJ.

Edhe GJKF gjermane ka mbajtur vazhdimisht të njëjtin qëndrim se nuk ka ndonjë detyrim kushtetues për të siguruar ekzistencën e instancave të ndryshme të ankimit, por nëse ato parashikohen, atëherë duhet të jenë efektive. Me anë të mjetit të ankimit të rekursit mund të shtrohen për zgjidhje çënime individuale ose pretendime që prekin një rreth të gjerë personash. Rasti i fundit është kur gjykata që shqyrton rekursin kërkon të saktësojë dhe të unifikojë një qëndrim të vetëm nisur nga ekzistenca e këndvështrimeve të ndryshme të gjykatave të zakonshme për të njëjtin problem. Pikërisht këtë qëllim ka patur parasysh edhe ligjvënësi kur ka parashikuar të drejtën e Kolegjeve të Bashkuara për të dhënë vendime unifikuese. Garancia juridike që i është mundësuar individit përfshin mbrojtjen kundër cenimeve të pretenduara nëpërmjet një gjykate më të ulët. Kështu që kjo mundësi duhet përdorur për të sqaruar çështjen nëse ka ndodhur vërtetë një cenim i tillë apo jo. Sqarimi i kësaj çështjeje, pra përgjigja e pyetjes nëse ndodhemi para një cenimi apo jo, është kompetencë dhe detyrë funksionale e gjykatave të zakonshme.³⁸³

Sa i përket parimit të parashikueshmërisë dhe qartësisë së sistemit të së drejtës për të shfrytëzuar mjetet e ankimit, doktrina kushtetuese mban linjën se mjafton që qytetari të ketë mundësinë e njohjes me mjetet e mundshme të ankimit dhe kushtet që duhet të plotësojë për shfrytëzimin e tyre në interes të tij. Nisur nga hapësira e vendimmarrjes që i njihet ligjvënësit nga Kushtetuta në hartimin e akteve normative, nuk mund të arrihet në përfundimin se duke garantuar një mjet ankimi, konkretisht rekursin, ligjvënësi duhet të përcaktojë saktësisht të gjitha rastet se kur duhet pranuar dhe si duhet vlerësuar kërkesa për rekurs. Kjo mbetet çështje e pushtetit

³⁸² *Frowein/Peukert, EMRK-Kommentar (1996), fq.256.*

³⁸³ Vendim i GJKF gjermane 1 BvR 864/2003.

gjyqësor. Kushtetuta garanton të drejtën e ankimit duke mbajtur parasysh dhe sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e sistemit juridik, por prej këtyre parimeve nuk mund të rrjedhë përfundimi se gjykatat nuk kanë të drejtë të marrin vendime të ndryshme. Parimi i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i respektuar, nëse individit i sigurohet minimalisht ose vetëm një mundësi ankimi efektiv, kështu që nuk mund të ngrihet pretendimi se gjykatat e tjera duhet të ndjekin të njëjtën linjë gjykimi dhe vlerësimi.³⁸⁴ Garancia e mjeteve të ndryshme të ankimit ka për qëllim riparimin e një shkelje ligjore nga një instancë më e lartë. Më tej kjo garanci nuk shkon. Nuk mund të ngrihet në nivel kushtetues pretendimi se vendimi i gjykatës rishikuese (rishqyruese) duhet patjetër t'i nënshtrohet një kontrolli tjetër për të parë nëse ka respektuar apo jo siç duhet normën ligjore, ose ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës më të lartë apo jo. Në të mirë të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së sistemit ligjor, gjykatat duhet të kujdesen që të zbatohet siç duhet kuadri ligjor dhe kushtetues.

Në këtë aspekt duhet trajtuar edhe një parim tjetër i rëndësishëm, ai i pavarësisë së gjyqtarit në vendimmarrje. Ky parim i rëndësishëm ka për qëllim të sigurojë që gjykatat i mbështesin vendimet e tyre në ligj. Garancitë procedurale kanë për qëllim që të sigurojnë mbështetjen e vendimeve gjyqësore të çdo instance në kritere objektive dhe prova të mjaftueshme që merren mbi bazën e vlerësimit të vetë gjyqtarit. Në rast se ndodhemi para një vendimi gjyqësor të mbështetur mbi shkelje procedurale, i cili dhe pas apelimit nuk riparohet nga gjykata më e lartë, atëherë detyrimisht do të ndërmerret rishikimi ose rishqyrtimi nga një instancë më e lartë, e cila ka të drejtë dhe detyrë të riparojë shkeljet e ndodhura. Kjo zgjidhje i shërben parimit të sigurisë juridike, parim i cili, si një nga elementet e tij, ka edhe moskrijimin e kushteve të tilla që mund ta bëjnë të vështirë përfundimin e procesit gjyqësor ose të krijojë atë që ndryshe njihet si sistem drejtësie pa fund.³⁸⁵

³⁸⁴ Vendim i GjKF gjermane 1 PbvU 30/2003.

³⁸⁵ Vendime të GjKF gjermane BVerfGE 49, 148 <164>; BVerfGE 87, 48 <65>.

GJK shqiptare vazhdimisht ka theksuar se e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës duhet parë si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale me qëllim kundërshtimin e vendimit të dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë. Kjo garanci është konsideruar nga GJK si një tejkalim pozitiv krahasuar me standartet që ofron në këtë drejtim KEDNJ, e cila në nenin 6 të saj nuk parashikon të drejtën për të pretenduar sa më shumë mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, e për pasojë, as detyrimin e shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (Gjykata të Larta ose Kasacioni). Prandaj, sipas jurisprudencës së Strasburgut, nuk mund të konsiderohet cenim i këtij parimi, nëse ligjvënësi i shteteve palë në Konventë do të zëvendësonte ose shfuqizonte një mjet ankimi ekzistues, të parashikuar në legjisllacionin e tij.³⁸⁶ Megjithatë, në nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës, vetëm për çështjet penale, është parashikuar e drejta e çdo personi të dënuar për kryerjen e një veprë penale që të paraqesë të paktën një herë për shqyrtim në një gjykatë më të lartë çështjen e deklaramit të fajësisë ose të masës së dënimit të tij. Por, sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të Protokollit 7 të Konventës, edhe në këto raste shtetet palë kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale ose rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, etj. Madje edhe në rastet kur parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit në çështjet penale, shtetet palë janë të lira ta vlerësojnë lejimin ose jo të të ankimit për çështje të faktit dhe të ligjit ose ta kufizojnë vetëm për çështje të ligjit.³⁸⁷ Pavarësisht kësaj, kur e drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor parashikohet nga Kushtetuta apo legjisllacioni i brendshëm i shteteve palë në këtë Konventë, proceset që do të zhvillohen në gjykatat e apelit ose kasacionit duhet të respektojnë me rigorozitet garancitë themelore të këtij neni.³⁸⁸ Për aq sa është e mundur, këto kërkesa apo standarte duhet të zbatohen edhe në gjykimet që zhvillojnë gjykatat kushtetuese të këtyre shteteve.³⁸⁹ Në

³⁸⁶ Shih *Frowein/Peukert*, EMRK-Komentar (1996), fq.209.

³⁸⁷ Shih çështjen *Krombach k. Francës*, 13 shkurt 2001.

³⁸⁸ Shih *Monnell & Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987.

³⁸⁹ Shih *Frowein/Peukert*, cituar më sipër.

këtë kuadër dhe brenda këtyre standarteve duhet të shihet edhe e drejta e ankimit. Për këto arsye, kufizimet e mundshme që mund t'i bëhen njohjes dhe ushtrimit të të drejtës së ankimit nga legjislati i brendshëm në analogji me të drejtën e aksesit në gjykatë që garanton paragrafi i parë i nenit 6 të KEDNJ duhet të plotësojnë dy kushte themelore: të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të mos çenojnë thelbin e kësaj të drejte.³⁹⁰

Përveç sa më sipër, si për çdo të drejtë tjetër të garantuar nga Konventa, sipas jurisprudencës së GJEDNJ, është më se e domosdoshme që për çdo realitet konkret legjitimimi ose jo i ndërhyrjes duhet të vlerësohet lidhur ngushtë me parimin e proporcionalitetit apo domosdoshmërisë së këtij kufizimi në një shoqëri demokratike. GJK, në praktikën e saj, këto kritere i ka ballafaquar, para së gjithash, me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke qenë gjithnjë në përpjestim me gjendjen që i ka diktuar. Ato nuk mund të çenojnë thelbin e së drejtës dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Kështu, në një vendim të saj, GJK ka theksuar se *"...përfundimisht nga rregulli i përgjithshëm procedural i gjykimit të çështjeve gjyqësore, për herë të parë në gjykatën e shkallës së parë ligjvënësi ka parashikuar që çështje të kësaj natyre, ashtu si edhe disa çështje të tjera, të gjykohen direkt në gjykatën e apelit. Pra, në këto raste juridiksioni i saj është fillestar, prandaj, për aq sa është e mundur, gjykata e apelit zbaton dispozitat respektive procedurale të gjykimit në shkallë të parë. Qëllimi kryesor i këtij përfundimi është shkurtimi i afateve për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke garantuar njëkohësisht edhe një gjykim fillestar më të kualifikuar e më profesional. Është në interes të administrimit të drejtësisë dhe të funksionimit normal të mekanizmave shtetërore që rastet e këtij lloji, mjaft të kufizuara në numër dhe relativisht të lehta për t'u zgjidhur, të trajtohen me përparësi dhe vëmendje të veçantë. Ky përfundim është në përputhje edhe me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, në të cilët, ndër të tjera, kërkohet zhvillimi i gjykimit brenda një afati sa më të arsyeshëm.*

³⁹⁰ Shih *Haser k. Zvicrës*, 27 prill 2000.

...Në rastin konkret, në përputhje me nenet 29 dhe 30 të ligjit nr.9102, datë 10.07.2003, kërkuesi është njohur me dokumentacionin e procedimit, është dëgjuar në Këshillin e Prokurorisë, ku i është dhënë mundësia të mbrohet duke paraqitur argumente dhe prova që ka çmuar të dobishme dhe të nevojshme. Më pas, sipas ligjit, ai i është drejtuar gjykatës së apelit, e cila e ka gjykuar çështjen dhe ka dhënë vendimin e saj. Nga dosja gjyqësore dhe nga natyra e pretendimeve të mëvonshme të kërkuesit në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë duket qartë se në këtë gjykatë janë respektuar të gjitha kërkesat themelore të procesit të rregullt ligjor sipas standarteve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ. Procesi gjyqësor në gjykatën e apelit ka qenë me gojë dhe publik, kërkuesi është mbrojtur vetë dhe me avokat, janë respektuar parimet e barazisë dhe të kontradiktoritetit, vendimi është marrë në bazë të administrimit dhe vlerësimit të provave që janë konsideruar si të nevojshme nga gjykata etj. Kërkuesi nuk ka patur asnjë pretendim apo kundërshtim lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e gjykatës në këtë gjykim.

Më pas, kërkuesi ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Lartë, duke iu drejtuar asaj me anë të rekursit, si një nga tre mjetet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatave, të parashikuara në nenin 442 të KPC... Në këtë drejtim duhet patur parasysh edhe karakteri i veçantë i shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë. Ajo nuk përsërit gjykimet e zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë apo atë të apelit, pra nuk e trajton çështjen edhe nga pikëpamja e faktit, por kufizohet kryesisht në çështjet ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga këto gjykata. Gjykata e Lartë kontrollon nëse në gjykimet e mëparshme janë zbatuar ose jo kërkesat e ligjit. Pra, ankimi (rekursi) në Gjykatën e Lartë faktikisht kufizohet në çështje të ligjit. Sipas KPC, kjo do të thotë që kundërshtimet e paraqitura në rekurs duhet të shqyrtohen fillimisht nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve dhe nëse ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon ligji (neni 472 i KPC), në bazë të nenit 480 të KPC, ky kolegji vendos mospranimin e tij, ashtu siç është vepruar edhe për rastin në gjykim.

...Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kjo mënyrë e shqyrtimit të çështjes dhe moskalimi i saj në seancë me anë të

*vendimit të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk përbën shkelle të së drejtës kushtetuese të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor. Kjo e drejtë praktikisht i është kufizuar në mënyrë të arsyeshme kërkuesit por pa u prekur në thelbin e saj. Në këndvështrimin formalo-juridik, kërkuesi e ka ushtruar atë në një masë të caktuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ai i ka paraqitur pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Këto pretendime janë shqyrtuar nga kolegji civil i kësaj gjykate, në dhomën e këshillimit, dhe mbi këtë bazë është vendosur moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Një qëndrim i tillë është në përputhje të plotë edhe me KEDNJ dhe me jurisprudencën e GJEDNJ. Kjo jo vetëm në këndvështrim të hapësirës së gjerë të vlerësimit që i lihet shteteve për të kufizuar të drejtën e ankimit, siç është trajtuar më lart, por edhe të mundësisë së mosshqyrtimit të këtij ankimi në seancë publike. GJEDNJ në një sërë rastesh ka theksuar, ndër të tjera, se moszhvillimi i një procesi publik në shkallët më të larta të gjykimit mund të përliqet nga veçantia e procedurave të veçanta të çështjes, por me kusht që procesi i zhvilluar në shkallën e parë të ketë qenë publik. Për këtë arsye edhe procesi që mund të zhvillohet në këto gjykata pa praninë e palëve dhe në bazë të një ankimi vetëm për çështje të zbatimit të ligjit konsiderohet si në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 6 të Konventës”.*³⁹¹

E drejta për të paraqitur ankim në GJL është një çështje që ka preokupuar mjaft GJK në vite. Mënyrat e gjykimit të GJL, në dhomë këshillimi ose në Kolegj, (mos)arsyetimi ose arsyetimi i pamjaftueshëm apo kontradiktor i vendimeve gjyqësore kanë qenë shpesh objekt gjykimi i GJK. Duke iu referuar në tërësi praktikës së GJK vihet re në ndonjë rast edhe luhajtje në praktikën e ndjekur. P.sh në vendime të hershme të saj është mbajtur qëndrimi se "*rekursi kishte shkaqe ligjore dhe ai duhej të ishte pranuar për gjykim*",³⁹² ndërkohë që më vonë është pranuar se "*shkaqet e pranimi ose jo të rekursit janë kompetencë e gjykatës që e shqyrton atë*".³⁹³ Në rastin e parë GJK ka deklaruar se "*Sipas nenit 433 të KPP është kompetencë*

³⁹¹ Vendim i GJK nr.14/2005.

³⁹² Vendime të GJK nr.160/2001; nr.161/2001; nr.198/2001; nr.231/2002.

³⁹³ Vendim i GJK nr.210/2001.

e kolegjit penal në dhomën e këshillimit të analizojë dhe vlerësojë përputhjen me kërkesat e ligjit të shkaqeve të ngritura në rekurs. Kjo analizë që bën kolegji nuk mund t'ia heqë atij të drejtën për të vendosur mospranimin e rekursit, kur bindet se shkaqet e ngritura në rekurs lidhen me mënyrën e të vlerësuarit të provave nga gjykatat e hallkave më të ulta. Gjithashtu, kur kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë i përket atij të vlerësojë dhe të vendosë konform kërkesave të ligjit për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Këto veprime nuk janë të njëjlojta dhe nuk mund të konfondohen me rastet kur jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se kolegjet e Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit kanë mohuar ekzistencën e shkaqeve ligjore, ndërkohë që këto shkaqe kanë qenë prezente në dosje, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e dëgjimit dhe të mbrojtjes, të cilat lidhen pazgjidhshmërisht me të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor... Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por të krijojë dhe të konkludojë në një praktikë të saj sa më të konsoliduar, për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor".³⁹⁴

Lidhur me kompetencën për të vlerësuar shkaqet e pranimit ose jo të rekursit GJK ka çmuar se "...vlerësimi i provave dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes mbi bazën e tyre është kompetencë ekskluzive e gjykatave të sistemit gjyqësor dhe në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet për vlerësim të gabuar të provave e zgjidhje të padrejtë të çështjes... këtu nuk kemi të bëjmë me injorim të shkaqeve ligjore në rekurs siç pretendojnë kërkuesit dhe as për kryerje të funksioneve që nuk i përkasin kolegjit në dhomën e këshillimit. Është pikërisht detyrë e këtij kolegji, i cili, kur shqyrton çështjen në dhomën e këshillimit, duhet të sqarojë nëse rekursi përmban ose jo shkaqe ligjore. Çdo

³⁹⁴ Vendim i GJK nr.205/2001.

*qëndrim i kundërt do të vinte ndesh me qëllimin e ligjit për karakterin parandalues të dhomës së këshillimit, për të kaluar në seancë vetëm ato çështje kur me të vërtetë në rekurs janë ngritur probleme ligjore. Për këtë arsye, vlerësimet që bën kolegji në dhomën e këshillimit, nuk mund të përbëjnë apriori proces të parregullt ligjor dhe të passjellin kurdoherë shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe do ta kthente padrejtësisht Gjykatën Kushtetuese në një instancë më të lartë gjykimi”.*³⁹⁵

GJK është ndalur tek elaborimi i të drejtës së ankimit edhe në rastet kur individëve u është mohuar kjo e drejtë për shkak të gabimeve të administratës gjyqësore. Kështu, në një vendim ajo ka vërejtur se "... kërkuesi ka bërë rekurs kundër vendimit nr. 9, datë 28.01.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin janë konstatuar si të pavlefshëm titujt ekzekutivë për borxhin doganor të subjektit të interesuar. Rekursi i paraqitur në gjykatë mban datën e përpilimit 27.02.2005, ndërsa administrata gjyqësore, ndonëse e ka marrë rekursin, ka shënuar si datë pranimit datën 28.02.2005 që është ditë e shtunë pra, ditë pushimi ku institucionet zyrtarisht nuk funksionojnë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pranuar si ditë paraqitjeje datën 28.02.2005, e konsideron jashtë afatit dorëzimin e rekursit në gjykatë.

*... Gjykata Kushtetuese konstaton se e drejta e ankimit ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuetit për shkak që rrjedhin nga mangësitë apo gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Kështu, vetë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse ka pranuar se rekursi është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ditë pushimi, se ai mban siglën e punonjësit të gjykatës të ngarkuar me pranimin e rekurseve dhe se administrata gjyqësore nuk e ka evidentuar këtë dorëzim rekursi në regjistrat e veta, në vend që të pranonte shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore e ka refuzuar atë duke i mohuar kërkuetit të drejtën e ankimit dhe atë të aksesit në Gjykatën e Lartë”.*³⁹⁶

³⁹⁵ Vendim i GJK nr.210/2001.

³⁹⁶ Vendim i GJK nr.22/2006.

GJK i është përmbajtur këtij qëndrimi duke e elaboruar edhe më tej atë. Kështu, ajo ka shqyrtuar edhe një çështje, e cila lidhej me një dispozitë të Kodit Rrugor, sipas të cilit ndaj vendimit administrativ mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor kompetent, vendim i cili është i formës së prerë, pra pa i lënë mundësi individëve të ankoheshin në një instancë më të lartë gjyqësore. Kjo dispozitë u ankimua si antikushtetuese, pasi mohonte të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, sipas nenit 43 të Kushtetutës.³⁹⁷ GJK në këtë çështje është ndalur gjatë në trajtimin e konceptit të së drejtës së ankimit. Ajo ka ritheksuar se *"...e drejta themelore e ankimit e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit ose nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë ...të drejtën e ankimit për në instancat më të larta gjyqësore e gëzon çdo individ që është gjykuar nga gjykatat. Kjo shënon një standard më të lartë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ai i ankimit efektiv që përcaktohet në nenin 13 të Konventës, nen që pranon si respektim të standardeve të Konventës lejimin e ankimit efektiv në një instancë më të lartë pa e kushtëzuar domosdoshmërisht këtë me ankimin në instancat e tjera gjyqësore. Gjykata vlerëson se standardi i nenit 43 të Kushtetutës duhet të shihet i lidhur ngushtë me "të drejtën e apelit në çështjet penale"* përcaktuar në nenin 2 të Protokollit 7 Shtesë të kësaj Konvente.

... Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të saj, ka vënë një standard më të lartë në krahasim me KEDNJ, por kjo nuk do të thotë që e drejta e ankimit nuk mundet, në mënyrë absolute, t'iu shmanget kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kapitulli i të drejtave themelore, i parashikuar në Kushtetutë, ka një përmbajtje të tillë që, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi dhe, në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese siç është dhe ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte

³⁹⁷ Në fakt kjo çështje nuk është inicuar nga individë por nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër në rrugën e kontrollit incidental. Ajo u përfshi në këtë punim meqenëse elaboron të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor.

themelore. Jo vetëm kaq, por formulimi dhe kuptimi juridik i nenit 17 të Kushtetutës është i tillë që përfshin të gjitha të drejtat themelore përderisa thekson se kufizimi i tyre nuk mund të prekë thelbin e së drejtës. Në vijim të këtij interpretimi vijnë edhe parashikimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të KPC (shih nenet 450, 451, 452 dhe 472 të KPC) lidhur me kufizimin e të drejtës së ankimit.

Gjykata vlerëson se togfjalëshi i nenit 202 të Kodit Rrugor, objekt i kundërshtimit kushtetues, vendos vërtetë një kufizim të së drejtës themelore të ankimit, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. E drejta e ankimit nuk është abstrakte, ajo është një e drejtë me karakter procedural, në mbrojtje të një të drejte tjetër. Ashtu siç rezulton nga përmbajtja e nenit 43 të Kushtetutës, e drejta e ankimit është, në radhë të parë, rrjedhojë e të drejtës për gjykim, (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës). Gjykata e quan të drejtë pretendimin e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili e identifikon interesin publik me interesin për t'i dhënë fund sa më shpejt dhe me kosto sa më të ulët proceseve gjyqësore, shqyrtimi i të cilave në instancat më të larta gjyqësore bëhet i panevojshëm për shkak të llojit dhe masës së lehtë të dënimit. Interesi publik shfaqet gjithashtu edhe në nevojën e shmangies sa më shpejt të pasigurisë në lidhje me mosmarrëveshjet e këtij lloji.

Gjykata, në kufizimin e të drejtës së këtij ankimi, arrin të identifikojë edhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve që, në rastin konkret, mund të çmohet në aspekt të realizimit efektiv sa më të shpejt të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të individëve të tjerë, subjekte ose jo në gjykim... Proporcionalitetin e një kufizimi Gjykata e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes të të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën. Balanca mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, në çështjen në shqyrtim, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis interesit të dhënies së drejtësisë që realizohet me anë të vendimeve gjyqësore dhe domosdoshmërisë

për t'í dhënë fund sa më shpejt mosmarrëveshjeve, me qëllimin që organet gjyqësore të lirohen nga detyrimet që rrjedhin nga ngarkesa e panevojshme e punës. Kusht i domosdoshëm është që balanca të arrihet duke i dhënë qartësi të drejtës në konflikt.

...Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor janë të shumta dhe janë kthyer në një fenomen mjaft shqetësues në vendin tonë. Kjo situatë e rënduar shkakton, përveç problemeve të shumta, dhe një numër të madh mosmarrëveshjesh. Në këto kushte, legjislatori duke kufizuar ankimin në instancat më të larta gjyqësore synon, nga njëra anë të jepet drejtësi dhe nga ana tjetër, të rritet efektiviteti i masave administrative ndaj këtyre shkeljeve, duke shmangur zgjatjen e panevojshme të kohës nga momenti i kryerjes së shkeljes deri tek ekzekutimi i dënimit ndaj tyre si dhe t'í jepet fund sa më shpejt zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve me koston më të ulët publike, duke parashikuar fillimisht shqyrtimin në instancat administrative të tyre. Gjykata çmon se në raport me gjendjen dhe me synimin që kërkon të arrijë legjislatori, kufizimi i ankimit gjyqësor është i përshtatshëm.

Duke ju përmbajtur qëndrimin se e drejta e ankimit është një e drejtë me karakter procedural që derivon nga e drejta e gjykimit dhe shërben për mbrojtjen e një të drejte tjetër, Gjykata çmon se duhet të analizojë edhe të drejtën në mbrojtje të së cilës shërben e drejta e ankimit. Bazuar në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, Gjykata konstaton se e drejta e cenuar në rastin konkret në mbrojtje të së cilës shërben e drejta e ankimit gjyqësor është e drejta e pronës. Në shumë vendime të GJEDNJ është pranuar se shteteve anëtare të kësaj Konvente u është lënë një diskrecion i gjerë për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme, qoftë për të vendosur..... gjoba qoftë edhe/ose për të siguruar pagimin..... e gjobave.

Në çështjen në shqyrtim, kufizimi i të drejtës së ankimit gjyqësor ka të bëjë me shkeljen e një prej rregullave të qarkullimit rrugor, për të cilën parashikohen disa lloje dënimesh administrative, ndër të cilat ai me gjobë deri 100.000 lekë dhe ai i konfiskimit të mjetit. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve administrative ashtu si dhe vetë masa e gjobave është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në

përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Por Gjykata analizon proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre. Për të bërë këtë analizë, Gjykata e sheh me vend që së pari t'i referohet jurisprudencës së GJEDNJ, e cila ka vendosur tre kritere alternative për të përcaktuar nëse një masë administrative ka elementë karakteristikë penalë. Këto kritere kanë të bëjnë me klasifikimin e cenimit të së drejtës në sistemin ligjor kombëtar e lidhjen e tij me të drejtën penale ose me atë administrative ose më të dyja; me natyrën e shkeljes;³⁹⁸ dhe, me natyrën e shkallën e ashpërsisë së sanksionit të mundshëm.³⁹⁹ Për të vendosur nëse një shkelje është e karakterit penal në kuptim të Konventës është e mjaftueshme që ajo të përputhet qoftë dhe me një nga kriteret e mësipërme.⁴⁰⁰ Në parim, Gjykata i përmbahet qëndrimit se, nëse një masë e dhënë është administrative ndëshkimore por ka edhe elementë karakteristikë penalë, gjë që e rrit shkallën e ashpërsisë së saj, individëve mund t'u njihet e drejta themelore e ankimit gjyqësor ndaj këtyre masave sipas vlerësimit të ligjvënësisë. Por, nëse shkalla e ashpërsisë së sanksionit administrativ është e lartë dhe barazohet ose pothuajse barazohet me shkallën e ashpërsisë së një sanksioni penal individëve duhet t'u garantohet domosdoshmërisht e drejta e ankimit gjyqësor ndaj këtij vendimi.

Në lidhje me klasifikimin e shkeljes Gjykata çmon se në sistemin kombëtar të së drejtës shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor që sanksionohen në Kodin Rrugor mund të cilësohet, në varësi të pasojave, ose si një fakt kriminal penal i rregulluar nga e drejta penale

³⁹⁸ Kur dispozitat përkatëse janë të karakterit të përgjithshëm, ato parashikojnë një sjellje të një lloji të caktuar dhe e bëjnë detyrimin që pason subjekt të një sanksioni që është njëherësh frenues dhe ndëshkues, atëherë shkelja mund të cilësohet si "penale" në kuptim të nenit 6. Shih çështjen *Gurepka k. Ukrainës*, 6 shtator 2005, cituar në vendimin e GJK.

³⁹⁹ Humbja e lirisë apo gjoba të rënda janë tregues të karakterit penal të shkeljes. Shih vendimet e GJEDNJ *Engel k. Hollandës*, 8 qershor 1976 dhe *Janosevic k. Suedisë*, 23 korrik 2002, cituar në vendimin e GJK.

⁴⁰⁰ Pra kriteret janë alternativë dhe jo kumulativë. Kjo nuk përjashton rastin e një analize kumulative, atëherë kur analiza e secilit kriter veçmas nuk mundëson arritjen e një konkluzioni të qartë për ekzistencën ose jo të akuzës penale. Shih vendimin e GJEDNJ *Bendenoun k. Francës*, 24 janar 1994, cituar në vendimin e GJK.

ose si shkelje administrative e rregulluar nga e drejta administrative. Përsa i takon natyrës së shkeljes, në rastin në shqyrtim, Gjykatës i rezulton qartësisht se qarkullimi me një mjet të pajisur me një targë që nuk është e vetja, e parashikuar nga pika 12 e nenit 99 të Kodit Rrugor, është shkelje e natyrës administrative për shkak se duke e krahasuar këtë shkelje me shkeljet e parashikuara nga Kodi Penal rezulton se ajo nuk përbën një fakt kriminal penal dhe, si e tillë, nuk përbën krim ose kundravajtje penale që në bazë të nenit 29 të Kushtetutës dhe 2 të Kodit Penal autori i saj të mund të ndiqet dhe të dënohet penalisht.

Në lidhje me natyrën dhe shkallën e ashpërsisë së sanksionit të mundshëm, Gjykata vlerëson se, nga natyra, gjoba si sanksion në sistemin kombëtar të së drejtës klasifikohet qoftë si masë administrative ndëshkimore, qoftë si një nga llojet e dënimeve penale të parashikuara nga Kodi Penal. Ndërsa përsa i takon ashpërsisë së sanksionit, Gjykata çmon se propocionaliteti i tij duhet të vlerësohet në raport me rëndësinë e shkeljes dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

Në lidhje me rëndësinë e shkeljes dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj Gjykata vlerëson se targa është një akt administrativ real (neni 146 i KPA) që konsiston në një shenjë publike të vënë nga një autoritet publik shtetëror në një mjet motorik që shërben për të identifikuar mjetin gjatë qarkullimit rrugor. Drejtimi jo i duhur i një mjeti motorik qoftë edhe nga pakujdesia mund të shkaktojë pasoja të rënda për jetën, shëndetin dhe pronën e individit, çka sipas rastit mund të sjellë përgjegjësi penale, civile ose administrative për drejtuesin e tij. Gjithashtu, nga pikëpamja e të drejtës civile drejtimi i një mjeti motorik konsiderohet burim i një rreziku të shtuar, gjë ka detyruar shumë shtete, përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, të kushtëzojnë qarkullimin e mjetit motorik me detyrimin ligjor të sigurimit të tij për përgjegjësitë civile ndaj palëve të treta. Nxjerrja e përgjegjësive për veprimet dhe pasojat e ardhura kërkon domosdoshmërisht identifikimin e mjetit nëpërmjet të cilit identifikohet dhe pronari apo drejtuesi i mjetit.

Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se masa e gjobës nga 25.000 deri 100.000 lekë kur mjeti qarkullon me targë të një automjeti tjetër ose të falsifikuar është në përpjesëtim me shkëlqen e bërë. Gjykata e vlerëson këtë masë administrative proporcionale edhe për arsye se kufijtë e saj janë më të vegjël se kufijtë e masave të gjobave si dënime penale, të parashikuara në nenin 34 të Kodit Penal. Nga ky këndvështrim, Gjykata, duke iu përmbajtur qëndrimit se ashpërsia e sanksionit është më tepër sesa natyra e tij vendimtare për të përcaktuar nëse një masë administrative ndëshkimore ka apo jo elementë penalë çmon se në rastin në shqyrtim masa administrative ndëshkimore e gjobës, e parashikuar në Kodin Rrugor, megjithëse ka elementë penalë është e vogël dhe për këtë arsye individëve mundet t'u kufizohet me ligj e drejta themelore e ankimit gjyqësor, parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton gjithashtu se në çështjen objekt shqyrtimi, në referim të pikës 12 e 15 të nenit 99 të Kodit Rrugor, është zbatuar edhe masa administrative plotësuese e konfiskimit të mjetit. Për të vlerësuar proporcionalitetin e kësaj mase Gjykata e sheh me vend që të theksojë fillimisht se, "konfiskimi" sjell kalimin e pronës së të pandehurit/gjykuarit në favor të shtetit. Ky i fundit bëhet pronar i sendit të konfiskuar pa paguar asnjë shpërblim. Këtu Gjykata gjen me vend të vlerësojë se konfiskimi nuk barazohet me shpronësimin ose me kufizimin në ushtrimin e të drejtës së pronës, të cilat sipas nenit 41 pika 3 dhe 4 të Kushtetutës bëhen me kundërshpërblim. Për të përcaktuar natyrën e vërtetë të sanksionit ose masës që përfaqëson konfiskimi Gjykata çmon të nevojshme të krahasojë pikën 15 të nenit 99 të Kodit Rrugor ku konfiskimi është parashikuar si masë administrative plotësuese dhe nenin 36 të Kodit Penal, në të cilin konfiskimi është parashikuar si dënim penal plotësues. Konfiskimi si masë administrative plotësuese jepet për një shkëlqje administrative, ndërsa konfiskimi si dënim penal plotësues jepet për një fakt të kundraligjshëm kriminal, i cili dënohet penalisht. Sipas Kodit Rrugor, konfiskimi i pronës si masë administrative plotësuese jepet nga një organ administrativ dhe mund të ankohet administrativisht deri në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa konfiskimi i pronës si dënim penal plotësues jepet nga

një gjykatë dhe mund të ankohet së bashku me dënimin kryesor në gjykatat më të larta.

Nga ky krahasim Gjykatës i rezulton qartësisht se masa administrative plotësuese e konfiskimit ka elementë të plotë dhe ekuivalentë me dënimin penal plotësues, për të cilin sistemi ligjor penal kombëtar parashikon garancinë procedurale të ankimit gjyqësor. Në varësi të vlerës së pronës së konfiskuar administrativisht moslejimi i ankimit ndaj konfiskimit mund të jetë disproporcional me shkëlqen administrative për të cilën jepet kjo masë.

Nga ky arsyetim Gjykata arrin në përfundimin se moslejimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që rrjedh nga parashikimi i nenit 202 të Kodit Rrugor jo në çdo rast është i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe duhet të shfuqizohet. Por Gjykata çmon se shfuqizimi i menjëhershëm i pjesës së dispozitës së nenit 202 të Kodi Rrugor të R.SH "...vendimi i së cilës është i formës së prerë" do të krijonte boshllëk ligjor dhe do të sillte efekte jo vetëm sa i takon masës administrative plotësuese të konfiskimit por edhe për masat e tjera administrative të parashikuara nga Kodi Rrugor, moslejimi i ankimit të të cilave mund të mos vijë në kundërshtim me Kushtetutën. Nga ana tjetër, ky boshllëk ligjor i krijuar mund të sjellë ndikim në të drejtat dhe liritë kushtetuese të shtetasve. Duke konfirmuar jurisprudencën e saj të mëparshme se detyrë e kësaj Gjykate nuk është të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullime ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe, me qëllim që pushtetit legjislativ t'i jepet koha e mjaftueshme për të bërë rregullimet e nevojshme ligjore që lidhen me të drejtën e ankimit për të gjitha masat administrative të parashikuara në nenin 202 të Kodit Rrugor, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës vendosi që ky vendim të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare".⁴⁰¹

Ky vendim u soll më i plotë, pasi paraqet interes lidhur me trajtimin që GJK i ka bërë masës së kufizimit duke e parë nga dy aspekte:

⁴⁰¹ Vendim i GJK nr.12/2010.

fillimisht me nevojën dhe interesin publik për të bërë drejtësi dhe për të përshpejtuar procedurat për gjoba, të cilat kanë një shpeshtësi të konsiderueshme në vendin tonë; së dyti, duke e lidhur kufizimin e së drejtës së pronës, pra konfiskimin e mjetit, si masë ekstreme për të cilën mjetet e ankimit duhet të jenë të plota dhe efikase. Analiza e Gjykatës në këtë rast është e plotë dhe përfshin të gjitha situatat në të cilat mund të ndodhë një kufizim ekstrem i të drejtave themelore. Gjithashtu, një gjë tjetër që vlen të përmendet është edhe fakti se GJK duke mos dashur të krijojë boshllëk për shkak të shfuqizimit të dispozitës konkrete, ka zgjedhur të vendosë një afat kohor brenda të cilit ligjvënësi ka mundësi të plotësojë dispozitën e shfuqizuar.⁴⁰²

4.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore është përfshirë relativisht vonë në praktikën e GJK. Edhe kjo çështje lidhet me praktikën e GJEDNJ, e cila detyroi GJK ta konsideronte mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore si pjesë e procesit të rregullt ligjor, gjë e cila deri në vitin 2005 nuk konsiderohej si e tillë prej GJK shqiptare.⁴⁰³ Dilemat e GJK lidhur me këtë kompetencë “të re” ishin disa. Ato lidheshin me natyrën e shqyrtimit që ajo do të bënte si edhe me llojin e vendimit që do të jepte. Në fillim ka patur diskutime lidhur me hapësirën e kontrollit që do të ushtronte GJK, pra, nëse ajo do të marrë në shqyrtim rast pas rasti veprimin ose mosveprimin e administratës kompetente lidhur me (mos)ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, gjë e cila është mjaft afër shqyrtimit në themel të çështjes. Deri ku mund të shkonte kontrolli i GJK, kur ajo kishte pranuar vazhdimisht se gjatë gjykimit kushtetues nuk i hyn çështjes në themel por analizon vetëm ato elementë që lidhen me procesin e

⁴⁰² Vlen të lexohet mendimi i pakicës në këtë vendim, i cili nuk lidhet me thelbin e kërkesës por me legjitimitimin e kërkuarit (gjykatës referuese). Sipas pakicës, kërkuari nuk duhet legjitimuar, pasi gjykata referuese nuk ishte kompetente të shqyrtonte çështjen dhe si rrjedhojë as të kërkonte para GJK shfuqizimin e dispozitës objekt shqyrtimi.

⁴⁰³ Çështja *Qufaj k. Shqipërisë*, 18 shtator 2004.

rregullt ligjor? Sot ka një praktikë të pasur lidhur me këto vendime, por problematike mbetet ende fakti se vendimi i GJK që konstaton cenim të procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm është një vendim tjetër i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim që i jepet kërkuesit, pa u shoqëruar me dëmshpërblim apo urdhërime të tjera. Kjo ka vënë në pikëpyetje efikasitetin e vendimeve të GJK, gjë e cila është konstatuar edhe nga GJEDNJ në praktikën e saj me palë shtetin shqiptar. Lidhur me këtë do të ndalemi më poshtë tek nënçështja "GJEDNJ për GJK" shqiptare. Le t'i hedhim një vështrim praktikës së GJK lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Praktika e re e GJK filloi me çështjen *Memishaj k. Bashkisë Tiranë*, në të cilën GJK deklaroi se "*Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore, të cilat janë të detyrueshme jo vetëm për palët, por dhe për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ.*

...kjo Gjykatë [në çështje të tilla] konstaton shkeljen e bërë nga organet përkatëse, të cilat nuk kanë zbatuar, pa shkaqe të përligjura ligjore, një vendim të formës së prerë të gjykatës. Është e vërtetë se natyra e vendimit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 132 të Kushtetutës, si rregull, lidhet me të drejtën për të shfuqizuar aktet që shqyrton. Në të vërtetë Gjykata Kushtetuese, duke pasur edhe shumë kompetenca të tjera veç atyre të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, është e detyruar të japë dhe vendime të llojeve të tjera, të ndryshme, pra dhe vendime konstatuese apo deklarative që në të vërtetë kanë efekte, pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret. Kështu p.sh, Gjykata Kushtetuese vendos dhe për vërtetimin e pamundësisë së Presidentit të Republikës për të ushtruar funksionet e tij ose për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të deputetëve, si dhe verifikimin e

zgjedhjes se tyre. Në raste të kësaj natyre dhe për të tjera si këto, Gjykata Kushtetuese merr vendime që kanë një natyrë të ndryshme nga ato për të cilat bëhet fjalë në nenin 132 të Kushtetutës. Pra, Gjykata Kushtetuese vendos nëse konstaton prekjën e një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pas kësaj, çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e KPC.⁴⁰⁴

...individit që i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte nuk mund të presë pa kufi për ta realizuar atë prandaj për këtë qëllim, Konventa Europiane ka insistuar në përcaktimin e një afati që sipas saj duhet të konsiderohet si afat i arsyeshëm. Nisur nga ky detyrim, GJEDNJ ka krijuar një praktikë të konsoliduar si për shumë fusha të tjera edhe për këtë problem konkret. Sipas saj, të gjitha shtetet detyrohen të organizojnë sistemin juridik në mënyrë të tillë që gjykatat të mundësojnë shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sepse "sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to".⁴⁰⁵... Në mënyrë të veçantë është për t'u përmendur qëndrimi i kësaj Gjykate në çështjen Qufaj k. Shqipërisë, ku Gjykata e Strasburgut vëren se "sistemi ligjor shqiptar ofron një rregullim në formë të një kërkesë-ankese lidhur me dhunimin e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor". Më poshtë ajo thekson se "dispozitat për procesin e rregullt gjyqësor në Shqipëri duhej të ishin interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonin një mjet ankimor efektiv për shkeljen e pretenduar të nenit 6/1 të Konventës, prandaj Gjykata dha opinionin se Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë në lidhje me mosrespektimin e një vendimi përfundimtar, si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor".

⁴⁰⁴ Në këtë deklaram të saj, GJK e sheh të arsyeshme të bëjë të ditur mënyrën e reagimit të saj ndaj kërkesave të tilla ku objekt nuk është shfuqizimi i ndonjë akti por konstatimi i një shkeljeje dhe detyrimi i organit për ta riparuar atë.

⁴⁰⁵ Çështja *Bageta k. Italisë*, 25 qershor 1998, cituar në vendimin e GJK.

Duke trajtuar këtë problem në lidhje me thelbin e saj dhe me interpretimin e nenit 6, Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj, datë 19.03.1997 ka pohuar se: "Do të ishte e papërfytyrueshme që neni 6(1), të përshkruaj me hollësi garancitë procedurale që u jepen palëve ndërgjyqësore, pa siguruar mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore pra, neni 6 i saj ka të bëjë vetëm me të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate. Kjo ka gjasa të çojë në situata të papajtueshme me parimin e sundimit të së drejtës, parim të cilin shtetet kontraktuese kanë marrë përsipër ta respektojnë kur ratifikuan Konventën. Në këtë mënyrë, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të dhëna nga çdo gjykatë duhet të shikohet si pjesë e pandarë e gjykimit për qëllimet e nenit"...Sa më lart, ankimi në Gjykatën Kushtetuese konsiderohet, në raste të tilla, si mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, sipas së cilës "çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv para një instance kombëtare edhe atëherë kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare". Ky qëndrim duhet parë lidhur edhe me parimin e sigurisë juridike që kërkon që vendimet gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim për t'u zbatuar. Edhe Gjykata Kushtetuese ka krijuar një praktikë të sajën duke u shprehur se "Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë" dhe se "asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre".

Meqenëse baza ligjore mbi të cilën ngrihet një kërkesë e tillë ka të bëjë drejtpërsëdrejti dhe me konceptin e KEDNJ, është e nevojshme të sqarohet pozicioni i saj në të drejtën e brendshme shqiptare. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, renditet menjëherë pas Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore përfshirë këtu dhe gjykatat e çdo niveli si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre. Garancitë e Konventës ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të

drejtave e lirive themelore të individit të shprehura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Veç kësaj, Gjykata Kushtetuese çmon se teksti i Konventës dhe jurisprudenca e GJEDNJ shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Ky pozicion i Konventës vjen si pasojë e angazhimeve të Shtetit Shqiptar për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë me detyrimet që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ për palët që marrin pjesë në gjykim, sepse sipas nenit 41 të Konventës, palët kontraktuese, me ratifikimin e Konventës janë të detyruara të garantojnë përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën. Veç kësaj, praktika e kësaj Gjykate paraqet rëndësi për vlerat orientuese të jurisprudencës të saj edhe për gjykatat shqiptare. Pra, ky problem ka mbetur për t'u vlerësuar rast pas rasti nga gjykatat që gjykojnë në shkallë të parë dhe nga ato që gjykojnë në shkallë të dytë, pa harruar se objekt i këtij vlerësimi, sipas GJEDNJ, duhet të jetë tërësia e procesit së bashku me fazën e hetimeve dhe me shkallën e apelit, me procesin eventual para Gjykatës Kushtetuese, si dhe me ekzekutimin e vendimit.

Për sa u përket, duke u bazuar në këto standarde kushtetuese, kërkesa e kërkuarit me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm duhet pranuar edhe për një shkak tjetër, pasi moszbatimi i një vendimi të tillë cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës".⁴⁰⁶

Pas këtij vendimi, GJK është përballur me mjaft raste të tjera, ku ajo e ka trajtuar më hollësisht çështjen e mosekzekutimit të vendimit duke analizuar veprimet/sjelljen e kërkuarit (kreditorit), të debitorit dhe sidomos edhe të organeve shtetërore të ngarkuara posaçërisht me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, konkretisht zyrën e përmbarimit gjyqësor. Ajo ka theksuar se "...Gjykata Kushtetuese ka pranuar tashmë në praktikën e saj se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë

⁴⁰⁶ Vendim i GJK nr.6/2006.

të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ. Gjykata Kushtetuese konsideron me vend t'i referohet edhe një prej çështjeve me palë shtetin shqiptar të shqyrtuar nga GJEDNJ, konkretisht rastin e Qufaj kundër Shqipërisë.⁴⁰⁷ GJEDNJ ka theksuar se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mosrespektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta,⁴⁰⁸ por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, e garantuar nga neni 6/1.⁴⁰⁹

...Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet refuzimit për moszbatim të vendimit të formës së prerë nga organet kompetente. Ajo vlerëson se në çështjen në shqyrtim pala debitore i kishte të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim t'i paguante kërkuarit shumë që i detyrohej sipas këtij vendimi. Jo vetëm kaq, por gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata Kushtetuese nuk arriti të shohë asnjë veprim konkret të palës debitore që do të tregonte sado pak vullnet për të ekzekutuar detyrimin që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Gjithashtu, edhe sa i përket organit të ngarkuar nga ligji me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pra, përmbarimit, Gjykata Kushtetuese çmon se ai duhet të kishte zbatuar me korrektësi dispozitat procedurale konkrete për këtë qëllim, pavarësisht faktit se debitor në këtë rast është një institucion buxhetor. Përballë detyrimin për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjitha subjektet, qofshin këto privatë apo publikë, duhet të përgjigjen njëjloj".⁴¹⁰

⁴⁰⁷ Çështja Qufaj k. Shqipërisë, 18 nëntor 2004.

⁴⁰⁸ Vendime të GJEDNJ Romashov k. Ukrainës, 27 korrik 2004; Shvedov k. Rusisë, 20 tetor 2005, cituar në vendimin e GJK.

⁴⁰⁹ Shih edhe Hornsby k. Britanisë së Madhe, 19 marsit 1997, cituar në vendimin e GJK.

⁴¹⁰ Vendim i GJK nr.43/2007.

Në një rast tjetër, GJK ka rikonfirmuar qëndrimin se "në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Ekzekutimi i vendimeve brenda afatit të arsyeshëm ka qenë në fokusin e vazhdueshëm edhe të GJEDNJ, e cila në jurisprudencën e saj, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Përsa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme me qëllim sigurimin e mbrojtjes nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme.⁴¹¹

...Çështja objekt gjykimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Zyra e Përmbarrimit. Përsa i përket sjelljes/veprimeve të kërkuesit, Gjykata konstaton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Përmbarruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që

⁴¹¹ Çështja *Cravcenko k. Moldavisë*, 15 prill 2008, cituar në vendimin e GJK.

mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Përfaqësuesi i Zyrës së Përmbarimit pretendoi se përmbaruesit gjyqësor kishin zbatuar dispozitat procedurale mbi ekzekutimin vullnetar deri në gjobitjen e personit të ngarkuar nga ligji për mosekzekutim vullnetar të detyrimit. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mosushtrimit të të gjithë kompetencave nga ana e tij. Gjykata Kushtetuese vlerëson se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj.

DPD-ja ka kundërshtuar ekzekutimin e vendimit me argumente që kanë të bëjnë me paligjshmërinë e vendimit të KSHC-së, vënien në dyshim të vlerës së tij si titull ekzekutiv dhe pamundësisë financiare për përmbushjen e detyrimit. Gjykata Kushtetuese konstaton se DPD-ja ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme e të pajustificuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Në lidhje me pretendimin e DPD-së mbi pavlefshmërinë e vendimit të KSHC-së si vendim i nxjerrë nga një organ jashtë kompetencave të parashikuara nga ligji, Gjykata Kushtetuese çmon se vlerësimi i këtij pretendimi i përket juridiksionit të gjykatës së zakonshme dhe jo juridiksionit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese vlerëson të pabazuar edhe pretendimin se vendimi i gjykatës nuk është titull ekzekutiv. Vënia në dyshim e fuqisë ekzekutive të vendimit të gjykatës nisur nga fakti se çështja nuk është zgjidhur në themel dhe dispozitivit i vendimit nuk përmban detyrime në të është e pabazuar. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3, datë 24.01.2007 kanë arritur në konkluzionin se Komisioni i Shërbimit Civil ka tiparet e një arbitri administrativ apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca quasi gjyqësore. Vendimi i KSHC-së ngjason me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nisur nga tiparet e tij dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet brenda afatit ligjor. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vëren se pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për t'u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjykate ose një vendimi të një autoriteti administrativ,

*legjislacioni i brendshëm dhe Konventa parashikon që ai duhet të ekzekutohet.*⁴¹²

...Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet refuzimit për moszbatim të vendimit të formës së prerë nga organet kompetente. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim Zyra e Përmbarimit dhe DPD-ja, i kishin të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim të ekzekutonin vendimin e formës së prerë. Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të KEDNJ".⁴¹³

Në vendimet e mëpasshme të GJK vihet re se ajo jo vetëm ka analizuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor por është fokusuar edhe tek afati kohor brenda të cilit është ose duhej të ishte ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Për këtë arsye, GJK ka analizuar edhe shkaqet që kanë çuar në vonesa të paarsyeshme të gëzimit të së drejtës së fituar nga kërkuesi. Qëndrimi i saj ka qenë në linjën se "... kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Përsa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, GJEDNJ

⁴¹² Çështja *Ramadhi k. Shqipërisë*, 13 nëntor 2007.

⁴¹³ Vendim i GJK nr.1/2009.

ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme.

Me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese Gjykata merr në konsideratë dispozitat e KPC lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Neni 451/a i këtij Kodi parashikon se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Neni 510 i Kodit parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe se tituj ekzekutivë, ndër të tjera, janë edhe vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Neni 511 parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 511 të KPC.

...Në çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon të nevojshme të vlerësojë nëse Zyra e Përmbarrimit ka marrë ndonjë masë për zbatimin e Urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe në këtë mënyrë të vlerësojë veprimet ose mosveprimet për një kohë të gjatë në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Zyra e Përmbarrimit ka sqaruar para Gjykatës se ajo ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe më konkretisht me shkresën nr.10414 Prot., datë 13.11.2006 ka urdhëruar palën debitore që brenda 10 ditëve nga marrja dijeni të bëjë ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor duke liruar e dorëzuar truallin e mësipërm. Me shkresën nr.6134, datë 19.05.2008 e ka urdhëruar sërish palën debitore për ekzekutim vullnetar. Me shkresën nr.7667, datë 16.06.2008 ka njoftuar Komisaratin e Policisë Nr.3, Tiranë, si edhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit më 25.06.2008, ora 10.00. Ekzekutimi nuk është kryer për shkak se personat debitorë bashkë me banorë të lagjes kanë penguar kryerjen e veprimeve

përmbarrimore. Me shkresën nr.7342 është njoftuar sërish Komisariati i Policisë Nr.3 Tiranë, si dhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit, e cila do të ishte me datë 03.07.2008, ora 11.30. Në këtë datë është konstatuar se në sipërfaqen objekt ekzekutimi ndodhej edhe një banesë dy katëshe me sipërfaqe ndërtimore 66 m². Zyra e Përmbarrimit sqaron se ka kryer veprimet procedurale duke bërë lirim të truallit dhe dorëzimin e tij në favor të palës kreditore por vetëm të sipërfaqes së lirë të truallit me përjashtim të sipërfaqes prej 66 m² ku ndodhej banesa dy katëshe. Për këtë të fundit Zyra Përmbarrimore i ka kërkuar palës kreditore që të kërkojë pranë gjykatës kompetente sqarimin dhe interpretimin e pjesës urdhëruese (dispozitivit) të titullit ekzekutiv në lidhje me faktin nëse Zyra e Përmbarrimit duhet të lirojë dhe dorëzojë truallin (duke prishur banesën e ndodhur brenda kësaj sipërfaqe) prej 452 m² palës kreditore, apo do të mjaftohet duke liruar atë pjesë të truallit që është e lirë. Përmbarruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga përmbarruesi gjyqësor nuk kanë arritur në ekzekutimin e titullit ekzekutiv për shkak të mosshtrimit të të gjithë kompetencave nga ana e tij dhe vonesat për rreth një vit e gjysëm nga data e urdhrimit të ekzekutimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nga kërkuesi. Gjykata nuk e gjen te bazuar as argumentin se vendimi gjyqësor është zbatuar por pjesësisht me dorëzimin e lirim të sendit përveç pjesës së zënë prej 66 metra katrorë ku ndodhet godina. Gjykata vlerëson se një vendim gjyqësor quhet i ekzekutuar kur ekzekutohet dispozitivi i vendimit në tërësinë e tij. Kjo nuk ka ndodhur në rastin në shqyrtim.

...Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga organet kompetente. Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuarit të parashikuar nga neni

42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të KEDNJ”.⁴¹⁴

Po përsëri lidhur me afatin kohor të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, GJK ka deklaruar se "...për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Përsa i përket sjelljes së kërkuarit, Gjykata Kushtetuese thekson se përdorimi nga ana e tij i të gjitha procedurave të parashikuara nga legjislacioni me qëllim sigurimin e mbrojtjes nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Lidhur me sjelljen e autoriteteve publike, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se megjithëse në një masë të madhe zbatohet parimi se iniciativa procedurale u takon palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

Gjykata Kushtetuese vëren se në rastin në shqyrtim masat dhe veprimet e ndërmarra për ekzekutimin e vendimeve të mësipërme ndahen në dy periudha. Periudha e parë i përket viteve 1998 dhe 1999, kur janë lëshuar dy urdhërat e ekzekutimit për secilin nga detyrimet e debitorit deri në vitin 2002, kur procedurat e ekzekutimit janë pushuar me kërkesë të kreditorit. Periudha e dytë fillon në fundvitin 2008, kur kërkuarisi i është drejtuar përsëri Zyrës së Përmbarrimit Shkodër, duke kërkuar ekzekutimin e pjesës së tij takuese të detyrimit. Në këto kushte, Gjykata do të vlerësojë nëse periudhat e mësipërme 1998-2009 duhen konsideruar si një e tërë apo këto dy periudha në të cilat rezulton të jenë kryer veprime nga Zyra e Përmbarrimit duhen vlerësuar në mënyrë të veçantë, pra si dy procedura të veçanta. Gjykata Kushtetuese vlerëson se këto procedura i referohen të njëjtës çështje, pra i referohen përpjekjeve të njëjta të kërkuarit për zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe kompensimit të tij sipas objektit të tyre. Edhe pse

⁴¹⁴ Vendim i GJK nr.6/2009. Në këtë vendim shihet edhe një herë analiza në themel që GJK i bën veprimeve të të gjithë palëve të përfshirë në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë me qëllim konstatimin e pengesave ose problemeve ligjore që kanë çuar në moszekutimin e tij.

ekzekutimi i vendimeve është pushuar për periudhën 2002-2008, kjo periudhë duhet të llogaritet në afatin e përgjithshëm të ekzekutimit. Për më tepër, siç shprehet edhe GJEDNJ, një personi, i cili pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohet t'u drejtohet organeve përmbartimore për të ekzekutuar vendimin.

Sa më sipër, Gjykata konkludon se periudha që duhet marrë në konsideratë fillon në momentin e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit (1998-1999) dhe mbaron në datën kur vendimet e formës së prerë janë ekzekutuar (2009), pra zgjati gati 11 vjet. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kjo periudhë duhet konsideruar paarsyershmërisht e gjatë.

ii) Kompleksiteti i çështjes

Gjykata nuk e vlerëson çështjen komplekse as nga pikëpamja e fakteve dhe as nga pikëpamja e ligjit, gjë që mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara me këtë qëllim nga ligji.

iii) Sjellja e kërkuessit

Përsa i përket sjelljes (veprimeve) së kërkuessit, Gjykata konstaton se kërkuessi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shterrur mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Lidhur me mospagimin e shumës që përkon me 3% të detyrimit si kusht për fillimin e ekzekutimit, gjë që ka sjellë edhe pushimin e ekzekutimit për një periudhë 6-vjeçare, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuessi nuk mund konsiderohet përgjegjës, pasi fakti i pamundësisë financiare të kreditorit nuk mund t'i ngarkohet atij për të justifikuar vonesat në ekzekutim. Përveç kësaj, siç u theksua më sipër, kërkuessi, i cili është pajisur me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund ngarkohet me përgjegjësi për arsyen se për shkak të vështirësive ekonomike kërkoj pushimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të këtij vendimi.

iv) Sjellja e autoriteteve publike

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në këtë drejtim duhet të shqyrtohet sjellja e secilit autoritet të përfshirë në këtë proces. Në lidhje me

sjelljen e debitorit, Bashkia Shkodër, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka qenë aktive duke nxjerrë si justifikim mungesën e fondeve dhe duke mos bërë përpjekje për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimet ndaj kërkuesit. Bazuar në nenin 9 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore "Bashkësitë vendore kanë të drejtë, në kuadrin e politikës ekonomike të vendit, të kenë burimet e tyre të mjaftueshme, të cilat mund t'i disponojnë lirisht në ushtrimin e kompetencave të tyre". Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim, debitori me marrjen dijani të vendimeve të formës së prerë të gjykatave duhej të merrte të gjitha masat për ekzekutimin e detyrimeve që i ishin ngarkuar në favor të kërkuesit dhe nuk duhej të priste vënien në lëvizje të procedurave të përmbartimit deri marrjen e masave shtrënguese për ekzekutimin e tyre. Për më tepër, pushimi i ekzekutimit nga Zyra e Përmbartimit nuk e shkarkoi Bashkinë si debitor shtetëror nga përmbushja e detyrimit.

Lidhur me sjelljen e organeve përmbartimore Gjykata vëren se, edhe pse nuk mund të konsiderohen si joaktive, ato arritën vetëm pas një periudhe 11 vjeçare të ekzekutojnë me masa shtrënguese vendimet gjyqësore të formës së prerë. Pra, veprimet e institucioneve shtetërore rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar zbatimin e vendimeve të gjykatave në favor të kërkuesit, brenda një afati të arsyeshëm.

Në këtë drejtim edhe GJEDNJ ka pranuar se, për të mbrojtur efektivisht të drejtat e njeriut dhe për të krijuar shtetin e të drejtës autoritetet administrative janë të detyruara rrjedhimisht të ekzekutojnë vendimet e formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Më specifikisht, GJEDNJ pohon se në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin detyrime monetare ndaj një shteti, shteti nuk duhet t'i kërkojë personit ndaj të cilit është debitor, të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit me qëllim kompensimin e shumës së caktuar.⁴¹⁵ Në raste të tilla, autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet në mënyrën e duhur për vendimin dhe është në pozicionin të marrë të gjitha iniciativat për ta përmbushur atë ose për

⁴¹⁵ Shih vendimet e GJEDNJ-së *Metaxas k. Greqisë*, 27 gusht 2004; *Qufaj k. Shqipërisë*, 30 mars 2005; *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, 22 gusht 2006; *Gjyli kundër Shqipërisë*, 29 shtator 2009, cituar në vendimin e GJK.

t`ia transmetuar një autoriteti tjetër shtetëror që është kompetent për ekzekutimin. Gjykata vlerëson se vetëm fakti që autoritetet shtetërore kanë zbatuar vendimin pas një vonese thelbësore, nuk mund të konsiderohet se i heq automatikisht kërkuetit statusin e personit të cilit i është cenuar një e drejtë në kuptimin kushtetues.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se fakti i ekzekutimit të vendimeve nga debitori, Bashkia Shkodër, në favor të kreditorit Shefqet Mandia nuk mjafton për të konkluduar se organet shtetërore kanë zbatuar vendimet e formës së prerë të gjykatave. Shlyerja e vonuar e shumave që Bashkia Shkodër i detyrohej kërkuetit nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm nuk mundet të riparojë mosveprimin e organeve shtetërore për të zbatuar për një periudhë të gjatë vendimet e gjykatave. Rrjedhimisht kërkueti mundet ende të pretendojë se është i cenuar në të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se organet shtetërore nuk kanë zbatuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e formës së prerë të gjykatave. Në këto kushte, nëpërmjet sjelljes së tyre organet shtetërore kanë cenuar të drejtën e kërkuetit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, duke i lënë pa efekt këto garanci mbrojtëse".⁴¹⁶ I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në vendimet e mëpasshme të GJK.⁴¹⁷

Gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me moszbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, GJK nuk ka pranuar argumentet subjekteve të interesuara (debitorëve) lidhur me faktin se kërkueti, që fillon një proces për konstatimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet t'i drejtohet fillimisht gjykatave të zakonshme për të kërkuar këtë detyrim nga debitori dhe jo GJK. Ajo ka theksuar se është "i pabazë argumenti [i Ministrisë së Drejtësisë] se kërkuetja duhej t'i ishte drejtuar gjykatës së shkallë së parë për

⁴¹⁶ Vendim i GJK nr.8/2010. Në këtë vendim GJK është shprehur edhe për kërkimin tjetër të kërkuetit lidhur me dëshmipërblimin financiar për vonesën e papërligjur lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm. Shih për më tepër edhe në më poshtë tek nënçështja GJEDNJ për GJK.

⁴¹⁷ Vendime të GJK nr.13/2010; 23/2010; nr.35/2010; nr.16/2011; nr.21/2011.

mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Nuk është detyrimi i kreditorit që të hapë një proces të ri gjyqësor nga i cili rrjedhimisht do të dalë një vendim tjetër gjyqësor për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të dhënë më parë. Gjykata thekson se vendimi për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit ka në thelb të tij jo konfirmimin e detyrimit të debitorit, por fillimin e procesit të ekzekutimit dhe vënien në lëvizje të organit kompetent për këtë qëllim. Në këtë aspekt, nuk ka arsye që pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili ka vënë në lëvizje përmbarrimin, kreditori t'i drejtohet përsëri gjykatës për të kërkuar detyrimin e debitorit për të shlyer detyrimin ndaj tij".⁴¹⁸ Ky qëndrim i GJK ka qenë edhe në linjën e GJEDNJ, e cila ka theksuar se autoritetet e brendshme duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që individit ta gëzojë të drejtën e tij me sa më pak pengesa dhe jo të zgjasë procedurat për këtë qëllim.

GJK ka shqyrtuar edhe pretendime të tjera të debitorëve në proces, si p.sh lidhur me faktin nëse vendimi gjyqësor që kërkohet të ekzekutohet është apo jo titull ekzekutiv. Ajo ka theksuar se "...Gjykata çmon se që një vendim gjyqësor të konsiderohet titull ekzekutiv ai duhet të ketë marrë formë të prerë, pra të mos ketë më mundësi ankimimi ndaj tij ose shfuqizimi si dhe të jetë lëshuar një urdhrin për ekzekutimin e tij. Në çështjen në shqyrtim para kësaj Gjykate, vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e KSHC-së, ka marrë formë të prerë dhe për këtë arsye Gjykata e Apelit ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit. Në këtë rast, detyrimi rrjedh nga vendimi i KSHC-së, i cili konsiderohet si vendim i një organi kuazigjyqësor dhe si i tillë i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha organet e administratës publike vendore dhe qendrore. Vendimi që jep KSHC ngjason me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nisur nga tiparet e tij dhe fuqinë detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet. Gjithashtu, subjekti i interesuar pretendon se është në pamundësi të ekzekutojë vendimin e formës së prerë për shkak se ai si titull ekzekutiv është i paqartë dhe nuk saktëson masën e detyrimit sa i takon pagesës ndaj kreditorit. Edhe këtë pretendim Gjykata e gjen të papabuar. Detyrimi i debitorit kundrejt kërkuesit është i përcaktuar ose i përcaktueshëm. Sipas vendimit të KSHC-së, i lënë në fuqi nga

418 Vendim i GJK nr.2/2011.

Gjykata e Apelit, pala e paditur, Ministria e Drejtësisë, detyrohet: a) të rikthejë kërkuesen në pozicionin e mëparshëm të punës dhe b) të paguajë kërkuesen nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.

...Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë element që mund ta bëjë të paqartë apo të paplotë detyrimin e debitorit ndaj kreditorit. Rikthimi në punë është urdhëruar si pasojë e shfuqizimit të urdhrit të largimit nga puna për shkak se është konstatuar si i pabazuar në ligj. Pretendimi i Ministrisë së Drejtësisë se rikthimi në pozicionin e mëparshëm është i pamundur për shkak se në atë pozicion është emëruar një person tjetër, i cili gëzon statusin e nëpunësit dhe për këtë arsye do të konsiderohej e paligjshme masa e largimit me qëllim rikthimin në punë të kërkuseses, është i pabazuar. I takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhje sa më të përshtatshme për këtë rast me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Pavarësisht zgjidhjes që mund dhe duhet të ofrojë debitori, Gjykata vlerëson se pjesa e detyrimit të përcaktuar me vendim gjyqësor sa i përket rikthimit në punë është i qartë, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë.

Sa i takon detyrimin të dytë të debitorit, pagesës së kërkuseses, Gjykata Kushtetuese vlerëson se edhe ky detyrim është i përcaktueshëm për shkak se: Së pari, në dispozitivin e vendimit të KSHC-së përfshihet shprehja "nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare". Gjykata çmon se e vetmja marrëdhënie financiare që ka patur kërkuesja me subjektin e interesuar, Ministrinë e Drejtësisë, është ajo e pagës kundrejt shërbimit apo punës që ajo ofronte në pozicionin e drejtores së QPZ-së. Pra, në këtë kontekst është e qartë se pagesa do të llogaritet mbi bazën e pagës mujore të kërkuseses nga momenti i largimit nga puna deri në momentin e kryerjes së pagesës nga debitori. Së dyti, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.306, dt.13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", pika 14 parashikon se: "Në rastin kur ndaj nëpunësit është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe Komisioni vendos shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të eprorit të drejtpërdrejt, nëpunësi merr pagën e plotë që nga çasti kur janë ndërprerë marrëdhëniet financiare." Kjo dispozitë parashikon qartë dhe saktë se nëpunësi i larguar mbi bazën e një

vendimi të paligjshëm, i cili si i tillë shfuqizohet nga KSHC-ja, përfiton masën e pagës së plotë që nga momenti i largimit. Vendimi i KSHC-së për kërkuesen mbështetet pikërisht në këtë VKM.

*Pra, si përfundim, Gjykata konkludon se titulli ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Apelit është i qartë dhe konkret dhe si i tillë nuk ekziston asnjë arsye për pengesë në ekzekutimin e tij nga ana e debitorit. Gjykata e sheh me vend të theksojë se Zyra e Përmbarimit Tiranë nuk ka gjetur vështirësi në marrjen e masave për zbatimin e vendimit, pra përlllogaritjen e detyrimit që rrjedh prej tij. Për këtë flasin veprimet e ndërmarra aktualisht nga Zyra e Shërbimit Përmbarimor Tiranë për ekzekutimin e tij, megjithëse rezultati nuk ka qenë i suksesshëm, për shkak të refuzimit të vazhdueshëm nga ana e debitorit”.*⁴¹⁹

4.10 Siguria juridike në vendimet gjyqësore

Siguria juridike si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës gjeti shprehje disi vonë në praktikën e GJK shqiptare. Kjo për faktin se përgjithësisht nga praktika e gjykatave ky element konsiderohej jo i lidhur me ndonjë të drejtë themelore por më shumë me hapësirën vendimmarrëse të tyre, e cila bazohet jo vetëm në aktet normative në fuqi por edhe në bindjen e brendshme të gjyqtarit. Kjo e fundit mund të sillte edhe ndryshimin e praktikës gjyqësore për çështje të ngjashme ose për të njëjtën çështje. Problemi i ndryshimit të vendimeve gjyqësore, pas marrjes formë të prerë të tyre dhe ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, ka investuar GJK vitet e fundit. Kjo Gjykatë ka trajtuar parimin e pandryshueshmërisë së vendimeve gjyqësore si pjesë e sigurisë juridike, e cila nuk trajtohet më vetëm në aspektin e akteve normative por shtrihet edhe ndaj vendimeve të gjykatave. Siguria juridike në aspektin e hartimit të akteve normative është trajtuar gjerësisht nga GJK, e cila ka vlerësuar se "*Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë i referon te parimi i shtetit të së drejtës konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës*

⁴¹⁹ Vendim i GJK nr.2/2011.

së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti, parim që është sanksionuar në neni 4 të Kushtetutës dhe që duhet kuptuar e interpretuar në lidhje të ngushtë me aspiratën e shprehur në Preambulën e Kushtetutës ku është skalitur vendosmëria e popullit shqiptar "... për të ndërtuar shtetin e së drejtës, demokratik e social. Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkëlja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Duke qenë se një ndër elementet më thelbësorë të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, del se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës.

E drejta për pension (qoftë edhe për pension të parakohshëm) është e drejtë subjektive. Këto të fundit - marrëdhëniet juridike të krijuara - mbrohen nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, në të cilin përfshihen edhe e drejta e fituar dhe siguria juridike. Prandaj futja e një rregullimi të ri për pensionet duhet të bëhet duke u kujdesur që kjo të respektojë, ndër të tjera, edhe këto të fundit. Ashtu sikundër theksohet edhe në vendimin nr. 34 të vitit 2005 të Gjykatës Kushtetuese, siguria juridike megjithatë nuk mund të eliminojë çdo pasojë negative që mund t'i vijë individit nga rregullimi i ri, përderisa

kjo siguri është e pandashme nga parimi i shtetit social. Prandaj edhe të drejtat e fituara mund të kufizohen si përjashtim, por kufizime të tilla mund të bëhen duke respektuar parimin e përpjesëtimin në lidhje të ngushtë me parimet e drejtësisë, e paanshmërisë dhe të mirëfunksionimit të shtetit. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se ndryshimet e bëra në ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nuk kanë respektuar kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të fituara".⁴²⁰

Ndryshimi i praktikës së GJK për shtrirjen e sigurisë juridike edhe ndaj vendimeve gjyqësore erdhi si pasojë e vendimeve të GJEDNJ me palë shtetin shqiptar, ku ajo deklaroi se siguria juridike duhet të përfshijë edhe veprimtarinë e gjykatave.⁴²¹ Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës sonë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Një nga elementët më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, i cili kërkon, midis të tjerash, që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim.⁴²²

Më konkretisht, GJK është ndalur tek mënyra se si kanë vepruar gjykatat kur kanë rigjykuar një çështje ose kur për të njëjtën çështje janë mbajtur nga instanca të ndryshme qëndrime të kundërta. Sipas saj, "*...vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuesit ka rëndësi edhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike*

⁴²⁰ Vendim i GJK nr.9/2007. Vlen të theksohet se edhe pas këtij vendimi, ligji për pensionin e ushtarakëve u miratua sërish pa marrë parasysh arsyetimin e GJK, e cila mbi bazën e një kërkesë të dytë e shfuqizoi përsëri këtë rregullim. Për më tepër shih edhe vendimin nr.33/2010 të kësaj Gjykate. Në këtë linjë ka ecur kjo Gjykatë edhe për çështje të tjera si ajo për qiramarrësve të shtëpive të ish-pronarëve, të shpërbllimit të ish- të përndjekurve të regjimit komunist, trajtimin e anëtarëve të akademisë së shkencave etj.

⁴²¹ Shih për më tepër çështjet *Xheraj, Balliu, Beshiri etj.* Më hollësisht praktika e GJEDNJ trajtohet më poshtë në nënçështjen GJEDNJ për GJK shqiptare.

⁴²² Vendim i GJK nr.7/2009.

nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Parë në prizmin e këtyre konsideratave, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykatat e zakonshme duke mos trajtuar vlerën e vendimit gjyqësor nr. 5972, datë 18.09.1995, kanë bërë të pavlefshëm një proces gjyqësor që kishte përfunduar me dhënien e këtij vendimi. Një gjë e tillë nuk mund të bëhet pa dhënë arsyt edhe në vështrim të nenit 451 shkronja "a" të KPC, i cili trajton detyrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për pasojë, mënjanimi i një vendimi të tillë pa dhënë asnjë arsye cenon besimin e individit tek shteti dhe institucionet shtetërore dhe për pasojë përbën cenim të parimit të sigurisë juridike".⁴²³

Gjykata ka shqyrtuar edhe rastet lidhur me vendimmarrjen e GJL mbi kërkesat për rishikim duke nënvizuar se "...Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese konceptin e sigurisë juridike, të të drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Për sa i përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka një jurisprudencë të sajën, duke u shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt" përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi, ku kërkohet të cenohen të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre.

...Në çështjen në shqyrtim subjekti i interesuar ka fituar të drejtën e pronës me vendim gjyqësor të formës së prerë por legjislati shqiptar, konkretisht KPC në dispozitat 445 e në vijim, ka parashikuar mënyra ankimi ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë nëpërmjet një mjeti procedural të jashtëzakonshëm sikundër është kërkesa për rishikim. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, pritshmëria e ligjshme e kërkuesit ka qenë pranimi i kërkesës së tij për rishikim,

⁴²³ Vendim i GJK nr.23/2007.

nisur nga fakti se Gjykata e Lartë ka pasur një vendim unifikues mbi këtë çështje, ku ka shprehur qëndrimin e saj ndaj dispozitave ligjore që nënkupton një përqaasje dhe pritshmëri të ligjshme për pranimin e kërkesës për rishikim. Për sa kohë që kërkuesi kishte në dorë një mjet ankimi për të ezauruar, edhe pse i jashtëzakonshëm, ai ishte në kushtet ku mund të fitonte të drejtën e tij (pritshmëri e ligjshme)".⁴²⁴

Më tej në vazhdim të paprekshmërisë së vendimeve gjyqësore, GJK ka deklaruar se në harmoni me parimin e sigurisë juridike ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të KPC, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. GJK ka çmuar se "...vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi por dhe siguri kësaj marrëdhënie. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. ...vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuetit ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmyet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim.

...Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese

⁴²⁴ Vendim i GJK nr.20/2008.

çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivitet të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

Gjykata Kushtetuese konstaton se padia mbi bazë të së cilës është dhënë vendimi i mëparshëm nr.56, datë 23.09.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka patur për objekt njohjen e të drejtës trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e trashëgimlënëses dhe konkretisht mbi vilën nr.27 të ndodhur në Rrugën "Nikole Tupe", Tiranë. Për këtë arsye, pjesë e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë dhe hetimi e vërtetimi i faktit nëse prona, objekt gjykimi, ka qenë apo jo pronë tërësisht apo pjesërisht e trashëgimlënëses M.L.... Gjithashtu, çështje e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë edhe përcaktimi i ligjit në bazë të të cilit do të njihet pjesa trashëgimore e kërkuesve mbi pasurinë e trashëgimlënëses. Në lidhje me faktin se në pronësi të kujt ka qenë banesa objekt mosmarrëveshje, kërkuesit kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të trashëgimlënëses, ndërsa subjektet e interesuara kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të bashkëshortit të saj, A.L., trashëgimlënësit të subjekteve të interesuara. Në fund të këtij gjykimi gjykatat, bazuar në Kodin Civil të vitit 1929, kanë pranuar përfundimisht faktin juridik se banesa objekt gjykimi, ka qenë tërësisht pronë e trashëgimlënëses M.L. Gjykatat kanë konkluduar gjithashtu se për caktimin e pjesëve trashëgimore ndërmjet ndërgjyqësve do të merrej për bazë Kodi Civil i vitit 1929 sipas të cilit, trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo Dekreti nr.1892, datë 05.07.1954 "Mbi Trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, si bashkëshorti, ashtu edhe trashëgimtarët e gjakut përfitojnë në pjesë të barabarta nga 1/2 pjesë secili.

...Gjykata Kushtetuese është shprehur se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të respektojnë

rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to.

Bazuar në jurisprudencën kushtetuese Gjykata vëren, se megjithëse në dispozitivin e vendimit nr.172, datë 22.01.1996 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk shprehet për pjesët takuese të trashëgimtarëve, përcaktimi konkret i tyre del jo vetëm nga pjesa arsyetuese e vendimit nr.56, datë 23.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por edhe nga vetë referimi i gjykatës tek nenet 474 dhe 487 të KC të vitit 1929 që duhen zbatuar në këtë rast. Gjykatat e mësipërme, në lidhje me të drejtën e pronësisë gjatë këtij gjykimi, duke interpretuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, kanë pranuar faktin se trashëgimlënësja M.L ka qenë pronare e vetme e banesës objekt gjykimi. Gjithashtu gjykatat, bazuar në dispozitat e lartpërmendura të Kodit Civil të vitit 1929 si dhe në faktin që P.K. është trashëgimtar i vetëm në lidhje gjaku i trashëgimlënësës arsyetojnë, se këtij i takojnë 2/3 pjesë të banesës ndërsa subjekteve të interesuara, si trashëgimtarë të bashkëshortit pasjetues, 1/3 pjesë e kësaj pasurie. Nga ky këndvështrim Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi nr.56, datë 23.09.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për pjesën që detyron subjektet e interesuara të njohin të drejtën trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e të ndjerës M.L, është i qartë.

Në lidhje me padinë mbi bazën e së cilës janë dhënë vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se këto vendime kanë të bëjnë me fazën e parë të gjykimit të pjesëtimit gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata e sheh të nevojshme që të theksojë edhe një herë çështjet që duhet të zgjidhë faza e parë e këtij gjykimi, të cilat në bazë të e nenit 370 të KPC janë hetimi dhe përcaktimi i të drejtës së bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre dhe sendet që do të pjesëtohen. Gjykata çmon se në një gjykim pjesëtimi përcaktimi i rrethit të bashkëpronarëve është i lidhur në mënyrë të pandashme me përcaktimin e sendeve që do

të pjesëtohen. Gjatë këtij gjykimi objekti i pjesëtimit është i njëjti send i paluajtshëm që ka qenë objekt gjykimi edhe në padinë për njohjen e të drejtës trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e M.L. Në lidhje me rrethin e trashëgimtarëve bashkëpronarë, gjykatat e sistemit gjyqësor kanë konkluduar se banesa do të pjesëtohet vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, kërkuesve si trashëgimtarë të gjakut të trashëgimlënëses dhe subjektit të interesuar si trashëgimtare e bashkëshortit të trashëgimlënëses.

Gjykata e apelit, në vendimin nr.66, datë 28.04.2005, në përcaktimin e pjesës së pronësisë në banesë, në ndryshim nga sa ishte vërtetuar dhe njohur në gjykimet e vitit 2002 ka arritur në përfundimin se banesa ka qenë send në bashkëpronësi ndërmjet trashëgimlënëses dhe bashkëshortit të saj, gjë që ka ndikuar në madhësinë e pjesës që do t'i takonte kërkuesve. Përsa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke pranuar indirekt zbatimin e KC të vitit 1929, pra që trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo të Dekretit nr.1892, datë 05.07.1954 "Mbi Trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, pjesët trashëgimore duhet të jenë të barabarta. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Gjykata Kushtetuese, duke i krahasuar vendimet e mëparshme me vendimet objekt kundërshtimi vëren se gjykimi me objekt njohjen e të drejtës trashëgimore mbi banesën i vitit 2002 është një gjykim njohje dhe vërtetimi me qëllim që të krijohet apo të ndryshohet bashkëpronësia, ndërsa gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit është një gjykim gjithashtu njohës dhe vërtetues, por që ka qëllim t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë. Megjithatë thelbi i mosmarrëveshjeve të vendosura me vendimin nr.56, datë 23.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara dhe me vendimin nr.4, datë 23.01.2007 të këtyre Kolegjeve është i njëjtë. Ai konsiston në përcaktimin e faktit se në pronësi të kujt ka qenë vila nr.27, ndodhur në Rrugën "Nikole Tupe" Tiranë dhe në bazë të kujt ligji material do të rregullohej trashëgimia ligjore e M.L. Në të dyja gjykimet palët, objekti dhe shkaku kanë qenë të njëjtë. Por, Gjykata Kushtetuese konstaton se zgjidhjet që gjykatat e sistemit gjyqësor u kanë dhënë kanë qenë të ndryshme.

*...Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimet objekt kërkese janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e nenit 6 të KEDNJ. Ato kanë cenuar parimin e sigurisë juridike duke i hequr efektet ligjore vendimit të formës së prerë nr.56, datë 23.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin nr.172, datë 22.01.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë”.*⁴²⁵

⁴²⁵ Vendim i GJK nr.24/2008. Shih edhe mendimin e pakicës, e cila është kundër sa i takon deklaramit se ndodhemi para dhënies së dy vendimeve gjyqësore të ndryshme. Pakica është e mendimit se ka të bëjë me rregullime ligjore të ndryshme dhe jo me praktikë gjyqësore të ndryshme, gjë e cila nuk mund të kërkohet në rrugën e kërkesës individuale.

III. GJEDNJ PËR GJK SHQIPTARE – NEVOJA PËR PËRMIRËSIM

Ankimi individual kushtetues para GJK shqiptare duke e analizuar në thellësi mund të çojë në përfundime të ndryshme lidhur me aspekte të veçanta të tij. Megjithatë për qëllimet e këtij shkrimi do të fokusohemi vetëm tek aspekti i efektivitetit të tij me synim garantimin e të drejtave që rrjedhin nga neni 6 i KEDNJ dhe neni 42/2 i Kushtetutës. Ankimi individual në GJK konsiderohet praktikisht si mjet efektiv sa i takon elementëve që lidhen me disa të drejta themelore procedurale si: e drejta ankimit, e mbrojtjes, parimi i gjykatës kompetente, kontradiktoriteti në gjykim etj. GJK në këto raste jo vetëm konstaton shkeljen e bërë nga gjykatat ose organet e tjera të administratës publike, por edhe shfuqizon aktin e prodhuar prej tyre si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, duke ia kthyer atyre për rishqyrtim. Megjithatë, duke iu referuar rasteve konkrete si dhe praktikës së GJEDNJ, ky ankim nuk rezulton të jetë efektiv sa i takon disa elementëve të veçantë të procesit të rregullt të tilla si p.sh: çështjet që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore (bashkë me të drejtën për dëmshpërblim), çështjet që kanë të bëjnë me zgjatjen e procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm si dhe me të drejta të tjera materiale. Nuk e shoh me vend të ndalem tek çështja nëse ankimi në GJK shqiptare duhet të konsiderohet apo jo (të paktën në kuptimin formal) mjet i fundit efektiv kombëtar. Kjo tashmë është deklaruar në mënyrë

të përsëritur nga GJEDNJ,⁴²⁶ gjë e cila sjell pas detyrimit për t'u marrë në konsideratë nga institucionet shqiptare kompetente.

Po përse paraqet rëndësi analiza lidhur me efektivitetin e ankimit individual para GJK? Mjetet e ankimit sot konsiderohen si mekanizmat kryesorë që përfshin rendi juridik i brendshëm i një vendi me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Llojet dhe hapësira mbrojtëse e tyre bëjnë diferencën midis mjeteve efektive dhe joefektive brenda sistemit të brendshëm të një shteti. Kohët e fundit është shtruar para profesionistëve shqiptarë çështja lidhur me mjetet e brendshme të ankimit, cilat prej tyre ofrojnë mbrojtje efektive për individët dhe deri ku shkon (duhet të shkojë) kjo mbrojtje. Një nga arsyet e këtij debati është edhe fakti se vitet e fundit janë shtuar kërkesat e shtetasve shqiptarë para GJEDNJ lidhur me vendosjen në vend të së drejtës së tyre të cenuar nga institucionet e brendshme shqiptare. Ankimi në GJEDNJ është një mjet subsidiar, pra mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet e brendshme juridike që sistemi i një vendi ka parashikuar për garantimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në KEDNJ.⁴²⁷ Prandaj çështja e mjeteve të brendshme të ankimit është e rëndësishme të shqyrtohet dhe nga GJEDNJ lidhur me faktin nëse këto mjete vërtetë janë efektive brenda vendit dhe a është e mundur që individi ta rivendosë në vend të drejtën e shkelur duke iu drejtuar asaj Gjykate. Koncepti i KEDNJ dhe si rrjedhim edhe qëndrimi i elaboruar nga GJEDNJ është se shtetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet të garantojnë brenda sistemit të brendshëm mundësitë për të riparuar shkeljet që administrata publike i bën individit.⁴²⁸ Si pjesë e përpjekjeve janë pa dyshim iniciativat dhe reformat legjislative, por nuk ngelet pa rëndësi edhe praktika e vetë institucioneve që janë të ngarkuara drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave themelore. Të dyja këto të ndërthurura së bashku i shërbejnë një mbrojtjeje sa më të mirë të individit brenda sistemit kombëtar duke e konsideruar ankimin në GJEDNJ realisht si mjet subsidiar.

⁴²⁶ Shih për më tepër çështjet *Balliu, Beshiri, Marini, Qufaj k. Shqipërisë*, cituara më sipër.

⁴²⁷ Çështja *Z dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe*, 10 maj 2001.

⁴²⁸ Vendime të GJEDNJ *Loizidou k. Turqisë*, 23 mars 1995; *Bankovic dhe të tjerë k. Belgjikës dhe 16 shtete të tjera anëtare*, 19 dhjetor 2001.

Çfarë cilësisht duhet të ketë një mjet juridik që të konsiderohet si efektiv sipas GJEDNJ? Neni 13 i KEDNJ i garanton çdokujt, që pretendon cenim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Konventë, të ketë në dispozicion një mjet ankimi efektiv në sistemin e brendshëm. GJEDNJ në çështjen *Scordino kundër Italisë*, elaboroi kuptimin e "mjetit efektiv" në lidhje me kërkesat për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm duke synuar në të njëjtën kohë dhënien e një udhëzuesi për shtetet anëtare në krijimin e mjeteve të brendshme sa më efektive.⁴²⁹ Megjithatë, thelbi i udhëzimit për shtetet anëtare ishte se "zgjidhja më e mirë në terma absolutë, ashtu si shumë sfera të tjera, është parandalimi". Mjeti efektiv i ankimit duhet të jetë i tillë që jo vetëm të vendosë lidhur me të drejtat që parashikon KEDNJ por edhe të rivendosë sa të jetë e mundur të drejtën e shkelur. Konventa kërkon që ky mjet efektiv të garantohet nga sistemi i brendshëm. Për këtë qëllim, me shprehjen "efektive" do të nënkuptohet mjete juridike me fuqi të detyrueshme, që në shumicën e rasteve identifikohet me gjykatat. Edhe instancat administrative mund të konsiderohen si mjete efektive nëse ato realisht arrijnë ta vendosin të drejtën e cenuar të individit në vend.⁴³⁰ Instanca e ankimit, sipas nenit 13 KEDNJ, duhet të të shqyrtojë jo vetëm nga ana substanciale cenimet e të drejtave të garantuara nga Konventa, por të garantojë dhe një mbrojtje juridike të përshtatshme. Në një çështje të hershme të GJENDJ, ajo ka përcaktuar kriteret që një instancë duhet të përmbushë për t'u konsideruar si efektive. Kështu, ajo ka përcaktuar se kompetencat dhe garancitë procedurale në proces janë thelbësore për të arritur në përfundimin nëse një mjet është apo jo efektiv.⁴³¹ Mjeti juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe ushtrimi i tij të mos pengohet pa arsye me veprime dhe mosveprime nga autoritetet shtetërore. Në mënyrë të përmbledhur, sipas nenit 13 të KEDNJ, do të konsiderohet si efektiv ai mjet juridik që:

⁴²⁹ Vendim i datës 29 mars 2006.

⁴³⁰ *Michael Tonne, Effektiver Rechtsschutz durch staatliche Gerichte als Foerderung des Europaischen Gemeinschaftsrecht (1997), fq.184.*

⁴³¹ Çështja *Klass k. Gjermanisë*, 6 shtator 1978.

- Së pari, garanton ekzistencën në nivel kombëtar të mjeteve që mundësojnë zbatimin e thelbit të së drejtës.
- Së dyti, parashikon shprehimisht dhe qartë autoritetin kompetent, thelbin e ankimit për shkeljen konkrete dhe
- Së treti, mundësinë e rivendosjes në vend të të drejtës së shkelur.⁴³²

Neni 34 i njeh të drejtën individëve, grupeve të personave dhe ojf-ve të ushtrojnë ankim individual, nëse ndihen të cenuar në të drejtat e garantuara nga KEDNJ. Neni 35 i KEDNJ vendos si kusht për ankimin shterrimin e të gjitha mjeteve juridike të brendshme. Shterrimi i mjeteve të brendshme i parashikuar në nenin 35 KEDNJ detyron ankuesit të përdorin mjetet e brendshme që janë zakonisht në dispozicion dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor për të mundësuar rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë e sigurt, si në praktikë dhe në teori. Nëse këto kritere nuk përmbushen, ato humbasin disponueshmërinë dhe efektivitetin e tyre.⁴³³ Shterrim i mjeteve të brendshme nënkupton situatën kur individ i nuk ka më asnjë mjet tjetër ankimi efektiv (administrativ ose/dhe gjyqësor) për të rivendosur në vend të drejtës e tij të shkelur. Në vendet me kontroll kushtetues të përqendruar mjeti i fundit i ankimit është kryesisht gjykata kushtetuese, ndërsa në ato me kontroll kushtetues të shpërndarë është kryesisht gjykata lartë.⁴³⁴

Arsyeja tjetër pse mjeti efektiv juridik është i rëndësishëm ka të bëjë me faktin se mjeti efektiv ofron një avantazh pakrahasueshmërisht më të madh sesa kompensimi për dëmin e ardhur, gjë e cila lidhet direkt me faktin e parandalimit të një shkelje të rëndë dhe të vazhdueshme gjatë gjithë procesit dhe nuk ka për qëllim vetëm

⁴³² Frowein/Peukert, EMRK-Kommentar (1996), fq. 431.

⁴³³ Çështja *Ramadhi k. Shqipërisë*, 13 nëntor 2007.

⁴³⁴ *Arta Vorpsi*, Ankimi individual para GJK shqiptare – Mjet juridik efektiv? Referat mbajtur në konferencën shkencore “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të një procesi të rregullt ligjor” organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë Tiranë.

riparimin *a posteriori* të shkeljes, siç e ka mjeti kompensator. Masat parandaluese mund të jenë të karakterit strukturor ose të lidhura me çështjen konkrete.⁴³⁵ Megjithatë ka dhe raste kur rikthimi në gjendjen e mëparshme (reparation) nuk është i mundur, por mund të shihen mënyrat e tjera siç janë: *restitution, compensation dhe satisfaction*.⁴³⁶

Megjithatë, ajo që duhet të mbahet parasysh në rastin e Shqipërisë është se GJEDNJ e ka konsideruar mosekzistencën e mjeteve efektive jo vetëm shkelje të nenit 13 të KEDNJ por edhe cenim të të drejtës themelore që kërkuesi synon të verë në vend nëpërmjet mjetit efektiv. Kështu, në çështjen *Driza k. Shqipërisë*, GJEDNJ ka deklaruar se "*ashtu si në çështjen Beshiri k. Shqipërisë*⁴³⁷, *Gjykata konstaton se ankuesit i është mohuar e drejta për një mjet juridik efektiv në lidhje me pretendimet e tij, e cila përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1*".⁴³⁸

Praktika e deritanishme e GJK ka treguar se dhënia e një vendimi përfundimtar prej saj nuk ka sjellë gjithmonë rivendosjen në vend të situatës para shkeljes të individit dhe as kompensim për dëmin e shkaktuar atij nga veprimet e administratës publike. Lind pyetja: Ku qëndron problemi që një organ kushtetues, i cili gjykon bazuar në rregullat procedurale të mirëpërcaktuara, jep vendime përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim, por në fund të procesit nuk arrin t'i garantojë individit të drejtat e tij të garantuara në KEDNJ dhe në Kushtetutë? Pse ankimi individual kushtetues, në raste të caktuara, nuk mund të konsiderohet mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ?

Megjithëse qëllimi i këtij botimi është paraqitja e ecuresë së jurisprudencës së GJK lidhur me hapësirën e kontrollit dhe standartet e vendosur për parimin e procesit të rregullt ligjor, u gjykua e nevojshme të jepen edhe disa propozime lidhur me mangësitë që vihen re në praktikën aktuale të kësaj Gjykate. Propozimet konsistojnë

⁴³⁵ Çështja *Scordino k. Italisë*, 29 mars 2006.

⁴³⁶ Po aty.

⁴³⁷ Vendim i GJEDNJ, 22 gusht 2006.

⁴³⁸ Shih për më tepër çështjen *Driza k. Shqipërisë*, 13 nëntor 2007.

kryesisht në masa legjislative por edhe në zgjerim të mundshëm të hapësirës së kontrollit të vetë GJK. Kjo nevojë vjen edhe nga praktika më e fundit e GJEDNJ me palë shtetin shqiptar, ku ajo ka mbajtur qendrim lidhur edhe me hapësirën e kontrollit të GJK. Për këtë arsye, shihet me vend të ndalemi në disa prej tyre dhe detyrimeve që lindin për përmirësim.

Në fakt, çështjet e gjykuara nga GJEDNJ me palë shtetin shqiptar si dhe rastet kur ajo ka konstatuar shkelje të të drejtave të parashikuara nga Konventa si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të administratës publike apo si rrjedhojë e mungesave në legjislacion, nuk janë ende aq të shumta në numër. Megjithatë ndodhemi në një situatë ku shteti shqiptar, konkretisht, ligjvënësi, gjykatat si dhe zyra të tjera që janë pjesë e kalvarit nëpër të cilin duhet të kalojë individi shqiptar për të fituar dhe gëzuar të drejtën e tij (kryesisht të lidhura me të drejtën e pronës, por jo vetëm) duhet të marrin masa të shpejta dhe afatgjatë me qëllim mospërsëritjen e shkeljeve në të ardhmen por edhe kompensimin në raste të caktuara. Në veçanti, duke iu referuar edhe temës së këtij botimi, pra ankimit para GJK, lind detyrimi që ky mjet juridik duhet të bëhet realisht dhe plotësisht efektiv sa i takon elementëve që u analizuan më lartë, me qëllim riparimin e shkeljes sa më shpejt dhe brenda sistemit. Në këtë kuadër, po parashiroj disa nga problemet kryesore të kompetencës së GJK për shqyrtuar kërkesat për proces të parregullt ligjor si dhe disa ide konkrete lidhur me përmirësimin e situatës ligjore dhe faktike, të cilat njëkohësisht synojnë edhe hapjen e debatit juridik publik mbi to.

1. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm

1.1 *Praktika e GJEDNJ mbi kompetencën e GJK*

Në lidhje me pretendimet për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, GJEDNJ ka theksuar se neni 13 i KEDNJ garanton një zgjidhje efikase përpara autoriteteve vendase për shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ. Mjetet efektive në dispozicion të palëve ndërgjyqëse në një sistem vendas për ngritjen e pretendimeve rreth tejzgjatjes së procedurave

do të konsiderohen si efektive, në kuptim të nenit 13 të Konventës, nëse ato parandalojnë shkeljen e pretenduar ose vazhdimin e saj, ose sigurojnë një adresim të përshtatshëm për çdo shkelje të mundshme që tashmë ka ndodhur.⁴³⁹ Prandaj neni 13 ofron një alternativë: një mjet ankimi është efektiv, nëse mund të përdoret ose për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t'u siguruar palëve ndërgjyqëse ushtrimin e një mjete të përshtatshëm për vonesat e ardhura deri në këtë moment.⁴⁴⁰ Gjithsesi, GJEDNJ ka theksuar se zgjidhja më e mirë në terma absolutë është pa dyshim parandalimi i shkeljes. Aty ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6/1 të KEDNJ, krijimi i një mjete ankimi për të përshpejtuar procedurat me qëllim parandalimin e tejzgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë. Ky mjet ankimi do të ofronte pa diskutim një avantazh mbi një mjet ankimi që rregullon vetëm kompensimin, meqenëse ai parandalon shkelje të mëtejshme në lidhje me të njëjtat procedura, pra nuk riparon shkeljet *a posteriori*, siç ndodh me një mjet ankimi me qëllim kompensimin.⁴⁴¹

GJEDNJ ka konstatuar se, megjithëse në teori GJK mund të marrë në shqyrtim ankimet individuale për tejzgjatje të procesit, nuk ka asnjë rast ku ajo të ketë vendosur mbi tejzgjatjen e procedurave. Nisur nga kjo GJEDNJ ka konstatuar se nuk provohet që ankimi sipas nenit 131/f të Kushtetutës para GJK shqiptare mund të konsiderohet me siguri të mjaftueshme se përbën një mjet efektiv ankimi për pretendimet e kërkuësve sa i takon gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.⁴⁴² Argumenti i përdorur nga GJK deri tani për mosefektivitetin e këtij ankimi lidhet me faktin se, edhe sikur GJK të ndërhynte me qëllim moszgjatjen tej afateve të procesit gjyqësor, legjislacioni shqiptar nuk ka parashikuar asnjë procedurë konkrete gjatë të cilës GJK të mund të vendosë mbi ankimet lidhur me tejzgjatje të procesit.

439 Çështja *Kudla k. Polonisë*, 26 tetor 2000.

440 Çështja *Mifsud k. Francës*, nr.57220/2000.

441 Shih çështjen *Scordino k. Italisë*, 29 mars 2006.

442 Çështja *Gjonboçari k. Shqipërisë*, 31 mars 2008 (përfundimtar).

Nga vetë natyra e gjykimit që ka GJK, e cila mund të vihet në lëvizje vetëm pas shterrimit të mjeteve të tjera juridike, rezulton se, pa përfunduar të gjitha shkallët dhe mjetet e gjykimit, ajo nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesa të tilla. Lind pyetja: A duhet kërkuar në këtë rast shterrimi i mjeteve kur kërkuesi ankimin e tij e bazon pikërisht në mospasjen mundësi për t'i shterrur ato, pasi gjykatat nuk gjykojnë në përputhje me standartet kushtetuese për afatin e arsyeshëm? Ç'kuptim do të kishte kërkitimi i tij por të priste sa të përfundonte i gjithë procesi gjyqësor për këtë lloj ankimi? Një gjë e tillë duket se humb thelbin e së drejtës së kërkuarit, pasi pas përfundimit të procesit riparimi është i pamundur. Mund të pretendohet vetëm për kompensim për dëmin e shkaktuar nga tejzgjatja e procesit. I këtij mendimi ka qenë edhe GJEDNJ, e cila ka theksuar se "*GJK do të mundej të ofronte një dëmshpërblim, por mungesa e praktikës së deritanishme tregon se ky mjet është i pasigurtë dhe si i tillë nuk është efektiv*".⁴⁴³ GJK deri sot ka patur pak kërkesa lidhur me pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor sa i takon tejzgjatjes së afateve të gjykimit. GJK një kërkesë të tillë e ka konsideruar si jashtë juridiksionit për shkak të mospasjes së një vendimi përfundimtar të formës së prerë.⁴⁴⁴ Pritet me kërshëri ecuria e mëtejshme e praktikës së kësaj Gjykate lidhur me këtë çështje⁴⁴⁵.

⁴⁴³ Çështja *Marini k. Shqipërisë*, 18 dhjetor 2007.

⁴⁴⁴ Çështja me kërkuar *Shoqëria Iliria Srl*, vendim nr.26/2009 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK për moskalimin e çështjes në seancë. Është me interes të lexohet mendimi i pakicës së këtij vendimi, i cili në vështrim të zhvillimeve më të fundit të jurisprudencës së GJEDNJ, ka konsideruar se "...përderisa ekziston një mjet ankimi i përgjithshëm përpara Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës, ankesa me pretendimin për gjykimin e një çështje teje afateve të arsyeshme mund të paraqitet në rrethana të caktuara, edhe përpara shterrimit të mjeteve të tjera të ankimit të brendshëm."

⁴⁴⁵ Aktualisht para GJK ka ardhur për shqyrtim një kërkesë për gjykim teje afateve të arsyeshme, e cila ka kaluar për gjykim në seancë gjyqësore por ende nuk ka një vendim përfundimtar lidhur me të.

1.2 Propozim për përmirësim

Disa legjislacione europiane kanë parashikuar së fundmi, si detyrim i përcaktuar nga GJEDNJ, edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përsheptimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në KPP dhe KPC lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përsheptim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo padi mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe mbase edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet parë si parandalues, duke i dhënë të kuptojë gjykatave se në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit, individi ka një mjet efikas që do t'i vijë në ndihmë.⁴⁴⁶

2. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë

2.1 Praktika e GJEDNJ mbi kompetencën e GJK

Shqyrtimi i kërkesave lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore si pjesë e procesit të rregullt ligjor nga GJK shqiptare ka filluar relativisht vonë.⁴⁴⁷ GJK sot pranon për shqyrtim kërkesat me këtë objekt duke kontrolluar në çdo rast arsyet dhe shkaqet që kanë çuar në mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë. GJK, sipas rastit, konstaton cenim të procesit të rregullt kur arrin në përfundimin se nuk janë kryer veprimet e nevojshme nga ana e administratës publike për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor

⁴⁴⁶ Ky mjet është futur si risi nga ligjvënësi gjerman dhe ai italian, nisur nga praktika e GJEDNJ, megjithëse ndaj Gjermanisë nuk ka patur çështje konkrete.

⁴⁴⁷ Çështja *Memishaj k. Bashkisë së Tiranës*, vendim i GJK nr. 6/2006.

të formës së prerë.⁴⁴⁸ Megjithatë gjatë praktikës u konstatua se, ndryshe nga faza fillestare, ku kërkesat përqendroheshin vetëm te konstatimi i cenimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, më vonë, kërkesat filluan të shoqërohen edhe me pretendime për dëmshpërblim material për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.⁴⁴⁹ Ajo që bie në sy në praktikën e GJK është fakti se, megjithëse kjo Gjykatë ka arritur në përfundimin se afati për ekzekutim të vendimit gjyqësor ka qenë jo i arsyeshëm për faj të administratës shtetërore dhe jo të sjelljes së individit (kreditorit), në disa raste këtë konkluzion nuk e gjen të pasqyruar në dispozitivin e vendimit të saj.⁴⁵⁰ Gjithashtu, ky konstatim nuk shoqërohet me asnjë detyrim tjetër ndaj organeve përgjegjëse për të realizuar të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor në fazën e ekzekutimit të së drejtës së tij.⁴⁵¹

Në fakt, sa i takon kompetencës së GJK për këtë çështje, GJEDNJ ka konstatuar se *"në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, legjislacioni kombëtar e lejon venien në vend të shkeljeve, por është jurisprudenca e GJK shqiptare që vendos interpretimin strictu sensu të konceptit të procesit të rregullt ligjor sipas kuptimit të nenit 6/1 të KEDNJ duke përjashtuar nga ky koncept dhënien e kompensimit për shkak të mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor ... e drejta për proces të rregullt ligjor duhej të ishte interpretuar (nga GJK shqiptare-shënim imi) në mënyrë që të garantonte një mjet juridik efektiv ... GJK ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën në lidhje me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor si pjesë e juridiksionit të saj..."*⁴⁵²

⁴⁴⁸ Vendime të GJK nr.6/2010; nr.8/2010; nr.13/2010; nr.14/2010 ;nr.43/2007; nr.35/2010.

⁴⁴⁹ Çështja me kërkuar *Alsula, Elgakoti* etj.

⁴⁵⁰ Shih vendimin e GJK nr.6/2011.

⁴⁵¹ Shih vendimin e GJK nr.2/2011.

⁴⁵² Çështja *Qufaj k. Shqipërisë*, 30 mars 2005.

Pra, nisur nga konstatimi i bërë nga GJEDNJ, i cili është ritheksuar edhe në një çështje të mëvonshme,⁴⁵³ rezulton se GJK nuk ka asnjë pengesë për të vendosur mbi kërkesat për kompensim si rezultat i vonesave të paarsyeshme dhe të pajustificuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore duke iu referuar dispozitave të përgjithshme materiale dhe procedurale për këtë qëllim. Megjithatë deri tani, GJK ka hezituuar të ndërmarrë një hap të tillë. Kjo ka sjellë si pasojë që, megjithëse GJK e konstaton procesin të parregullt për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, garantuar neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ, vendimi i GJK nuk sjell për individin asgjë konkrete. Pas këtij hapi ai ka në dorë edhe një vendim tjetër gjyqësor të formës së prerë dhe të detyrueshëm për zbatim si dhe ka plotësuar kushtin formal të ezaurimit të mjeteve të brendshme në kuptim të nenit 35 KEDNJ për t'iu drejtuar GJEDNJ si mjet realisht efektiv, i cili në vendimet ende të pakta me palë shtetin shqiptar ka reaguuar sipas rastit me kompensim ose marrjen e masave të menjëhershme nga shteti shqiptar (brenda afatit maksimal prej 3 muaj) me qëllim rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur të individit.

Lidhur me efektivitetin e ankimit individual para GJK vlen të ndalemi edhe tek kërkesat që së fundmi kanë filluar të paraqesin kërkuesit edhe sa i takon dëmshpërblimit për shkak të vonesave të papërligjura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kështu, në një rast GJK ka deklaruar se *"kërkuesi ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese edhe dëmshpërblimin financiar dhe jofinanciar, të ardhur për shkak të vonesës në ekzekutimin e vendimeve. Gjykata Kushtetuese thekson se në sistemin tonë ligjor kushdo që konsideron se ka patur një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ka shterrur të gjitha mjetet e brendshme juridike, në kuptim të nenit 131, germa "f", të Kushtetutës. Një kërkesë e tillë është edhe ajo që ka paraqitur kërkuesi lidhur me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i ekzekutimit të një afati të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore në favor të tij.*

⁴⁵³ Shih për më tepër çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*, 29 shtator 2009.

Sa i përket kërimit për kompensimin e dëmit si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të KC që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i KC). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, germa "f", të Kushtetutës...Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj".⁴⁵⁴

Kjo linjë ka vazhduar dhe është ende aktuale duke vënë theksin tek fakti se "...kërkuesi nuk legjitimohet racione personae për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkak se nuk ka shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, parakusht ky i sanksionuar në nenin 131 germa "f" të Kushtetutës. Gjykata arrin në këtë konkluzion, pasi mbrojtja juridike e kërimit të këtij dëmi në bazë të nenit 42 të Kushtetutës, të KC dhe të KPC realizohet me anë të ngritjes dhe gjyqimit të padisë me një objekt të tillë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të pushtetit gjyqësor të parashikuara nga neni 135 i Kushtetutës. Pas shterrimit të këtyre mjeteve juridike, individit për mbrojtjen e kësaj të drejte mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por kurdoherë që shkelja e të drejtës së tij kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor.....ku në sferën e gjyqimit nga Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet as mënyra e zbatimit të ligjit material, as mënyra e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme".⁴⁵⁵

Pra, mesa duket deri në një ndryshim të bazës ligjore nuk do të ketë ndonjë ndryshim të praktikës së GJK në këtë drejtim.

⁴⁵⁴ Vendim i GJK nr.8/2010.

⁴⁵⁵ Vendim i GJK nr.23/2010. I njëjti qendrim është mbajtur edhe në vendime të mëpasshme, shih vendimin nr.35/2010.

3. Propozim për përmirësim

Siç u përmend edhe më lartë, një konstatim i gjykatës pa një mundësi konkrete për individin të paktën për ta kompensuar lidhur me pasojat negative të kësaj shkelje, do të ishte pa kuptim. GJEDNJ në një rast ka konstatuar se megjithë konstatimin e shkeljes GJK duhej të kishte marrë edhe masa të tjera (p.sh rikthimin në punë ose dëmshpërblim material ose jomaterial).⁴⁵⁶ Ligji për GJK parashikon vetëm një gjobë prej 100.000 lekë lidhur me mosekzekutimin e vendimeve të vetë GJK, e cila deri sot nuk është zbatuar asnjëherë.⁴⁵⁷ Megjithatë kjo dispozitë nuk duket e përshtatshme dhe as e mjaftueshme për rastet kur konstatohet mosekzekutimi i vendimit gjyqësor në kuadër të procesit të rregullt. Kompensimi duhet të jetë i tillë që të mund të kënaqë disi kërkuesin duke patur parasysh pasojat negative që ai ka vuajtur në pritje të gëzimit të së drejtës së tij të fituar gjyqësisht. Megjithatë ka diskutime lidhur me faktin nëse GJK ka mundësi të pranojë kërkesat për dëmshpërblim financiar duke iu referuar normave të KPC, pa qenë nevoja e parashikimit në ligjin për GJK. Duke qenë se GJK deri tani nuk e ka bërë një hap të tillë, atëherë mbetet për t'u parë mundësia e parashikimit të përshtatshëm procedural për këto raste.

4. Siguria juridike në vendimet gjyqësore

4.1 *Praktika e GJEDNJ për kompetencën e GJK*

Parimi i sigurisë juridike është elaboruar jo vetëm nga GJEDNJ por edhe nga vetë GJK shqiptare, e cila duke u bazuar edhe tek konstatimet e GJEDNJ në çështjen *Driza k. Shqipërisë*, vendosi të merrte në shqyrtim pretendimet për cenim të procesit të rregullt ligjor që lidheshin me ndryshimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga një gjykatë më e lartë.⁴⁵⁸ Siguria juridike presupozon, veç të tjerave,

⁴⁵⁶ Çështja *Gjyli k. Shqipërisë*, 29 shtator 2009.

⁴⁵⁷ Neni 81/4 i ligjit për GJK shqiptare.

⁴⁵⁸ Çështja *Driza k. Shqipërisë*, 13 nëntor 2007.

besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. *"Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht. Është pranuar tashmë se siguria juridike si element i shteti të së drejtës shtrihet jo vetëm ndaj akteve të ligjvënësist por edhe ndaj vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, të cilat nuk duhet të vihen në dyshim. Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të gjësë së gjykuar".*⁴⁵⁹

Parimi i sigurisë juridike është konsideruar i cenuar nga GJEDNJ edhe në rastet kur për arsye të ndryshme (organizative ose jo) organi kompetent (gjykata) nuk ka qenë në gjendje të dalë me një vendim përfundimtar për zgjidhjen e konfliktit gjyqësor. Kështu, në çështjen *Marini k. Shqipërisë*, ajo deklaroi se *"mosmarrja e një vendimi përfundimtar nga GJK shqiptare në çështjen konkrete për shkak të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë midis gjyqtarëve, nuk i shërben sigurisë juridike dhe privon kërkuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar mbi kërkesën e tij drejtuar GJK"*.⁴⁶⁰

Do të ndalem vetëm tek një çështje, e cila është ende në proces shqyrtimi para gjykatave shqiptare, konkretisht në GJL. Në çështjen *Xheraj k. Shqipërisë*, kërkuesi pretendonte se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse, megjithëse ai ishte shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, gjykata kishte vendosur, jashtë afateve ligjore për këtë qëllim dhe tej shkaqeve, rihapjen e procesit me kërkesë të prokurorit. Përveç kësaj, kërkuesi nuk kishte qenë prezent gjatë gjykimit duke e vendosur atë në pozita të pabarabarta me akuzën. Më parë, kërkuesi kishte vënë në lëvizje edhe GJK (si kusht për ezaurimin e mjeteve të brendshme juridike), e cila, mbi ankimin e kërkuesit, vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës

⁴⁵⁹ Çështja *Xheraj k. Shqipërisë*, 28 korrik 2008.

⁴⁶⁰ Vendim i GJEDNJ, 18 dhjetor 2007.

si jashtë juridiksionit.⁴⁶¹ GJEDNJ, kur mori në shqyrtim kërkesën e tij, ritheksoi edhe një herë qëndrimin e saj se *"ankimi në GJK mund të konsiderohet si mjet efektiv që duhet të përdoret për qëllimet e nenit 35 të KEDNJ, kur ngrihen çështje që lidhen me një proces të rregullt ligjor"*.⁴⁶²

Pas dhënies së këtij vendimi të GJEDNJ në favor të kërkuarit, lindi detyrimi i shtetit shqiptar, konkretisht i gjykatave shqiptare, për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar të kërkuarit nga një proces i parregullt duke anuluar vendimin e dytë që e shpallte atë fajtor, pasi gjatë atij procesi nuk ishin respektuar të drejtat për proces të rregullt ligjor, konkretisht njoftimi i të pandehurit për rihapjen e procesit dhe e drejta e tij për të qenë i pranishëm dhe për t'u mbrojtur. GJL refuzoi të rishqyrtonte çështjen me argumentin se KPP nuk parashikon si shkak për rihapjen e procesit penal dhënien e një vendimi nga GJEDNJ dhe vendosi mospranimin e rekursit. Kërkuari, në kushtet e refuzimit nga GJL për të zbatuar vendimin e GJEDNJ, iu drejtuar GJK, e cila deklaroi se *"...respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore... roli i një gjykate të lartë në një palë kontraktuese është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria. Në fakt në çështjen në shqyrtim vetë Gjykata e Lartë u bë burimi i pasigurisë duke minuar besimin publik te sistemi ligjor dhe shteti i së drejtës"*.⁴⁶³

Gjykata çmon se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij Kodi por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ... Interpretimi i Gjykatës së Lartë se vendimet e GJEDNJ nuk janë të barasvlershme me vendimet

⁴⁶¹ Vendim moskalimi në seancë i Kolegjit të GJK, datë 26 prill 2002.

⁴⁶² Çështja *Xheraj k. Shqipërisë*, si dhe vendimet e mëparshme të cituara po në këtë vendim *Balliu k. Shqipërisë, Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*.

⁴⁶³ Çështja *Mullai k. Shqipërisë*, 23 mars 2010, cituar në vendimin e GJK.

e gjykatave shqiptare bie në kundërshtim edhe me nenin 10 të KPP, i cili parashikon se marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si edhe dispozitat e këtij Kodi. Duke pasur parasysh, veç të tjerave, edhe dispozitën e sipërpërmendur, Gjykata çmon se për sa i përket institutit të rishikimit nuk mund të pretendohet se vendimet, të cilave u referohet neni 450/1/a, janë vetëm ato të dhëna nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, pasi neni 10 i KPP në mënyrë eksplicite detyron gjykatat që të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

... Mospranimi i kërkesës për rishikim të vendimeve nga ana e Kolegjit Penal, në kushtet kur një vendim i Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si organin e përshtatshëm për korrigjimin e pasojave që kanë ardhur nga shfuqizimi i vendimit nr. 4/60, datë 14.12.1998 të Gjykatës së Apelit të Durrësit, ngre, gjithashtu, probleme në lidhje me cenimin e fuqisë detyruese që kanë vendimet e Gjykatës. Në jurisprudencën e saj kjo Gjykate ka vlerësuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Gjykata rithekson se rreziku i një shtete të tillë qëndron jo vetëm në faktin se një individ i caktuar i cenohet e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por edhe për faktin se preket vetë thelbi i funksionimit të shtetit të së drejtës, duke qenë se njëri prej pushteteve tejkalon pikërisht ato caqe që kushtetutbërësi i konsideron si të padhunueshme dhe në mbrojtje të të cilave ka parashikuar një organ të posaçëm siç është Gjykata Kushtetuese...Në rastin konkret dhunimi i të drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga Kushtetuta, vjen pa ligj dhe, për më keq nga një organ i lartë gjyqësor, i cili, veç të tjerash, me qëndrime të kësaj natyre shton pasojat e dëmshme të një procesi tashmë të deklaruar joligjor si nga GJEDNJ ashtu dhe nga kjo Gjykatë edhe me elemente të tjerë, siç janë zvarritjet e paarsyeshme në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi nr. 00-2010-1042, datë 09.07.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të kësaj gjykate, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ dhe, si i tillë, duhet shfuqizuar...”.⁴⁶⁴

4.2 Propozime për përmirësim

Një nga çështjet e fundit që ka ngjallur debate është edhe ajo lidhur me rastet kur GJEDNJ konstaton se shkeljet vijnë nga legjislativi jo në përputhje me KEDNJ ose zbatim i gabuar i saj nga gjykatat dhe se e vetmja rrugë për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur të individit është rihapja e procesit gjyqësor naga gjykatat vendase. Ndërhyrja në ligjet procedurale përkatëse është bërë deri tani nga legjislativi shqiptar vetëm sa i takon KPC. Mbetet ende i përcaktuar parashikimi i të njëjtit rregull edhe për çështjet e natyrës penale. Megjithatë, në mungesë të rregullimit të ri përkatës, kjo mangësi është plotësuar (të paktën për momentin) nga praktika e GJK, e cila para disa muajsh, me vendim detyroi GJL të rimerrte në shqyrtim një çështje penale për ta deklaruar të gjykuarin të pafajshëm, në zbatim të vendimit të GJEDNJ lidhur me të.⁴⁶⁵

⁴⁶⁴ Vendim i GJK nr.20/2011. Shih gjithashtu edhe mendimin e pakicës në këtë vendim, e cila shpreh idenë e shfuqizimit të të dyja vendimeve të GJL (të dënimit të kërkuarit dhe atë të mospranimit për shqyrtim pas marrjes së vendimit nga GJEDNJ dhe GJK) si e vetmja mënyrë për të vendosur të drejtën e individit në vend.

⁴⁶⁵ Shih për më tepër vendimin e GJK nr.20/2011.

ARTA VORPSI

IV. PËRFUNDIME

Të pretendosh analizën e hollësishme të një veprimtarie gati 20-vjeçare të një institucioni kushtetues të posaçëm siç është GJK, nuk është një ndërmarrje e lehtë. Së pari është përgjegjësi e madhe, pasi për të bërë një analizë sa më objektive duhen mbajtur parasysh shumë faktorë si p.sh: faktorët socialo-ekonomik të një vendi, faktorët historikë të zhvillimit të së drejtës, faktorë që lidhen me formimin profesional (por jo vetëm) të gjyqtarëve në një periudhë të caktuar, faktorë që ndikojnë në përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe njëkohësisht në ushtrimin e detyrës prej tyre në pavarësi dhe përgjegjësi të plotë. Megjithatë, duke qenë se analiza të tilla kanë qenë gjithmonë të fokusuar në elementë të veçantë të praktikës së GJK shqiptare lidhur me një nga kompetencat më të gjera dhe më të përdorura të saj, ky botim modest ka si qëllim pikërisht evidentimin e ecures së jurisprudencës së GJK gjatë 20 viteve të funksionimit të saj lidhur me procesin e rregullt ligjor. Këtu nuk janë përfshirë të gjitha vendimet e GJK, jo për arsye se ato nuk paraqesin rëndësi. Çdo vendim në vetëvete ka interes për zhvillimin e doktrinës kushtetuese edhe në ato raste kur ai nuk sjell ndonjë të re por i shërben vazhdimësisë së jurisprudencës. Lënia jashtë e tyre ka qenë thjesht për efekt të mospërsëritjes së qëndrimit të GJK duke prezumuar se ato të prezantuara janë të mjaftueshme për të krijuar idenë mbi linjën e ndjekur nga GJK në vite.

Në përfundim të kësaj paraqitje të elementëve të procesit të rregullt ligjor sipas praktikës së GJK mund të thuhet me bindje të plotë se GJK ka patur një rritje të konsiderueshme profesionale sa i takon mënyrës së interpretimit në vite të kompetencave të saj si dhe të mbrojtjes

së të drejtave të individit në rrugën e ankimit individual kushtetues. Kjo rritje, megjithëse graduale, ka qenë ritmike duke u munduar jo vetëm të mos stonojë me ecurinë e vazhdueshme të praktikës së GJEDNJ ose të gjykatave të tjera homologe, por në ndonjë rast edhe t'í paraprijë atyre. Kjo ka sjellë dhe një harmonizim të praktikës së vetë GJK shqiptare, e cila, në raste të rralla ka shënuar shmangie nga praktika e saj e mëparshme. Në rastet kur ka ndodhur, ajo në disa prej tyre ka dhënë shpjegime për arsyet e këtij ndryshimi, të cilat kanë qenë në funksion të një mbrojtje më të mirë të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Nisur nga prezantimi i mësipërm lind natyrshëm pyetja: Si mund të jetë e ardhmja e hapësirës së GJK kur shqyrton kërkesat që lidhen me procesin e rregullt ligjor? Personalisht, mendoj se duke u nisur edhe nga tendenca e GJK për të zgjeruar praktikisht kuptimin e procesit të rregullt ligjor, e ardhmja duhet të shkojë drejt njësimi me përmbajtjen e të njëjtit parim nga KEDNJ, pra një interpretimi edhe më të zgjeruar për të përfshirë edhe të drejta të tjera që parashikohen në Kushtetutën shqiptare. Ky kontroll i GJK duhet të përfshijë jo vetëm vendimet gjyqësore por edhe aktet normative të organeve të pushtetit publik të kundërshtuara nga individit. Një gjë e tillë është e mundur. Argumenti për këtë duhet të kërkohet midis dispozitave të Kushtetutës sonë. Një mundësi i tillë mund të rrjedhë nga vetë përmbajtja dhe kuptimi i nenit 15/2 të Kushtetutës, sipas të cilit, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Në nenin 124 është përcaktuar si detyrë e GJK respektimi i Kushtetutës. Mbi këtë bazë është miratuar edhe neni 131 dhe 134 që përcakton procedurën dhe personat që legjitimohen të nisin një proces të kontrollit kushtetues. Duke qenë se këto dispozita janë përfshirë me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, atëherë në këtë kuadër duhet parë edhe fakti se ligjet që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut gjatë zbatimit të tyre, duhet t'í nënshtrohen kontrollit të GJK.

Natyrisht Kushtetuta, nëpërmjet neneve 131, 134, 145/2, ua jep këtë mundësi në rradhë të parë gjyqtarëve, që, nëse ndodhen para zbatimit të tij gjatë një konflikti gjyqësor, të ushtrojnë kontrollin e

kushtetutshmërisë dhe të inicojnë një procedurë kontrolli para GJK. Por kjo varet tërësisht nga fakti se sa të ndërgjegjshëm dhe profesional janë gjyqtarët e sistemit të zakonshëm gjyqësor, sa seriozisht e marrin ata këtë funksion. Të kontrollosh kushtetutshmërinë e akteve gjatë një procesi të zakonshëm gjyqësor është shumë më e rëndësishme nga pikëpamja e parimeve të shtetit të së drejtës sesa të zgjidhësh një konflikt duke zbatuar të drejtën procedurale dhe materiale. Nëse duam të gjejmë një mundësi për t'i hapur rrugën atakimit të akteve normative para GJK shqiptare, mund ta bëjmë duke interpretuar dispozitat përkatëse në këtë mënyrë: nëse konstatohet se të drejtat themelore të individit janë cenuar dhe shkak për këtë është ligji mbi të cilin është bazuar akti dhe instanca më e lartë e kontrollit gjyqësor nuk është shprehur për këtë çështje, atëherë këtë mund ta bëjë GJK. Nëse GJK nuk do ta bënte këtë, s'do të arrinte gjë tjetër vetëm sa do të shtynte procedurat, pasi gjykata e zakonshme, vendimi i së cilës do të shfuqizohet nga GJK, do të fillonte një procedurë të kontrollit konkret duke e sjellë vetë çështjen para GJK. Gjithsesi, këto janë thjesht disa refleksione mbi mënyrën se si GJK mund të rrisë aktivizmin e saj në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit pa patur nevojë të presë ndryshimin ose riformulimin e vullnetit politik për këtë qëllim.

Në përfundim, mund të thuhet se rruga nëpër të cilën ka kaluar elaborimi i elementëve të procesit të rregullt ligjor është lehtësisht e identifikueshme në vendimet e GJK, prandaj nuk mbetet shumë për të komentuar përveçse për të theksuar edhe një herë vlerësimin për punën e saj dhe dëshirën e shpresën legjitime për të shkuar më tej, duke mbajtur parasysh standartet e arritura deri sot.

Tiranë, 2011.

V. Pasqyrë statistikore mbi vendimmarrjen e GJK 1999-2010⁴⁶⁶

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Vendime të dhëna gjithsej	67	96	213	243	279	210	256	251	222	200	136	143
Lloji i vendimit												
Vendime të seancës	24	30	93	46	39	20	41	30	45	29	32	38 ⁴⁶⁷
Vendime moskallimi	43	66	114	197	240	190	215	221	177	171	104	105
Rezultati i kontrollit												
Rrëzim kërkesë	16	15	53	21	21	12	16	11	23	13	17	12
Pranim	8	14	40	18	15	8	23	15	22	12	13	19
Interpretim	0	8	2	3	1	0	1	2	0	1	1	0
Refuzim	0	1	0	4	0	0	1	0	0	0	0	0
Pushim	0	0	6	0	2	0	0	2	0	1	1	1
Subjektet kërkuese												
Presidenti i RSH	0	1	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0
Kryeministri	1	0	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0
1/5 e deputetëve	0	4	0	2	1	1	0	2	2	1	2	1
Kryetari i KLSH	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0
Gjykata	4	2	0	3	5	2	2	1	4	3	2	5
Avokati i Popullit	0	1	2	0	1	1	0	0	1	0	0	4
Organe të pusht.vendor	3	7	9	1	0	0	0	1	0	0	1	1
Bashkësi fetare	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Parti politike, organizata	2	12	28	17	5	3	5	3	4	7	5	10
Individë, shoqëri	57	67	170	215 ⁴⁶⁸	27	12	33	23	30	17	22	13

⁴⁶⁶ Statistikat janë hartuar nga Drejtoria e Studimeve, Botimeve dhe Kërtimeve pranë GJK.

⁴⁶⁷ Në numrin e përgjithshëm të vendimeve në këtë vit duhet të llogariten edhe 6 vendime për deklarimin e përfundimit të mandatit të 6 anëtarëve të GJK.

⁴⁶⁸ Deri në këtë vit për efekt të numrit të përgjithshëm të vendimeve janë llogaritur edhe vendimet e kolegjeve për moskallimin e çështjes në seancë. Më pas, vendimet e kolegjeve regjistrohen në regjistër më vete dhe marrin numër të veçantë nga Drejtoria e Administratës Gjyqësore pranë GJK.

VI. Lista e shkurtimeve

BVerfGE	Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane
DKK	Dispozitat Kryesore Kushtetuese
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJKF	Gjykata Kushtetuese Federale
GJL	Gjykata e Lartë
GJEDNJ	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KPC	Kodi i Procedurës Civile
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KP	Kodi Penal
KC	Kodi Civil
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
EMRK KEDNJ	Europäische Menschenrechtskonvention (gjerm) -

VII. Bibliografia

1. Literaturë

Andreas Vosskuhle, në: von Mangold/Klein/Starck, Das Bonner Grundgesetzkommentar (2001).

Andreas Kley-Struller, Art.6 EMRK als Rechtsschutzgarantie gegen die oeffentliche Gewalt (1993).

Arta Vorpsi (Palushi), Rechtsstaat und Verfassungsgericht-Disertacion (2001).

Arta Vorpsi, Ankimi individual para GJK shqiptare – Mjet juridik efektiv? Referat mbajtur në konferencën shkencore “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të një procesi të rregullt ligjor” organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë Tiranë.

Arta Vorpsi, Barazia para ligjit në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, botuar në revistën Jeta Juridike, Nr.1/2003.

Christian Stark, Verfassungsgerichtsbarkeit und Fachgerichte, JZ (1996).

Claire Ovey, RobinWhite, European Convention on Human Rights (2006).

Denar Biba, Ne bis in idem, në: Jeta Juridike (2005).

Edward Rubin, Due Process and the Administrative State, 72 California Law Review 1044 (1984).

Erwin Chemerinsky, Constitutional Law, Principles and Policies (2006).

Felix Ermacora, Der Verfassungsgerichtshof (1956).

Frowein/Peukert, EMRK-Kommentar, (1996).

Georg Brunner, Der Zugang des Einzelnen zur Verfassungsgerichtsbarkeit im europaeischen Raum (2001).

Georg Brunner, Die neue Verfassungsgerichtsbarkeit in Osteuropa në: Zeitschrift fuer Auslaendisches Oeffentliches Recht und Voelkerrecht des Max Planck Institutes (1998).

Hans Kelsen, Wesen und Entwicklung der Staatsgerichtsbarkeit (1928, e ribotuar).

- Joanne Banker Hames/Yvonne Ekern*, Constitutional Law, Principles and Practice (2005).
- Karin Grasshof*, Die Annahmefaeigkeit und Zulaessigkeit der Verfassungsbeschwerde eines Einzelnen Buergers in Deutschland në: Seminarin e organizuar nga GJK shqiptare dhe Fondacioni gjerman IRZ me temë "Përzgjedhja e kërkesave individuale nga GJK" (2005).
- Karl Schrameyer*, Das makedonische Verfassungsgericht në: WGO-MfOR (1997).
- Karl/Miehsler*, Internationaler Kommentar zur EMRK (1995).
- Klaus Stern*, Allgemeine Lehre der Grundrechte (1988).
- Klaus Stern*, Das Staatsrecht der Bundesrepublik Deutschland, Band 2 (1994).
- Kristaq Traja*, "Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës shqiptare", referat i mbajtur me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, botuar në: "10-vjet Gjykatë Kushtetuese" – Buletin i Posaçëm, Botim i Gjykatës Kushtetuese (2003).
- Kristaq Traja*, Karakteristikat e sistemit të të drejtave themelore, në: Tribuna Juridike Nr.47 (2004).
- Ledi Bianku*, Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut (2005).
- Lothar Michael/Martin Morlok*, Grundrechte (2010).
- Luan Omari/Aurela Anastasi*, E drejta kushtetuese (2008).
- Manfred Nowak*, Pakti i OKB për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolli Fakultativ – Komentar (1989).
- Marek Antoni Nowicki*, Rreth Konventës Europiane (2003).
- Michael Kleine-Cosack*, Verfassungsbeschwerden und Menschenrechtsbeschwerde (2001).
- Michael Tonne*, Effektiver Rechtsschutz durcht staatliche Gerichte als Foerderung des Europaeischen Gemeinschaftsrecht (1997).
- Otto Luchterhandt/Christian Starck/Albrecht Weber*, Verfassungsgerichtsbarkeit in Mittel- und Osteuropa (2007).
- Paul Kirchhof*, Die Aufgaben des Bundesverfassungsgerichts in Zeiten der Umbruch në: NJW 1996.
- Peter Habaerle*, Bundesverfassungsgericht in der Krise? Në: Das Bundesverfassungsgericht zwischen Recht und Politik (1996).
- Sokol Sadushi*, Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, referuar në seminarin e organizuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Kushtetuese.
- Sokol Sadushi*, Kontrolli kushtetues (2004).
- Umbach/Clemens*, Grundgesetz-Mitarbeiterkommentar (2002).
- Walter Haller*, Schweizerischer Bundesgerichtshof als Verfassungsgericht (1989).

- Walter/Mayer*, Bundesverfassungsrecht (2000).
Werner Heun/Christian Starck, Verfassungsgerichtsbarkeit im Rechtsvergleich (2006).
William van Alstyne, Cracks in the New Property: Adjudicative Due Process in the Administrative State, 62 Cornell Law Review 445 (1977).
Winfried Brugger, Grundrechte und Verfassungsgerichtsbarkeit in den Vereingiten Staaten von Amerika (1997).
Xhezair Zaganjori/Aurela Anastasi/Eralda Methasani (Cani), Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (2010).

2. Praktikë e GJK shqiptare

Vitet 1992-1998

- Vendim i GJK nr.2/1992
Vendim i GJK nr.3/1992
Vendim i GJK nr.5/1992
Vendim i GJK nr.6/1992
Vendim i GJK nr.10/1992
Vendim i GJK nr.11/1992
Vendim i GJK nr.4/1994
Vendim i GJK nr.8/1994
Vendim i GJK nr.9/1995
Vendim i GJK nr.4/1993
Vendim i GJK nr.11/1993
Vendimi i GJK nr.3/1994
Vendim i GJK nr.8/1994
Vendim i GJK nr.11/1995
Vendim i GJK nr.1/1996
Vendim i GJK nr.4/1997
Vendim i GJK nr. 5/1997
Vendim i GJK nr.8/1994
Vendim i GJK nr.11/1997
Vendim i GJK nr.13/1997
Vendim i GJK nr.20/1997
Vendim i GJK nr.43/1997
Vendim i GJK nr. 45/1997
Vendim i GJK nr.7/1998
Vendim i GJK nr.25/1998
Vendim i GJK nr. 30/1998

Vendim i GJK nr.31/1998
Vendim i GJK nr.34/1998
Vendim i GJK nr.40/1998
Vendim i GJK nr.48/1998
Vendim i GJK nr.71/1998
Vendim i GJK nr.76/1998

Vitet 1998-2011

Vendim i GJK nr.7/2000
Vendim i GJK nr.12/2000
Vendim i GJK nr.17/2000
Vendim i GJK nr.18/2000
Vendim i GJK nr.48/2000
Vendim i GJK nr.77/2000

Vendim i GJK nr.5/2001
Vendim i GJK nr.53/2001
Vendim i GJK nr.95/2001
Vendim i GJK nr.106/2001
Vendim i GJK nr.160/2001
Vendim i GJK nr.161/2001
Vendim i GJK nr.185/2001
Vendim i GJK nr.198/2001
Vendim i GJK nr.205/2001
Vendim i GJK nr.207/2001
Vendim i GJK nr.210/2001

Vendim i GJK nr.22/2002
Vendim i GJK nr.76/2002
Vendim i GJK nr.166/2002
Vendim i GJK nr.231/2002

Vendim i GJK nr.8/2003
Vendim i GJK nr.9/2003
Vendim i GJK nr.10/2003
Vendim i GJK nr.16/2003
Vendim i GJK nr.15/2003
Vendim i GJK nr.17/2003
Vendim i GJK nr.19/2003
Vendim i GJK nr.25/2003

Vendim i GJK nr.38/2003

Vendim i GJK nr.39/2003

Vendim i GJK nr.8/2004

Vendim i GJK nr. 9/2004

Vendim i GJK nr.4/2005

Vendim i GJK nr.5/2005

Vendim i GJK nr.7/2005

Vendim i GJK nr.9/2005

Vendim i GJK nr.11/2005

Vendim i GJK nr.12/2005

Vendim i GJK nr.13/2005

Vendim i GJK nr.14/2005

Vendim i GJK nr.15/2005

Vendim i GJK nr.17/2005

Vendim i GJK nr.21/2005

Vendim i GJK nr.22/2005

Vendim i GJK nr.23/2005

Vendim i GJK nr.24/2005

Vendim i GJK nr.25/2005

Vendim i GJK nr.28/2005

Vendim i GJK nr.29/2005

Vendim i GJK nr.31/2005

Vendim i GJK nr.41/2005

Vendim i GJK nr.1/2006

Vendim i GJK nr.5/2006

Vendim i GJK nr.6/2006

Vendim i GJK nr.8/2006

Vendim i GJK nr.9/2006

Vendim i GJK nr.13/2006

Vendim i GJK nr.16/2006

Vendim i GJK nr.19/2006

Vendim i GJK nr.21/2006

Vendim i GJK nr.22/2006

Vendim i GJK nr.29/2006

Vendim i GJK nr.1/2007

Vendim i GJK nr.5/2007

Vendim i GJK nr.7/2007

Vendim i GJK nr.9/2007

Vendim i GJK nr.10/2007
Vendim i GJK nr.12/2007
Vendim i GJK nr.14/2007
Vendim i GJK nr.15/2007
Vendim i GJK nr.17/2007
Vendim i GJK nr.18/2007
Vendim i GJK nr.23/2007
Vendim i GJK nr.24/2007
Vendim i GJK nr.26/2007
Vendim i GJK nr.27/2007
Vendim i GJK nr.29/2007
Vendim i GJK nr.37/2007
Vendim i GJK nr.38/2007
Vendim i GJK nr.42/2007
Vendim i GJK nr.43/2007

Vendim i GJK nr.1/2008
Vendim i GJK nr.4/2008
Vendim i GJK nr.5/2008
Vendim i GJK nr.8/2008
Vendim i GJK nr.11/2008
Vendim i GJK nr.13/2008
Vendim i GJK nr.19/2008
Vendim i GJK nr.20/2008
Vendim i GJK nr.21/2008
Vendim i GJK nr.23/2008
Vendim i GJK nr.24/2008
Vendim i GJK nr.26/2008
Vendim i GJK nr.28/2008

Vendim i GJK nr.1/2009
Vendim i GJK nr.5/2009
Vendim i GJK nr.6/2009
Vendim i GJK nr.7/2009
Vendim i GJK nr.10/2009
Vendim i GJK nr.11/2009
Vendim i GJK nr.14/2009
Vendim i GJK nr.16/2009
Vendim i GJK nr.17/2009
Vendim i GJK nr.18/2009
Vendim i GJK nr.26/2009
Vendim i GJK nr.27/2009

Vendim i GJK nr.28/2009
Vendim i GJK nr.30/2009
Vendim i GJK nr.32/2009

Vendim i GJK nr.1/2010
Vendim i GJK nr.6/2010
Vendim i GJK nr.8/2010
Vendim i GJK nr.12/2010
Vendim i GJK nr.13/2010
Vendim i GJK nr.23/2010
Vendim i GJK nr.30/2010
Vendim i GJK nr.35/2010
Vendim i GJK nr.36/2010
Vendim i GJK nr. 37/2010

Vendim i GJK nr.1/2010
Vendim i GJK nr.6/2010
Vendim i GJK nr.8/2010
Vendim i GJK nr.13/2010
Vendim i GJK nr.14/2010
Vendim i GJK nr.20/2010
Vendim i GJK nr.21/2010
Vendim i GJK nr.28/2011
Vendim i GJK nr.35/2010
Vendim i GJK nr.38/2010

Vendim i GJK nr.2/2011
Vendim i GJK nr.5/2011
Vendim i GJK nr.6/2011
Vendim i GJK nr.9/2011
Vendim i GJK nr.10/2011
Vendim i GJK nr.12/2011
Vendim i GJK nr.16/2011
Vendim i GJK nr.20/2011
Vendim i GJK nr.21/2011
Vendim i GJK nr.22/2011
Vendim i GJK nr.25/2011
Vendim i GJK nr.26/2011

3. Praktikë e GJKF gjermane

BVerfGE 6,32 (36)
BverfGE 45, 63 (74); 33, 247 (259)
BverfGE 7, 198
BVerfGE 3, 383
BverfGE 21, 362 (373)
2BvR 452/01
BVerfGE 35, 311, 320
BVerfGE 74, 358
BVerfGE 42, 312
BVerfGE 70, 138
BVerfGE 67, 90, 94
BverfGE 23, 191
1 BvR 864/03
1 PbvU 30.04.2003
BVerfGE 49, 148
BVerfGE 87, 48

4. Praktikë e GJL të SHBA-së

Solesbee k. Balkcom, 339 U.S. 9 (1950)
Mayer k. Nebraskas, 262 U.S 390, 399 (1923)
Lochner k. New York, 198 U.S 45 (1905)
Roe k. Wades, 410 U.S. 113 (1973)
Murray's Lessee k. Hoboken Land & Improv.Co. 59 U.S. 272 (1856)
Powell k. Alabamës, 287 U.S 45 (1932)
Johnson k. Zerbst, 304 U.S 458 (1938)
Scott k. Illinois, 440 U.S> 367 (1979)
Bram k. United States, 168 U.S. 532 (1987)
Robinson k. Kalifornisë 370 U.S. 660 (1962)
District of Columbia k. Lcawans, 300 U.S. 617 (1937)

5. Praktikë e GJEDNJ

Adkivar k. Turqisë, 16 shtator 1996
Adolf k. Austrisë, 26 mars 1982
Aerts k. Belgjikës, 30 korrik 1998
Airey k. Irlandës, 9 tetor 1979
Akdivar, etj. k. Turqisë, 16 shtator 1996

Albert dhe Le Compte k. Belgjikës, 10 shkurt 1983
Alimena k. Italisë, 19 shkurt 1991
Allenet de Ribemont k. Francës, 10 shkurt 1995
Andronicou dhe Constantinou k. Qipros, 5 korrik 1995
APIS a.s. k. Sllovakisë, 13 janar 2002
Artico k. Italy, datë 13 maj 1980
Axen k. Republikës Federale të Gjermanisë, 8 dhjetor 1983
Bageta k. Italisë, 25 qershor 1998
Balliu k. Shqipërisë, 16 qershor 2005
Bankovic dhe të tjerë k. Belgjikës dhe 16 shtete të tjera anëtare, 19 dhjetor 2001
Barbera, Messegue dhe Jabardo k. Spanjës, 6 dhjetor 1988
Bendenoun k. Francës, 24 janar 1994
Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë, 22 gusht 2006
Brualla Gómez de la Torre k. Spanjës, 19 dhjetor 1997
Bujnita k. Moldavisë, 16 janar 2007
Caka k. Shqipërisë, 8 dhjetor 2009
Cerin k. Kroacisë, 8 mars 2001
Colozza k. Italisë, 12 shkurt 1985
Cravcenko k. Moldavisë, 15 prill 2008
Cuscani k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 24 shtator 2002
Darby k. Spanjës, 23 tetor 1990
Debled k. Belgjikës, 22 shtator 1994
Dehaes dhe Giples k. Belgjikës, 24 shkurt 1997
Delcourt k. Belgjikës, 17 shkurt 1970
Doorson kundër Hollandës, 26 mars 1996
Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 16 dhjetor 1992
Engel k. Hollandës, 8 qershor 1976
Feldbrugge k. Hollandës, datë 29 maj 1985
Fouquet k. Francës, 12 tetor 1994
Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1975
Grobera Radio AG dhe të tjerë k. Zvicrës, 28 mars 1990
Gjonboçari k. Shqipërisë, 31 mars 2008
Gjyli kundër Shqipërisë, 29 shtator 2009
Håkansson dhe Sturesson k. Suedisë, 21 shkurt 1990
Haser k. Zvicrës, 27 prill 2000
Heaney&McGuinness k. Irlandës
Hermi k. Italisë, datë 12 qershor 2006
Holm k. Suedisë, 25 nëntor 1993
Holzinger k. Austrisë, 30 janar 2001
Imbrioscia k. Zvicrës, datë 24 nëntor 1993
Janosevic k. Suedisë, 23 korrik 2002

- Jones k. Anglisë, 9 shtator 2003*
Kimmel k. Italisë, 2 shtator 2004
Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë, 6 shtator 1987
Kostovski k. Holandës, 20 nëntor 1989
Krombach k. Francës, 3 shkurt 2001
Kudla k. Polonisë, 26 tetor 2000
Libert k. Belgjikës, 8 korrik 2004
Lithgow dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe, 8 korrik 1986
Loizidou k. Turqisë, 23 mars 1995
Lutz, Englert dhe Nolckenbockhof k. Gjermanisë, 25 gusht 1987
Marini k. Shqipërisë, 18 dhjetor 2007
Mark Intern Verlag GmbH k. Gjermanisë,
Markass Car Hire Ltd k. Qipros, 23 tetor 2001
Medenica k. Zvicrës, 12 dhjetor 2001
Metaxas k. Greqisë, 27 gusht 2004
Micallef k. Maltës, 15 tetor 2009
Mifsud k. Francës, nr.57220/2000
Monnelli & Morris k. Mbretërisë së Bashkuar, 2 mars 1987
Mullai k. Shqipërisë, 23 mars 2010
Murray k. Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996
National & Provincial Building Society k. Britanisë së Madhe, 23 tetor 1997
Niderhost-Huber k. Zvicrës, 18 shkurt 1997
P.k Zvicrës, 13 mars 1984
P.S. k. Gjermanisë, 4 shtator 2002
Pakelli k. Gjermanisë, 7 maj 1981
Poitrinol k. Francës, 23 nëntor 1993
Quaranta k. Zvicrës, datë 24 maj 1991
Qufaj k. Shqipërisë, 30 mars 2005
R.D. k. Polonisë, 18 dhjetor 2001
Raimondo k. Italisë, 22 shkurt 1994
Ramadhi k. Shqipërisë, 13 nëntor 2007
Ringeisen k. Austrisë, 22 qershor 1972
Romashov k. Ukrainës, 27 korrik 2004
Ruiz-Mateos k. Spanjës, 23 qershor 1993
Saez Maeso k. Spanjës, 9 nëntor 2004
Salabiaku k. Francës, 7 tetor 1988
Saunders k. Mbretërisë së Bashkuar, 17 dhjetor 1996
Schenk k. Zvicrës, 12 korrik 1988
Schouten dhe Meldrum k. Hollandës, 9 dhjetor 1994
Scordino k. Italisë, 29 mars 2006
Sejdovic k. Italisë, 10 nëntor 2004

Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee k. Greqisë, 16 nëntor 2001

Sunday Times k. Britanisë së Madhe, 26 prill 1979

Sutter k. Zvicrës, 22 shkurt 1984

Shvedov k. Rosisë, 20 tetor 2005

Telfner k. Austrisë, 20 mars 2001

Vocaturò k. Italisë, 24 maj 1991

Windisch kundër Austrisë, 27 shtator 1990

Wiot k. Francës, 15 mars 2001

Xheraj k. Shqipërisë, 29 korrik 2008

Z dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe, 10 maj 2001

6. Legjislacion

Kushtetuta shqiptare

Kushtetuta e SHBA-së

Kushtetuta (Ligji Themelor) gjerman

Kushtetuta austriake

Kushtetuta sllovene

Kushtetuta e Bosnje-Hercegovinës

Kushtetuta e Sllovenisë

Kushtetuta e Rumanisë

Kushtetuta e Hungarisë

Kushtetuta e Maltës

Ligji për GJK shqiptare

Ligji për GJKF gjermane

Ligji për GJK sllovene

Ligji për GJK spanjolle

Ligji për GJK austriake

Ligji për GJK rumune

Ligji për GJK sllovake

Ligji për GJK çeke

Ligji për GJK hungareze

Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollat Shtesë të saj

Raportin Shpjegues (Explanatory Report) lidhur me hartimin dhe miratimin e Protokollit 7 të KEDNJ

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike e OKB

VIII.

Indeks alfabetik

A

- Afat
 - kohor (fq.31; 58; 78; 80; 113; 126; 201; 217)
 - i arsyeshëm (fq.61; 142; 205; 217; 221; 223; 228; 243; 248; 253)
- Akt
 - administrativ (fq.24; 60; 111;)
 - individual (fq.27; 29; 36)
- Ankim individual kushtetues (fq.13; 20; 33; 50; 64; 69; 78; 83; 88; 97; 247;
- Arsytimi i vendimit (fq.46; 58; 67; 98; 124; 149; 185; 197; 207; 227; 238)
- Avokat (fq.70; 132; 135; 160; 163; 165; 168; 174; 178; 180; 187; 191; 206;)
- Avokati i Popullit (fq.56)

B

- Barazia
 - e armëve (fq.61; 76; 83; 107; 169; 183; 188; 192; 197; 282)
 - në ligj (fq.67; 85)

D

- Detyrim doganor (fq.128; 209)
- Dëmshpërblim financiar (fq.231; 253; 255)
- Dëshmitar (fq.49; 178; 184; 191)
- Diskriminim (fq.52; 66; 85)
- Doktrinë kushtetuese (fq.17; 34; 79; 90; 112; 202; 261)

E

- E drejta
 - e aksesit në gjykatë (fq.60; 81; 86; 117; 123; 125; 129; 134; 166; 201; 205; 209)
 - e ankimit (fq.61; 75; 86; 119; 128; 133; 136; 140; 175; 183; 199; 204; 209; 212; 243)
 - e pronës (fq.14; 46; 66; 126; 157; 212; 248)
 - e punës (fq.67; 233)
 - për t'u mbrojtur (fq.49; 56; 68; 77; 98; 131; 135; 139; 159; 162; 166; 171; 175; 180)
 - për pension (fq.67; 235)
 - për t'u dëgjuar (fq.76; 82; 117; 123; 131; 137; 153; 159; 171)
 - për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (fq.116; 142; 153; 156)
- Ekzekutim i vendimit gjyqësor (fq.80; 98; 217; 221; 225; 251; 255)

F

- Familjarët e të pandehurit, caktimi i mbrojtësit (fq.162; 175)
- Fuqi prapavepruese (fq.35; 69; 154)

GJ

- Gjë e gjykuar (fq.100; 238; 256)
- Gjobë (fq.129; 212; 217; 224)
- Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (fq.50; 73; 91; 101; 108; 118; 127; 134; 161; 173; 177; 184; 190; 196; 201; 213; 217; 221; 232; 236; 243; 248; 251; 255)
- Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane (fq.16; 19; 28; 31; 35; 40; 80; 83; 90; 106; 112; 202)
- Gjykata e Lartë e SHBA (fq.44; 48)
- Gjykim në mungesë (fq.70; 162; 168; 175; 178; 183; 194;)

H

- Hierarkia e burimeve të së drejtës (fq.20; 220)

I

- (I) pandehur (fq.49; 69; 101; 106; 112; 132; 155; 161; 163; 168; 171; 175; 180)
- Interes publik (fq.60; 162; 211)

J

- Juridiksion
 - gjyqësor (fq.73; 75; 83; 93; 97; 118; 153; 158; 187; 198; 208; 224; 254)
 - kushtetues (fq.72; 90; 94; 97; 100; 219; 224; 250; 257)

K

- Kod
 - Civil (fq.239)
 - Doganor (fq.103; 130)
 - Doganor Komunitar (fq.129)
 - Penal (fq.70; 115)
 - Procedurës Civile (fq.93; 125; 153; 226)
 - i Procedurës Penale (fq.136; 182; 185; 257)
 - Rrugor (fq.210; 213)
- Kolegji Penal i GJL (fq.110; 131; 134; 136; 144; 152; 167; 182; 188; 258)
- Kolegji Civil i GJL (fq.93; 119; 126; 139; 147; 156; 193; 200; 207)
- Kolegjet e Bashkuara të GJL (fq.96; 120; 133; 136; 144; 224; 239)
- Komision(i)
 - i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (fq.157)
 - i Shërbimit Civil (fq.120; 224; 233)
 - parlamentar (hetimor) (fq.110)
- Kompensim (fq.157; 230; 246; 249; 252; 255)
- Konfiskim (fq.215)
- Konflikt (juridiksional) (fq.21; 43)
- Kontroll kushtetues (fq.13; 20; 27; 31; 34; 36; 42; 46; 61; 70; 77; 92; 106; 108; 185; 189; 246; 262)
 - abstrakt (fq.39; 143)
 - incidental (fq.21; 27; 33; 36; 130; 210)
 - konkret (fq.13; 21; 38; 64; 262)
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (fq.50; 58; 74; 101; 124; 134; 161; 178; 204; 210; 220; 244; 248; 253; 259)
- Kufizim
 - i të drejtës (fq.51; 61; 75; 77; 95; 119; 124; 127; 131; 176; 205; 210; 217)
 - proporcional (fq.60; 129; 205; 236)

L

- Legjitimim (fq.78; 83; 86; 91; 123; 183; 217)
- Ligjshmëria (fq. 30; 144; 148; 152; 155)

M

- Marrëveshje ndërkombëtare (fq.20; 111; 220; 258)
- Mbrojtës shih "avokat"
- Mendim pakice (fq.130; 137; 150; 156; 217; 242; 250; 259)
- Mosekzekutim vendimi gjyqësor të formës së prerë – shih "ekzekutim"
- Mosmarrëveshje (fq.41; 51; 119; 124; 131; 157; 173; 211; 238)
- Mungesë

- e nënshkrimit të mbrojtësit (fq.133; 137; 160)
- fondesh (fq.222; 230)

N

- Ndjekje penale (fq.70; 75; 111; 116)
- Ndryshim praktike (fq.10; 152; 163; 177; 234; 236; 254)
- Ne bis in idem (fq.49; 111; 155)

NJ

- Njoftim
 - i të pandehurit (fq.49; 160; 164; 168; 178; 181; 189; 257)
 - i palëve në proces (fq.159; 189; 194)

O

- Organ
 - administrativ (fq.117; 157; 215; 224; 232)
 - gjyqësor (fq.122; 137; 169; 258)

P

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (fq.112)
- Parimi
 - i barazisë para ligjit (shih "barazia")
 - i kontradiktoritetit (fq.138; 167; 183; 188; 192; 201; 243)
 - i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve (fq.37; 65; 141; 157)
 - i paanshmërisë (fq.59; 102; 111; 143; 147; 201; 236)
 - i pavarësisë së gjyqësorit (fq.59; 65; 122; 140; 206)
 - prezumimit të pafajësisë (fq.77; 101; 106; 110)
 - i proporcionalitetit (fq.45; 128; 205; 211)
 - i shtetit të së drejtës (fq.142; 145; 157; 172; 203; 230; 234; 238; 257)
 - i sigurisë juridike (fq.88; 172; 194; 203; 220; 234; 238; 255)
- Pronar (fq.66; 157; 215)

R

- Rekurs (fq.92; 131; 135; 146; 151; 159; 164; 181; 183; 188; 195; 202; 207)
- Rigjykim (fq.90; 101; 113; 145; 160; 194)
- Rishikim vendimi (fq.91; 118; 126; 138; 151; 192; 203; 237; 258)
- Rivendosje në afat (fq.175; 179; 181)

S

- Sigurim shoqëror (fq.66; 236)
- Subjekt kërkues:

PROCESI I RREGULLT LIGJOR

- Individët (fq.79)
- OJF (fq.83)

SH

- Shoqata (fq.55; 80)
- Shpronësim (fq.66; 125; 215)
- Shterim i mjeteve juridike (fq.26; 33; 38; 56; 78; 89; 92; 246; 250)

T

- Titull ekzekutiv (fq.224; 232;)
- Trashëgimtarë (fq.66; 218; 226; 238)

U

- Urdhër ekzekutimi (fq.226)
- Ushtarakë (fq.66; 236)

Z

- Zgjidhje mosmarrëveshje (fq.124; 131; 145; 212; 256;)
- Zyra e Përmbarimit (fq.221)

